

MENAXHIMI I RREZIQEVE FINANCIARE, KUSHT PËR PËRFITUESHMËRINË E BANKAVE TREGTARE NË SHQIPËRI; PERIUDHA 2006-2015

Sokol Ndoka

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Ekonomike, profili Financë, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës Shkencor: **Prof. Dr. Anilda Bozdo**

Numri i fjalëve: 57,999

Tiranë, Qershor 2018

© DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se ky punim është origjinal dhe nuk përmban plagjiaturë. Materiali nuk është prezantuar më parë në këtë institucion apo në ndonjë institucion tjetër të ngjashëm me të. Mënyra e mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave të këtij punimi është plotësisht origjinale dhe objektive.

ABSTRAKT

Ky punim ka në fokus analizën e faktorëve që ndikojnë në përfitueshmërinë e sistemit bankar në Shqipëri gjatë periudhës (2006-2015). Punimi shkon përtej përcaktimit të faktorëve duke u thelluar deri në analizën dhe menaxhimin e tyre. Gjatë këtij studimi evidentohen pesë variabla të rëndësishëm në terma të përfitueshmërisë (ROE), të tilla si rreziku i normës së interesit, rreziku i kredisë, rreziku i kursit të këmbimit, rreziku operacional dhe rreziku i likuiditetit. Nëpërmjet analizës numerike do të studiohet efekti sasior i secilit prej këtyre variablave në përfitueshmërinë (ROE) e bankave tregtare në Shqipëri. Në vijim të studimit pritet që rreziku i kredisë dhe rreziku i likuiditetit të kenë ndikim më të madh në përfitueshmërisë (ROE) e bankave tregtare në Shqipëri, përkundëjt tri variablave tjera të pavaruara, rrezikut të normës së interesit, rrezikut të kursit të këmbimit dhe rrezikut operacional.

Punimi ngrihet mbi bazën e një studimi empirik me të dhëna sekondare, të karakterit sasior. Ky studim jep një kontribut të konsiderueshëm në kuadër të identifikimit të faktorëve që ndikojnë në përfitueshmërinë e sistemit bankar në Shqipëri, si dhe në publikimin e një raporti apo zgjidhjeje shkencore për menaxhimin e rreziqeve financiare në mënyrë sa më eficiente. Rekomandimet e derivuara nga ky punim do t'iu shërbejnë kërkuesve të rinj të fushës akademike dhe profesionale. Po ashtu punimi hap një shteg të ri diskutimi mbi instrumentat dhe menaxhimin e rreziqeve financiare në sistemin bankar Shqiptar.

Fjalë kyçe: Përfitueshmëri (ROE), rreziku i normës së interesit, rreziku i likuiditet, rreziku i kursit të këmbimit, rreziku operacional, rreziku i kredisë.

ABSTRACT

The focus of this reserach is the analysis of the factors affecting the profitability of the Albanian banking system during the period (2006-2015). The study goes over the simply definition of the factors by extending the research to their analysis and management. Five important variables that affect the profitability of commercial banks (ROE) are identified, such as interest rate risk, credit risk, exchange rate risk, operational risk and liquidity risk. The quantitative effect of each variable on the profitability (ROE) of commercial banks in Albania will be study through numerical analysis. It is expected that credit and liquidity risk will have a greater impact on the profitability (ROE) of commercial banks in Albania, compared to the other three independent variables, interest rate risk, exchange rate risk and risk operational.

This research is based on an empirical analysis of quantitative secondary data. The study provides a significant contribution on identifying the factors affecting the profitability of the commercial banks in Albania, as well as publishing a report or scientific solution for managing financial risks in a more efficient way. The recommendations derived from this study will serve to young researchers in the academic and professional field. Also, the study opens a new way of discussion regarding the instruments used and the financial risks management in the Albanian banking system.

Key words: Profitability (ROE), interest rate risk, liquidity risk, exchange rate risk, operational risk, credit risk.

FALENDERIME

Falenderim dhe mirënjohje për udhëheqësen shkencore, Prof. Dr. Anilda Bozdo, e cila me perkushtimin, mendimet, këshillat dhe sugjerimet e vazhdueshme, bëri të mundur që ky punim të merrte formën e duhur dhe të përfundohej me sukses. Ishte privilegj dhe kënaqësi për mua të punoja me një eksperte të tillë për realizimin e këtij punimi.

Falenderim dhe mirënjohje e thellë për kolegët e Departamentit Financë & Ekonomiks, në veçanti Prof. Asoc. Dr. Ermela Kripa për mendimet dhe mbështetjen morale, Prof. Asoc. Dr. Arbi Agalliu, Dr. Teuta Xhindi, Prof. Asoc. Dr. Elvin Meka, MSc. Manjola Islami, MSc. Tatjana Moçka, MSc. Krisdela Kaçani, MSc. Joana Shima, MSc. Grisejda Myslymi, MSc. Megi Kurushi, Dr. Klodjan Rama, Dokt. Altin Zefi, për këshillat dhe rekomandimet e tyre të vyera.

Së fundi, falenderoj përzemërsisht familjen time për mbështetjen. Pa suportin e tyre ky punim nuk do të ishte i mundur.

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I:

HYRJE.....	1
1.1 Parathënie.....	1
1.2 Shtrimi i problemit.....	3
1.3 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë.....	7
1.4 Debati aktual mbi problematikën e zgjedhur.....	7
1.5 Përmbledhje e shkurtër e literaturës, avantazhet dhe kufizimet e saj.....	8
1.6 Përshkrim i shkurtër i metodologjisë dhe metodave të hulumtimit.....	9
1.7 Shpjegim i shkurtër i strukturës së punimit.....	9
1.8 Përmbledhje e kapitullit.....	12

PJESA E PARË:KUADRI TEORIK.....13

KAPITULLI II: TEORITË EKONOMIKE MBI MENAXHIMIN E RREZIQEVE

FINANCIARE.....	13
2.1 Menaxhimi i rreziqeve financiare dhe rëndësia e tyre.....	13
2.2 Teoria e palëve të interesit (Stakeholders).....	17
2.3 Teoria Markowitz vs Teoria Sharpe.....	22
2.4 Teoria e asimetrisë së informacionit në institucionet financiare.....	37
2.5 Teoria e financave të sjelljes.....	44
2.6 Përmbledhje e kapitullit.....	47

KAPITULLI III: KUPTIMI DHE LLOJET E RREZIQEVE FINANCIARE QË NDIKOJNË NË PËRFITUESHMËRINË E BANKAVE TREGTARE.....48

3.1 Menaxhimi i rrezikut dhe performanca e institucioneve financiare.....	48
3.1.1 Performanca financiare.....	49
3.1.2 Depozitat.....	50
3.1.3 Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit.....	52
3.1.4 Raportet e likuiditetit.....	55
3.1.5 Madhësia e bankës.....	57
3.2 Lidhja ndërmjet rreziqeve financiare dhe performancës në bankat tregtare.....	59
3.3 Rreziku i kredisë.....	62
3.3.1 Matja e rrezikut të kredisë.....	64
3.3.2 Modelet e rrezikut të kredisë.....	69
3.3.3 Proceset e menaxhimit të rrezikut të kredisë.....	72

3.3.4	Marrëveshjet e Bazelit për rrezikun e kredisë.....	74
3.4	Rreziku i normës së interesit.....	80
3.4.1	Matja e rrezikut të normës së interesit.....	80
3.4.2	Modelet e rrezikut të normës së interesit.....	83
3.4.3	Proceset e menaxhimit të rrezikut të normës interesit.....	84
3.5	Rreziku i kursit të këmbimit.....	87
3.5.1	Matja e rrezikut të kursit të këmbimit.....	89
3.5.2	Modelet e rrezikut të kursit të këmbimit.....	91
3.5.3	Proceset e menaxhimit të rrezikut të kursit të këmbimit.....	92
3.6	Rreziku operacional.....	94
3.6.1	Matja e rrezikut operacional.....	97
3.6.2	Modelet e rrezikut operacional.....	102
3.6.3	Proceset e menaxhimit të rrezikut operacional.....	103
3.7	Rreziku i likuiditetit.....	106
3.7.1	Matja e rrezikut të likuiditetit.....	109
3.7.2	Modelet e rrezikut të likuiditetit.....	110
3.7.3	Proceset e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.....	110
3.8	Përmbledhje e kapitullit.....	113
	PJESA E DYTË: STUDIMI EMPIRIK.....	114
	KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E KËRKIMIT.....	114
4.1	Shfrytëzimi i kuadrit teorik në funksion të realizimit të studimit empirik.....	114
4.2	Burimet e informacionit.....	117
4.3	Popullata e synuar.....	118
4.4	Metodologjia, metodat dhe instrumentet bazë të hulumtimit.....	118
4.5	Mbledhja e të dhënave dhe përpunimi i tyre.....	118
4.6	Qasja teorike e Modelit Ekonometrik.....	123
4.7	Kufizimet e punimit.....	125
4.8	Përmbledhje e kapitullit.....	126
	KAPITULLI V: ANALIZA E TË DHËNAVE EMPIRIKE.....	127
5.1	Situatë e përgjithshme mbi ecurinë e rreziqeve financiare në sistemin bankar shqiptar.....	127
5.1.1	Rregullore e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, Vendim Nr. 62, datë 14.09.2011.....	129
5.1.2	Rregullore e Bankës së Shqipërisë “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, Vendim Nr.69, datë 18.12.2014.....	144

5.1.3	Rregullore e Bankës së Shqipërisë “Për kapitalin rregullator të bankës”, Vendim Nr.48, datë 31.07.2013.....	150
5.1.4	Analizë e rrezikut të kredisë në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri.....	165
5.1.5	Udhëzimi i Bankës së Shqipërisë “Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës”, Vendim Nr. 33, datë 30.04. 2013.....	169
5.1.6	Analizë e rrezikut të normës së interesit në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri.....	176
5.1.7	Rregullore e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore”, Vendim Nr. 48, datë.14.07.2010.....	179
5.1.8	Analizë e rrezikut të kursit të këmbimit në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri.....	185
5.1.9	Rregullore e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut operacional”, Vendim, Nr. 03, datë 19.01.2011.....	187
5.1.10	Analizë e rrezikut operacional në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri.....	196
5.1.11	Rregullore e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”, Vendim Nr. 71 datë 14.10.2009.....	197
5.1.12	Analizë e rrezikut të likuiditetit në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri.....	208
5.2	Analiza e regresionit, korrelacioni ndërmjet variablave dhe testimi i hipotezave.....	210
5.3	Përmbledhje e kapitullit.....	223
KAPITULLI VI: DISKUTIME, KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....		224
6.1	Konkluzionet e studimit.....	224
6.2	Rekomandimet përkatëse të studimit.....	230
BIBLIOGRAFIA.....		233
ANEKSE.....		241

LISTA E TABELAVE, GRAFIKËVE DHE FIGURAVE

Lista e Tabelave

Tabela Nr. 1 - Kategoritë e palëve të interesit.....	18
Tabela Nr. 2 - Degët kryesore të literaturës së sjelljes	44
Tabela Nr. 3 - Vlerësimi dhe klasifikimi i rrezikut të kredisë.....	68
Tabela Nr. 4 - Peshat e ponderimit sipas intervaleve kohore	175
Tabela Nr. 5 - Ngjarjet e rrezikut operacional që mund të shkaktojnë humbje të rëndësishme	194
Tabela Nr. 6 - Përmbledhje e rezultateve të testit të stacionaritetit.....	215
Tabela Nr. 7 - Përmbledhje e rezultateve të testit të rëndësisë individuale.....	219
Tabela Nr. 8 - Përmbledhje e rezultateve të testit të rëndësisë tërësore dhe shpjegueshmërisë së ROE.....	220
Tabela Nr. 9 - Përmbledhje e rezultateve të supozimeve të modelit.....	223

Lista e Grafikëve

Grafiku Nr. 1 - Mundësitë e investimit.....	30
Grafiku Nr. 2 - Kurbat e indiferencës.....	32
Grafiku Nr. 3 - Modeli Beta-Zero	33
Grafiku Nr. 4 - Numri i bankave që kanë falimentuar në periudhën 1934-2006.....	51
Grafiku Nr. 5 - ROE (në %)......	119
Grafiku Nr. 6 - Rreziku i Kredisë (në %)......	120
Grafiku Nr. 7 - Rreziku i Likuiditetit (në %)......	120
Grafiku Nr. 8 - Rreziku Operacional (në %)......	121
Grafiku Nr. 9 - Rreziku i Normës së Interesit (në %)......	122
Grafiku Nr. 10 - Rreziku i Kursit të Këmbimit (në mln lek)......	122
Grafiku Nr. 11 - Peshat e rreziqeve financiare në sistemin bankar Shqiptar.....	166
Grafiku Nr.12 - Pritjet e bankave për aktivitetin kreditues (majtas) dhe për normat e interesit (djathtas)......	177
Grafiku Nr. 13 -Pritjet për aktivitetin kreditues në valutë dhe lekë.....	186

Lista e Figurave

Figura Nr. 1 - Llogaritja e kapitalit ekonomik nga humbja e një viti e shpërndarë me X % nivel besimi.....	54
Figura Nr. 2 - Kategorizimi i rreziqeve të ballafaquara nga një bankë dhe kërkesa për kapital rregullator.....	54
Figura Nr. 3 - Procesi i menaxhimit të rrezikut të kredisë.....	73
Figura Nr. 4 - Menaxhimi i rrezikut të kursit të këmbimit.....	93
Figura Nr. 5 - Testi i stacionaritetit për serinë ROE.....	241
Figura Nr. 6 - Testi i stacionaritetit për serinë RK (Rreziku i Kredisë).....	241
Figura Nr. 7 - Testi i stacionaritetit për serinë RL (Rreziku i Likuiditetit).....	242
Figura Nr. 8 - Testi i stacionaritetit për serinë RNI (Rreziku i Normës së Interesit)....	243
Figura Nr. 9 - Testi i stacionaritetit për serinë RO (Rreziku Operacional).....	243
Figura Nr. 10 - Testi i stacionaritetit për serinë RKK (Rreziku i Kursit të Këmbimit)...	244
Figura Nr. 11 - Analiza e regresionit të shumëfishtë linear.....	245
Figura Nr. 12 - Supozimi për shpërndarjen normale të mbetjeve.....	246
Figura Nr. 13 - Supozimi për korrelacionin e rendeve të larta.....	246
Figura Nr. 14 - Supozimi për homoskedasticitetin.....	247
Figura Nr. 15 - Supozimi për përshtatshmërinë e formës funksionale.....	248

KAPITULLI I: HYRJE

1.1 Parathënie.

“Risk comes from not knowing what you`re doing.”

Warren Buffett

Në biznesin e sotëm, menaxhimi me sukses i rrezikut përbën një nga faktorët kyç që ndikon pozitivisht në performancën financiare. Në çdo vendim biznesi është e rëndësishme që drejtuesit të balancojnë rrezikun dhe kthimin në mënyrë që të sigurohet një rezultat pozitiv në kompani. Në mënyrë që një kompani të jetë e suksesshme dhe konkurruese në treg, është e rëndësishme të bëhet një menaxhim efektiv i rrezikut të biznesit. Në sektorin bankar menaxhimi i rrezikut merr një rëndësi edhe më të veçantë, pasi për mbrojtjen ndaj dështimit të këtij sistemi janë përgjegjës rregullatorët ekonomikë dhe financiar. Banka, ashtu si çdo biznes tjetër është e ekspozuar ndaj rreziqeve. Rreziqet kryesore financiare që ndikojnë direkt në përfitueshmërinë e bankave tregtare janë: rreziku i kredisë, rreziku i normës së interesit, rreziku operacional, rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i likuiditetit, rreziku i zërave jashtë bilancit etj. Në mënyrë që bankat të shmangen falimentimit duhet të jenë të kujdesshme në menaxhimin me sukses të këtyre rreziqeve, pasi një menaxhim i tillë sjell rezultat pozitiv në pasqyrat financiare të bankave tregtare dhe njëkohësisht një perceptim pozitiv për depozituesit e sistemit bankar.

Menaxhimi i mirëfilltë i rrezikut filloi të studiohej pas Luftës II Botërore. Autorë të ndryshëm ndër vite realizuan analiza vrojtuese rreth historikut, evoluimit, konceptit dhe procesit të menaxhimit të rrezikut, duke arritur në përfundimin se literatura e

menaxhimit të rrezikut ka ndryshuar në natyrë dhe në rëndësi, pasi teoritë për këtë çështje kanë patur një zhvillim të madh.

Para viteve '70 menaxhimi i rrezikut në pjesën më të madhe të korporatave lidhej gjerësisht me blerjen e kontratave të sigurimit për mbulimin e rreziqeve të pastra të tilla si: kontratat e sigurimit për mbrojtjen e individëve dhe kompanive nga humbjet e ndryshme që lidheshin me aksidentet.

Menaxhimi i rrezikut financiar në bankat tregtare ka marrë një vëmendje të madhe gjatë viteve të fundit (Glaum, 2000). Arsyeja se pse këto rreziqe kanë këtë rëndësi, lidhet me faktin se ato ndikojnë në një masë të madhe edhe në operacionet e bizneseve të tjera (Triantis, 2000). Rreziqet financiare mund të jenë të formave të ndryshme. Nga njëra anë kemi rreziqe financiare të jashtme që varen nga ndryshimet e tregjeve financiare dhe nga ana tjetër kemi rreziqe financiare të brendshme, ku vetë kompania është burimi i tyre (Eichhorn, 2004).

Qëllimi kryesor i këtij punimi lidhet me analizën e pesë rreziqeve kryesore financiare (rreziku i kredisë, rreziku i normës së interesit, rreziku operacional, rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i likuiditetit) që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri, gjatë periudhës kohore 2006-2015. Arsyeja se pse studimi fokusohet në pesë rreziqe financiare lidhet me faktin se këto faktorë kanë rolin kryesor në rezultatin financiar të bankave tregtare. Duke qënë se sektori bankar është një ndër sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë së një vendi, natyrshëm një menaxhim me sukses i rreziqeve financiare do të përmirësonte ekonominë kombëtare, duke ndikuar pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin afatgjatë të Shqipërisë.

Institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare si Banka e Shqipërisë,

Shoqata e Bankave, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Banka Botërore, BERZH etj., publikojnë raporte sistematike mbi përfitueshmërinë (ROE) e bankave tregtare në Shqipëri. Por nga ana tjetër, një studim më i thelluar i cili analizon shkaqet e mundshme që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri është i domosdoshëm, pasi ndihmon dhe përmirëson menaxhimin e rreziqeve financiare në të ardhmen, duke nxitur një interes të shumë palëve, qofshin ato aktorë politikë, grupe biznesi, konsumatorë etj.

Disa nga *objektivat* kryesore të këtij punimi janë: Së pari, ky studim synon të analizojë gjendjen aktuale të përfitueshmërisë së bankave tregtare në Shqipëri në raport me rreziqet financiare. Së dyti, synohet që nëpërmjet përdorimit të analizës së regresionit linear të shumëfishtë, të identifikohet shkalla e ndikimit e secilit rrezik financiar në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri gjatë periudhës 2006-2015. Së treti, përmes këtij studimi synohet të ndërgjegjësohen bankat tregtare në Shqipëri, mbi domosdoshmërinë e një menaxhimi të suksesshëm të rreziqeve financiare.

1.2 Shtrimi i problemit.

Pjesa më e madhe e rreziqeve financiare në sistemin bankar kanë të bëjnë me rrezikun e kredisë, rrezikun e likuiditetit, rrezikun e normës së interesit, rrezikun e kursit të këmbimit, rrezikun operacional, mjaftueshmërinë e kapitalit etj. Problemi shtrohet se cili nga keto rreziqe financiare ka patur impaktin më të madh në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri gjatë periudhës 2006-2015 dhe si duhet të menaxhohen këto faktorë në mënyrë që të minimizohen humbjet.

Sipas Bankës së Shqipërisë, rreziku i kredisë përbën 44% të rreziqeve financiare në sistemin bankar shqiptar. Gjatë vitit 2014 raporti vjetor i mbikqyrjes i Bankës së

Shqipërisë tregon se kërkesa e bizneseve dhe familjeve për kredi ka rënë, kjo lidhet edhe me faktin se gjatë kësaj periudhe ka patur një ngadalësim të rritjes ekonomike. Po ashtu nga ana tjetër, bankat kanë ulur ritmin e dhënies së kredisë, duke shtrënguar kushtet e kreditimit në mënyrë që ti shmangen rrezikut të kredisë. Banka e Shqipërisë gjatë kësaj periudhe orientoi bankat tregtare që të shisnin kreditë, në mënyrë që të menaxhonin me sukses portofolin e aktiveve. Kjo politikë e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2013 ndikoi pozitivisht në uljen e nivelit të kredive me probleme në banka. Nisur nga rëndësia e rrezikut të kredisë, bankat tregtare duhet të jenë të kujdesshme në menaxhimin e këtij rreziku, në mënyrë që t'i shmangen një rezultati financiar negativ.

Gjatë vitive 2012-2015, raportet vjetore të mbikqyrjes të Bankës së Shqipërisë treguan një likuiditet të tepërt në bankat tregtare, duke paraqitur një ekspozim relativisht të ulët ndaj këtij rreziku. Treguesit e likuiditetit qëndruan përtej normave të parashikuara nga aktet rregullative në fuqi të Bankës së Shqipërisë. Raporti i aktiveve likuide me detyrimet afatshkurtra në fund të vitit 2014 për sistemin bankar rezultoi me një rritje prej 5.7 pikë përqindjeje, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013. Kjo rritje erdhi si pasojë e ndryshimit të rregulloreve të Bankës së Shqipërisë “Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë” dhe “Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjelltave të riblerjes”, të cilat në një farë mënyre, reflektuan në kriteret e kualifikimit të aktiveve si likuide, duke sjellë një rritje dhe një përmirësim të treguesve të likuiditetit.

Rrezik tjetër, i cili, duhet të merret në konsideratë nga bankat tregtare është rreziku i tregut. Banka e Shqipërisë, sipas një vlerësimi të përgjithshëm mbi rreziqet e tregut, tregon se bankat tregtare në Shqipëri kanë një ekspozim të ulët ndaj këtij rreziku. Në këtë vlerësim është analizuar ekspozimi i bankave ndaj rrezikut të kursit të këmbimit,

rrezikut të normës së interesit, si dhe është llogaritur kapitali i nevojshëm për mbulimin e humbjeve të mundshme nga këto rreziqe. Vlera e ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit matet si diferencë midis aktiveve dhe pasiveve të ndjeshme ndaj normës së interesit, e ndarë sipas shportave të riçmimit. Sipas Bankës së Shqipërisë, diferenca e matur qëndron në nivelin 7-8% të totalit të aktiveve, e cila tregon një ekspozim të vogël të bankave ndaj këtij rreziku. Niveli i ulët i kësaj difference reflekton një strukturë të balancuar të riçmimit të aktiveve dhe pasiveve të sistemit bankar shqiptar. I njëjti ekspozim i ulët i rrezikut të normës së interesit paraqitet edhe në bankat tregtare të marra individualisht.

Po ashtu, një tjetër faktor i cili duhet të merret në konsideratë nga bankat tregtare është edhe rreziku operacional, i cili ka patur një impakt të vogël mbi përfitueshmërinë e bankave tregtare shqiptare. Me rrezik operacional do të kuptojmë humbjet që mund të pësojnë bankat si pasojë e dështimit të proceseve, dështimit të sistemeve të brendshme, si dhe ndikimit të faktorëve të jashtëm. Duke qënë se treguesit e rrezikut operacional janë sasiore dhe indirektë, duhet të bëhet një shqyrtim nga afër i sistemeve, proceseve dhe i procedurave të brendshme të bankave. Cilësia e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit që përdorin bankat, përbën një faktor të rëndësishëm në vlerësimin e rrezikut operacional. Sipas Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2014, bankat tregtare shqiptare kanë përmirësuar programet bazë bankare duke futur versione bashkëkohore. Kjo bëri që këto institucione financiare të ishin më konkurruese në treg. Sipas raportit vjetor të mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2014, vërehet një tendencë rritëse e përfshirjes së drejtimit të lartë në sistemin e administrimit të rrezikut operacional, gjë e cila ka ndikuar pozitivisht në menaxhimin e këtij rreziku.

Po ashtu pjesë e rrezikut operacional është edhe rreziku reputacional. Ky faktor vlerësohet duke u bazuar në identifikimin e atyre elementëve që ndikojnë negativisht në reputacionin e bankës tek publiku. Elementë të tillë si, përdorimi i bankës për pastrim parash, mosrespektimi i kushteve të punës, mungesa e transparencës me klientët etj, janë faktorë të cilët dëmtojnë reputacionin e bankës. Sipas Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 2014, sistemi bankar shqiptar ka përmirësuar ndjeshëm mbikqyrjen në lidhje me parandalimit e pastrimit të parave, duke zbatuar në mënyrë rigoroze ligjin dhe kuadrin rregullativ përkatës. Kjo bëri të mundur parandalimin e ekspozimit të bankave tregtare ndaj rrezikut reputacional. Po ashtu, bankat tregtare shqiptare, si subjekte nën juridiksionin e Bankës së Shqipërisë, kanë patur në mënyrë të vazhdueshme një bashkëpunim maksimal me këtë autoritet.

Mjaftueshmëria e kapitalit është një tjetër element që duhet të merret në konsideratë nga bankat tregtare, në mënyrë që të minimizojnë rreziqet financiare dhe të rrisin performancën në treg. Sipas Banksës së Shqipërisë, në fund të vitit 2014, mjaftueshmëria e kapitalit u vlerësua me 111 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 7.6 miliardë lekësh, ndryshe nga viti 2013 i cili pati një rritje vjetore jo më shumë se 1.5 miliardë lekë. Gjithashtu një komponent me ndikim të madh në rritjen e kapitalit aksioner është fitimi i periudhës në banka, i cili ka patur një rritje të konsiderueshme ndër vite. Ky zhvillim është një tregues pozitiv në mbarëvajtjen e sistemit bankar shqiptar dhe në menaxhimin me sukses të rreziqeve financiare.

1.3 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë.

Më poshtë paraqiten pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë të punimit që do t'iu jepet përgjigje në kapitullin e analizës së të dhënave empirike.

Pyetjet kërkimore:

- 1. Si ndikon rreziku i kredisë në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri ?*
- 2. A ndikon negativisht likuiditeti i tepërt në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri?*

Hipotezat bazë:

- 1. Ndër rreziqet financiare, rreziku i kredise ka ndikimin më të madh në përfitueshmërinë (ROE) e bankave tregtare në Shqipëri.*
- 2. Likuiditeti i tepërt ndikon negativisht në përfitueshmërinë (ROE) e bankave tregtare në Shqipëri.*

Sipas literaturës të marrë në studim, me *rreziqe financiare* do të kuptojmë rrezikun e kredisë, rrezikun e likuiditetit, rrezikun e normës së interesit, rrezikun e kursit të këmbimit dhe rrezikun operacional. Gjithashtu fraza '*ndikimin më të madh*' ka kuptimin e rëndësisë nga pikëpamja statistikore e rrezikut të kredisë.

1.4 Debati aktual mbi problematikën e zgjedhur.

Diskutimi nis që me pyetjen se çfarë quhet rrezik financiar dhe si ndikon ai në përfitueshmërinë (ROE) e bankave tregtare në Shqipëri. Përkufizimet e rrezikut dhe përfitueshmërisë, ashtu siç ndodh me pjesën më të madhe të koncepteve, janë të shumta. Debati kryesor shtrohet se si kanë ndikuar rreziqet financiare gjatë periudhës 2006-2015 në përfitueshmërinë e bankave tregtare shqiptare.

Gjithashtu, debati shtrohet se cili nga rreziqet financiare ka patur impaktin më të

madh në përfitueshmërinë e bankave tregtare shqiptare dhe arsyet pse këto rreziqe kanë këtë ndikim. Një menaxhim i dobët i rreziqeve financiare, bën që bankat tregtare të kenë një performancë të dobët, duke ndikuar në moszhvillimin dhe mospërshtatjen me kërkesat dinamike të tregut dhe konkurrentëve. Debati aktual mbi menaxhimin e rreziqeve financiare lidhet me faktin se si duhet të menaxhohen këto rreziqe, në mënyrë që bankat tregtare të rrisin fitimet e tyre dhe të bëhen me konkuresë në treg duke kontribuar në zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme.

1.5 Përmbledhje e shkurtër e literaturës, avantazhet dhe kufizimet e saj.

Literatura ekzistuese përse i përket menaxhimit të rreziqeve financiare është e gjërë, si në aspektin e shtrirjes në kohë, ashtu edhe në larmishmërinë e saj. Megjithatë, në funksion të qëllimit dhe objektivave të këtij studimi, është shfrytëzuar kryesisht literaturë që trajton perkufizimet e përfitueshmërisë dhe rreziqeve financiare në bankat tregtare. Gjithashtu, rëndësi të veçantë në literaturën e marrë në shqyrtim, zë edhe analiza e faktorëve të brendshëm në sistemin bankar, që nxisin dhe pengojnë menaxhimin me sukses të rreziqeve financiare në bankat tregtare.

Në pjesën më të madhe të literatures trajtohet impakti i pesë rreziqeve kryesore financiare (rreziku i kredisë, rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i likuiditetit, rreziku i normës së interesit dhe rreziku operacional) në përfitueshmërinë (ROE) e bankave tregtare. Kur flasim për rreziqe financiare, i referohemi kryesisht modeleve të rrezikut, proceseve të menaxhimit të rrezikut si dhe mënyrës se si matet rreziku. Gjithashtu, pjesë e rëndësishme e literaturës është edhe marreveshja e Bazelit në lidhje me menaxhimin e rrezikut të kredisë.

Literatura në botë për menaxhimin e rreziqeve financiare në sistemin bankar

është e pasur, duke përfshirë analiza të thelluara teorike dhe raste konkrete studimore. Të dhënat empirike për vendet e zhvilluara, në pjesën më të madhe të rasteve janë të aksesueshme dhe kjo ndikon pozitivisht në realizimin e këtij punimi. Por nga ana tjetër, literatura dhe të dhënat për menaxhimin e rreziqeve financiare në Shqipëri janë të limituara. Në mënyrë të theksuar, kjo vërehet në pamundësinë për të siguruar statistika të plota mbi përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri. Megjithatë, ndoshta kjo mungesë të dhënash dhe studimi, e bën këtë punim më të rëndësishëm dhe më të domosdoshëm për menaxhimin me sukses të rreziqeve financiare në bankat tregtare shqiptare. Pavarësisht rezultateve modeste të studimit, shpresoj që kjo analizë të shërbejë si një bazë për studime empirike më të thelluara në sistemin bankar shqiptar nga studiues të tjerë në të ardhmen.

1.6 Përshkrim i shkurtër i metodologjisë dhe metodave të hulumtimit.

Në këtë studim përfshihen të gjitha bankat tregtare që operojnë në Shqipëri. Të dhënat e këtij punimi janë dytësore dhe seri kohore, të mbledhura gjatë periudhës 2006-2015. Natyra e punimit është hulumtuese dhe analitike. Mbledhja e të dhënave dytësore është realizuar nga pasqyrat kryesore financiare të bankave tregtare shqiptare, më pas këto të dhëna janë përpunur për llogaritjen e indikatorëve (rreziqet financiare) të marrë në studim. Analiza e të dhënave është realizuar përmes programit statistikor EViews6. Ekuacioni i regresionit të shumëfishtë linear i dalë nga ky program statistikor, përbën komponentin kryesor të analizës së rezultateve të këtij studimi për testimin e hipotezave dhe nxjerrjen e konkluzioneve përfundimtare.

1.7 Shpjegim i shkurtër i strukturës së punimit.

Punimi ndahet në gjashtë kapituj, konkretisht kapitulli i parë përbën hyrjen e

punimit, kapitulli i dytë dhe i tretë përbëjnë pjesën e parë të punimit, ndërsa kapitulli i katërt, i pestë dhe i gjashtë përbëjnë pjesën e dytë të punimit. Në pjesën e parë të këtij punimi, bëhet një përmbledhje e kuadrit teorik në lidhje me menaxhimin e rreziqeve në institucionet finansiare (bankat tregtare). Pjesa e dytë e punimit analizon impaktin e rreziqeve finansiare mbi përfitueshmërinë e bankave tregtare shqiptare gjatë periudhës 2006-2015. Rreziqet kryesore finansiare të marra në analizë, si; rreziku i kredisë, rreziku i normës së interesit, rreziku i likuiditetit, rreziku i kursit të këmbimit dhe rreziku operacional, përbëjnë indikatorët kryesorë që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare. Grumbullimi, analizimi dhe interpretimi i të dhënave, përbën bazën e pjesës së dytë të punimit.

Më konkretisht, kapitulli i parë është hyrja e punimit, ku parashtrohen në mënyrë të përmbledhur; parathënia, shtrimi i problemit, pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë, problematika e zgjedhur në lidhje me bankat tregtare shqiptare, qëllimi dhe objektivat e studimit, avantazhet dhe kufizimet e literaturës si dhe një përshkrim i shkurtër i metodologjisë dhe metodave të hulumtimit etj.

Kapitulli i dytë përmbledh dhe shpjegon literaturën në lidhje me temën e marrë në studim. Nisur nga kjo, në këtë kapitull jepen përkufizimet kryesore në lidhje me rrezikun, menaxhimin dhe minimizimin e tij në institucionet finansiare. Teoritë kryesore të trajtuara në këtë punim për menaxhimin e institucioneve finansiare janë: Teoria e palëve të interesit (Stakeholders), teoria Markowitz, teoria Sharpe, teoria e Asimetrisë së informacionit në institucionet finansiare si dhe Teoria e financave të sjelljes.

Kapitulli i tretë shpjegon në mënyrë të detajuar matjen, modelet dhe proceset e rreziqeve kryesore finansiare që ndikojnë në përfitueshmërinë (ROE) e bankave tregtare.

Rreziqet kryesore të marra në studim dhe të trajtuara në këtë kapitull janë: rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit, rreziku i normës së interesit, rreziku i kursit të këmbimit dhe rreziku operacional.

Kapitulli i katërt shpjegon në mënyrë të detajuar metodologjinë e studimit. Në këtë pjesë analizohen burimet e informacionit, instrumentat kërkimorë të përdorur, popullata e synuar, qasja teorike e modelit ekonometrik, mbledhja dhe përpunimi i të dhënave dytësore dhe seri kohore të marra nga pasqyrat kryesore finaciare të bankave tregtare në Shqipëri gjatë periudhës 2006-2015. Në fund të këtij kapitulli analizohen edhe vështirësitë e hasura gjatë mbledhjes së të dhënave në terren.

Kapitulli i pestë jep një panoramë të përgjithshme mbi menaxhimin e rreziqeve finaciare nga bankat tregtare shqiptare, rregulloret e Bankës së Shqipërisë për rreziqet finaciare të marra në studim, si dhe pasqyron në mënyrë të detajuar analizën e rezultateve të studimit. Pjesa më e rëndësishme e këtij kapitulli është analiza e regresionit të shumëfishtë linear, e realizuar nëpërmjet programit statistikor EViews6. Kjo analizë, bën të mundur testimin e hipotezave bazë të ngritura në fillim të studimit.

Kapitulli i gjashtë dhe i fundit fokusohet mbi diskutimin e rezultateve të studimit. Pjesa e parë e këtij kapitulli jep konkluzione të nxjerra nga analiza e regresionit të shumëfishtë linear, në lidhje me impaktin e rreziqeve finaciare mbi përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri. Ndërsa pjesa e dytë e këtij kapitulli jep disa rekomandime të rëndësishme për bankat tregtare në Shqipëri mbi menaxhimin me sukses të rreziqeve finaciare, me synim përmirësimin e përfitueshmërisë dhe rritjen e konkurrencës në të ardhmen. Gjithashtu, në këtë kapitull dalin në pah limitet kryesore të këtij studimi si dhe perspektiva për zgjerimin e tij në të ardhmen.

1.8 Përmbledhje e kapitullit.

Në këtë kapitull u diskutua lidhur me qëllimet dhe objektivat e studimit, problematikën e zgjedhur, pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë, debatin aktual si dhe arsyet pse ky debat përbën rëndësi të veçantë në lidhje me menaxhimin e rreziqeve financiare. Në kapitullin vijues do të diskutohet më në thellësi në lidhje me përkufizimet e menaxhimit të rreziqeve financiare në bankat tregtare si dhe ballafaqimin me kontributet më të fundit të studiuesve dhe shkencës në këtë drejtim.

PJESA E PARË: KUADRI TEORIK

KAPITULLI II: TEORITË EKONOMIKE MBI MENAXHIMIN E RREZIQEVE FINANCIARE

2.1 Menaxhimi i rreziqeve financiare dhe rëndësia e tyre.

Menaxhimi i rrezikut përbën një çështje shumë të rëndësishme në përmirësimin e procesit të vendimarrjes të çdo biznesi. Para viteve '70 menaxhimi i rrezikut në pjesën më të madhe të korporatave lidhej gjerësisht me blerjen e kontratave të sigurimit për mbulimin e rreziqeve të pastra të tilla si: kontratat e sigurimit për mbrojtjen e individëve dhe kompanive nga humbjet e ndryshme që lidheshin me aksidentet. Pra, kryesisht procesi i menaxhimit të rrezikut, më herët, realizohej nga kompanitë e sigurimit. Pas kësaj periudhe procesi i menaxhimit të rrezikut u bë i rëndësishëm edhe në sektorin financiar. Për kompanitë që operojnë në këtë sektor të tilla si bankat, shoqëritë e sigurimit si edhe për kompanitë jo-financiare, u pa e nevojshme të zhvillonin procesin e menaxhimit të rrezikut për shkak të luhatjeve të normës së interesit, kursit të këmbimit, çmimit të aksioneve si edhe çmimeve të të mirave (Commodities). Përpara se të bëhet një rishikim i detajuar i literaturës teorike dhe studimeve empirike, shihet e nevojshme të paraqitet në mënyrë kronologjike se si ka evoluar koncepti i rrezikut dhe menaxhimi i tij.

Menaxhimi i rrezikut filloi të studiohej pas Luftës së Dytë Botërore. Autorë të ndryshëm ndër vite, realizuan kërkime dhe analiza vrojtuese rreth historikut dhe evoluimit të konceptit të rrezikut dhe procesit të menaxhimit të tij, duke arritur në përfundimin se literatura e menaxhimit të rrezikut ka ndryshuar në natyrë dhe në rëndësi.

Sipas Crockford (1982) ndryshimet e sjella nga forcat e jashtme në tregun e sigurimeve dhanë efektin e tyre në zhvillimin e literaturës. Ky studim i bërë nga Crockford përqëndrohet në fushën akademike dhe menaxhimin e rrezikut, duke i kushtuar vëmendje ndryshimeve në botën e jashtme përballë ideve kryesore të literaturës, me synim menaxherët jashtë fushës së sigurimit. Autorët Harrington & Neihaus (2004) në librin e tyre konkludojnë se origjina e teorive moderne në lidhje me rrezikun daton nga viti 1955 deri në vitin 1964. Autorët në këtë libër studiojnë konceptet e rrezikut dhe menaxhimin e tij si proces, duke u fokusuar në modelet e ndryshme të shmangies së rrezikut, si për individët ashtu edhe për korporatat (Harrington & Niehaus, 2004).

Në vitin 1955 Wayne Snider, profesor i sigurimeve në Universitetin Temple, sugjeroi që, meqënëse menaxherët e sigurimeve u përqëndruan vetëm në rreziqet dhe mënyrat për t'i kontrolluar ato, duhet të quheshin menaxherë të rrezikut dhe jo thjeshtë blerës të sigurimeve. Në vitin 1956 autori Russell Gallagher, në shkrimin e tij në Harvard Business Review (Vol. 34), u prezantoi menaxherëve të organizateve termin 'menaxhim rreziku'. Barlow (1993) sugjeroi se termi në lidhje me menaxhimin e rrezikut i takonte drejtuesve të lartë ekzekutivë (CEO-s), pavarësisht se gjatë kësaj periudhe asnjë CEO nuk paraqiti interes.

Snider (1956) vërejti një mungesë literature mbi menaxhimin e rrezikut dhe se asnjë universitet nuk ofronte kurse në këtë drejtim. Më vonë, dy librat e parë akademikë u botuan nga Mehr & Hedges në vitin 1963 dhe Williams & Hems në vitin 1964. Përmbajtja e këtyre librave lidhej me menaxhimin e pastër të rrezikut, duke përjashtuar rrezikun financiar të korporatave. Paralelisht, studiuesit gjatë kësaj periudhe zhvilluan

modele në lidhje me menaxhimin e rrezikut operacional që shkaktohej nga zhvillimi teknologjik. Në ditët e sotme, menaxhimi me sukses i rrezikut operacional përbën një nga proceset më të rëndësishme, i cili ndihmon institucionet financiare në minimizimin e humbjeve (Dionne, 2013).

Mbetet ende e vështirë të japen përkufizime të sakta, të plota dhe konçize për sa i përket menaxhimit të rrezikut. Fillimisht, menaxhimi i rrezikut lidhej me sigurimin e individëve dhe kompanive, me qëllim mbrojtën e tyre nga humbje që mund të shkaktoheshin si pasojë e aksidenteve të ndryshme. Ky përkufizim gjen mbështetje edhe në studimet e Crackford, i cili thekson se rreziku spekulativ dhe rreziku i pastër mund të menaxhohen si dy funksione të ndara të kompanisë, pavarësisht se, theksi i menaxhimit të rrezikut vazhdon të mbetet ende mbi rrezikun e pastër. Sipas Crockford (1982) ajo që duhet pasur parasysh është fakti se menaxhimi i rrezikut si proces lidhet me kontrollin e humbjeve, por nga ana tjetër çdo aspekt i kontrollit të humbjeve si parandalimi i zjarrit, siguria, etj., duhet të trajtohet dhe përkufizohet nëpërmjet një literature specifike.

Menaxhimi i rrezikut, kohët e fundit njihet si funksion i korporatës. Në fillim të viteve 1970, koncepti i menaxhimit mbi rrezikun financiar evoluoi në mënyrë të konsiderueshme. Veçanërisht, menaxhimi i rrezikut u zgjerua në mbulimin e sigurimit të tregut, gjë që nuk konsiderohet si mjet mbrojtës konkurses, por që plotëson disa aktivitete të tjera të menaxhimit të rrezikut. Pas Luftës së II Botërore, kompanitë e mëdha filluan të zhvillonin vetë-sigurimin kundër rreziqeve, i cili mbulonte në mënyrë efektive disa rreziqe të vogla. Vetë-sigurimi mbulon pasojat financiare të një ngjarjeje ose humbjet nga një aksident. Një aktivitet i thjeshtë vetë-sigurimi përfshin krijimin e një rezerve mjaft likuide fondesh për të mbuluar humbjet e mundshme që mund të

rezultojnë nga një aksident ose një luhajtje negative e tregut. Zbutja e rrezikut, tashmë e përdorur shpesh nga kompanitë për reduktimin e pasojave financiare të katastrofave natyrore, është një nga format e vetë-sigurimit.

Revolucioni në menaxhimin e rreziqeve financiare erdhi si pasojë e luhajtjeve të mëdha të kurseve të këmbimit valutor, paqëndrueshmërisë së çmimeve të mallrave dhe katastrofave natyrore në rritje. Historikisht, për t'u mbrojtur nga këto rreziqe financiare, kompanitë përdorin bilancet ose rezervat e likuiditetit. Për të rritur fleksibilitetin ose për të ulur koston e aktiviteteve tradicionale të mbrojtjes, institucionet financiare përdorin derivatet (Erllich & Becker, 1972). Derivatet janë kontrata që mbrojnë mbajtësin nga rreziqe të caktuara. Vlera e tyre varet nga paqëndrueshmëria e legjislacionit, vlera e aseteve ose nga vlera në të cilat bazohen kontratat. Derivatet më të njohura janë: forward, options, futures dhe swaps.

Vendimet financiare në lidhje me menaxhimin e rrezikut, duhet të gjykohen bazuar në efektin e tyre mbi vlefshmërinë e firmës apo të portofolit dhe jo mbi bazën sesa mirë një vendim financiar mbulon një rrezik të caktuar. Ky përkufizim vlen veçanërisht për kompanitë e mëdha, të cilat mund të kanë më pak nevojë për mbrojtje nga rreziqe të ndryshme (përveç rrezikut spekulativ), pasi ato janë në gjendje ta diversifikojnë shumë më lehtë portofolin se kompanitë e vogla.

Menaxhimi i rrezikut financiar, gjatë viteve të fundit ka marrë një vëmendje të madhe (Glaum, 2000). Arsyeja për këtë lidhet me faktin se rreziqet financiare, pavarësisht se nuk janë kompetencë thelbësore e firmave jofinanciare, ndikojnë në një masë të madhe në operacionet e tyre të biznesit (Triantis, 2000). Rreziqet financiare mund të jenë të formave të ndryshme. Nga njëra anë kemi rreziqe financiare të jashtme,

që vijnë si pasojë e ndryshimeve në tregjet financiare dhe nga ana tjetër kemi rreziqe financiare të brendshme, ku vetë kompania është burimi i tyre (Eichhorn, 2004). Rreziku i kredisë, rreziku i normës së interesit, rreziku i kursit të këmbimit, rreziku operacional si dhe rreziku i likuiditetit, përbëjnë faktorët kryesorë që ndikojnë direkt në përfitueshmërinë e bankave tregtare. Nisur nga kjo themi që instucionet financiare duhet të jenë shumë të kujdesshme në menaxhimin e këtyre rreziqeve në mënyrë që të minimizohen humbjet nga aktiviteti i tyre financues.

2.2 Teoria e palëve të interesit (stakeholders).

Sipas Freeman & Reed (1983) palët e interesit ndahen në dy kategori. Grupi i ngushtë i palëve të interesit, që nënkupton:

"... çdo grup apo individ të identifikueshëm në të cilin organizata është e varur për vazhdimësinë e jetës së saj" (Freeman & Reed, 1983).

Grupi i gjerë i palëve të interesit, që nënkupton:

"... çdo grup ose individ të identifikueshëm që mund të ndikojë në arritjen e një objektiv të organizatës ose që ndikohet nga arritja e objektivave të një organizate " (Freeman & Reed, 1983).

Përkufizimet e propozuara nga Freeman (1984) janë të ngjashme me ato të sugjeruara më parë, që theksojnë rëndësinë e çdo individi, grupi apo organizate me pretendime legjitime në firmë. Megjithatë, Freeman ishte autori i cili zhvilloi më tej dallimin ndërmjet grupit të ngushtë dhe të gjerë të palëve të interesit. Pas përkufizimeve të propozuara nga Freeman & Reed (1983) dhe Freeman (1984), autorë të tjerë si, Carroll (1989), Hill & Jones (1992), Clarkson (1994), Donaldson & Preston (1995), paraqitën përkufizime të shumta alternative, që përcaktojnë financuesit, punonjësit,

furnitorët, anëtarët e komunitetit dhe konsumatorët si palë të interesit. Një tipologji tjetër e mëvonshme e identifikimit të grupeve e prezantuar nga Mitchell, Agle & Wood (1997) u ndërtua mbi një dinamikë ku perceptimi menaxherial dhe veçantia e situatës njihen në mënyrë që të udhëzojnë menaxherët mbi prioritetin e palëve të interesit. Tipologjia bazohet në tri attribute të përcaktuara mbi palët e interesit: fuqinë, legjitimitetin dhe urgjencën.

Bazuar në këtë kornizë, u identifikuan shtatë grupe të palëve të interesit (Mitchell, Agle & Wood 1997), të paraqitura në Tabelën Nr. 1. Tri grupet e para janë identifikuar si me më pak ndikim në firmë, pasi posedojnë vetëm një atribut. Ndryshe këto grupe njihen edhe si palë të fshehta. Grupet 4-6 ndikojnë konsiderueshëm nëpërmjet dy attributeve të tyre, ndërsa grupi 7 posedon të gjitha atributet duke u identifikuar si shumë i rëndësishëm dhe me ndikim të lartë.

Tabela Nr. 1 - Kategoritë e palëve të interesit

Kategoria e palëve të interesit	Përshkrimi	Shembuj
Dormant	Posedon pushtet ndërkohë që ka pak ose aspak bashkëveprim me firmën.	Ish-punonjës.
Diskrecional (Discretionary)	Palët e interesit që posedojnë vetëm atributin e legjitimitetit dhe shpesh arrijnë të ndikojnë në firmë.	Hulumtuesit ,institutet, organizatat, etj.
Kërkuesit (Demanding)	Pa fuqi apo legjitimitet, këto palë janë përshkruar si problematikë, jo të rrezikshëm, por që tërheqin vëmendje të përkohshme tek drejtuesit.	Individët e parë në një protestë ose kryengritje.
Dominantët	Përmes fuqisë dhe legjitimitetit	Aksionarët, kreditorët,

	këto palë shpesh përbëjnë dominimin ose koalicionin në firmë. Posedojnë qasje në disa mekanizma formal që njohin fuqinë e tyre, p.sh: Bordi i drejtorëve, departamenti i burimeve njerëzore, etj.	qeveria, punonjësit.
Të rrezikshmit	Palët e interesit që kanë fuqi dhe urgjencë por mungesë të legjitimitetit, shpesh të dhunshëm dhe shtrëngues.	Grevat, punonjësit e sabotazhit, terrorizmi.
Të varur (Dependent)	Në mungesë të pushtetit për këto palë legjitimiteti dhe urgjenca varen nga palët e tjerë të interesit në firmë.	Banorët vendas dhe komuniteti.
Definitivët (Definitive)	Palët e interesit që kanë të tre atributet dhe që kanë ndikim të menjëhershëm në menaxhimin e firmës.	

Burimi: Mitchell, Agle & Wood (1997).

Tipologjia e propozuar më lart thekson se atributet e palëve të interesit janë të ndryshme dhe të ndërtuara në baza shoqërore. Përcaktimi i shtatë grupeve të palëve të interesit, lehtëson çdo analizë që merret me perceptimin dhe studimin e këtyre grupeve.

Në teoritë e mëvonshme një mënyrë shumë e zakonshme e diferencimit të llojeve të ndryshme të palëve të interesit, bazohet në marrjen në konsideratë të të gjithë individëve apo grupeve që kanë marrëdhënie me organizatën. Sipas Friedman (2006) grupet kryesore të palëve të interesit janë:

- konsumatorët;

- punonjësit;
- komunitetet lokale;
- furnizuesit dhe shpërndarësit ;
- aksionerët.

Përveç kësaj, grupet dhe individët e tjerë që konsiderohen të jenë palë të interesit në literaturën e Friedman (2006) janë:

- media;
- publiku në përgjithësi;
- partnerët e biznesit;
- gjeneratat e ardhshme;
- gjeneratat e kaluara (themeluesit e organizatave);
- akademikët;
- konkurentët;
- OJQ-të ose aktivistët;
- sindikatat ose shoqatat tregtare të furnizuesve ose shpërndarësve;
- financues të tjerë (mbajtësit e depozitave, mbajtësit e obligacioneve, kreditorët);
- qeveria, rregullatorët, politikëbërësit.

Në artikullin e tyre, Donaldson & Preston (1995) "The Stakeholder Theory of the Corporation: Concepts, Evidence, and Implications ", sugjeruan se literatura e teorisë së palëve të interesit mund të ndahet në tri drejtime:

1. Përshkruese: Qëllimi është të kuptohet se si menaxherët merren me palët e interesit dhe interesat e tyre.
2. Instrumentale: Studion pasojat në organizatë duke marrë në konsideratë praktikën e

palëve të interesit dhe arritjet e qëllimeve të ndryshme qeveritare.

3. Normative: Identifikimi i udhëzimeve morale ose filozofike të lidhura me aktivitetet ose menaxhimin e korporatave.

Mënyra se si bizneset i përfshijnë palët e interesit, përbën një tipar kyç mbi konceptin e Përgjegjësisë Sociale të Korporatës (CSR). Sipas Commission Green Paper (2001), CSR është një koncept në të cilin kompanitë integrojnë shqetësimet sociale dhe mjedisore në planet e tyre të biznesit duke bashkëvepruar me palët e interesit. Kompanitë janë të varura nga palët e interesit pasi nga to marrin burimet e nevojshme për mbijetesën dhe zhvillimin e tyre. Në artikullin e tyre “Teoria e palëve të interesit” Fontaine, Haarman & Schmid (2006) përshkruajnë se legjitimiteti i kompanisë për të përdorur këto burime varet nga mënyra e sjelljes së saj me rregullat dhe vlerat e njohura nga shoqëria. Nisur nga kjo, çdo kompani do të marrë një "licencë për të vepruar" me kusht që të mos konsiderohet si një grabitqar i mjedisit natyror dhe social. Në këtë rast, në qoftë se do të kishin një mundësi zgjedhje, punonjësit do të preferonin të punonin në një kompani me përgjegjësi sociale.

Përveç performancës financiare, investitorët duhet të integrojnë në portofolet e tyre edhe menaxhimin e rrezikut reputacional, pasi një menaxhim me sukses i këtij rreziku rrit vlerën e kompanisë. Sipas “Teoria e interesit të MNC (Multinational Corporation)” (2006), qëllimi i korporatave nuk është më vetëm sigurimi i fitimit aksioner, por edhe mbrojtja e një imazhi dhe vlere që respekton të gjitha palët e interesit, duke mbajtur kështu në nivele të ulëta rrezikun e dështimit. Ekziston gjithashtu një lidhje midis pasurisë së aksionerëve dhe pasurisë së të gjithë palëve të interesit, pasi korporata ka nevojë për një reputacion të mirë në mënyrë që të shesë produktet e saj dhe

të gjenerojë fitime, pavarësisht se kjo nuk është vërtetuar ende nga studimet empirike. Freeman (1984) ishte një nga kontribuesit kryesorë në teorinë e palëve të interesit, me librin e tij "Menaxhimi strategjik: Një përfaqësim i palëve të interesit".

2.3 Teoria Markowitz vs Teoria Sharpe.

Teoritë ekonomike financiare e përcaktojnë menaxhimin e rrezikut financiar si një element të rëndësishëm me impakt në performancën e një firme, ndër këto rreziqe përmendim: rrezikun e kredisë, rrezikun e likuiditetit, rrezikun e tregut, kostot e falimentimit, sistemin tatimor si dhe mungesën e investimeve. Sipas Carter et al. (2006) menaxhimi i rrezikut mund të rrisë vlerën e aksioneve duke harmonizuar politikat e financimit dhe investimeve. Një menaxhim i mirë i rrezikut financiar zbut kostot e investimeve dhe ul luhatshmërinë e vlerës së firmës. Viti 1932 shënoi lindjen e Shoqatës Amerikane të Rrezikut dhe Sigurimeve. Studimet e para akademike mbi sigurimet u botuan në *Revistën e Sigurimeve*, e cila më vonë u riemërua "*Journal of Risk and Insurance*" në vitin 1964 (Weiss & Qiu, 2008). Më pas edhe revista të tjera të specializuara pasuan publikime duke përfshirë revistën *Menaxhimi i Rrezikut*, botuar nga Shoqata e Menaxhimit të Rrezikut dhe Sigurimeve (RIMS), një shoqatë profesionale e menaxherëve të rrezikut e themeluar në vitin 1950. Po ashtu në vitin 1976 u krijua *Gazeta e Gjenevës për Rrezikun dhe Sigurimet*, botuar nga Shoqata e Gjenevës.

Në vitet 1950 dhe 1960 studiuesit (Markowitz, Lintner, Treynor, Sharpe dhe Mossin) ndërmorën studime themelore në lidhje me vendimet financiare. Harry Markowitz ishte i pari që propozoi një metodë sasiore moderne për zgjedhjen e portofolit, me anë të luhatshmërisë së asetëve dhe korrelacioneve ndërmjet tyre. Ai tregoi rrugën e optimizimit të një portofoli për një nivel risku të dhënë. Markowitz fitoi

çmimin Nobel në Shkencat Ekonomike në vitin 1990 për kontributin e tij në Teorinë e Portofolit. Në vitin 1963, William Sharpe, John Lintner dhe Jan Mossin zhvilluan një model për përcaktimin e çmimit të aseteve, të quajtur Capital Asset Pricing Model (CAPM, në shqip, Modeli i Vlerësimit të Aktiveve Kapitale).

Megjithatë, vetëm në fillim të viteve 1970 u shfaqën produktet e para kryesore të menaxhimit të rrezikut financiar dhe u publikuan modelet fillestare teorike të mbulimit të rrezikut. Modeli i Black dhe Scholes është padyshim më i njohuri ndër to. Këta autorë ishin të parët që propozuan një formulë të qartë për çmimet e një derivati. Ky model ishte aq revolucionar, sa revistat kryesore financiare refuzuan të botonin versionin e parë. Në vitin 1973 modeli u pranua dhe u botua për herë të parë në një nga gazetatat më të mira të ekonomisë, *Journal of Economic Politics*. Një vit më vonë, Merton botoi një shtesë të këtij modeli në revistën *Bell Journal of Economics and Management Science*. Derivatet për mbulimin e rreziqeve u zgjeruan shpejt, duke prekur rrezikun e kursit të këmbimit valutor dhe rrezikun e ndryshimit të normave të interesit etj. Po ashtu matematika financiare dhe rritja e përdorimit të kompjuterave personale përshpejtuan rritjen dhe përdorimin e derivateve.

Gjatë vitit 1972 u shfaqën derivatet e aseteve financiare (Bordi i Tregtisë i Çikagos, CBOT). Ndërsa në vitin 1973 u shënua një pikë kthese në historinë financiare me krijimin e CBOE (Chicago Board Exchange Options Exchange), së bashku me shtëpinë e pastrimit të parave (clearing house). Rritja e tregut të opsioneve u përshpejtua pas kontratave të standardizuara të CBOE, duke zhvilluar kështu tregje dytësore të nevojshme për të gjeneruar aktive likuide për efektshmërinë e tregut (Smith, Smithson & Wakeman, 1990). Gjatë viteve 1980 dhe 1990, zbatimi i këtyre produkteve mbrojtëse i

sensibilizoi lojtarët e tregut mbi rrezikun e aktiviteteve të tyre investuese. Ndërkohë, u krijuan mjete të reja statistikore në banka dhe agjenci vlerësimi për të zgjedhur klientelën (p.sh. vlerësimi i kredisë) dhe për të menaxhuar rrezikun e kredisë. Këto mjete lehtësuan vlerësimin e rrezikut të kredisë me probleme. Po ashtu, marrëveshja e Baselit e krijuar në vitin 1988 imponoi një vizion të ri rregullator mbi menaxhimin e rrezikut të kredisë.

Në fund të viteve 1980, paqëndrueshmëria e lartë e tregut nxiti bankat e mëdha amerikane për investime që të krijonin departamentet e menaxhimit të rrezikut (Field, 2003). JP Morgan në vitet 1994 dhe 1997 zhvilloi dy modelet më të njohura të menaxhimit të rrezikut të brendshëm të paraqitura si më poshtë:

- riskometria (metodologji që përmban teknika dhe grupe të të dhënave të përdorura për të llogaritur vlerën e rrezikut (VaR) të një portofoli të investimeve në lidhje me menaxhimin e rrezikut të tregut);
- kredimetria (metodologji për menaxhimin e rrezikut të kredisë).

Këto mjete të matjes së rrezikut cilësohen si instrumente shumë të rëndësishme për llogaritjen e kapitalit rregullator të bankave sipas Basel II dhe Basel III, të cilat u përdorën për të analizuar humbjet e para të mëdha në vitet 1994 dhe 1995 pas keqpërdorimit të derivateve (Procter and Gamble, Orange County dhe Barings). Si pasojë e kësaj, gjatë viteve 1994-1997 u shfaqen tri kriza financiare në lidhje me rrezikun e kredisë, të tilla si: kriza aziatike, kriza ruse dhe rënia e modeleve të menaxhimit të kapitalit afatgjatë. Këto dy modele theksuan idenë e matjes së rreziqeve në portofol, duke marrë parasysh varësitë dhe vlerën e tyre, në mënyrë që të përcaktohej qartë ndikimi që do të kishin. Publikimi i modelit të riskometrisë nxiti shpërndarjen e

gjerë të vlerës së rrezikut VaR midis profesionistëve dhe akademikëve. Ai u importua nga siguruesit, të cilët përdorën një matës të ngjashëm rreziku për të llogaritur humbjet maksimale të tyre (MPY ose Maksimumi i Mundshëm i Humbjes Vjetore Agregate, Cummins dhe Freifelder, 1978). VaR është vlera maksimale që një portofol ose kompani mund të humbasë gjatë një periudhe të caktuar kohe, në një nivel të caktuar besimi. Kjo masë gjithashtu lejon matjen e kapitalit optimal që kërkohet për të mbrojtur kompaninë ose portofolet nga humbjet e parashikuara dhe të paparashikuara (Scaillet, 2003).

Menaxhimi i rrezikut u bë çështje kryesore e korporatave në fund të viteve 1990. Vendimet më të mëdha në lidhje me orientimin e politikave për menaxhimin e firmave merren nga bordi i drejtorëve. Nga ana tjetër, komiteti i auditimit merret me vëzhgimin e këtyre vendimeve edhe pse disa institucione të mëdha financiare kanë krijuar komitetet e menaxhimit të rrezikut dhe personi përgjegjës për to quhet oficer i rrezikut të korporatave, ose CRO (Corporate Risk Officer).

Një shqetësim i madh në fillim të viteve 2000 u bënë rezervat adekuate kapitale pas humbjeve të mëdha në fund të viteve 1990 dhe falimentimit të Enron në 2001. Bazeli II vendosi rregulla më rigorozë për bankat. Përveç ndryshimit të rregullave të administrimit të rrezikut të kredisë, marrëveshja paraqiti rregulla të reja për rrezikun operacional.

Pasojat në firmat financiare, jofinanciare dhe në agjencitë qeveritare, tregojnë nevojën për forma të ndryshme të administrimit të rrezikut. Mospërputhjet financiare janë një fenomen i hershëm, por kohët e fundit, subjektet ekonomike janë hasur me shumë probleme financiare. Kriza e kursimeve dhe kredive (S&L) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës zgjati dy dekada dhe tërhoqi një vëmendje të madhe në

diskutimet e bëra rreth saj. Çdokush që njeh derivatet e normave të interesit, e di se ky proces mund të zhvillohej shumë më shpejt dhe në një formë krejt ndryshe. Për procesin e kreditimit, shumica e autoriteteve rregullatore duhet të dinë se thelbi i problemit nuk është derivati, por menaxhimi i dobët i rrezikut.

Bankat dhe institucionet e ngjashme financiare, duhet të plotësojnë disa kërkesa rregullatore për matjen e rrezikut dhe kapitalit. Megjithatë, është gabim të mendohet se përmbushja e kërkesave rregullative është e vetmja apo arsyeja më e rëndësishme në krijimin e një sistemi për menaxhimin e rrezikut. Menaxherët kanë nevojë për matësa të besueshëm ndaj rrezikut, në mënyrë që të drejtojnë kapitalin në investime me kthim të sigurtë. Ata gjithashtu kanë nevojë për vlerësimin e humbjeve të mundshme për të qëndruar brenda kufijve të vendosur nga likuiditeti, kreditorët, klientët dhe rregullatorët. Përveç këtyre, menaxherët kanë nevojë edhe për mekanizma që të përcaktojnë strategjitë dhe të krijojnë stimuj për shpërndarjen dhe uljen e rrezikut. Menaxhimi i rrezikut është procesi përmes të cilit menaxherët i plotësojnë këto nevoja duke identifikuar rreziqet kryesore, duke marrë masa konkrete dhe të kuptueshme dhe duke zgjedhur rreziqet që duhen zvogëluar dhe monitoruar (Pyle, 1997).

Menaxhimi i rrezikut financiar ka të bëjë me kontrollin e cilësisë financiare dhe përkufizohet si identifikimi, analizimi dhe marrja e masave për të zvogëluar ose eliminuar ekspozimin e humbjes në një organizatë. Autorë të ndryshëm, përfshirë Stulz (1984), Smith et al (1990) dhe Froot et al (1993) ofruan disa arsye pse drejtuesit e organizatave duhet të jenë aktiv në menaxhimin e rreziqeve financiare. Qëllimi kryesor i menaxhimit të institucioneve financiare ka të bëjë me maksimizimin e fitimit të pritshëm duke marrë parasysh luhatshmërinë e rrezikut financiar. Modeli i Vlerësimit të Aktiveve

të Kapitalit (CAPM) përbën një nga teoritë më të dobishme dhe të përdorura në përcaktimin e normës së kërkuar të kthimit. Në teori, modeli i vlerësimit të aktiveve të kapitalit është përdorur për të vendosur normën e kthimit të kërkuar nga investitori në një nivel rreziku të dhënë, duke pasur parasysh rrezikun sistematik (të pa-diversifikueshëm) të firmës, pasi rreziku jo-sistematik (i diversifikueshëm) eliminohet në një portofol të mirë-diversifikuar. Modeli i Vlerësimit të Aktiveve të Kapitalit (CAPM) u prezantua nga William Sharpe (1964) dhe John Lintner (1965), për të cilin në vitin 1990 Sharpe mori çmimin Nobël. Në vitin 1959 Harry Markowitz ndërtoj modelin me “variancë minimale” ose modelin e zgjedhjes së portofolit. Portofoli me variancë minimale nënkupton një portofol me nivel të ulët rreziku.

Modeli Markowitz (1959) sugjeron që investorët duhet të zgjedhin një portofol i cili minimizon variancën e kthimit, duke pasur parasysh një nivel specifik të kthimit të pritur, ose të maksimizojë kthimin e pritur, duke pasur parasysh një nivel specifik variance. Kështu modeli Markowitz supozon që investorët janë efikasë, të gatshëm të përballojnë riskun dhe të maksimizojnë shërbimet që ndodhen në pikat eficiente (të quajtur kufiri minimal i variancës), kështu, portofoli i përzgjedhur varet nga funksioni i shërbimeve të investorit për kthimin e pritur. Për këtë arsye, investorët zgjedhin portofolet për një periudhë të caktuar investimi dhe përqëndrohen në mesataren dhe variancën e kthimit të investimeve të tyre.

Sharpe (1964) dhe Lintner (1965) zhvilluan më tej modelin Markowitz, i cili kishte si bazë balancën midis rrezikut dhe kthimit, duke prezantuar modelet e tyre me dy supozime të rëndësishme. Supozimi i parë e vë theksin tek huamarrja dhe kreditimi me një normë pa risk. Domethënë, investorët mund të huazojnë ose të japin hua çdo shumë

parash në normën e lirë të kthimit, e cila është e njëjtë për të gjithë investitorët dhe nuk varet nga shumat e huazuar apo e dhënë hua. Ndërsa supozimi i dytë thekson se të gjithë investitorët kanë pritje homogjene të cilat rezultojnë në vlerësimin e shpërndarjeve të njëjta të probabilitetit për kthimin e ardhshëm, domethënë, marrëveshjen e përgjithshme për shpërndarjen e kthimit të pasurisë nga koha $t-1$ në t .

Modeli CAPM përcakton një tërësi parashikimesh për kthimin e pritur të mjeteve me rrezik. Studimet empirike tregojnë se ky model është "mjaft i dobët dhe i pavlefshëm për të vlerësuar mënyrën se si përdoret në aplikime" (Fama & French, 2004). Më poshtë përmbledhen supozimet e thjeshtuara që çojnë në një version më të saktë të CAPM-së, të propozuara po nga autorët (1964) dhe Lintner (1965). Shtysë kryesore për këto supozime është përpjekja për të siguruar që individët të jenë sa më të ngjashëm, me përjashtim të nivelit fillestar të pasurisë dhe shkallës së kundërshtisë ndaj rrezikut.

➤ Supozimet e teorisë:


1. Mundësitë e investimit i përkasin një "universi" që përfshin mjete financiare të tregtueshme në tregjet publike (aksione dhe obligacione), si dhe marrëveshje të huadhënies apo huamarrjes pa rrezik. Ky supozim lë jashtë investimet në mjete të patregtueshme, si edukimi (kapitali njerëzor), kompanitë private (të pakuotuar në tregje) dhe mjetet që financohen nga qeveria. Gjithashtu, supozohet që investitorët mund të japin apo të marrin hua një shumë çfarëdo me një normë fikse dhe pa risk.
2. Të gjithë investitorët marrin një pozicion në kufirin efikas, ku të gjitha investimet maksimizojnë dobinë. Investitorët nuk e pranojnë rrezikun dhe fokusohen vetëm tek kthimi (mean) dhe risku i ndërlidhur (varianca).

3. Të gjithë investitorët kanë pritje homogjene, që do të thotë se ata vlerësojnë shpërndarjet e njëjta për normat e ardhshme të kthimit.
 4. Të gjithë investitorët planifikojnë për një periudhë të njëjtë investimi.
 5. Të gjithë investitorët janë optimizues racionalë, që do të thotë se ata përdorin modelin Markowitz të përzgjedhjes së portofolit.
 6. Investitorët nuk paguajnë taksa mbi fitimet ose kosto të transaksionit për tregtimin e letrave me vlerë.
 7. Nuk ka inflacion ose asnjë ndryshim në normat e interesit.
 8. Pasuria e cdo individi është e vogël në krahasim me pasurinë totale të të gjithë investitorëve. Investitorët nuk janë të aftë të ndikojnë në çmimet e letrave me vlerë.
- (Reilly & Brown, 2003).

➤ Zhvillimi i modelit Sharpe-Lintner:

Fama & French (2004) i përshkruajnë mundësitë e portofolit duke kombinuar mjetet në kufirin eficient me vijën e zgjeruar nga pika e normës së kthimit në mjetet pa risk në boshtin y, (Grafiku Nr. 1).

Grafiku Nr. 1: Mundësitë e investimit



Burimi: Fama & French (2004).

Të gjitha aktivet e veçanta ndodhen në të djathtë dhe brenda kufirit, të paktën kur lejojmë shitjen *short* në ndërtimin e portofolit me risk. Kjo tregon se portofolet me risk që kanë një aktiv të vetëm janë joefiçentë. Diversifikimi i investimeve jep portofole me kthim të pritur të lartë dhe me devijim standard të ulët. Të gjitha portofolet që ndodhen në kufirin e variancës minimale, japin kombinimet më të mira të kthimit të pritur dhe riskut dhe si të tilla, janë kandidatë për portofolin optimal. Për këtë arsye, pjesa e kufirit që ndodhet mbi portofolin me variancë minimale, quhet kufiri i efijencës së aktiveve me risk. Për çdo portofol në pjesën e poshtme të kufirit të variancës minimale, ka një portofol me të njëjtin devijim standard, por me një normë të pritur kthimi më të lartë. Prandaj, pjesa e poshtme e kufirit të variancës minimale është joefiçente.

Risku i portofolit matet me devijimin standard të portofolit dhe tregohet në boshtin horizontal, ndërsa kthimi i pritur i portofolit tregohet në boshtin vertikal. Kufiri minimal i variancës, i treguar nga kurba (a, b dhe c), përfshin portofolet e aseteve të rrezikshme me kombinime të ndryshme të kthimit të pritshëm dhe riskut. Portfolet në kufirin eficient nuk përfshijnë normën e lirë të kthimit për huamarrjen dhe huadhënien.

Investitorët balancojnë marrëdhëniet mes riskut dhe kthimit të pritshëm duke marrë pozicione të ndryshme në kufirin efikas sipas preferencave të tyre të nivelit të rrezikut.

Më poshtë japet shpjegimi i pikave në grafik :

Pika (a) - një investitor që kërkon kthim të lartë dhe në përputhje me rrethanat do të jetë gati të pranojë dhe një nivel risku të lartë.

Pika (b) - investitori mund të ketë një kthim të pritshëm të ulët, për një nivel risku më të ulët.

Pika R_F - norma e kthimit e mjeteve pa risk.

Pika g - portofoli pa risk ose investime huamarrjeje pa risk në vijën e drejtë midis R_F - g , ku investitorët mund të huazojnë mjete pa risk dhe të përdorin këto hua për të investuar në portofolin g .

Fama & French (2004) sqarojnë se kur kemi në dispozicion huamarrje dhe huadhënie pa risk, kthimi i pritshëm i aktiveve do të jetë i barabartë me normën pa risk (R_F). Ekuacioni i CAPM-së, sipas supozimeve të Sharpe dhe Lintner për huamarrje dhe huadhënie pa rrezik shprehet si më poshtë:

$$E(R_i) = R_f + \beta [E(R_M) - R_f] \quad (1)$$

Beta e tregut:


$$\beta_{iM} = \frac{COV(R_i, R_M)}{\sigma^2(R_M)} \quad (2)$$

Ku, $E(R_i)$ është kthimi i pritshëm në asetin i , dhe koeficienti beta (β) është rreziku i tregut (risku sistematik) që mat ndjeshmërinë e kthimit të aktivitetit në variacion me kthimin e tregut. R_f është norma e lirë e kthimit e mjetit pa risk, dhe R_M është norma e kthimit të tregut. Duke qenë se $Cov(R_i, R_M) = \beta_i \sigma^2_M$, koeficienti i ndjeshmërisë β_i tregon

pjerrësinë në vijën e regresit që përfaqëson modelin indeks. Kështu, rezulton se koeficienti beta i modelit indeks është i njëjtë me betën e CAPM-së në marrëdhënien kthim i pritshëm-beta, me përjashtim të faktit që portofoli (teorik) i tregut në CAPM zëvendësohet me indeksin e tregut, i cili është i përcaktueshëm dhe i vrojtueshëm.

Kthimi i pritshëm i çdo aktivi i është norma e interesit pa risk, RF , plus një prim risku, i cili përfaqëson kthimin e mjeteve të tregut, $\beta_i M$, që shumëzon primin për njësi të riskut beta, $E(RM) - RF$.

Grafiku Nr.1 - Kurbat e indiferences




Burimi: Sharp (1964).

➤ Normat e huamarrjes diferenciale dhe të kreditimit:

Friend & Blume (1970) argumentuan se pabarazia midis huamarrjes së investorëve dhe normave të kreditimit, pritet të shkaktojë një treg bazuar në parashikime të riskut dhe kthimit. Risku matet me koeficientin e tij beta, i përbërë nga dy vijat të drejta që rezultojnë nga huamarrja dhe mundësitë e kreditimit, të lidhura nga një kurbë e cila është konkave në lidhje me aksin e riskut. Reilly & Brown (2003) në

përpyqje për të diskutuar problemin e huamarrjes dhe huadhënies, supozojnë aftësinë e pakufizuar të investorëve për të investuar në letra me vlerë pa risk. Por, duhet theksuar se ka kufizime për huazimin e fondeve pa risk pasi investorët duhet të paguajnë një normë më të lartë kur huazojnë para dhe në përputhje me rrethanat do të ketë dy vija të ndryshme që kalojnë në kufirin efikas.

Grafiku Nr. 2 - Modeli Beta - Zero



Burimi: Raily & Brown (2003).

➤ Modeli Beta - Zero:

Black (1972) propozoi një model huamarrje pa risk. Ky propozim përcaktonte një CAPM në të cilin shkalla Beta-Zero e portofolit të tregut tejkalon normën e kreditimit pa risk. Black (1972), supozon se një investor mund të marrë pozicion të pakufizuar të gjatë ose të shkurtër në aktivin e rrezikshëm dhe konkludon se pjesa e rrezikshme e çdo portofoli është një kombinim i ponderuar i portofoleve m dhe z, ku portofoli m është portofoli i tregut dhe portofoli z është portofoli minimal me variancë zero. Beta e portofoleve që kanë kthime të pakorreluara me kthimet e portofolit të tregut do të jetë e barabarta me zero, duke bërë që investorët ti zgjedhin këto portofole me risk minimal. Portofolet me beta zero nuk ndikojnë në Vijën e Tregut të Kapitalit (CML), por në një vijë tjetër e quajtur Vija e Tregut e Letrave me Vlerë (SML), siç

tregohet në grafikun më sipër. Ndërprerja e kësaj vije me boshtin y përcakton kthimin e pritur të një portofoli me beta zero. Kthimi i këtij portofoli me beta zero do të jetë më i lartë se mjetet pa risk. Pjerrësia e vijës është e sheshtë, pasi diferenca midis kthimit të tregut dhe kthimit pa risk është e vogël (Reilly & Brown, 2003).

➤ Kostot e Transaksionit:

Reilly & Brown (2003) theksojnë se një nga supozimet e CAPM-së është se nuk ka kosto transaksioni, kështu që investitorët do të blejnë ose shesin letra me vlerë me çmime të larta derisa të arrijnë në vijën e tregut të letrave me vlerë (SML). Komisionet e tregtimit të letrave me vlerë varen nga madhësia e tregtimit dhe nga rëndësia e investitorëve individualë.

➤ Pritjet Heterogjene dhe Periudhat e Planifikimit:

Reilly & Brown (2003) argumentojnë se investitorët nuk do të kenë të njëjtat pritshmëri për flukset monetare të ardhshme të letrave me vlerë, prandaj secili investitor do të ketë një CML të ndryshëm dhe SML të përcaktuar sipas pritshmërive të tyre për shpërndarjen e kthimeve. Kjo paraqitet grafikisht nga një sërë vijash paralele pranë njëra-tjetrës. Distancat mes këtyre vijave do të ngushtohen për shkak se pritjet e investitorëve janë të drejtuara së bashku. Të gjithë investitorët planifikojnë për një periudhë të njëjtë investimi, kjo sjellje nuk është optimale, pasi le mënjanë çdo gjë tjetër që mund të ndodhë pas përfundimit të periudhës së investimit.

➤ Taksat:

Reilly & Brown (2003) sugjerojnë se norma e kthimit e përdorur përmes këtij modeli, përbën kthimin para taksave, por në fakt, kthimet aktuale për shumicën e investorëve janë:

$$E(R_1)(AT) = \frac{(P_t - P_b) \times (1 - T_{cg}) + (Div) \times (1 - T_d)}{P_b} \quad (3)$$

Ku :

$E(R_1)(AT)$ = kthimi pas normës tatimore

P_t = çmimi përfundimtar

P_b = çmimi fillestar

T_{cg} = tatimi mbi fitimin ose humbjen kapitale

T_d = taksa në të ardhurat e zakonshme

Autorët konstatojnë se normat e taksave ndryshojnë ndërmjet individëve dhe institucioneve. Investorët në pjesën më të madhe të rasteve kanë barrë të rëndë tatimore dhe kjo mund të shkaktojë dallime të mëdha në CML-n dhe SML-n e tyre.

➤ A është praktike CAPM-ja?

Për të diskutuar rolin e CAPM-së në investimet e jetës reale duhet tu përgjigjemi dy pyetjeve. Së pari, edhe nëse të gjithë biem dakord se CAPM-ja do të ishte modeli teorik më i mirë i mundshëm për të shpjeguar normat e kthimit të mjeteve me rrezik, si do të ndikonte kjo në politikën e investimit në praktikë? Së dyti, si mund të përcaktojmë nëse CAPM-ja është në fakt modeli më i mirë i mundshëm për të shpjeguar kthimin e mjeteve me rrezik? Të gjitha modelet, në ekonomi apo shkencë, bazohen në thjeshtëzime që na bëjnë të mundur përballjen me realitetin sfidues, çka do të thotë se

perfeksioni është një standard i paarsyeshëm dhe i papërdorshëm. Në paragrafët më sipër, theksuam se nëse CAPM-ja do të ishte e vlefshme, modeli me një indeks do të ishte gjithashtu i vlefshëm, (ku indeksi përfshin të gjitha letrat me vlerë të tregtueshme, pra të gjitha letrat me vlerë me rrezik në universin e investimit). Në këtë rast, shprehja “modeli CAPM shpjegon në mënyrë të përkryer normat e kthimit të mjeteve me rrezik” nënkupton se të gjitha vlerat e alfave do të ishin zero në mënyrë identike. Nocioni se vlerat e alfave do të ishin të gjitha zero është i mundshëm në parim, por një gjë e tillë nuk pritet të haset në tregjet reale. Kjo u demonstrua nga Grossman dhe Stiglitz, të cilët treguan se ekonomia reale mund të jetë duke iu afruar një ekuilibri të tillë, por jo detyrimisht e arrin atë. Ideja e tyre kryesore është se veprimet e analistëve të letrave me vlerë janë forcat që drejtojnë çmimet e aksioneve drejt niveleve “të duhura” në të cilat alfa është zero. Por nëse të gjitha alfat do ishin zero nuk do të kishte asnjë motivim për të kryer analizën e letrave me vlerë. Në të vërtetë, ekuilibri i tregut karakterizohet nga çmimet që luhaten “pranë” vlerës së tyre të duhur, në të cilën alfat janë thajse zero, por mjaftueshëm ndryshe nga zero sa të nxisin analistët të vijnë me përpjekjet e tyre. Një standard më i arsyeshëm është ai që thotë se CAPM-ja është “modeli më i mirë i mundshëm për të shpjeguar kthimet e mjeteve me rrezik” kjo nënkupton se në mungesë të analizës, alfat e letrave me vlerë duhet të konsiderohen me vlerë zero. Një letër me vlerë është vlerësuar gabim nëse alfa e saj është e ndryshme nga zero. Letra në fjalë është e nënvlerësuar nëse alfa është pozitive dhe e mbivlerësuar nëse alfa është negative. Alfat negative apo pozitive zbulohen vetëm nëpërmjet analizës superiore të letrave me vlerë. Në mungesë të investimeve të mëdha në këtë analizë, një investitor do të ndërtonte portofolin më të mirë vetëm nën supozimin se alfat janë zero. Ky përkufizim i

superioritetit të CAPM-së ndaj çdo modeli tjetër përcakton gjithashtu rolin e tij në investimet e jetës reale.

2.4 Teoria e asimetrisë së informacionit në institucionet financiare.

Në fillimet e saj industria bankare vepronte si një industri me shërbime të plota (Bankë universale), duke ofruar në mënyrë direkte ose indirekte të gjitha shërbimet financiare (si bankë tregtare dhe bankë investimesh). Në fillim të viteve 1930, Depresioni i Madh çoi në ndarjen e këtyre aktivitetëve. Në vitet 1970 dhe 1980, pati një zhvillim të madh të shërbimeve financiare, kryesisht të parregulluara, që kryenin funksione të ndryshme financiare. Ndërsa në shekullin XXI, teknologjia dhe inovacioni në sistemin financiar bënë që një sërë shërbimesh financiare të ofroreshin nga një institucion i vetëm financiar. Funksioni thelbësor i institucioneve financiare (institucionet depozituese, kompanitë e sigurimeve, fondet e përbashkëta të investimit, bankat e investimeve, etj.), është kanalizimit i fondeve nga ata që kanë fonde me tepriçë (huadhënësi) drejt atyre që kanë mungesë fondesh (huamarrësi).

Menaxhimi i institucioneve financiare konsiston në marrjen përsipër si dhe menaxhimin e rreziqeve financiare në bankat tregtare dhe kompanitë e sigurimit. Rreziku financiar nuk është i njëjtë për të gjitha institucionet financiare. Ndryshimet në tregjet bankare dhe financiare kanë rritur sfidat e menaxhimit të rreziqeve financiare në bankat tregtare. Pozicioni kyç i bankave tregtare në ekonominë moderne, ka bërë që menaxhimi i rreziqeve financiare të jetë gjithnjë e më i rëndësishëm për stabilitetin financiar dhe rritjen ekonomike. Rreziku financiar ndikon në interesat e aksionerëve, kreditorëve, depozituesve etj, por kjo nuk mjafton për të justifikuar rregullimin e institucioneve financiare, pasi këta agjentë kompensohen për rreziqet që ata marrin përsipër dhe kanë

akses në mjetet e monitorimit që u japin atyre informacion të mjaftueshëm për tu mbrojtur ndaj rrezikut financiar.

Institucionet financiare si bankat tregtare, kompanitë e sigurimeve, si dhe kompanitë e tjera të shërbimeve financiare, ofrojnë një balancë të mirë midis kthimit dhe rrezikut sistematik për investuesit e tyre. Megjithatë, ekziston një arsye tjetër pse shumica e institucioneve financiare monitorojnë me kujdes rreziqet financiare dhe kjo lidhet me rregulloret e përcaktura ndaj këtyre institucioneve (Hull, 2012). Ndryshe nga kompanitë e tjera, shumica e institucioneve financiare janë të mirë rregulluara. Qeveritë në të gjithë botën kërkojnë që sektori financiar të jetë i qëndrueshëm. Është e rëndësishme që kompanitë dhe individët të kenë besim tek bankat dhe kompanitë e sigurimeve. Rregulloret janë hartuar për të siguruar një probabilitet të ulët të problemeve financiare që përjetojnë bankat e mëdha tregtare dhe kompanitë e sigurimit gjatë periudhave të ndryshme.

Kriza e vitit 2008 ilustron vullnetin e qeverive për t'i lënë institucionet e mëdha financiare të falimentojnë. Rregullatorët përpiqen të sigurojnë që kapitali i mbajtur nga bankat tregtare të jetë i mjaftueshëm për të amortizuar humbjet e mëdha. Teoritë kryesore tregojnë se rregullorët janë ndërtuar për të përballuar jo vetëm rreziqet sistematike por edhe ato globale. Qëllimi i tyre është që falimentimi i një institucioni financiar të jetë një ngjarje shumë e vështirë për të ndodhur. Ekzistojnë dy strategji të mëdha të menaxhimit të rrezikut të përdorura nga një institucion financiar (ose organizatë tjetër) (Hull, 2012). Strategjia e parë identifikon rreziqet financiare dhe i trajton veçmas secilin prej tyre. Kjo njihet edhe si dekompozim i rrezikut. Strategjia tjetër merret me zvogëlimin e rreziqeve financiare përmes diversifikimit.

Teoria e asimetrisë së informacionit përqëndrohet në marrëdhëniet midis huamarrësit dhe huadhënësit (bankat tregtare). Kroszner & Strahan (2001) dhe Berger & Udell (2002) theksojnë se çështjet kryesore në marrëdhënien bankë/huamarrës kanë të bëjnë me funksionimin dhe monitorimin e bankave (asimetria e informacionit), problemin e përzgjedhjes negative (Akerlof, 1970), racionimin e kredive (Stiglitz & Weiss, 1981), problemin e dëmit moral (Stiglitz & Weiss, 1983) si dhe problemin e verifikimit ex post (Gale & Hellwig, 1985).

Prania e kostove të transaksionit në tregjet financiare është një faktor me anë të të cilit shpjegohet pjesërisht fakti se përse ndërmjetësit financiarë dhe financimi i tërthortë luajnë një rol kaq të rëndësishëm në tregjet financiare. Një arsye tjetër me të cilën shpjegohet kjo, lidhet me faktin se në tregjet financiare një palë shpesh nuk ka njohuri të mjaftueshme për palën tjetër që të jetë në gjendje të marrë vendime të sakta. Kjo pabarazi njohurish quhet informacion asimetrik. Për shembull, një huamarrës i cili merr një hua zakonisht ka informacion më të mirë për kthimet e mundshme dhe rrezikun që shoqëron projektet e investimit, për të cilin janë caktuar fondet, sesa huadhënësi. Mungesa e informacionit krijon probleme në sistemin financiar në dy fronte: përpara se të kryhet transaksioni dhe pasi të jetë kryer ai.

Përzgjedhja negative është ai problem i cili krijohet prej informacionit asimetrik përpara se të kryhet transaksioni. Problemi i përzgjedhjes negative në tregjet financiare shfaqet kur huamarrësit e mundshëm, të cilët kanë më shumë të ngjarë të prodhojnë një rezultat të padëshirueshëm (negativ), pra ata huamarrës të cilëve u referohemi si huamarrës me rrezik të lartë kredie (besueshmëri të ulët), janë ata të cilët më së shumti kërkojnë një hua dhe për rrjedhojë, ka më shumë të ngjarë që të jenë po ata të cilët

përzgjidhen. Meqenëse shfaqja e problemit të përzgjedhjes negative bën që të rritet mundësia që huat t'u jepen atyre huamarrësve që kanë rrezik të lartë kredie, huadhënësit mund të vendosin të mos japin më hua edhe nëse në treg ka huamarrës të cilët kanë rrezik të ulët kredie (besueshmëri të lartë).

Dëmi moral është problemi i cili krijohet prej informacionit asimetrik pasi kryhet transaksioni. Problemi i dëmit moral që shfaqet në tregjet financiare është rreziku (dëmi) që huamarrësi të angazhohet në veprimtari që janë të padëshirueshme (jo të moralshme) nga pikëpamja e huadhënësit, pasi këto veprimtari e pakësojnë mundësinë e shlyerjes së huasë. Meqenëse prej problemit të dëmit moral pakësohet mundësia që huaja të shlyhet, huadhënësit mund të vendosin që të mos japin hua. Problemet e krijuara nga përzgjedhja negative dhe dëmi moral janë një pengesë e rëndësishme për mirëfunksionimin e tregjeve financiare. Përsëri, këto probleme mund t'i zbutin ndërmjetësit financiarë. Kur në ekonomi ka ndërmjetës financiarë, atëherë kursimtarët e vegjël mund të ofrojnë fondet e tyre në tregjet financiare, duke ua dhënë hua këto fonde një ndërmjetësi të besueshëm ose nëpërmjet veprimtarisë së kredidhënies, ose duke blerë tituj të tillë si aksione ose obligacione. Ndërmjetësit e suksesshëm financiarë kanë të ardhura më të larta nga investimet e tyre sesa kursimtarët e vegjël sepse ata zotërojnë aftësi më të mira sesa individët për të bërë dallimin dhe për të zbuluar kreditë me rreziqe të larta dhe të ulëta. Në këtë mënyrë, ndërmjetësit financiarë pakësojnë humbjet që shkaktohen nga prania e problemit të përzgjedhjes negative. Përveç kësaj, ndërmjetësit financiarë kanë të ardhura më të larta, pasi ata kanë të zhvilluar ekspertizën në vëzhgimin e palëve të cilave u japin hua, duke pakësuar kështu humbjet që krijohen për shkak të pranisë së problemit të dëmit moral. Rezultati është që ndërmjetësit financiarë kanë mundësi të përballojnë

pagesat e interesit për huadhënësit kursimtarë ose të ofrojnë shërbime në masë të konsiderueshme dhe përsëri të sigurojnë një fitim. Siç e kemi parë, ndërmjetësit financiarë luajnë një rol të rëndësishëm në ekonomi, pasi ata ofrojnë shërbime likuiditeti, nxisin ndarjen e rrezikut dhe zgjidhin problemet me informacionin. Për rrjedhojë, ata u krijojnë mundësi kursimtarëve dhe huamarrësve të vegjël të përfitojnë nga prania e tregjeve financiare. Luajtja me sukses e rolit të ndërmjetësve financiarë del në dritë nga fakti që pjesa më e madhe e amerikanëve i investojnë kursimet e tyre në këta ndërmjetës financiarë dhe njëkohësisht përftojnë prej tyre financim. Ndërmjetësit financiarë luajnë një rol kyç në përmirësimin e efektshmërisë së ekonomisë, pasi ata ndihmojnë tregjet financiare që të kanalizojnë fondet nga huadhënësit kursimtarë tek njerëzit me mundësi investimi produktive. Pa një bashkësi ndërmjetësish financiarë që funksionojnë mirë, është shumë e vështirë për një ekonomi që të arrijë potencialin e plotë të saj.

Temat kryesore në marrëdhënien bankë/huamarrës lidhen me problemet që shkaktohen nga kjo marrëdhënie si dhe mënyrat e parandalimit të këtyre problemeve me pasoja në ekonomi (Kindleberger, 1989; Bernanke, 1983; Diamond & Dybvig, 1983). Një qasje tjetër e marrëdhënies bankë/huamarrës lidhet me kostot e transaksioneve (Benston & Smith, 1976; Campbell & Kracaw, 1980; Fama, 1980). Këtu, ndërmjetësit financiarë veprojnë si koalicione të huadhënësve që shfrytëzojnë ekonomitë e shkallës ose fushëveprimin e teknologjinë së transaksionit. Nocioni i kostove të transaksionit përfshin jo vetëm kostot e shkëmbimit ose të transaksioneve monetare (Tobin, 1963; Towey, 1974; Fischer, 1983), por edhe kostot e kërkimit, monitorimit dhe auditimit (Benston & Smith, 1976). Këtu, roli i ndërmjetësve financiarë është transformimi i

kërkesave të veçanta financiare në lloje të tjera kërkesash (të ashtuquajtura transformime cilësore të aktiveve). Si të tilla, ato ofrojnë likuiditet (Pyle, 1971) dhe mundësi diversifikimi (Hellwig, 1991). Sigurimi i likuiditetit është një funksion kyç për depozituesit dhe huamarrësit, ndërsa ofrimi i diversifikimit gjithnjë e më tepër po vlerësohet në financimin individual dhe institucional.

Holmström & Tirole (2001) sugjerojnë se likuiditeti duhet të luajë një rol kyç në teorinë e çmimeve të aktiveve. Në hartimin e kontratës së huasë, është shumë e rëndësishme që palët të jenë në gjendje të negociojnë, në vend që të vlerësojnë plotësisht rrezikun aktual ose të pritshëm që strukturon kontratën përfundimtare (Gorton & Kahn, 2000). Në dallim nga qasja e asimetrisë së informacionit, arsyeja për ekzistencën e ndërmjetësve financiarë, përkatësisht të kostove të transaksionit, është ekzogjenë. Qasje tjetër e cila shpjegon qëllimin e ndërmjetësve financiarë bazohet në rregullimin e transferimit të fondeve dhe financimin e ekonomisë (Guttentag & Lindsay, 1968; Fama, 1980; Mankiw, 1986; Merton, 1995). Rregullorja e institucioneve financiare ndikon në aftësinë paguese dhe likuiditetin e tyre. Diamond & Rajan (2000) tregojnë se kapitali bankar ndikon në sigurinë e bankës, aftësinë e bankës për tu refinancuar dhe aftësinë për të gjeneruar rimbursimin nga huamarrësit ose gatishmërinë e saj për ti likuiduar ato. Sidoqoftë, pikëpamja e bazuar në ligj e sheh rregullimin si një faktor vendimtar që formon sektorin financiar dhe ekonominë (La Porta et al., 1998). Të shumtë janë ata që i shohin rregullorët financiarë si diçka plotësisht ekzogjene ndaj industrisë financiare. Megjithatë, aktivitetet e ndërmjetësve financiarë në thelb "kërkojnë rregullim". Për më tepër, paraja dhe vlera e saj, elementi kryesor i industrisë së shërbimeve financiare, në masën më të madhe përcaktohen nga shteti, dmth. nga autoritetet rregullatore. Siguria

dhe shëndeti i sistemit financiar në tërësi dhe miratimi i politikave industriale, financiare dhe fiskale konsiderohen si arsyt kryesore për rregullimin e industrisë financiare (Kareken, 1986; Goodhart, 1987; Boot & Thakor, 1993). Gjithashtu, historia tregon se në sistemin financiar ka patur dhe ka një bashkëveprim të qartë midis institucioneve financiare, tregjeve dhe rregullatorëve (Kindleberger, 1993).

Rregullimi i ndërmjetësve financiarë, sidomos i bankave, është i kushtueshëm duke përfshirë këtu kosto direkte dhe indirekte. Pra, ekziston një marrëdhënie e vërtetë dinamike midis rregullimit dhe prodhimit financiar. Sipas teorisë moderne të ndërmjetësimit financiar, ndërmjetësit financiarë janë aktivë sepse ekzistojnë papërsosmëri në tregun financiar që parandalojnë depozituesit dhe huamarrësit të tregtojnë drejtpërdrejtë me njëri-tjetrin në një mënyrë optimale. Papërsosmëritë më të mëdha të tregut financiar kanë të bëjnë me asimetrinë e informacionit midis depozituesve dhe huamarrësve. Ndërmjetësit financiarë, bankat në mënyrë specifike, plotësojnë si agentë dhe si monitorues të deleguar boshllëqet e informacionit midis depozituesve dhe huamarrësve. Ky është edhe funksioni bazë i këtyre institucioneve, i cili justifikon kostot e transaksionit që ata i faturojnë secilës prej palëve.

Të gjitha studimet mbi arsyt e ekzistencës së ndërmjetësuesve financiarë përqendrohen në funksionimin e këtyre institucioneve në procesin e ndërmjetësimit. Optimizimi i tregut është arsyeja kryesore e funksionimit të ndërmjetësve financiarë. Tregjet perfekte janë standarte dhe palët ndërmjetësuese analizohen dhe gjykohen nga këndvështrimi i kontributit të tyre në një alokim optimal të kursimeve, që do të thotë të përsosmërisë së tregut. Në mënyrë ideale, ndërmjetësit financiarë nuk duhet të jenë atje dhe, duke qenë atje, në rastin më të mirë lehtësojnë mungesat e tregut për aq kohë sa

pjesëmarrësit e tregut nuk kanë informacion të përsosur. Si përfundim mund të themi që ndërmjetësit financiarë gjithnjë e më shumë po luajnë një rol vendimtar në rritjen ekonomike, pasi ata lidhen drejtpërdrejt me të gjitha llojet e transaksioneve dhe proceseve ekonomike.

2.5 Teoria e financave të sjelljes.

Ndonëse *analiza e sjelljes* është pjesë e disiplinave antropologjike dhe shkencave shoqërore, të tilla si psikologjia dhe sociologjia, ditët e sotme *sjellja* përmes *teorisë së Financave të Sjelljes* dhe nëndegëve të saj po konsiderohet gjithnjë e më shumë si një koncept i rëndësishëm në fushën e ekonomisë pasi ndihmon ekonomistët të kuptojnë vendim-marrjen e agjentëve ekonomikë dhe të bëjnë më realiste hipotezat e teorive ekonomike.

Sipas Charreaux (2005), literatura e sjelljes ndahet në katër degë kryesore: Financat e sjelljes, Ekonomia e sjelljes, dega e sjelljes në "E drejta dhe ekonomia" dhe dega e sjelljes në "Menaxhim Strategjik". Nëpërmjet tabelës së mëposhtme, Charreaux (2005), paraqet katër degët kryesore të sjelljes, objektivat dhe autorët përfaqësues të tyre.

Tabela Nr. 2 - Degët kryesore të literaturës së sjelljes

	Financat e sjelljes	Ekonomia e sjelljes	Dega e sjelljes në "E drejta dhe ekonomia "	Dega e sjelljes në "Menaxhim Strategjik"
Objektivi	Shpjegimi i anomalive të tregjeve financiare. Një zhvillim i fundit në lidhje me financat e	Të kuptuarit më mirë i sjelljeve në ekonomi, duke integruar, veçanërisht, kontributet e	Të paturit e një teorie shpjeguese më të mirë të ligjit, duke përfshirë edhe	Kuptimi i ndikimit të paragjykimave konjitive në

	ndërmarrjes për të kuptuar më mirë vendim-marrjen financiare.	psikologjisë konjitive dhe sociale.	karakterin e tij autoritar.	vendim-marrjen e drejtuesve.
Autorët përfaqësues	Shiller, Sheffrin, Shleifer, Thaler...	Kahneman, Tversky, Vernon Smith, Rabin, Camerer...	Jolls, Korobkin, Langevoort, Cunningham...	Simon, March, Hogarth, Bazerman, Schwenk...

Burimi: Charreaux, (2005).

Charreaux (2005), për më tepër, prezanton dy mënyra të mundshme për të përmirësuar fuqinë shpjeguese të teorive të qeverisjes: *qasjen e partneritetit dhe levën njohëse të krijimit të vlerës* (të cilat padyshim krijojnë aluzione rreth sjelljes së agjentit bazuar në teorinë e agjencisë, duke marrë parasysh aftësitë individuale dhe elementë të tjerë).

Në sintezën e tyre mbi themelet e financave të sjelljes, Debondt & Thaler (1994) theksojnë se "Ndoshta gjetja më e rëndësishme në psikologjinë e gjykimit është se njerëzit kanë shumë vetëbesim." Vetëbesimi karakterizon një individ me besim të tepruar në kapacitetet, aftësitë apo njohuritë e tij. Ky faktor së bashku me atë të optimizmit, përbëjnë një aspekt kryesor të literaturës aktuale të financave të sjelljes korporative (Baker et al., 2004)

Nga pikëpamja metodologjike, sipas Glaser et al. (2003), vetëbesimi i tepruar i investuesve në tregun financiar, gjeneron anomali në kuotimin e letrave me vlerë, nisur nga kjo, financa e sjelljes ka dy qasje. Qasja e parë rrjedh prej psikologjisë, e cila përshkruan sjelljen e individit në rrethana të caktuara ekonomike. Më vonë këto studime u përdorën për ndërtimin e një modeli të ri, i cili shpjegon monitorimet e tregut. Nga ana tjetër, qasja e dytë shqyrton devijimet empirike të parashikuara nga teoritë financiare klasike, që lindin si pasojë e iracionalitetit individual.

Shumë ekonomistë, mbështetur edhe në dy krizat e fundit financiare, kanë vënë në pikëpyetje teorinë klasike të financave të ndërmarrjes dhe janë mbështetur në një nëndegë të financave të sjelljes, që quhet *financat e sjelljes korporative*. Kjo nëndegë e financave të sjelljes, shpjegon rolin e dimensionit psikologjik në vendim-marrjen financiare (vendim-marrje e agjentëve ekonomikë dhe e drejtuesve të lartë), e cila ndikohet në mënyrë rastësore ose sistematike nga paragjykimet konjitive dhe emocionale. Studimi mbi ndikimin e sjelljes në vendim-marrjen financiare, veçanërisht në vendim-marrjet e investuesve financiarë, ka qenë objekt diskutimesh dhe zhvillimesh të shumta, pasi këto paragjykime ndihmojnë për të kuptuar më mirë gabimet e drejtuesve.

Në realitet, vendimet në çdo kompani merren ose nga një individ (menaxheri/drejtuesi) ose nga një grup individësh, që sipas *qeverisjes së korporatave*, ky grup quhet ndryshe edhe si bordi i drejtuesve. Këta vendim-marrës ndikohen nga faktorë të ndryshëm të sjelljes përmes:

- modeleve të tyre konjitive dhe emocionale (gjendja psikologjike);
- ndërveprimeve të tyre (efektet e socializimit / efektet e grupit).

Në këto rrethana, sjellja është një element thelbësor për të kuptuar vendim-marrjen e kompanive. Nisur nga kjo, një sjellje e gabuar e drejtuesve mund ti shkaktojë humbje të mëdha korporatave. Marrja në konsideratë e faktorëve të sjelljes, çon në ripërcaktimin e elementeve të sistemit të qeverisjes së korporatave, në mënyrë që paragjykimet e drejtuesëve të parandalohen, pasi prania tyre ka një impakt negativ në qeverisjen e korporatave dhe prek funksionimin e mekanizmave të qeverisjes. Si rezultat, Charreaux (2005) dhe Marne (2008) propozojnë integrimin e dimensionit të

sjelljes në modelin e qeverisjes, pasi kjo ndihmon në minimizimin e dështimeve dhe rritjen e performacës në kompani. Nisur nga kjo, teoria e financave të sjelljes është shumë e rëndësishme të merret në konsideratë nga bankat tregtare, pasi ndikon në menaxhimin me sukses të rreziqeve financiare.

2.6 Përmbledhje e kapitullit.

Në këtë kapitull u diskutua lidhur me rëndësinë e menaxhimit të rreziqeve financiare në sistemin bankar. Po ashtu në këtë kapitull u dhanë përkufizime të përgjithshme në lidhje me rrezikun si fenomen financiar, menaxhimin dhe minimizimin e tij në institucionet financiare. Pjesa më e madhe e këtij kapitulli trajton teoritë kryesore (Teoria Stakeholders, teoria Markowitz, teoria Sharpe, teoria e Asimetrisë së informacionit në institucionet financiare dhe Teoria e financave të sjelljes) të marra në studim, në lidhje me menaxhimin e rreziqeve financiare. Kapitulli vijues do të trajtojë në mënyrë më të detajuar matjen, modelet dhe proceset e manaxhimit të rreziqeve financiare, si faktorë kryesorë që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare. Siç u përmend edhe më lart, me rreziqe financiare do të kuptojmë: rrezikun e kredisë, rrezikun e likuiditetit, rrezikun e normës së interest, rrezikun e kursit të këmbimit si dhe rrezikun operacional.

KAPITULLI III: KUPTIMI DHE LLOJET E RREZIQEVE FINANCIARE QE NDIKOJNË NË PËRFITUESHMËRINË E BANKAVE TREGTARE

3.1 Menaxhimi i rrezikut dhe përformanca e institucioneve financiare.

Kohët e fundit, menaxhimi i rrezikut është përqendruar më shumë në zhvillimin e aktiviteteve të kontrollit dhe sigurimin e rregulloreve, se sa në përmirësimin e rezultateve financiare (Banks, 2004). Banks (2004) vuri në dukje se kontrolli dhe menaxhimi me sukses i rreziqeve çon në rritjen e vlerës së firmës. Prandaj, objektivi kryesor i institucioneve financiare është zvogëlimi i ekspozimit ndaj rrezikut financiar në mënyrë që të minimizohen humbjet (Fitzpatrick, 2004). Pasiguritë i mundësojnë kompanitë të kryejnë parashikime më të sakta mbi të ardhurat ose flukset e mjeteve monetare (Drogt & Goldberg, 2008).

Një tjetër arsye që lidhet me menaxhimin e rreziqeve financiare është edhe zvogëlimi i vështirësive monetare dhe kostove përkatëse (Drogt & Goldberg, 2008). Pra vëmendja kushtuar menaxhimit të rrezikut duhet të jetë në një linjë me situatën reale monetare të kompanisë. Sipas Stulz (1996), menaxhimi i rrezikut mund të përdoret nga firma për të fituar një avantazh konkurrues dhe për të përmirësuar kthimin. Praktikrat e biznesit dinamik e karakterizojnë industrinë financiare si një mjedis rregullator. Për këtë arsye, bankat kërkojnë perspektiva të reja për menaxhimin me sukses të rrezikut financiar.

Rreziku financiar rrjedh si rezultat i pasigurive që lidhen me mosveprimet në kreditë e vonuara, luhatshmërinë e normave të interesit, menaxhimin e likuiditetit dhe ndryshimet në kurset e këmbimit. Vendimet që përfshijnë veprimtaritë bankare kanë

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

element rreziku me efekte mbi performancën e përgjithshme financiare të bankave, të matura përmes parametrave të ndryshëm të cilët përfshijnë të ardhurat neto, kthimin nga aktivet dhe kthimin nga kapital i vet (Athanasoglou et al. 2005). Babakovia (2003) vuri në dukje se aftësitë e një banke për të identifikuar, vlerësuar, kontrolluar dhe monitoruar rreziqet, ndikojnë në përfitimet e saj. Bikker & Metzmackers (2005) arritën në përfundimin se qëllimi kryesor i menaxhimit të rrezikut financiar është përmirësimi i performancës financiare në banka, për shkak se menaxhimi i rrezikut nxit kontrollin e treguesve përkatës, që mund të ndikojnë negativisht në planet e kompanisë për arritjen e performancës financiare.

Është e domosdoshme që bankat të menaxhojnë rreziqet financiare për të siguruar qëndrueshmëri financiare dhe performancë në rritje. Palët e interesit kërkojnë gjithmonë informacion për sa i përket efikasitetit të menaxhimit të rrezikut, pasi është me rëndësi të madhe në arritjen e objektivave organizative. IPPF (2010) përshkruan tre mënyra për përcaktimin e efektivitetit të një procesi në lidhje me menaxhimin e rrezikut; trajtimi i elementëve të procesit, trajtimi e parimeve themelore dhe trajtimi e modelit të maturimit. Një menaxhim i plotë i rrezikut ofron një lidhje të qartë ndërmjet objektivave të përcaktuara, kontrolleve të vendosura dhe sigurimit në të gjitha nivelet e organizatës.

3.1.1 Performanca financiare.

Performanca financiare konsiston në metoda të ndryshme vlerësimi, për të parë se sa mirë një organizatë po përdor aktivet e saj për të gjeneruar të ardhura (Richard, 2009). Shembuj të zakonshëm të performancës financiare përfshijnë të ardhurat operative, të ardhurat para interesit, tatimet dhe vlerën neto të aktiveve. Është shumë e rëndësishme të theksohet se asnjë element i performancës financiare nuk duhet të

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

vlerësohet më vete. Përkundrazi, një vlerësim i plotë i performancës së një kompanie duhet të marrë parasysh shumë elementë të ndryshëm të performancës së saj. Kompanitë duhet të vlerësojnë dhe monitorojnë periodikisht nivelet e përfitimit të tyre, në mënyrë që të matin performancën financiare nëpërmjet përdorimit të elementëve të përfitimit të llogaritura e shpjeguara më sipër. Dy elementët më të njohur të përfitimit janë ROE dhe ROA. ROE mat fitimet kontabël për një periudhë për monedhë të kapitalit aksioner ndërsa ROA mat kthimin e çdo monedhe të investuar në aktive.

Ekzistojnë disa qasje analitike për vlerësimin e gjendjes financiare dhe performancës në institucionet financiare. Një ndër to është CAMELS, akronim për: Mjaftueshmërinë e kapitalit, Cilësinë e Aktiveve, Cilësinë e Menaxhimit, Fitimet, Likuiditetin dhe Ndjeshmërinë ndaj rrezikut të tregut.

3.1.2 Depozitat.


Depozitat u krijuan në vitin 1933 në prag të panikut bankar të viteve 1930-1933, kur rreth 10,000 banka tregtare në Amerikë dështuan. Niveli fillestar i sigurimit të depozitave individuale që mbulohej në bankat tregtare ishte 2,500 dollarë, në vitin 1934 kjo vlerë u rrit gjashtë herë, duke kapur shifrën prej 100,000 dollarësh në vitin 1980. Ndërmjet viteve 1945 dhe 1980, sigurimi i depozitave në bankat tregtare ka funksionuar me metodologji të qartë, pasi nuk kishte pasoja dhe numri i dështimeve individuale të bankave ishte shumë i vogël (Grafiku Nr. 4). Nga viti 1980 deri në vitin 1990, falimentimet e bankave u përshpejtuan, duke kapur një numër prej 1,039 bankash. Kulmi arriti në vitin 1988 me 221 banka të falimentuara. Ky numër falimentimesh ishte në fakt më i madh se sa të gjithë falimentimet e periudhës 1933-1979. Për më tepër, kostot e secilit prej këtyre falimentimeve ishin shpesh më të mëdha se kostot totale për

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

falimentimet e bankave kryesisht të vogla.

Depozitat e disa klientëve u shërbejnë bankave tregtare si burime për të financuar huatë që u ofrohen klientëve të tjerë. Sipas Stephen Simpson, depozitat janë burimet më të lira të fondeve për bankat tregtare dhe në këtë mënyrë depozitat kanë një ndikim pozitiv në përfitimin e këtyre institucioneve financiare nëse kërkesa për kredi është e lartë. Kjo do të thotë se sa më shumë depozita të grumbullojnë bankat tregtare, aq më e madhe është aftësia e tyre për të ofruar hua dhe për të gjeneruar fitime (Rasiah, 2010). Kërkimet e realizuara nga Husni (2011) mbi performancën e bankave tregtare në Jordani tregojnë se ekziston një marrëdhënie pozitive e rëndësishme midis ROA dhe totalit të detyrimeve ndaj totalit të aktiveve. Për të matur depozitat, Vong et al (2009) propozoi një model i cili paraqet efektin e depozitave mbi kthimin, si depozita ndaj raportit total të aktiveve.

Grafiku Nr.4 - Numri i bankave që kane falimentuar në periudhën 1934-2006



Burimi: Raporti Vjetor FDIC dhe të dhëna statistikore në www.fdic.gov (2005).

Ekzistojnë së paku dy pikëpamje, jo domosdoshmërisht të pavarura, që shpjegojnë se përse fondet e sigurimit të institucioneve depozituese i shndërruan këto në institucione ekonomike pa aftësi paguese, në një mjedis financiar të ndërlikuar dhe me

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

rrezik moral (Saunders & Cornett, 2008). Pikëpamja e parë, cilëson si shkak për paaftësinë paguese ngjarjet ose goditjet e jashtme, ku ngjarja më e rëndësishme ishte rritja dramatike e normave të interesit në periudhën 1979-1982. Ndërsa pikëpamje e dytë theksonte se efektet e mjedisit financiar ishin katalizatorë të krizës gjatë kësaj periudhe. Sigurimi i depozitave gjatë këtyre viteve u pa si një instrument i rëndësishëm për minimizimin e rrezikut. Saunders & Cornett (2008) në librin e tyre “Financial Institutions Management: A Risk Management Approach”, përcaktuan tre mënyra për sigurimin e depozitave në mënyrë që të reduktohet rreziku:

- Rritja e disiplinës së aksionerëve,
- Rritja e disiplinës së depozituesit,
- Rritja e disiplinës së rregullatorit.

Në mënyrë të veçantë, ridizenjimi i tipareve të kontratës së sigurimit mund të ndikojë direkt ose tërthorazi në stimulimin e marrjes së rrezikut nga aksionerët duke ndryshuar sjelljen e depozituesve dhe rregullatorëve.

3.1.3 Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit.

Rasiah (2010) dhe Vong et al (2009) përfshinë raportin e kapitalit (EQTA ose CTRA) si një ndryshore në studimin e tyre në lidhje me kthimin dhe performancën e bankave, pasi kapitali shërben gjithashtu si burim fondesh së bashku me depozitat dhe huamarrjen. Po ashtu ata argumentuan se struktura e kapitalit që përfshin fondet, rezervat dhe fitimet e pashpërndara ndikojnë në kthimin e bankave tregtare për shkak të efektit të levës dhe rrezikut.

Sipas Molyneux (1992) bankat me nivel të lartë kapitali mund të ulin koston e tyre të kapitalit, duke ndikuar pozitivisht në përfitime. Studimet empirike të paraqitura

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare


nga Karkrah & Ameyaw (2010) mbi përcaktuesit e përfitueshmërisë së bankave tregtare në Gana zbuluan se raporti i kapitalit neto që është edhe masa e fuqisë kapitale të bankave shënoi një lidhje pozitive me ROA-n e këtyre institucioneve.

Greuning (2009) thekson se kapitali duhet të ruhet si një mbrojtës ndaj humbjeve të mundshme nga rreziku i tregut, ndërsa Saunders & Cornett (2008) në librin e tyre e shprehin kapitalin si mjet primar për mbrojtjen nga rreziqet financiare. Kështu, sipas tyre, së pari kapitali shërben për të absorbuar humbjet e papritura, për të rritur besimin dhe për ti mundësuar institucionit financiar të vazhdojë ekzistencën në treg. Përveç kësaj, së dyti kapitali mbron palët e tjera të interesit, sidomos ata që janë të pasiguruar nga një garantues i jashtëm, si p.sh depozituesit dhe kreditorët. Së treti kapitali i një institucioni financiar ofron mbrojtje për fondet e sigurimeve dhe për tatimpaguesit që depozitojnë fondet e sigurimeve. Së fundmi, funksion tjetër i kapitalit është zvogëlimi i rrezikut të falimentimit, duke mbrojtur pronarët e institucioneve financiare kundër rritjes së primeve të sigurimit.

Sipas Hull (2012) mjaftueshmëria e kapitalit përkufizohet si shuma e kapitalit që një institucion financiar ka nevojë për të absorbuar humbjet mbi një vit me një nivel të caktuar besimi. Niveli i besueshmërisë është probabiliteti që banka nuk do të falimentojë (dmth., do të bëhet e paaftë të paguajë) në vitin e ardhshëm.

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

Figura Nr. 1 - Llogaritja e kapitalit ekonomik nga humbja e një viti e shpërndarë me X% nivel besimi



Burimi: Risk management and financial institutions, Third edition Hull (2012)

Përsa i përket kapitalit, ai ndahet në dy kategori: Kapital rregullator dhe Kapital jo rregullator (Figura Nr. 2).

Figura Nr. 2 - Kategorizimi i rreziqeve të ballafaquara nga një bankë dhe kërkesa për kapital rregullator



Burimi: Risk management and financial institutions, Third edition Hull (2012).

Jobst (2007) shkroi një artikull me titull "Operational Risk-The Sting is still in the Tail butthe Poison Depends on the Dose". Në këtë dokument autori hulumtoi

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

metodat e përgjithësuara të matjes parametrike të rrezikut operacional në përputhje me standardet e kapitalit rregullator për rrezikun operacional sipas Bazel II. Rreziku operacional zakonisht përkufizohet si rrezik i humbjes që rrjedh nga proceset e brendshme dhe sistemet e informacionit të papërshtatshme ose nga ngjarje të jashtme të paparashikuara. Analiza e Jobst (2007) përcaktoi një vlerësim të integruar të sasisë së ekspozimit të rrezikut operacional dhe konsistencën e rregullave aktuale të kapitalit mbi rrezikun operacional bazuar në vlerësimin parametrik të përgjithësuar. Megjithatë, studimi i Jobst (2007) u përqëndrua vetëm në rrezikun operacional dhe jo në rreziqet e tjera financiare.

3.1.4 Raportet e likuiditetit.

Likuiditeti përfaqëson aftësinë e bankës për të realizuar në mënyrë efikase shlyerjen e depozitave dhe detyrimeve të tjera si dhe për të mbuluar rritjen e financimit në portofolin e huave dhe investimeve. Likuiditeti është i nevojshëm për bankat që të kompensojnë luhatjet e bilancit të pritshëm dhe të paparashikuar si dhe të sigurojnë fonde për rritje. Një bankë ka potencial të përshtatshëm likuiditeti në momentin kur mund të marrë fondet e nevojshme menjëherë dhe me një kosto të arsyeshme. Çmimi i likuiditetit është një funksion i kushteve të tregut dhe perceptimit të tregut për rrezikshmërinë që shfaq institucioni huamarrës.

Kriza e kredive që filloi në mes të vitit 2007 theksoi rëndësinë e rrezikut të likuiditetit për institucionet financiare dhe rregullatorët e tyre. Shumë institucione financiare që mbështeteshin kryesisht në depozitat për financimin e tyre, përjetuan probleme pasi investitorët humbën besimin në institucionet financiare. Për më tepër, institucionet financiare zbuluan se shumë instrumente për të cilat më parë kishte patur

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

një treg likuid, mund të shiteshin vetëm me çmime në ofertë (fire-sale) gjatë krizës.

Sipas Wiley (2012) ekzistojnë dy lloje rreziqesh likuiditeti, rreziku i likuiditetit të tregut dhe rreziku i likuiditetit të financimit. Rreziku i likuiditetit të tregut ka të bëjë me lehtësinë me të cilën pozicionet në portofolin e tregtimit mund të mbyllen. Rreziku i likuiditetit të tregut të një aktivi varet nga natyra e aktivit, sasia dhe koha kur duhet të tregtohet aktivi, si dhe mjedisi ekonomik. Kriza e kredive e vitit 2007 theksoi rëndësinë e transparencës. Aktivitet që nuk janë të përcaktuara apo të kuptuara mirë, ka të ngjarë të mos tregtohen në një treg likuid për një kohë të gjatë. Likuiditeti i një aktivi në një kohë të caktuar mund të matet si aftësia për ta konvertuar shpejt dhe me pak kosto në mjet këmbimi. Institucionet financiare duhet të monitorojnë koston e zhvendosjes së gjithë portofolit të tregtimit si në kushtet normale të tregut ashtu edhe në kushtet e vështira të tregut.

Në po të njëjtin libër (Wiley, 2012) theksoi se rreziqet më serioze të likuiditetit lindin nga ato që nganjëherë quhen vrima të zeza të likuiditetit. Këto ndodhin kur të gjithë tregtarët duan të jenë në të njëjtën anë të tregut dhe në të njëjtën kohë, si pasojë e pozitave të ngjashme dhe menaxhimit të rreziqeve në mënyra të ngjashme. Kjo bën që tregtarët të jenë të paarsyeshëm, duke u ekspozuar ndaj rreziqeve të veçanta. Ajo që është e nevojshme në strategjitë tregtare të ndjekura nga pjesëmarrësit e tregut është diversiteti. Tregtarët që kanë objektiva afatgjata, duhet të shmangen nga reagimet afatshkurtra të tregjeve.

3.1.5 Madhësia e Bankës.

Performanca e bankave mund të ndikohet nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm (Aburime, 2005 & Sufian, 2011). Faktorët e brendshëm janë karakteristikat

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

individuale të bankës që ndikojnë në ecurinë e saj. Shumë studime kanë analizuar lidhjen e performancës bankare fokusuar në faktorët specifikë të sektorit (Chantapong, 2005; Olweny & Shipho, 2011; Azam & Siddiqoui, 2012). Në veçanti, ndikimi i madhësisë në performancën bankare diskutohet gjerësisht midis kërkuesve. Teoria ekonomike sugjeron që struktura e tregut ndikon në performancën e firmës pasi institucionet e mëdha mund të ofrojnë shërbime me kosto më të ulët derisa të vendosen disekonomitë e shkallës. Literatura ka treguar se lidhja midis madhësisë së bankës dhe kthimit mund të jetë pozitive ose negative (Staikouras & Wood, 2004; Athanasoglou Et al., 2008; Dietrich & Wanzenried, 2010; Naceur & Omran, 2011).

Vong et al (2009) dhe Rasiah (2010) e përfshinë pjesën e tregut dhe madhësinë e bankës në studimet e tyre si dy faktorë shumë të rëndësishëm në menaxhimin e rreziqeve financiare të bankave. Sipas Rasiah (2010) pjesa e tregut mund të përfshihet në modelin e përfitimit si një përcaktues i jashtëm, pasi nëse bankat tregtare zgjerojnë pjesën e tyre të tregut, atëherë ato mund të jenë në gjendje të rrisin të ardhurat e tyre dhe fitimin. Sipas Karkrah & Ameyaw (2010) pjesa e tregut ose madhësia e bankave normalisht përdoret për të analizuar ekonomitë e mundshme ose disekonomitë e shkallës në sektorin bankar. Për të analizuar efektin e pjesës së tregut ose të madhësisë së bankës në përfitueshmëri, Rasiah (2010) theksoi se si depozitat dhe kreditë përfaqësojnë rezultatin e bankave tregtare, dhe se si duhet të realizohet një zgjedhje midis depozitave dhe mjeteve që do të përdoren si përfaqësues të pjesës së tregut të bankave.

Kapitali bankar jep një efekt të rëndësishëm dhe pozitiv në përfitueshmërinë e bankave tregtare, pavarësisht se efekti i raporteve të likuiditetit në ROA ndryshon shumë sipas madhësisë së institucioneve financiare (Terraza, 2012). Bankat e mëdha tregtare të

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

prekura nga kriza e fundit financiare, shkaktuan probleme dhe dëme në ekonominë reale, duke ngritur një debat të madh mbi madhësinë optimale, kompleksitetin organizativ dhe gamën e aktiviteteve të bankave (Viñals et al., 2013). Ky debat zhvillohet përkundër sfondit të një panorame financiare që ka evoluar dukshëm gjatë dy dekadave të fundit, të nxitura nga risitë financiare dhe derregullimi financiar. Bankat e mëdha kohët e fundit janë rritur gjithnjë e më shumë në përmasa, kompleksitet dhe përfshirje në aktivitetet e tregut, si pasojë e sistemeve financiare gjithnjë e më globale dhe të ndërlydhura.

Brenda këtij debati, pikëpamjet mbi mënyrën optimale ndryshojnë. Disa autorë favorizojnë shpenzimet kapitale në bankat e mëdha, sipas Bazel III, ndërsa të tjerë përkrahin kufizimet mbi aktivitetet e bankave në bazë të tregut, siç është rregulli Volcker në Shtetet e Bashkuara ose raportet Vickers dhe Liikanen në Europë. Megjithatë, ka autorë që theksojnë rëndësinë e reduktimit të subvencioneve "shumë të mëdha për të falimentuar ose too-big-to-fail" (Farhi & Tirole, 2012; Stein, 2013), ose përmirësimin e zgjidhjes së bankave (Claessens et al., 2011), duke përfshirë rolin e kapitalit të kushtëzuar. Duke qënë se kjo shumëllojshmëri pikëpamjesh është e pashmangshme, duke pasur parasysh rrethana të ndryshme, është e rëndësishme të arrihet përfundimisht një politikë e koordinuar globalisht. Në një sistem financiar global të modernizuar, vetëm një qasje e tillë e koordinuar mund të parandalojë përhapjen në të gjitha juridiksionet dhe të sigurojë stabilitetin financiar botëror (Viñals et al., 2013).

3.2 Lidhja ndërmjet rreziqeve financiare dhe përfitueshmërisë së bankave tregtare.

Menaxhimi bankar synon të arrijë fitimin monetar, pra një performancë të lartë bankare. Stabiliteti dhe ritmi i rritjes së fitimit janë treguesit më të mirë të performancës së bankave dhe i gjithë sistemi bankar. Një nga mjetet më efikase për matjen e performancës së bankës është sistemi i treguesve financiarë. Indikatorët e performancës tregojnë situatën e një banke në një kohë të caktuar dhe interpretimi i tyre i lejon menaxherët të marrin masat e duhura për funksionimin e bankës në të ardhmen.

Përfitueshmëria tregon aftësinë e bankës për të marrë përsipër rreziqe dhe për të zgjeruar biznesin. Treguesit e përdorur në vlerësimin e përfitueshmërisë së bankës janë kthimi nga kapitali i vet (ROE), kthimi nga aktivet (ROA) dhe raporti i kapitalit. Për të zbuluar tendencat e përfitimit, të gjithë këta tregues monitorohen gjatë një periudhe të caktuar kohore. Nga treguesit e mësipërm, kthimi nga kapitali i vet (ROE) është shprehja më e rëndësishme e fitimit që nxjerr në pah rezultatet e menaxhimit më të gjerë financiar dhe tregon për aksionerët nëse investimet e tyre janë efikase (Cociú & Chirleúan, 2007).

Bankat duhet vazhdimisht ta pozicionojnë veten në drejtim të rrezikut dhe përfitueshmërisë. Menaxhimi i rrezikut nuk ka kuptim pa kthimin e pritshëm, pasi synimi i tij është optimizimi i marrëdhënies ndërmjet rrezikut dhe përfitueshmërisë. Menaxhimi i rrezikut tregon se si disa indikatorë të përfitueshmërisë duhet të mbahen në kufij të caktuar (Nagy 2012). Sa i përket aktivitetit bankar, performanca shoqërohet me krijimin e vlerës së shtuar, një raport optimal midis kostos dhe përfitimeve. Gjithashtu investimet në teknologjinë e sistemit bankar kanë çuar në rritjen e rrezikut, duke krijuar

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

kështu një lidhje të natyrshme midis performancës dhe rrezikut. Përtej sistemit bankar, performanca është gjendja e karakterizuar nga vendimet e stabilitetit, legjislacioni, monitorimi dhe koordinimi i kujdesshëm "i lojtarëve" (Bolocan, 2011).

Motivet e kompanisë për menaxhimin e rreziqeve financiare janë të shumta. Një nga motivet kryesore është reduktimi i paqëndrueshmërisë së fitimeve ose e rrjedhës së parasë për shkak të ekspozimit ndaj rrezikut financiar (Dhanini, 2007). Reduktimi i rrezikut i mundëson kompanisë të kryejë parashikime më të mira (Drogt & Goldberg, 2008). Po ashtu, reduktimi i rrezikut e ndihmon kompaninë të sigurojnë fonde të mjaftueshme në dispozicion për tu investuar në kompani (Ammon, 1998). Një arsye tjetër e menaxhimit me sukses të rreziqeve financiare është shmangia e ankthit financiar dhe kostove lidhur me të (Triantis, 2000; Drogt & Goldberg, 2008). Së fundmi, menaxhimi i rrezikut financiar lidhet me stabilitetin e fitimeve, me qëllim mbajtjen e një niveli konstant të taksave (Dhanini, 2007). Në varësi të argumenteve të përmendura më sipër, kompania strukturon menaxhimin e rrezikut, duke u fokusuar në minimizimin e luhatshmërisë ose duke shmangur humbjet e mëdha (Ammon, 1998). Reduktimi i paqëndrueshmërisë në rrjedhat e parasë si dhe parandalimi i humbjeve i mundëson kompanisë një planifikim më të mirë në nevojat për likuiditet. Kjo mund të shmangë mangësitë e fondeve në dispozicion dhe konsumin e kapitalit (Eichhorn, 2004). Për të ruajtur financiarisht likuiditetin dhe për të shmangur humbjet në fund të periudhës, ajo që duhet të analizohet nga bankat është humbja maksimale e toleruar. Vëmendja e menaxhimit të rrezikut duhet të jetë në përputhje me gjendjen aktuale financiare të kompanisë.

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

Stabiliteti financiar është përcaktuar si gjendja në të cilën sistemi financiar mund të përballojë tronditjet financiare dhe pabarazitë në procesin e ndërmjetësimit financiar (Crockett & Ferguson, 2003). Performanca e bankës nga këndvështrimi i aksionerëve të një banke është arritja e fitimit duke maksimizuar të ardhurat dhe duke minimizuar kostot. Teoritë ekonomike tregojnë se, në situatën e konkurrencës së përsosur, maksimizimi i fitimit është i barabartë me minimizimin e kostove, pavarësisht se në praktikë, ndërhyrja e faktorëve të tillë si ndryshimet në kuadrin rregullator, pengojnë arritjen e performancës së dëshiruar. Faktorët që shpjegojnë devijimin e fitimit mund të grupohen në dy kategori: iniciativa të pasakta dhe paaftësi (Bikker & Bos, 2008). Performanca totale e një banke karakterizohet nga rezultatet e saj të përgjithshme, që merren nga niveli i përfitueshmërisë i lidhur me rreziqet e marra nga banka në fjalë (Olteanu, 2003). Në literaturë, performanca bankare shprehet nëpërmjet indikatorëve të përfitueshmërisë dhe qëndrueshmërisë financiare ose rrezikut. Për shkak se kontrolli i rreziqeve bankare është një faktor që varet nga përfitueshmëria e bankës, interpretimi i treguesve të rrezikut duhet të realizohet përmes shkaqeve, pasojave dhe efekteve mbi përfitueshmërinë e bankës (Stoica, 1999). Duke patur parasysh se bankat luajnë një rol kryesor në ndërmjetësimin financiar, analiza e performancës së bankave duhet të kryhet në aspektin e efikasitetit, produktivitetit, konkurueshmërisë dhe rentabilitetit.

Ecuria globale e bankave jepet nga raporti midis fitimit dhe rrezikut. Në pasqyrat financiare të një banke llogaritet një numër i madh treguesish financiarë që bazohen në rezultate bruto të lidhura ngushtë me rrezikun e marrë nga banka dhe karakterizohen nga ecuria e këtij institucioni. Informacioni i dhënë nga treguesit e performancës është i dobishëm jo vetëm për përdoruesit e brendshëm të bankës (aksionarët, menaxherët e

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

përgjithshëm, të punësuarit, etj.), por edhe për përdoruesit e jashtëm të saj (mbikëqyrësit bankar, qeveria, klientët jobanka, klientët bankarë, institucionet e vlerësimit etj.) Aktiviteti bankar karakterizohet nga disa rreziqe financiare (rreziku i normës së interesit, rreziku i likuiditet, rreziku i kursit të këmbimit, rreziku operacional, rreziku i kredisë) që ndikojnë drejtpërdrejt në performancën e këtyre institucioneve (Apătachioae, 2015). Një menaxhim i mirë i rreziqeve financiare minimizon humbjet dhe lejon arritjen e objektivave të bankës.

3.3 Rreziku i kredisë.

Rreziku financiar është një koncept i studiuar prej kohësh nga autorë të ndryshëm, pavarësisht se nuk ka një përkufizim universal për të. Gallati (2003) e përkufizon rrezikun si një gjendje në të cilën ekziston një ekspozim ndaj vështirësive, ose një gjendje në të cilën ekziston mundësia e devijimit nga një rezultat i dëshiruar që pritet ose shpresohet. Përkufizimet e tjera e përcaktojnë rrezikun bazuar në ngjarjet reale, duke përfshirë një kombinim të rrethanave në mjedisin e jashtëm (Bessis, 2002; Machiraju, 2008; Schroeck, 2002). Por për fat të keq ky përkufizim nuk merr parasysh rrethanat në mjedisin e brendshëm. Shumë kriza në ekonomi dhe në industrinë e shërbimeve financiare ndodhin për shkak të problemeve brenda organizatave. Termi rrezik përdoret për të përcaktuar potencialin për humbje. Tregjet financiare dhe rreziqet kanë ndryshuar vazhdimisht gjatë dekadave të fundit.

Rreziku përbën një element shumë të rëndësishëm i cili përcakton sjelljet financiare. Pa rreziqet, sistemi financiar do të thjeshtësohej shumë. Megjithatë, në botën reale rreziku është i pranishëm dhe institucionet financiare duhet ta menaxhojnë atë në mënyrë efikase për të mbijetuar në këtë mjedis jo të sigurtë. Vetëm ato institucione

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

financiare që kanë një sistem efikas të menaxhimit të rrezikut do të mbijetojnë në treg për një periudhë afatgjatë. Bankat me përvojë në menaxhimin e rreziqeve financiare kanë përparësi konkurruese në treg. Këto institucione marrin rreziqe me vetëdije, parashikojnë ndryshimet e pafavorshme dhe mbrojnë veten nga këto ndryshime.

Disa nga llojet e rreziqeve financiare me të cilët përballen bankat tregtare janë (Bessis, 2000):

- Rreziku i kredisë,
- Rreziku i normës së interesit,
- Rreziku i kursit të këmbimit,
- Rreziku operacional,
- Rreziku i likuiditetit.

Rreziku më i madh financiar me të cilin përballen bankat tregtare është rreziku i kredisë.

Por çfarë është rreziku i kredisë?

Rreziku i kredisë u shfaq si një çështje e rëndësishme e administrimit të rrezikut gjatë viteve 1990. Në tregjet gjithnjë e më konkurruese, bankat ndërmarrin rreziqe gjithnjë e më të mëdha përsa i përket kredidhënies. Rreziku i kredisë është faktori kryesor për nga rëndësia dhe madhësia e humbjeve që i shkakton bankës. Ky rrezik përcaktohet thjesht si mundësia që një huamarrës i një banke do të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të tij ndaj bankës sipas kushteve të përcaktuara në kontratë midis dy palëve (Greuning & Bratanovic, 2009). Duke qenë se rreziku i kredisë është faktori kryesor i falimentimit të bankës, atëherë është e kuptueshme se menaxhimi në mënyrë efikase i tij merr një rëndësi vendimtare për mbijetesën e biznesit bankar. Në mënyrë që të minimizohet rreziku i kredisë, është thelbësore t'i kushtohet vëmendje burimeve potenciale të

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

originës së tij. Strukturat menaxhuese të bankës duhet të monitorojë rrezikun e kredisë, duke patur parasysh pikat e mëposhtme:

- Përzgjedhje e rreptë e huamarrësve potencial,
- Kufizim i shumës së huamarrjes tek një klient i vetëm ose një grup klientësh,
- Diversifikim i kreditimit.

Në menaxhimin e rrezikut të kredisë, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përzgjedhjes së kërkesave për kredi, të cilat duhet të kryhen me kujdes për të vlerësuar në mënyrë të menjëhershme kapacitetin kreditues të huamarrësve. Objektivi kryesor i menaxhimit të rrezikut kreditues është parandalimi i marrjes së huave nga konsumatorë të cilët janë të paaftë për t'i kthyer ato. Një studim mbi falimentimin e bankave i realizuar në NewEngland zbuloi se, 62 banka tregtare falimentuan nga viti 1989 deri në vitin 1992, ku në 58 prej tyre u konstatuan probleme me kthimin e kredisë në kohë. Kjo nënkupton rolin dhe rëndësinë që ka menaxhimi i rrezikut të kredisë në mbarëvajtjen e sistemit bankar (Sabrani, 2002).

3.3.1 Matja e rrezikut të kredisë.

Sipas Altman & Saunders (1998), katër modelet kryesore për matjen e rrezikut të kredisë janë:

1. sistemet e ekspertëve,
2. rrjetet neurale artificiale,
3. sistemet e vlerësimit, duke përfshirë sistemet e vlerësimit të brendshëm të bankës,
4. sistemet e vlerësimit të kredive.

➤ Sistemet e ekspertëve:

Në një sistem ekspertësh, vendimi i kredisë i takon oficerit të kredidhënies së

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

degës. Në mënyrë implicite, ekspertiza e këtij personi, gjykimi subjektiv dhe vlerësimi i disa faktorëve kryesorë janë përcaktuesit më të rëndësishëm në vendimin për dhënien e kredisë. Një nga sistemet më të zakonshme të ekspertëve është ai i *Pesë "C-ve"* të kredisë (Character, Capital, Capacity, Collateral, Cycle conditions). Oficeri i kredidhënies analizon këto faktorë kryesorë dhe në bazë të saj arrin të marrë një vendim në lidhje me dhënien e kredisë (BIS, 1999).

Më poshtë jepet një shpjegim i shkurtër i *Pesë "C-ve"*

1. *Karakter*. Një njësi matëse e reputacionit të firmës, gatishmëria e saj për të shlyer dhe historia e saj e pagesave.
2. *Kapitali*. Kontributi i kapitalit të pronarëve dhe raporti i tij ndaj borxhit. Këto elementë shihen si parashikues të mirë të probabilitetit për të falimentuar.
3. *Kapaciteti*. Aftësia për të shlyer, e cila pasqyron paqëndrueshmërinë e të ardhurave të huamarrësit. Nëse ripagimet në kontratat e borxhit ndjekin një rrymë konstante me kalimin e kohës, por fitimet janë të paqëndrueshme (ose kanë devijime të larta standarde), mund të ketë periudha kur kapaciteti i firmës për të shlyer pretendimet e borxhit është i kufizuar.
4. *Garancia*. Në rast të vonesës, një bankier ka pretendime mbi kolateralin e zotuar nga huamarrësi. Sa më i madh të jetë ky prioritet dhe sa më e madh të jetë vlera e tregut e kolateralit bazë, aq më i ulët do të jetë rreziku i ekspozimit ndaj kredisë.
5. *Kushtet Ekonomike*. Gjendja ekonomike e biznesit. Një element i rëndësishëm në përcaktimin e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë.

Përveç pesë "C-ve", një ekspert duhet të marrë parasysh edhe nivelin e normave të interesit. Siç dihet edhe nga teoria ekonomike, marrëdhënia ndërmjet nivelit të

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

normave të interesit dhe kthimit të pritshëm të një kredie është jolineare (Stiglitz & Weiss, 1981). Pra, një rritje e normave të interesit, mund të ulë kthimin e një kredie. Kjo marrëdhënie negative midis normave të larta të kredisë dhe kthimit të pritshëm ndodh për shkak të (1) përzgjedhjes së pafavorshme dhe (2) zhvendosjes së rrezikut. Kur normat e kredisë rriten përtej një pike, huamarrësit potencial e braktisin tregun e kredive. Ata preferojnë të vetëfinancojnë projektet e tyre të investimeve (përzgjedhje të pafavorshme). Në këtë rast, huamarrësit e mbetur, me përgjegjësi dhe kapital të kufizuar, kanë prirjen për t'u zhvendosur drejt projekteve me nivel të lartë rreziku (zhvendosje e rrezikut).

➤ Rrjetet neurale artificiale:

Zhvillimi i një sistemi të kompjuterizuar kërkon marrjen e njohurive nga ekspertët e fushës. Për shkak se ky angazhim kërkon kohë, shumë sisteme përdorin faktorin human për realizimin e këtyre vendimeve. Elmer & Borowski (1988) krahasuan parashikimet e falimentimit të një sistemi me disa modele të vlerësimit të kredive dhe konstatuan se sistemi parashikonte saktë mbi 60% të dështimeve, 7 deri në 18 muaj para falimentimit. Në mënyrë të ngjashme, Messier & Hansen (1988) treguan se sistemi i tyre tejkalon modelet e vlerësimit të kredive dhe vetë ekspertët e fushës në parashikimin e dështimeve të biznesit.

Disavantazhet e sistemeve të ekspertëve përfshijnë:

1. Kohën dhe përpjekjet e nevojshme për të përkthyer proceset e vendimeve të ekspertëve të fushës në një sistem rregullash.
2. Vështirësitë dhe shpenzimet që lidhen me programimin e algoritmit të vendimit dhe mbajtjen e sistemit.

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

3. Pamundësitë e sistemit të ekspertëve për t'iu përshtatur kushteve të ndryshimit.

Rrjetet neurale artificiale si një pjesë e inteligjencës artificiale janë propozuar si zgjidhje për këto probleme. Sistemi tregon natyrën e marrëdhënieve midis inputeve dhe rezultateve duke përzgjedhur në mënyrë të përsëritur grupet e informacionit të input/output. Rrjetet neurale artificiale kanë një avantazh të veçantë mbi sistemet e ekspertëve në momentin kur të dhënat janë jo të plota. Altman, Marco & Varetto (1994) shqyrtuan 1.000 firma industriale italiane nga viti 1982 deri në vitin 1992 dhe konstatuan se rrjetet neurale kanë të njëjtin nivel saktësie me modelet e vlerësimit të kredive.

➤ Vlerësimet e brendshme të bankës:

Një nga sistemet më të vjetra të vlerësimit të kredive u zhvillua nga Zyra Amerikane e Kontrollorit të Valutave. Sistemi u përdor në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga rregullatorët dhe bankierët për të vlerësuar mundësinë e humbjes së rezervave të kredisë. Sistemi i vlerësimit vendos një portofol ekzistues të kredisë në pesë kategori, përkatësisht katër vlerësime me cilësi të ulët dhe një vlerësim me cilësi të lartë.

Sipas Fadil (1997), bankierët e zgjeruan sistemin e vlerësimit të kredive duke zhvilluar sistemet e vlerësimit të brendshëm. Aktualisht, vlerësohet se rreth 60% e kompanive bankare amerikane zhvilluan sistemet e brendshme të vlerësimit për kredi me një shkallë prej 1 deri në 9 ose 1 deri në 10. Miratimi i vlerësimeve të brendshme për vlerësimin e kërkesave të kapitalit rregullator ka potencialin ta deformojë integritetin e sistemit të klasifikimit, veçanërisht nëse bankat e shohin kapitalin si të kushtueshëm dhe dëshirojnë ta minimizojnë atë. Nisur nga kjo, mbikqyrësve në bankë do t'iu duhet të vërtetojnë saktësinë e një shumëllojshmërie të gjerë sistemesh vlerësimi të brendshëm

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

(Belkin, Suchower, Wagner, & Forest, 1998).

Tabela Nr. 3 – Vlerësimi dhe klasifikimi i rrezikut të kredisë

Fitch	Moody's	S&P	Summary Description
<i>Investment grade</i>			
AAA	Aaa	AAA	Gilt edged, prime, maximum safety, lowest risk, and when sovereign borrower considered "default-free"
AA+	Aa1	AA+	High-grade, high-credit quality
AA	Aa2	AA	
AA-	Aa3	AA-	
A+	A1	A+	Upper-medium grade
A	A2	A	
A-	A3	A-	
BBB+	Baa1	BBB+	Lower-medium grade
BBB	Baa2	BBB	
BBB-	Baa3	BBB-	
<i>Speculative Grade</i>			
BB+	Ba1	BB+	Low grade; speculative
BB	Ba2	BB	
BB-	Ba3	BB-	
B+	B1	B	Highly speculative
B	B		
B-	B3		
<i>Predominantly speculative, Substantial Risk or in Default</i>			
CCC+	Caa	CCC+	Substantial risk, in poor standing
CCC		CCC	
CC	Ca	CC	May be in default, very speculative
C	C	C	Extremely speculative
		CI	Income bonds - no interest being paid
DDD			Default
DD			
D		D	

Burimi: Fabozzi, Mann & Choudhry (2003).

➤ Sistemet e vlerësimit të kredive:

Sistemet e vlerësimit të kredive mund të gjenden pothuajse në të gjitha llojet e analizave të kredisë, nga kredia konsumatore deri tek kredia tregtare. Këto sisteme identifikojnë dhe kombinojnë faktorët kryesorë që përcaktojnë probabilitetin e humbjes, duke nxjerrë një rezultat sasior. Rezultati mund të përdoret si një sistem klasifikimi duke e vendosur një huamarrës potencial në një grup të mirë apo të keq. Ekzistojnë katër forma metodologjike të modeleve multifaktoriale të vlerësimit të kredive: (1) modeli i

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

probabilitetit linear, (2) modeli logit, (3) modeli probit dhe (4) modeli i analizës përshkruese (Basak & Shapiro, 2001).

3.3.2 Modelet e rrezikut të kredisë.

Në identifikimin e rrezikut të kredisë, një nga çështjet më të rëndësishme është përcaktimi i një ngjarje e cila tregon se humbja ka ndodhur. Natyrisht, ngjarja e kredisë konsiston në dështimin e pagesave. Megjithatë, çështja shtrohet se si përcaktohet një kredi jo-performuese që nuk është shlyer për një periudhë kohore nga huamarrësi. Për shembull, nëse klienti është me vonesë 10 ditë, kjo mund të tregojë tashmë se ai ose ajo ka disa probleme në lidhje me shlyerjen e kredisë. Prandaj, është e rëndësishme të përcaktohet siç duhet pragu kohor i cili e klasifikon kredinë si me probleme. Në supozimet e menaxhimittë rrezikut të kredisë, një hua konsiderohet si jo-performuese kur klienti ka kaluar të paktën 90 ditë (3 muaj) pa paguar.

Modelet e rrezikut të kredisë mund të klasifikohen në dy kategori të mëdha (Standard & Poor's Credit Model , 2000):

a) *Modelet strukturore*: Këto modele supozojnë se mosshlyerja e borxhit (default) mund të shkaktohet nga një veprim i caktuar, për shembull nga një rënie e vlerës së aktiveve nën pragu e caktuar (vlera e borxhit). Vetë vlera e aktiveve është modeluar si një proces stokastik.

b) *Modelet me formë të reduktuar*: Këto modele supozojnë se dështimet ndikohen nga intensiteti i borxhit. Nuk supozohet asnjë ngjarje specifike, por intensiteti i mosshlyerjes së borxhit (default) mund të varet nga ndryshimet në faktorët e jashtëm (rritja e GDP-së, inflacioni, papunësia, normat e interesit etj.). Kjo marrëdhënie vlerësohet duke përdorur të dhëna historike dhe teknika ekonometrike. Më poshtë paraqiten disa nga modelet e

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

rrezikut të kredisë:

➤ Merton and KMV model:

Modeli Merton është një nga modelet strukturore. Modeli vlerëson probabilitetin e shlyerjes së borxhit të një korporate bazuar në një strukturë të thjeshtë të bilancit të saj. Bilanci përbëhet nga aktivet (At) dhe detyrimet, ku kjo e fundit mund të ndahet më tej në borxh (Dt) dhe kapital (Et), dmth $At = Dt + Et$. Ashtu si në modelet e tjera të strukturës, ka një variabël të pandryshueshëm, i cili bazohet në një variabël të ndryshueshëm. Në rastin e modelit Merton, variabli i ndryshueshëm është vlera reale e aktiveve (At). Megjithatë, ky variabël nuk është drejtpërdrejtë i vëzhgueshëm, sepse dihet vetëm vlera kontabël e aktiveve të firmës. Përveç kësaj, vlera e aktiveve nuk është e përditshme, pasi ajo raportohet zakonisht nga kontabiliteti në baza tremujore. Supozimi kryesor i modelit është që firma dështon kur vlera reale e aktiveve ulet nën vlerën e borxhit të saj në kohën e maturimit.

Modeli KMV është një përmirësim i modelit Merton i propozuar dhe përdorur nga Moody, zbatuar kryesisht në fushat e mëposhtme:

- Struktura e borxhit,
- Pragu për mosshlyrjen e borxhit (default),
- Shpërndarja e humbjeve.

Një nga përparësitë kryesore të modelit KMV është se ai mund të përshtatet shumë shpejt me çdo informacion që lidhet me përkeqësimin e gjendjes financiare të firmës, me kushtin që ky informacion të kapet nga ndryshimet në çmimet e kapitalit (Shimko, 1999). Dobësia kryesore është se modeli jep rezultate të arsyeshme vetëm pasi ka marrë parasysh rregullimet e propozuara në modelin KMV, të cilat janë mjaft arbitrare.

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

➤ CreditMetrics:

CreditMetrics u prezantua në vitin 1997 nga J. P. Morgan. Parimi bazë i CreditMetrics është modelimi statistikor i ndryshimeve në vlerësimet (vlerësime të jashtme ose të brendshme) e investimeve individuale (obligacione ose kredi) në portofolin e bankës. Ky është një model i reduktuar, pasi bazohet në vlerësimin e mundshëm të ndryshimit të kredisë dhe nuk mbështetet në ndonjë faktor të fshehur ose ngjarje që sjellin këto ndryshime. Rezultati i këtij modeli lidhet me shpërndarjen e vlerës ekonomike të portofolit të një viti më parë (i shprehur në vlerën aktuale në atë kohë). Përparësitë kryesore të këtij modeli krahasuar me modelin Merton/KMV janë:

- CreditMetrics ka ndjeshmëri më të ulët ndaj problemeve që ndodhin në periudha afatshkurtër.
- Përdorimi i matricave të përlllogaritura në një periudhe afatgjatë, lejon matjen e sasisë së rrezikut të kredisë, i cili zakonisht nuk ndryshon gjatë ciklit ekonomik.

Nga ana tjetër, një nga dobësitë kryesore të këtij modeli është se ndryshimet në vlerësim janë më të vonuara në krahasim me sinjalet e tregut. Modeli bazohet në supozimin se probabiliteti i një ndryshimi të veçantë të vlerësimit varet vetëm nga vlerësimi aktual, pavarësisht nga historia e ndryshimeve të mëparshme. Ky supozim është qartazi jo i saktë. Pasi në praktikë, nëse një firmë kohët e fundit në historikun e saj ka regjistruar përkeqësime në vlerësimin e kredive është më e prirur drejt një rënie sesa një firmë e cila ka pasur një vlerësim të qëndrueshëm ose përmirësim për një periudhë të gjatë (J.P.Morgan, 1997).

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

➤ Credit Portfolio View (CPV):

Modeli i CPV supozon se probabiliteti i shlyrjes së borxhit ndryshon në kohë dhe varet nga një grup i variablave makroekonomikë. Për shembull, është e arsyeshme të supozohet se probabiliteti i mosshlyrjes së borxhit rritet në një recesion i cili karakterizohet nga një rënie në GDP dhe rritje në papunësi. Avantazhi kryesor i këtij modeli është se ai mund të zbatohet lehtësisht në portofolet e shitjes me pakicë (p.sh. hipotekat ose kreditë konsumatore) si dhe kreditë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Ndryshe nga modelet e mëparshme, ky model nuk mbështetet në informacione që lidhen me çmimet e kapitalit. Në aplikimet praktike, modeli shpesh zgjerohet duke përfshirë indikatorë të tjerë përveç variablave makroekonomikë. Këta indikatorë mund të grumbullohen për të gjithë sektorët dhe nën-segmentet, ose mund të përfshihen si karakteristika specifike të firmës (Basel Committee on Banking Supervision 1999).

➤ Credit Risk +:

Ky model u propozua nga Credit Suisse. CreditRisk + është një model i bazuar në simulime. Parimi bazë i këtij modeli thekson se numri i kredive dhe madhësia e humbjeve janë modeluar në mënyrë të pavarur bazuar në disa supozime të këtyre dy shpërndarjeve.

3.3.3 Proceset e menaxhimit të rrezikut të kredisë.

Siç u theksua edhe më sipër, menaxhimi i rrezikut të kredisë është një proces i rëndësishëm për mbarëvajtjen e sistemit bankar. Secila bankë duhet të zbatojë një skemë vlerësimi në përputhje me të gjitha mundësitë e saj të investimit në mënyrë që vendimet e kredisë të bëhen në mënyrë konsistente dhe raportimi rreth ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë të jetë kuptimplotë. Për të lehtësuar këtë, kërkohet një shkallë e konsiderueshme


Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

e standardizimit të procesit dhe dokumentacionit. Kjo ka çuar në vlerësime të standartizuara të të gjithë huamarrësve dhe në një raport të portofolit të kredisë që paraqet informacion kuptimplotë për cilësinë e përgjithshme të portofolit të kredisë (Richard, 2008). Në disa institucione, ekziston një sistem i dyfishtë ku vlerësohen si huamarrësi ashtu edhe objekti i kredisë. Disa banka preferojnë një sistem të tillë të dyfishtë. Fokusi i analizës së rrezikut nuk është për të eliminuar rrezikun, por për të kuptuar efektin e saj në aftësinë e klientit për të shlyer detyrimin.

Procesi i menaxhimit të rrezikut të kredisë mund të strukturohen në 5 faza, të cilat mund të përmbliidhen në tre pika (Jarrow & Yu, 2001; Kang & Kim, 2005):

- Identifikimi i rrezikut (Rating),
- Vlerësimi i rrezikut (Kosto),
- Kontrolli i rrezikut (Cmimi, Monitorimi, Zgjidhja).

Figura Nr. 3 - Procesi i menaxhimit të rrezikut të kredisë



Burimi: Jarrow & Yu, (2001); Kang & Kim, (2005).

Qëllimi i vlerësimit (rating) është të përcaktojë rrezikun që paraqet huamarrësi. Për këtë qëllim, bankat kryejnë vlerësimin e kredisë përpara se ti japin para një klienti. Përveç kontrollit personal të kredibilitetit, një vlerësim kredie kryhet edhe për të përcaktuar probabilitetin e dhënies së kredisë .

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

Qëllimi i fazës së kostos është të përcaktojë sasinë e humbjes së pritshme nga huadhënia, bazuar në probabilitetin e dhënies së huasë. Humbja e parashikuar është humbja e pritur kur një huamarrës falimenton. Në fazën e çmimeve, kostot e identifikuar janë të integruara në kushtet e kreditimit. Gjatë periudhës së huasë, kredia vëzhgohet dhe ndryshimet në riksun e kredisë monitorohen. Nëse humbja e pritur nga një huamarrës rritet, duhet të analizohen arsyet dhe të merren masa për korigjim. Ndërsa objektivi i fazës së zgjidhjes, ka të bëjë me zvogëlimin e humbjeve dhe nëse është e mundur, kthimin e huasë. Zgjidhjet janë të ndryshme nga një bankë në tjetrën.

3.3.4 Marrëveshjet e Bazelit për rrezikun e kredisë.

Institucionet financiare ndërkombëtare duhet t'i kushtojnë vëmendje të konsiderueshme standarteve mbikëqyrëse në mënyrë që bankat, depozituesit dhe investitorët të mund të mbrojnë veten nga rreziqet, të cilët janë pjesë përbërëse e biznesit bankar. Për të kontrolluar operacionet e biznesit bankar duke zbatuar standarte të përbashkëta të mbikëqyrjes, u pa e nevojshme që të krijohej një organ i cili do të ishte përgjegjës për koordinimin dhe përcaktimin e standarteve që do të zbatoheshin. Këto standarte u përcaktuan nga Komisioni i Komuniteteve Europiane dhe Komiteti i Bazelit. Komisioni i Komuniteteve Europiane kishte për detyrë të formonte standarte të përbashkëta të mbikëqyrjes, të cilat do të zbatoheshin në vendet e BE-së. Guvernatorët e Bankave Qëndrore të shteteve anëtare themeluan Komitetin e Bazelit në vitin 1974. Komiteti mbledhet katër herë në vit dhe anëtarët e saj janë përfaqësues të Belgjikës, Gjermanisë, Kanadasë, Itali, Luksemburg, Japoni, Hollandë, Spanjë, Suedi, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA (McNeil, Frey & Embrechts, 2005). Funkcioni i Komitetit të Bazelit lidhet me formulimin e standarteve të përgjithshme mbikëqyrëse, udhëzimeve si

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

dhe ofrimin e shembujve të praktikave më të mira bankare. Këto standarte diskutohen nga autoritetet legjislative të çdo vendi anëtar duke marrë masa për zbatimin e tyre sipas specifikave të secilit shtet. Pas miratimit të legjislacionit kombëtar, rekomandimet e Komitetit të Bazelit bëhen përfundimtare dhe detyruese për vendet që kanë vendosur t'i zbatojnë ato (Barjaktarović, 2009).

Komiteti i raporton guvernatorëve të vendeve anëtare për miratimin e planeve dhe iniciativave të tyre. Vendimi i komitetit ka të bëjë me fusha të ndryshme. "Një nga fushat më të rëndësishme lidhet me harmonizimin e dallimeve që ekzistojnë në kuadrin e mbikëqyrjes ndërkombëtare me qëllim zbatimin e parimeve themelore" (Barjaktarović, 2009).

➤ Marreveshja Basel I:

Në vitin 1987, përfaqësuesit e vendeve kryesore industriale në kuadër të Komitetit të Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare njoftuan një marrëveshje paraprake mbi standardet bankare dhe të kapitalit (marrëveshja Basel I). Bazeli zyrtarisht hyri në fuqi në vitin 1988 dhe aplikimi i tij efektiv filloi në vitin 1992. Që nga viti 1998, kjo marrëveshje u aplikua pothuajse në të gjitha vendet ku bankat veprojnë në nivel ndërkombëtar, rreth 100 shtete. Bazel I kryesisht fokusohet në rrezikun e kredisë (De Stefano, 1999).

Përparësitë dhe efektet pozitive të zbatimit të Basel I janë:

- rritja e mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave ndërkombëtare;
- struktura relativisht të thjeshta;
- i zbatueshëm në vende të ndryshme të botës;
- forcimi i konkurrencës së bankave në nivel ndërkombëtar;

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

- rritja e disiplinës në procesin e menaxhimit të kapitalit;
- pikë referimi për vlerësimin e bankave të kryera nga pjesëmarrësit në tregun financiar.

Por përvec përfitimeve dhe efekteve pozitive, me kalimin e kohës Bazal shfaqti edhe disa disavantazhe të paraqitura si më poshtë:

- mjaftueshmëria e kapitalit varet nga rreziku i kredisë, ndërsa rreziqet e tjera (p.sh. tregu dhe operimi) janë lënë jashtë analizës;
- gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë, nuk ka dallim midis debitorit dhe vlerësimeve të ndryshme të cilësisë;
- theksi mbi kontabilitetin dhe jo mbi vlerat e tregut;
- shqyrtim jo i përshtatshëm i rrezikut, efekteve të përdorimit të instrumenteve financiare moderne, si dhe teknikave të zbutjes së rreziqeve financiare.

Për të përcaktuar rrezikun e nevojshëm të kapitalit aktiv, kjo marrëveshje përcakton pesë kategori rreziku me peshat përkatëse, të paraqitura si më poshtë:

- nuk ka peshë rreziku, pesha 0% - e lidhur me rezervat, letrat me vlerë të qeverive qendrore dhe bankat qendrore të vendeve të OECD;
- rreziku i ulët, pesha 10% - subjekte të sektorit publik, duke përjashtuar bankat qendrore;
- rreziku i ulët, pesha 20% - bankat nga vendet e OECD, bankat multilaterale të zhvillimit, pjesëmarrësit në tregun e letrave me vlerë, bankat dhe llogaritë e arkëtueshme nga bankat që nuk janë anëtar të OECD etj.;
- rreziku i moderuar, pesha 50% - kreditë hipotekare dhe llogaritë e arkëtueshme nga bankat homologe e bazuar në produkte të cilat zakonisht shoqërohen me një peshë

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

prej 100%;

- pesha e rrezikut standard, pesha 100% - të gjitha aktivet e tjera, të gjitha kreditë e dhëna jashtë sektorit privat bankar, pretendimet ndaj bankave të OECD me maturitet mbi një vit dhe aktive fikse.

Kapitali i Basel I është definuar si burimi i vetëm i qëndrueshëm në dispozicion për të mbuluar humbjet që mund të rezultojnë nga rreziqet e supozuara. Në kapitalin e klasit të parë (Tier 1) bëjnë pjesë: kapitali kryesor, aksionet e zakonshme, aksionet e preferuara me kohëzgjatje të pakufizuar dhe fitimi i pashpërndarë. Në kapitalin e klasit të dytë (Tier 2) bëjnë pjesë: kapitali dytësor, obligacionet e varura, aksione preferenciale me afat të kufizuar, si dhe dispozita për humbjet nga kreditë. Ndërsa kapitali i klasit të tretë (Tier 3), përdoret për të mbuluar rreziqet e tregut dhe përbëhet nga detyrime (deri në 2 vjet) që shkojnë deri në 250% të kapitalit të klasit të parë (Tier 1).

Objektivat kryesore të Marrëveshjes së Bazelit i siguruan:

- nivele të mjaftueshme të kapitalit në sistemin bankar ndërkombëtar;
- konkurrencë të drejtë në tregun e shërbimeve bankare, pasi asnjë bankë nuk mund të operojë në treg pa një volum të mjaftueshëm të kapitalit.

Me arritjen e këtyre objektivave, gjatë viteve 1990, Marrëveshja e Bazelit u pranua si standard botëror. Më shumë se 100 vende aplikuan standartet e Bazeli I në sistemin e tyre bankar. Disa nga disavantazhet e Marrëveshjes së Bazelit u hoqën me amendamente në vitin 1993 dhe 1996 (Stanišić & Stanojević, 2009).

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

➤ Marrëveshja Bazel II:

Në vitin 1999, Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare ngriti çështjen e harmonizimit të rregullave të auditimit dhe të mbikëqyrjes si një funksion i menaxhimit të mjaftueshmërisë së kapitalit në bankat aktive ndërkombëtare. Komiteti shpalli propozime shtesë në vitin 2001 dhe 2003 që përfaqësonin përmirësim në krahasim me propozimin fillestar. Kjo rezultoi në krijimin e Bazel II, i cili përcaktoi një marrëveshje përfundimtare për matjen e kapitalit dhe zbatimin e standardeve në nivel ndërkombëtar. Shtetet anëtare të komunitetit e kanë për detyrim të vlerësojnë dhe të zbatojnë paralel mjaftueshmërisë e kapitalit sipas Basel I dhe II që nga janari i vitit 2006.

Objektivi kryesor i Basel II ka të bëjë me promovimin e stabilitetit, sigurinë e bankave si dhe krijimin e vlerësimeve të përshtatshme të rrezikut, duke ruajtur kështu nivelin minimal të kapitalit ekzistues prej 8% të përcaktuar në Marrëveshjen e Bazel I. Marrëveshja e Basel II përqëndrohet në bankat tregtare ndërkombëtare dhe grupet bankare, por parimet bazë të saj duhet të zbatohen edhe nga bankat e tjera.

Bazat e marrëveshjes së Basel II kanë të bëjnë me:

- përmirësimin e ndjeshmërisë ndaj punëve të arbitrazhit dhe inovacionit në tregun financiar;
- identifikimin e ekspozimeve të ndryshme të bankave ndaj rrezikut, duke aplikuar metodave të posaçme për vlerësimin e këtij ekspozimi;
- zgjerimin e llojeve të rreziqeve financiare gjatë vlerësimit të nivelit të kapitalit të kërkuar për mbulimin e rrezikut të kredisë, tregut dhe biznesit;
- zhvillimin e një kërkese ku të gjitha bankat të zhvillojnë modele të brendshme për menaxhimin e rrezikut dhe stres testet, për të vlerësuar nivelin e ekspozimit ndaj

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

rrezikut (VaR);

- zhvillimin e një kërkesë ku secila bankë të përcaktojë kriteret e kapitalit të saj bazuar në ekspozimin e rrezikut të llogaritur, me mundësinë e rishikimit të buxhetit të autoritetit mbikëqyrës.

Bazeli II përbëhet nga tre nivele (Stanišić & Tanojević, 2009):

- Niveli I përcakton kërkesat minimale të kapitalit për rrezikun e kredisë, tregut dhe rrezikun operacional, me mundësinë e përdorimit të modeleve dhe teknikave të sofistikuara për llogaritjen e tyre. Kërkesa themelore është që bankat të kenë së paku 8 % të kapitalit në raport me aktivet e tyre të peshuara me rrezik. Aktivet e ponderuara me rrezik llogariten duke shumëzuar shumat nominale të pozicioneve të aktiveve sipas faktorëve të rrezikut. Kapitali minimal i bankave siguron aftësinë paguese të bankave në lidhje me rreziqet ndaj të cilave banka është e ekspozuar.
- Niveli II përforcon lidhjen midis kërkesave të kapitalit, llojit dhe shkallës së rreziqeve ndaj të cilave një bankë është e ekspozuar në operacionet e saj dhe insiston në procesin e mbikëqyrjes. Mbikëqyrësit kontrollojnë përputhjen me kërkesat e kapitalit, metodologjitë e brendshme të vlerësimit të rrezikut dhe përcaktojnë veprime rregulluese për bankat që nuk i përmbushin standardet e përshkruara.
- Niveli III thekson rëndësinë e disiplinës së tregut dhe vendosjen e kërkesave minimale për zbulimin e informacionit nga bankat. Ky standard thekson rëndësinë e informacionit transparent në bankat tregtare. Gjithashtu, institucionet financiare e kanë të detyrueshme të paraqesin informacion mbi performancën e bankave, çdo tre ose gjashtë muaj.

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

➤ Marrëveshja Basel III:

Marrëveshja e Basel III përcakton:

- kapital më të lartë dhe me cilësi më të mirë;
- mbulim më të mirë të rrezikut, veçanërisht lidhur me aktivitetet e tregut të kapitalit;
- vendosjen e një raporti leve si një ndihmë ndaj kërkesës së bazuar në risk;
- vendosjen e dy raporteve të likuiditetit.

3.4 Rreziku i normës së interesit.

Rreziku i normës së interesit përkufizohet si ekspozimi i gjendjes financiare të një banke ndaj lëvizjeve të pafavorshme të normave të interesit. Pranimi i këtij rreziku është një pjesë normale e sistemit bankar dhe mund të jetë një burim i rëndësishëm përfitimi. Megjithatë, rreziku i tepruar i normës së interesit mund të përbëjë një kërcënim për fitimet e bankës dhe bazën e kapitalit. Ndryshimet në normat e interesit ndikojnë në fitimet e një banke duke ndryshuar të ardhurat neto të saj nga interesi dhe nivelin të ardhurave nga interesa të tjerë. Ndryshimet në normat e interesit gjithashtu ndikojnë në themel vlerat e aktiveve, detyrimeve dhe instrumenteve të tjerë të bankës, për shkak se vlera aktuale e flukseve të ardhshme të parasë ndryshon kur ndryshojnë normat e interesit. Prandaj, një proces efektiv në menaxhimin e rrezikut të normës së interesit brenda niveleve të duhura është thelbësor për sigurinë dhe vazhdimësinë e bankave. Ndryshimet në normat e interesit mund të sjellin efekte negative si në të ardhurat e një banke ashtu edhe në vlerën e saj ekonomike (Jacque, 1996).

3.4.1 Matja e rrezikut të normës së interesit.

Është thelbësore që bankat të kenë sisteme për matjen e rrezikut të normës së interesit të cilët kapin të gjitha burimet e këtij rreziku dhe që vlerësojnë efektin e

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

ndryshimeve të normave të interesit sipas fushëveprimit të aktiviteteve bankare. Këto sisteme duhet të vlerësojnë efektet e ndryshimeve të normës së interesit në të ardhurat dhe në vlerën ekonomike të bankës. Gjithashtu këto sisteme, duhet të sigurojnë masën aktuale të ekspozimit të bankës ndaj rrezikut të normës së interesit, duke identifikuar çdo ekspozim të tepruar që mund të shfaqet. Ekzistojnë teknika të ndryshme të cilat bëjnë të mundur matjen e ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit në të ardhurat dhe në vlerën ekonomike të bankës (Merton, 1994).

Teknikat më të thjeshta për të matur ekspozimin ndaj rrezikut të normës së interesit të bankës fillojnë me një plan maturimi që shpërndan aktivet dhe pasivet. Këto programe mund të përdoren për të gjeneruar tregues të thjeshtë të rrezikut të normës së interesit për të ardhurat dhe vlerën ekonomike të bankës, ndaj ndryshimit të normës së interesit. Kur kjo teknikë përdoret për të vlerësuar rrezikun e normës së interesit të fitimeve aktuale, zakonisht i referohemi si analiza e hendekut. Madhësia e këtij hendeku për një kohë të caktuar është një tregues i ekspozimit ndaj rrezikut. Analiza e hendekut ("gap analysis") u përcaktua si një nga metodat e para të zhvilluara për të matur ekspozimin ndaj rrezikut të normës së interesit të bankës dhe vazhdon të përdoret akoma gjerësisht edhe sot nga bankat tregtare.

Për të vlerësuar ekspozimin e të ardhurave, detyrimet e normës së interesit në secilin interval kohor zbriten nga aktivet përkatëse të normës së interesit për të prodhuar një "hendek" të rivlerësimit. Ky hendek mund të shumëzohet me një ndryshim të supozuar të normave të interesit për të dhënë një përafrim të ndryshimit në të ardhurat neto nga interesi, që rezulton nga një lëvizje e normave të interesit. Madhësia e lëvizjes së normës së interesit mund të bazohet në disa faktorë, përfshirë përvojën historike,

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

simulimin e lëvizjeve të mundshme të normës së interesit në të ardhmen, si dhe gjykimin e menaxhimit të bankave. Një hendek negativ ndodh kur detyrimet tejkalojnë aktivet në një kohë të caktuar (Hakala & Wystup, 2002). Kjo do të thotë se një rritje në normat e interesit të tregut mund të shkaktojë rënie në të ardhurat neto nga interesi. Anasjelltas, një hendek pozitiv ndaj aktiveve nënkupton që të ardhurat neto të interesit të bankës mund të bien si rezultat i një rënie në nivelin e normave të interesit.

Shumë banka (veçanërisht ato që përdorin instrumente financiare komplekse) përdorin sisteme matjesh të rrezikut të normës së interesit më të sofistikuara se ato të bazuara në plane apo programe të thjeshta maturimi. Këto teknika zakonisht përfshijnë vlerësime të detajuara të efekteve të mundshme të ndryshimeve në normat e interesit duke simuluar lëvizje të normave të interesit për të parë ndikimin e tyre mbi flukset e mjeteve monetare. Në njëfarë mënyre, teknikat e simulimit mund të shihen si një zgjerim dhe përsosje e analizës së thjeshtë të bazuar në planet e maturimit. Megjithatë, teknikat e simulimit zakonisht përfshijnë një ndarje më të detajuar të kategorive të ndryshme të pozicioneve brenda dhe jashtë bilancit (on- and offbalance sheet positions) në mënyrë që supozimet specifike në lidhje me pagesat e interesit dhe të principalit, si dhe të ardhurat e përftuara jo nga interesat të mund të integrohen.

Në simulimet statike, flukset e mjeteve monetare që rrjedhin vetëm nga aktivi aktual i bankës vlerësohen duke patur parasysh pozicionet jashtë bilancit. Për vlerësimin e ekspozimit të të ardhurave, simulimet marrin në konsideratë flukset e mjeteve monetare dhe rezultatet e fitimeve gjatë një periudhe të caktuar, të cilat zhvillohen duke u bazuar në një ose më shumë skenarë të normës së interesit të supozuar. Në teknikën e simulimit dinamik, simulimi krijon shumë supozime të detajuara rreth kursit të

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

ardhshëm të normave të interesit dhe ndryshimeve të pritura të aktivitetit të një banke. Një shembull tipik është simulimi i cili mund të përfshijë supozime rreth strategjisë së një banke për ndryshimin e normave të interesit, rreth sjelljes së klientëve të bankës ose për rrjedhën e ardhshme të biznesit (kredi të reja ose transaksione të tjera) (Froot & Thaler, 1990). Simulimet i përdorin këto supozime për aktivitetet e ardhshme dhe strategjitë e riinvestimit duke projektuar flukse monetare të pritshme dhe duke vlerësuar fitimet dinamike. Këto teknika të sofistikuara lejojnë ndërveprimin dinamik të rrjedhës së pagesave dhe të normave të interesit.

3.4.2 Modelet e rrezikut të normës së interesit.

Raporti midis aktiveve dhe pasiveve të ndjeshme ndaj ndryshimeve të normës së interesit përbën një nga mënyrat bazë për matjen këtij rreziku. Ky raport në thelb pasqyron gatishmërinë e bankës për të pranuar rrezikun kundrejt parashikimit të lëvizjeve të ardhshme në normat e interesit të tregut, veçanërisht gjatë periudhës së luhatjeve të mëdha të këtyre normave. Nëse ka një rënie të normave të interesit dhe banka e ka këtë raport në nivel më të lartë se njësia, të ardhurat e saj do të ulen, ndërsa në rast se normat e interesit rriten, të ardhurat e saj do të rriten. Për të minimizuar ekspozimin ndaj rrezikut të normave të interesit dhe për shkak të vështirësive në parashikimin e lëvizjeve të këtyre normave, shumë banka përdorin ristrukturimin e aktiveve dhe detyrimeve në bilanc të ndjeshme ndaj normave të interesit.

Ekzistojnë tre modele për vlerësimin e rrezikut të normës së interesit (BIS, 2001):

- Modeli i parë është ai i rivlerësimit, i cili bazohet në mospërputhjen e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve të bankës, duke pasur parasysh se madhësitë e tyre mund të

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

rivlerësohen në periudhën e ardhshme për shkak të ndryshimeve në normat e interesit. Brenda çdo segmenti të maturimit, llogaritet shuma e aktiveve dhe detyrimeve të bankës dhe sasia e mosbalancimit me shenjat pozitive dhe negative, ndërsa rezultatet për secilin segment i shërbejnë bankës për të llogaritur efektin e ndryshimeve të normave të interesit.

- Modeli dytë i vlerësimit është ai i maturitetit, i cili jep një panoramë më të qartë mbi efektet e ndryshimeve të normës së interesit në pozicionin e bilancit të bankave. Ky model bazohet në ndryshimin e vlerës së tregut të aktiveve dhe detyrimeve të bankës (sidomos obligacionet) që ndodhin për shkak të ndryshimeve në normat e interesit. Aktivitetet dhe detyrimet në këto raste nuk vlerësohen me vlerën që kanë, por me çmimet e tregut. Ky model ka një qasje të ndërtuar në mënyrë të tillë ku një rritje e normave të interesit, ul vlerën e tregut të aktiveve dhe detyrimeve të bankës, ndërkohë që një rënie e normave të interesit rrit vlerat përkatëse të tregut.
- Modeli i tretë i vlerësimit është ai i kohëzgjatjes, i cili mat kohën mesatare të ponderuar të maturimit të aktiveve dhe detyrimeve duke përdorur si pesha vlerat relative të tashme të flukseve të mjeteve monetare.

3.4.3 Proceset e menaxhimit të rrezikut të normës së interesit.

Bankat duhet të kenë politika dhe procedura të përcaktuara qartë për kufizimin dhe kontrollin e rrezikut të normës së interesit. Politikat dhe procedurat e tilla duhet të përcaktojnë linjat e përgjegjësisë dhe llogaridhënies mbi vendimet në menaxhimin e rrezikut të normës së interesit, duke përcaktuar qartë instrumentet e autorizuara dhe strategjitë mbrojtëse. Politikat e menaxhimit të rrezikut të normës së interesit duhet të identifikojnë gjithashtu parametrat sasiore që përcaktojnë nivelin e rrezikut të normës së

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

interesit të pranueshëm për bankën. Të gjitha politikat e rrezikut të normës së interesit duhet të rishikohen në mënyrë periodike ose sipas nevojës.

Niveli menaxhues duhet të përcaktojë qartë procedurat specifike dhe miratimet e nevojshme për përjashtimet, politikat, kufizimet dhe autorizimet (BIS, 2000). Zona e rrezikut të normës së interesit vlerësohet e dyta për nga rëndësia e menaxhimit të rreziqeve financiare. Shumica e bankave tregtare bëjnë një dallim të qartë ndërmjet aktivitetit tregtar dhe ekspozimit të normës së tyre të interesit në bilanc. Bankat e investimeve në përgjithësi e shohin rrezikun e normës së interesit si një pjesë klasike e rrezikut të tregut dhe për këtë arsye kanë zhvilluar sisteme të menaxhimit të rrezikut tregtar për të matur dhe monitoruar ekspozimin. Për bankat e mëdha tregtare dhe bankat universale evropiane, sisteme të tilla janë bërë pjesë e domosdoshme e infrastrukturës. Por, në fakt, sistemet e menaxhimit të rrezikut të tregut ndryshojnë ndjeshëm nga banka në bankë dhe përgjithësisht janë më pak reale sesa duken. Në një numër të madh firmash, modelet e vlerësimit të quajtura “Vlera e Rrezikut” (VaR), janë funksionale, por në të shumtën e rasteve, këto modele janë ende në fazën e zbatimit. Ndërkohë që kjo mund të jetë plotësisht e pranueshme për institucionet që kanë aktivitet tregtar të vogël dhe punojnë kryesisht në emër të klientëve. Ndërsa për institucionet financiare që janë aktive në treg, vlera e rrezikut tashmë është bërë një element standart. Kjo procedurë kohët e fundit është shfaqur publikisht me nxjerrjen e mjeteve matëse të rrezikut nga J. P. Morgan. Duke pasur parasysh procedurat kontabël të pranuara në lidhje me aktivet e bankës, si dhe korespondencën e ngushtë të strukturave të aktiveve dhe pasiveve, bankat tregtare kanë tendencë të mos përdorin raporte, udhëzime apo limite të vlerës së tregut. Përkundrazi, ato mbështeten në rrjedhën e parasë (cash flow). Për kategoritë e kredive

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

me normë primare, duhet të caktohet një masë e kohëzgjatjes bazuar në fleksibilitetin aktual të rivlerësimit. Një problem i ngjashëm ekziston edhe për detyrimet kryesore. Megjithatë, industria përpiqet të masë këto vlerësime me saktësi, duke përfshirë në këtë procedurë raportimi ekspozimet brenda dhe jashtë bilancit. Shumica pranojnë se raportet e hendekut dhe të kohëzgjatjes janë statike dhe nuk përshtaten mirë me natyrën dinamike të tregut bankar, ku asetet dhe detyrimet ndryshojnë me kalimin e kohës.

Prandaj, industria bankare ka shtuar një tjetër nivel analize në procedurat e saj për menaxhimin e rrezikut të normës së interes (Furash, 1994). Aktualisht, shumë banka po përdorin modelet e simulimit të bilancit për të hetuar efektin e ndryshimit të normës së interesit në të ardhurat e raportuara gjatë periudhave një, tre dhe pesë vjeçare. Këto simulime, relativisht kërkojnë raporte të sakta të rivlerësimit, të vlerësimit të parapagesave si dhe flukseve të mjeteve monetare. Përsa i përket çështjes së parë, një analizë e tillë kërkon një funksion të supozuar të përgjigjes nga ana e bankës për të lëvizur normën e interesit, në të cilën simulohen vendimet e çmimeve të bankës. Në aspektin e çështjes së dytë, simulimet kërkojnë modele preçize parapaguese për produkte të tilla si kreditë hipotekore dhe kreditë konsumatore. Përveç kësaj, kërkohet simulimi i kurbës së të ardhurave përgjatë një vije të supozuar të lëvizjeve të normave të interesit dhe ndryshimeve të kurbës së të ardhurave. Pas përfundimit, simulimi raporton devijimet e rezultuara në të ardhurat që lidhen me skenarët e normave të konsideruara të interesit. Pranueshmëria e këtij raportimi, varet nga kufijtë e vendosur të nivelit menaxherial, të cilët paraqesin devijimet e fitimeve nga rezultati i pritur.

Nocioni në lidhje me Fitimet në Rrezik (EaR), po shfaqet si një pikë referimi e zakonshme për rrezikun e normës së interesit. Sidoqoftë, vlera e këtij nocioni është e

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

kufizuar, pasi pretendohet që shkalla e normave të konsideruara të interesit dhe mekanizmi i reagimit të bankës që gjendet në simulim janë të saktë. Megjithatë, rezultatet shihen si tregues të efektit të mospërputhjes së normës bazë të interesit të përfshirë në bilanc. Raportet e këtyre simulimeve, tani janë bërë të zakonshme në industrinë financiare. Për shkak të shqetësimeve mbi rezultatet e fitimeve të mundshme të simulimeve, zyrtarët e thesarit shpesh përdorin tregjet e parasë për të zvogëluar rrezikun e të ardhurave nga normat e interesit të bankës. Prandaj, çdo institucion ka një politikë investimi që përcakton grupin e aktiveve të lejuara dhe kufizimet për pjesëmarrjen e bankës në çdo fushë. Të gjitha institucionet financiare e kufizojnë veprimtarinë e thesarit deri në një farë mase duke përcaktuar grupin e veprimtarive që mund të përdorë për të ndryshuar pozicionin e normës së interesit të bankës në tregun e parasë.

3.5 Rreziku i kursit të këmbimit.

Një përkufizim i zakonshëm i rrezikut të kursit të këmbimit lidhet me efektin e ndryshimeve të papritura të kursit të këmbimit në bilancin e firmës (Madura, 1989). Në veçanti, ky rrezik përkufizohet si humbje e mundshme direkte ose indirekte në flukset e mjeteve monetare, aktivet dhe pasivet dhe fitimin neto të firmës. Për të menaxhuar rrezikun e kursit të këmbimit, një firmë duhet të përcaktojë llojin specifik të ekspozimit ndaj rrezikut aktual, strategjinë mbrojtëse dhe instrumentet e duhura në dispozicion për të menaxhuar këtë rrezik. Për të matur ndikimin e lëvizjeve të kursit të këmbimit në një firmë që është e angazhuar në transaksione në valutë të huaj, duhet të identifikohen llojet e rreziqeve dhe sasia ndaj të cilave firma është ekspozuar (Hakala & Wystup, 2002). Tre llojet kryesore të rrezikut të kursit të këmbimit janë (Shapiro, 1996, Madura, 1989):

1. Rreziku i transaksionit, i cili në thelb përcaktohet si rreziku i fluksit të mjeteve

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

monetare dhe merret me efektin e kursit të këmbimit, si pasojë e ekspozimit të llogarisë transaksionare nga kontratat e eksportit dhe importit. Ndryshimi i kursit të këmbimit në monedhën e emërimit të ndonjë kontrate të tillë do të rezultojë në një rrezik të kursit të këmbimit të drejtpërdrejtë të transaksionit për firmën.

2. Rreziku i konvertimit, i cili në thelb është rreziku i kursit të këmbimit të bilancit dhe lidhet me lëvizjet e kursit të këmbimit në vlerësimin e një filiali të huaj dhe nga ana tjetër, në konsolidimin e një filiali të huaj në bilancin e shoqërisë mëmë. Rreziku i konvertimit për një degë të huaj matet zakonisht nga ekspozimi i aktiveve neto (aktivet minus detyrime) ndaj lëvizjeve të kursit të këmbimit. Në konsolidimin e pasqyrave financiare, konvertimi mund të bëhet ose në kursin e këmbimit në fund të periudhës ose në kursin mesatar të këmbimit të periudhës, në varësi të standarteve kontabël që ndikojnë në kompaninë mëmë. Kështu, përderisa pasqyrat e të ardhurave janë zakonisht të konvertuara me kursin mesatar të këmbimit gjatë periudhës, ekspozimet e bilancit të filialeve të huaja shpesh përkthehen në kursin aktual të këmbimit në kohën e konsolidimit.

3. Rreziku ekonomik, i cili reflekton në thelb rrezikun ndaj vlerës aktuale të firmës në flukset e mjeteve monetare të ardhshme nga lëvizjet e kursit të këmbimit. Rreziku ekonomik ka të bëjë me efektin e ndryshimeve të kursit të këmbimit në të ardhurat (shitjet dhe eksportet e brendshme) dhe shpenzimet operative (kostoja e inputeve dhe importeve vendase). Rreziku ekonomik zakonisht aplikohet në vlerën aktuale të operacioneve të ardhshme të fluksit monetar të një shoqërie mëmë dhe filialeve të huaja. Identifikimi i llojeve të ndryshme të rrezikut të kursit të këmbimit, së bashku me matjen e tyre është thelbësor për të zhvilluar një strategji për administrimin e rrezikut të kursit

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

të këmbimit.

3.5.1 Matja e rrezikut të kursit të këmbimit.

Pas përcaktimit të llojeve të rrezikut të kursit të këmbimit ndaj të cilëve bankat ekspozohen, një aspekt tjetër i rëndësishëm në vendimet e menaxhimit e këtij rreziku lidhet me matjen e tij. Matja e rrezikut të kursit të këmbimit mund të jetë e vështirë, të paktën në lidhje me rrezikun e konvertimit dhe rrezikun ekonomik (Van Deventer, Imai & Mesler, 2004; Holton, 2003). Aktualisht, metoda më e përdorur gjerësisht është modeli i vlerës së rrezikut (VaR). Në përgjithësi, vlera në rrezik përcaktohet si humbja maksimale për një ekspozim të dhënë gjatë një periudhe kohore me besueshmëri z %. Modeli VaR mund të përdoret për të matur një shumëllojshmëri rreziqesh, duke ndihmuar firmat në menaxhimin e rrezikut të tyre. Megjithatë, VaR nuk përcakton se çfarë ndodh me ekspozimin për $(100 - z)$ % të besimit. Meqenëse modeli VaR nuk përcakton humbjen maksimale me besueshmëri 100 %, firmat shpesh vendosin kufijtë e funksionimit, si p.sh. shumat nominale ose urdhrat për të ndaluar humbjet, përveç limiteve VaR, për të arritur mbulimin më të lartë të mundshëm (Papaioannou & Gatzonas, 2002).

Llogaritja e vlerës së rrezikut të kursit të këmbimit përdoret nga firmat për të vlerësuar rrezikshmërinë e një pozicioni të këmbimit valutor që rezulton nga aktivitetet e një firme, duke përfshirë pozicionin e këmbimit valutor të thesarit të saj, për një periudhë kohore të caktuar në kushte normale (Holton, 2003). Llogaritja VaR varet nga 3 parametra:

1. Periudha e mbajtjes, p.sh kohëzgjatja gjatë së cilës është planifikuar të mbahet pozicioni i këmbimit valutor. Periudha tipike e mbajtjes është 1 ditë.

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

2. Niveli i besimit në të cilin parashikohet të bëhet vlerësimi. Nivelet e zakonshme të besimit janë 95 % dhe 99 %.

3. Njësia e monedhës që do të përdoret për emërtimin e VaR.

Për të llogaritur VaR, ekziston një shumëllojshmëri modelesh. Midis tyre, më gjerësisht të përdorura janë:

- Simulimi historik, i cili supozon se kthimi i monedhës në pozicionin e huaj të këmbimit të një firme do të ketë shpërndarje të njëjtë sikurse në të kaluarën.
- Modeli i variancë-kovariancë, i cili supozon se kthimi i monedhës në pozicionin total të këmbimit valutor të një firme, ka gjithmonë një shpërndarje normale dhe se ndryshimi në vlerën e pozicionit të këmbimit valutor është linearisht i varur nga të gjitha kthimet në valutë.
- Simulimi i Monte Karlo, i cili supozon se kthimi i ardhshëm i monedhës do të shpërndalet në mënyrë rastësore. Simulimi historik është metoda më e thjeshtë e llogaritjes. Kjo përfshin drejtimin e pozicionit aktual të këmbimit valutor në një grup ndryshimesh historike të kursit të këmbimit për të dhënë një shpërndarje të humbjeve në vlerën e pozicionit të këmbimit valutor, duke llogaritur një përqindje (VaR). Përfitimi kryesor është se kjo metodë nuk merr në konsideratë shpërndarjen normale të kthimit të parasë, por një shpërndarje me Kurtois më të madhe se shpërndarja normale. Mangësia e këtij silimi është se përlllogaritje kërkon një bazë të madhe të dhënash.

Më gjerësisht modeli i variancës dhe kovariancës supozon që kthimet e monedhës kanë shpërndarje normale. Pra, për një nivel besueshmërie prej 99 %, VaR mund të llogaritet si: $VaR = -V_p (M_p + 2.33 S_p)$, ku V_p është vlera fillestare (në njësi

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

monetare) e pozicionit të këmbimit valutor, M_p është mesatarja e kthimit të monedhës në pozicionin total të këmbimit valutor të firmës, që është një mesatare e ponderuar e pozicioneve individuale të këmbimit valutor, S_p është devijimi standard i kthimit të monedhës në pozicionin total të këmbimit valutor të firmës, ku ndryshe mund të quhet si devijimi standard i transformimit të peshuar të matricës së variancës dhe kovariancës së pozicioneve individuale të këmbimit valutor. Modeli i variancës dhe kovariancës lejon llogaritjen e shpejtë, por nga ana tjetër ky model ka edhe të meta që përfshijnë supozimet kufizuese të një shpërndarjeje normale të kthimit të monedhës dhe një kombinim linear të pozicionit të përgjithshëm të këmbimit valutor (Longin, 2001). Kur përdoret një shpërndarje jo normale, kostoja e llogaritjes do të ishte më e lartë për shkak të vlerësimit shtesë të intervalit të besimit për humbjen. Simulimi i Monte Karlo zakonisht përfshin analizën e përbërësve kryesorë të modelit të variancës, e ndjekur nga simulimi i rastësishëm i komponentëve. Avantazhet e këtij simulimi përfshijnë aftësitë për të trajtuar çdo shpërndarje kryesore dhe për të vlerësuar më saktë VaR-in kur faktorët e monedhës jo-lineare janë të pranishme në pozicionin e këmbimit valutor, ndërsa disavantazhi kryesor i tij përfshin procesin intensiv të llogaritjes.

3.5.2 Modelet e rrezikut të kursit të këmbimit.

Mbrojtja strukurore dhe mbrojtja financiare janë dy metodat kryesore që përdoren për të menaxhuar rrezikun e kursit të këmbimit valutor. Shumë institucione financiare i përdorin të dyja metodat. Qëllimi i mbrojtjes strukurore është zvogëlimi i diferencës midis arkëtimit dhe pagesave në një monedhë të huaj të dhënë. Mbrojtja strukurore mund të jetë efektive në zvogëlimin e rrezikut të kursit të këmbimit të një kompanie, por mund të kërkojë kohë për tu zbatuar.

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

Metoda tjetër, ajo e mbrojtjes financiare, përfshin blerjen e instrumenteve mbrojtës të këmbimit valutor që zakonisht shiten nga bankat dhe ndërmjetësit e këmbimit valutor. Kontratat e së ardhmes si instrumente mbrojtëse, lejojnë një kompani të vendosë kursin e këmbimit me të cilin do të blejë ose shesë një sasi të caktuar të valutës së huaj në të ardhmen (qoftë në një datë të caktuar ose gjatë një periudhe të caktuar kohe). Këto instrumente janë fleksibël dhe mund të përputhen lehtë me ekspozimet e ardhshme të transaksioneve (përgjithësisht deri në një vit). Nëpërmjet këtyre kontratave, kompania eliminon pothuajse të gjitha ekspozimet e transaksionit me të cilët përballlet. Kontratat e ardhshme janë të lehta për t'u përdorur dhe nuk kanë asnjë çmim blerjeje. Supozojmë se një kompani ka një angazhim kontraktual për të dorëzuar (ose blerë) në një bankë ose tek një ndërmjetësues i këmbimit valutor një sasi të caktuar të këmbimit valutor në një datë të ardhshme. Nëse kjo nuk realizohet, atëherë kontrata e së ardhmes mund të përfundojë ose të zgjatet, duke përbërë një penalitet për kompaninë në fjalë. Kjo shpjegon edhe faktin se përse bankat dhe agjentët e këmbimit valutor vendosin kufizime mbi shumën maksimale që një kompani mund të mbrojë duke përdorur kontratat e së ardhmes.

3.5.3 Proceset e menaxhimit të rrezikut të kursit të këmbimit.

Për shumë kompani, menaxhimi i rrezikut të kursit të këmbimit mund të duket shumë kompleks, i kushtueshëm ose konsumues në kohë. Të tjerë mund të mos dinë për ekzistencën e instrumentave dhe teknikave mbrojtëse ose besojnë se mbrojtja është një aktivitet spekulativ. Megjithatë, kompanitë që zgjedhin të mos e menaxhojnë rrezikun e kursit të këmbimit valutor mund të supozojnë se kurset e këmbimit do të mbeten në nivelet e tyre aktuale ose do të lëvizin në një drejtim që do të jetë i favorshëm për

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

kompaninë. Studime të shumta kanë zbuluar se menaxhimi i këtij rreziku mund të reduktojë me sukses ekspozimin e kompanisë ndaj këmbimit valutor.

Menaxhimi i rrezikut të kursit të këmbimit ofron përfitime të shumta në kompani (Jacque, 1996), të rënditura si më poshtë:

- minimizon efektet e lëvizjeve të kursit të këmbimit në kufijtë e fitimit;
- rrit parashikueshmërinë e flukseve të ardhshme të parasë;
- eliminon nevojën për të parashikuar me saktësi drejtimin e ardhshëm të kursit të këmbimit;
- lehtëson çmimet e produkteve të shitura në tregjet e eksportit.

Vendimi për të blerë instrumentet mbrojtëse të këmbimit valutor është i ngjashëm me format e tjera të sigurimit që kompania bën. Menaxhimi i rrezikut, në këtë rast, lidhet me reduktimin e flukseve të mjeteve monetare dhe marzheve të fitimit të shkaktuara nga ndryshimet e pafavorshme në kursin e këmbimit. Shumë firma i mbrojnë llogaritë e tyre nga rreziku i mospagimit duke i siguruar ato. Kjo bëhet për të mbrojtur rrjedhën e parasë dhe për të siguruar që përpjekjet e kompanisë janë të përqendruara në aktivitetet kryesore të biznesit.

Menaxhimi i rrezikut të kursit të këmbimit është një proces me katër hapa (Figura Nr. 4).

Figura Nr. 4- Menaxhimi i rrezikut të kursit të këmbimit



Burimi : Jacque, (1996).

Hapi i parë përfshin identifikimin dhe matjen e rrezikut të këmbimit valutor. Siç u përmend edhe më sipër, identifikimi i rrezikut në kohë sjell pasoja më të vogla dhe

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

mundësia për të rregulluar apo përmirësuar efektet e tij në një kohë të shkurtër është më e madhe. Pas identifikimit dhe matjes së rrezikut të kursit të këmbimit, hapi i dytë specifikon zhvillimin e politikave për menaxhimin e këtij rreziku. Këto politika duhet të miratohen nga niveli menaxherial dhe zakonisht japin përgjigje të hollësishme për pyetjet si:

- Kur duhet të mbrohem ndaj rrezikut të këmbimit valutor?
- Cilat mjete dhe instrumente duhet të përdoren për tu mbrojtur nga rreziku i këmbimit valutor?
- Kush është përgjegjës për menaxhimin e ekspozimit në valutë të huaj?
- Si do të matet performanca e veprimeve mbrojtëse të kompanisë?
- Cilat janë kërkesat e raportimit të rregullt?

Hapi i tretë përfshin mbrojtjen ndaj rrezikut të kursit të këmbimit në përputhje me politikat e kompanisë. Ndërsa hapi i katërt kërkon matjen periodike për të kuptuar nëse mbrojtja ndaj rrezikut është efektive. Vendosja e objektivave të qarta dhe standarteve nga kompania do të ndihmojë në lehtësimin e këtij vlerësimi.

3.6 Rreziku operacional.

Edhe pse rreziku operacional nuk është një koncept i ri, deri më tani ky faktor nuk ka marrë aq shumë vëmendje sa rreziku i kredisë. Menaxhimi i rrezikut operacional përfshin marrjen e masave të përshtatshme për të siguruar transaksione cilësore dhe pa gabime, në mënyrë që institucinet financiare të ofrojnë shërbime më të mira për klientët. Ndryshimet themelore në tregjet financiare, rritja e globalizimit, liberalizimi, si dhe ristrukturimi i korporatave patën një ndikim të madh në madhësinë dhe natyrën e rreziqeve operationale që hasen bankat (Helbok & Wagner, 2006). Rreziku operacional

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

është një term i cili ka kuptime të ndryshme në industrinë bankare, për këtë arsye dhe për qëllime të brendshme bankat mund të zgjedhin vetë ta miratojnë menaxhimin e rrezikut të tyre operacional. Ky përkufizim i brendshëm i industrisë bankare duhet të respektojë situatën individuale të çdo banke, duke marrë parasysh madhësinë, inovacionin, natyrën dhe kompleksitetin e aktiviteteve, si dhe gamën e gjërë të rreziqeve operationale që këto institucione hasin. Menaxhimi i rrezikut operacional nuk është një praktikë e re. Bankat gjithmonë janë përpjekur të parandalojnë mashtrimet, të ruajnë integritetin e kontrolleve të brendshme, të reduktojnë gabimet në përpunimin e transaksioneve etj., në mënyrë që të ofrojnë shërbime cilësore për klientët e tyre dhe të minimizojnë humbjet e mëdha (Banerjee & Banipal 2005). Megjithatë, pikëpamja e menaxhimit të rrezikut operacional është një praktikë e re, gjithëpërfshirëse dhe e krahasueshme në parim me menaxhimin e rrezikut të kredisë dhe rrezikut të tregut. Në të kaluarën, për të menaxhuar rrezikun operacional bankat mbështeteshin pothuajse vetëm në mekanizmat e kontrollit të brendshëm të linjave të biznesit, të realizuara nga funksioni i auditimit. Kohët e fundit në institucionet financiare janë aplikuar struktura dhe procese specifike që synojnë menaxhimin e rrezikut operacional.

Pas përhapjes së rëndësisë së rrezikut operacional në bankë dhe njohurive se ky rrezik shfaq karakteristika thelbësisht të ndryshme nga ato të rreziqeve të tjera, gjithnjë e më shumë po vërehet një rritje e tendencës së kërkimit akademik drejt këtij fenomeni. Power (2005) dhe Harmanzis (2002), realizuan studime mbi zhvillimin e rrezikut operacional në përgjithësi, ndërsa mënyrat për ta matur dhe menaxhuar rrezikun operacional u paraqiten nga Ebnoter, Vanini, McNeil & Antolinez (2003) dhe nga anketat e Healy & Palepu (2001). Shumica e hulumtimeve mbi rrezikun operacional në

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

të kaluarën u përqëndruan në metodat sasiore të matjes së ekspozimit ndaj rrezikut operacional (Makarov, 2006; Degen et al., 2006; Mignola & Ugoçioni, 2006; Nešlehova et al., 2005; De Fontnouvelle et al, 2004; Moscadelli, 2004; Alexander, 2003; Coleman & Cruz, 1999; Cruz et al., 1998) dhe në modele teorike të stimujve ekonomikë për menaxhimin dhe sigurimin e këtij rreziku (Leippold & Vanini, 2005, Crouhy et al., 2004; Banerjee & Banipal, 2005), duke i kushtuar më pak vëmendje çështjeve statistikore të raportimit dhe matjes së rreziqeve operationale koherente dhe konsistente brenda dhe jashtë bankave.

Raportimi i rrezikut operacional ka mbetur një temë e pashkelur nga kërkimi akademik (Dima, 2009). Harmantzis (2002) supozon se korrelacioni midis llojeve të ndryshme të rrezikut është zero, që do të thotë se të gjitha llojet e rreziqeve janë krejtësisht të pavarura nga njëri-tjetri. De Fontnouvelle et al. (2004) përdori të dhëna të publikuara nga instancat përkatëse për të përcaktuar sasinë e rrezikut operacional dhe për të provuar se sasia e kapitalit për rrezikun operacional, shpesh do të tejkalojë atë të rrezikut të tregut.

Rreziku operacional në aspektin e matjes dhe menaxhimit të tij kategorizohet si:

- Rreziku i ngjarjes, i cili përkufizon se humbjet në bankë shkaktohen nga ngjarje të tilla si, dështimi i sistemeve kryesore, dështimet e proceseve dhe kontrollit (p.sh. gabimet dhe mosveprimet), mashtrimet, rreziku ligjor dhe katastrofat natyrore (p.sh. zjarri ose katastrofa të tjera).
- Rreziku i biznesit, i cili përkufizon se banka do të përjetojë humbje nëpërmjet ndryshimeve të papritura në të ardhura, si pasoje e kostove të shkaktuara nga ndryshimet në mjedisin konkurrues të bankës (p.sh., konkurrentët e rinj, ndryshimet

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

në rregullore etj.) dhe jo nga rreziku i kredisë apo rreziku i tregut.

Rreziku operacional mund të përkufizohet si rreziku i humbjes që shkaktohet nga mungesa e burimeve të brendshme të papërshtatshme (proceset, stafi, sistemet) si dhe nga ngjarjet e jashtme (Basel II, 2004). Duhet të theksohet se këto rreziqe janë të natyrshme në bankë. Megjithatë, praktikat për menaxhimin e rrezikut operacional janë përmirësuar për shkak të kërkesave të reja të Bazel II, të cilat kërkojnë më shumë formalitet në matjen e rrezikut operacional. Rreziku operacional mund të jetë i formave të ndryshme, duke përfshirë stafin (paaftësi ose mashtrim), dështime në sistem (prishjet në sisteme ose teknologji) si dhe dështimet në proces. Nga natyra e tij, rreziku operacional është i pranishëm në të gjitha aktivitetet dhe është vështirë të shmanget. Instrumentat që përdoren për menaxhimin dhe zbutjen e rrezikut operacional janë më të paktë në krahasim me rreziqet e tjera financiare. Rreziku operacional menaxhohet në mënyrë tipike përmes proceseve dhe kontrolleve të brendshme rigoroze. Po ashtu grupet e auditimit të brendshëm në banka luajnë një rol aktiv në testimin e kontrolleve, me mbështetjen e audituesve të jashtëm.

3.6.1 Matja e rrezikut operacional.

Ebnoether et al (2003) paraqiti raste studimi për matjen e rrezikut operacional dhe tregoi se për një njësi prodhimi të një banke me detyra të përcaktuara mirë, rreziku operacional mund të identifikohet dhe modelohet qartë. Modelet sasiore për matjen dhe menaxhimin e rrezikut operacional janë bërë të domosdoshme dy dekadat e fundit, pasi rrezikut operacional tashmë përbën një peshë të konsiderueshme në rreziqet financiare të një banke. Tregjet financiare të paqëndrueshme, mjediset rregullatore në rritje dhe sistemet financiare gjithnjë e më komplekse, kanë orientuar drejtuesit e rrezikut

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

operacional që të kuptojnë rëndësinë e matjes dhe menaxhimit të këtij rreziku (Harmantzis, 2002). Megjithatë, është menduar se rreziku operacional nuk mund të matet aq lehtë, për shkak se mbulon rreziqe të ndryshme si gabimet e përpunimit të transaksioneve, dështimet e sistemit, vjedhjet dhe mashtrimet, paditë, dëmtimin e pasurisë nga katastrofat natyrore etj. (Mori, Hiwatashi & Ide, 2000). Metoda e vlerësimit të brendshëm është një nga mjetet e përdorura nga bankat për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut operacional. Ky proces është i drejtuar nga brenda dhe shpesh përfshin përcaktimin e pikave të forta dhe dobësitë në mjedisin e rrezikut operacional. P.sh metoda Scorecards, siguron përkthimin e vlerësimeve cilësore në metrika sasiore, duke dhënë një renditje të llojeve të ndryshme të ekspozimeve ndaj rrezikut operacional. Në momentin kur rreziku operacional matet, është e nevojshme të vlerësohet probabiliteti i ngjarjes operative që shkakton humbje dhe madhësia e kësaj humbjeje. Faktorët e rrezikut në përgjithësi janë sasiorë, por mund të ketë edhe vlerësime cilësore të përkthyer në rezultate (siç është vlerësimi i auditimit) (Moosa, 2007). Grupi i faktorëve të rrezikut operacional përfshin variabla të cilët masin rrezikun në secilën njësi të biznesit, siç janë:

- të dhënat nga vlerësimet cilësore, duke përfshirë vlerësimet e auditimit të brendshëm;
- të dhëna operative të përgjithshme si vëllimi, kthimi dhe kompleksiteti;
- të dhëna mbi cilësinë e operacioneve të tilla si shkalla e gabimit ose masa e rrezikshmërisë së biznesit që lidhet me paqëndrueshmërinë e të ardhurave.

Nevoja për të matur rrezikun operacional vjen nga rekomandimet e komitetit të Bazelit. Sipas këtij komiteti, bankat duhet të ndajnë një sasi të mjaftueshme kapitali për

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

të mbuluar rrezikun e tyre operacional. Në teori, kjo shumë e kapitalit duhet të korespondojë me humbjen maksimale të shkaktuar nga rreziku operacional në bankë, me një probabilitet të lartë (99%) dhe me një afat kohor të caktuar (për shembull, një vit). Për këtë na vjen në ndihmë "Vlera në Rrezik" (VAR) (King, 2000).

Metodat e vlerësimit të rrezikut operacional të përcaktuara nga komiteti i Bazelit dhe të pranuar globalisht paraqiten si më poshtë:

➤ Metodat Statistike:

Shembulli më tipik i metodave statistike është "Metoda e Shpërndarjes së Humbjeve" (Loss Distribution Approach) (LDA). Kjo metodë mbështetet në një bazë të dhënash bazuar në ngjarje të ndodhura që shkaktojnë humbje brenda bankës dhe të dhëna shtesë nga burime të jashtme. Hapi i parë i kësaj metode lidhet me ndërtimin për çdo linjë biznesi dhe çdo lloj ngjarjeje që shkakton humbje, dy kurba të shpërndarjes së probabilitetit për humbje. Ku njëra përfaqëson frekuencën e ngjarjeve të humbjes gjatë një intervali kohor (shpërndarja e frekuencës së humbjes), ndërsa tjetra intensitetin e këtyre ngjarjeve (shpërndarja e intensitetit të humbjes). Për secilën shpërndarjeje, modeli matematikor përfaqëson më së miri formën e kurbës. Për të vërtetuar zgjedhjen e një modeli matematikor, krahasohen rezultatet e parashikuara me ato faktike, nëse të dy kurbat mbivendosen, atëherë modeli konsiderohet i besueshëm (Lopez, 1999). Më pas të dy shpërndarjet kombinohen, duke përdorur simulimin Monte-Carlo, në mënyrë që të sigurohet për çdo linjë biznesi dhe për çdo lloj ngjarjeje, një kurbë e agreguar e shpërndarjes së humbjeve për një periudhë kohe të dhënë. Në secilin prej tyre, Vlera në Rrezik (VAR) përfaqëson humbjen maksimale të shkaktuar me një probabilitet prej 99.9%. Kapitali i kërkuar në kuadrin e Basel II përfaqëson VAR-in e llogaritur.

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

➤ Analiza bazuar në skenar:

Analiza e bazuar në skenar përfshin anketime sistematike me ekspertë të linjave të biznesit dhe ekspertë të menaxhimit të rrezikut. Qëllimi i kësaj analize është marrja e një vlerësimi mbi probabilitetin dhe koston e ngjarjeve operacionale, bazuar në kornizën analitike të propozuar nga komiteti i Bazelit. Përpunimi i skenarëve kombinon të gjithë treguesit kryesorë të rrezikut të një aktiviteti të dhënë, duke kryer pastaj edhe simulime me këto tregues.

Kjo metodë paraqet një vlerë të shtuar në rastin kur të dhënat historike nuk janë të mjaftueshme për të zbatuar një metodë statistikore. Në veçanti, zbatimi i kësaj metode është mjaft i rëndësishëm për vlerësimin e ndikimit të ngjarjeve të rënda që shkaktohen nga rreziku operacional. Pavarësisht nga emri i saj, analiza e skenarit nuk është vetëm "cilësore", pasi ajo mbështet edhe modelet matematikore.

➤ Scorecards:

Metodat statistikore mund të paraqiten si të njëanshme dhe të rrezikshme, për nga mënyra se si i bëjnë llogaritjet (ndonjëherë jashtëzakonisht të sofistikuara) e disa të dhënave të shpërndara të kampionimit duke u bazuar në një numër supozimesh subjektive. Sofistikimi i llogaritjeve krijon një përshtypje besueshmërie, duke mos dhënë gjithmonë një shqyrtim të plotë të të dhënave themelore. Për më tepër, këto metoda, duke u mbështetur në të dhëna krejtësisht historike, nuk lejojnë parashikimin e ndryshimeve në profilin e rrezikut të bankës për shkak të evolucioneve të brendshme (organizata të reja, aktivitete të reja) ose evolucioneve të jashtme (ndryshime në tregje, konkurrencë, inovacion). Disavantazhi i këtyre metodave lidhet me faktin se ato vlerësojnë vetëm ngjarjet e ndodhura në të kaluarën dhe jo ngjarjet që do të ndodhin në

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

të ardhmen, të cilat mund ti shkaktojnë shumë pasoja negative organizatës. Lidhur me këtë, metoda e pikave të vlerësimit ofron një alternativë interesante, pasi nuk mbështetet në të dhënat aktuale të humbjeve të regjistruara, por në treguesit e rrezikut, duke mbështetur në këtë mënyrë një vizion "përpara ndodhisë" të rreziqeve operacionale. Kjo metodë konsiston në ndërtimin e pyetësorëve për secilën kategori rreziku, të përbërë nga tregues sasiore (qarkullimi, numri i operacioneve) dhe tregues cilësor (vlerësimi i shpejtësisë së ndryshimit të një aktiviteti). Këto pyetësorë hartohen nga grupe ekspertësh dhe specialistë të rrezikut operacional të secilës linjë biznesi, bazuar në kriteret e menaxhimit të këtij rreziku (Marshall, 2001).

Pas hartimit të pyetësorëve, bëhet vlerësimi i kapitalit që kërkohet për të mbuluar rrezikun operacional në të gjithë bankën. Për të kryer këtë vlerësim është e nevojshme të përdoret një nga metodat statistikore. Shuma e kapitalit të vlerësuar shpërndahet për secilën kategori rreziku, duke vlerësuar për çdo linjë biznesi rëndësinë relative të secilës kategori. Meqenëse Basel II përcakton 13 kategori të rrezikut, atëherë edhe pyetësorët duhet të përmbajnë të paktën 20 pyetje. Së fundmi, pyetësorët shpërndahen dhe plotësohen në të gjitha linjat e biznesit duke rezultuar në një sasi të konsiderueshme të dhënash që duhet të analizohen. Si rezultat i ekzaminimit të këtyre të dhënave, është e mundur të përcaktohet një "pikë" e rrezikut operacional për secilën linjë biznesi, me qëllim ndarjen e kapitalit rregullator në mënyrën e duhur. Përsëritja e këtij procesi lejon që të ndryshohet në kohë shumat e kapitalit të alokuar për çdo linjë biznesi. Metoda e pikëve tregon një pasqyrë të detajuar të profilit të rrezikut operacional në institucionin financiar. Po ashtu, kjo metodë lejon përfshirjen e stafit në menaxhimin e rrezikut operacional, gjë e cila nxit fort reduktimin e këtij rreziku.

3.6.2 Modelet e rrezikut operacional.

Industria financiare ka kohë që sfidohet nga zbatimi i konceptit të stres-testit dhe nga analiza e skenarit të rrezikut operacional. Në praktikë, modelet e analizës së rrezikut duhet të lidhen dhe të përdoren si një trajtë e kombinuar për të hetuar ndjeshmëritë e një firme ndaj rrezikut operacional. I përdorur si një term i përcaktuar ngushtë, stres-testi zakonisht i referohet ndryshimit të një parametri të vetëm të rrezikut operacional. Ndryshe ndodh me analizën e skenarit e cila ndryshon në të njëjtën kohë një numër të caktuar parametrash të këtij rreziku. Një përdorim në mënyrë efektive i stres-testit në lidhje me rreziqet operationale të një firme, sqaron saktë për menaxhimin e kompanisë marrëdhëniet shkakësore midis rreziqeve, vështirësitë interpretuese të lidhura me treguesit e rrezikut operacional dhe mungesën e të dhënave në lidhje me këtë rrezik (Moscadelli, 2004).

Pika e parë që duhet patur parasysh kur zhvillohet një grup efektiv stres-testesh për rrezikun operacional ka të bëjë me ndërtimin e këtyre testeve bazuar edhe në teknikat e tjera të përdorura në biznes, siç është parashikimi. Shumë biznese ndërmarrin parashikime rutinë gjatë zhvillimit të planeve të tyre tre vjeçare duke dhënë informacion të vlefshëm të rrezikut operacional në përputhje me strategjitë e nivelit të lartë menaxherial. Të dhënat e marra nga stres-testet janë të rëndësishme për të nxjerrë rezultate të vlefshme. Këto të dhëna mund të merren nga aplikimi i stres-testeve të zhvilluara në regjistrin ekzistues të rrezikut operacional të firmës. Shqyrtimi i treguesve të rrezikut operacional dhe humbjet ekzistuese për të njëjtin stres-test japin një set të plotë të të dhënave fillestare të rrezikut operacional. Përsëritja e këtij procesi për secilin stres-test të identifikuar prodhon një seri të plotë të dhënash për analizën e rrezikut

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

operacional. Pas mbledhjes së plotë të të dhënave, është e rëndësishme të kontrollohet qëndrueshmëria e brendshme e secilit stres-test dhe krahasueshmëria e tyre. Pjesa më e madhe e stres-testeve të rrezikut operacional janë gjerësisht të ndryshme në detaje (Van Den Brink, 2002).

Modelet matematikore të përdorura për gjenerimin e rezultateve të stres-testit mund të jenë të njëjta me modelet e përdorura për llogaritjet e kapitalit, duke supozuar se këto modele tashmë përputhen me nevojat rregullatore të cilat marrin në konsideratë humbjet e brendshme, humbjet e jashtme dhe mjedisin e kontrollit të brendshëm. Të dhënat e zhvilluara nga stres-testet marrin parasysh tre elementët e përmendur më sipër dhe për këtë arsye një model stres-testi i rrezikut operacional mund të ekzistojë tashmë në firmë, duke reduktuar kohë dhe para në zhvillimin e një modeli tjetër. Orientimi i çdo stres-testi nëpërmjet modelit, prodhon një sërë vlerash të cilat japin një pasqyrë të ndjeshmërisë së firmës ndaj ngjarjeve ekstreme të rrezikut operacional. Pavarësisht se modelet matematikore nuk japin një përgjigje të plotë, ato mundësojnë ngritjen e pyetjeve në një mënyrë logjike dhe të qëndrueshme duke siguruar një diskutim menaxherial të dobishëm. Si përfundim stres-testet e rrezikut operacional sigurojnë informacon në përputhje me parashikimet e firmës, të vlefshme për nivelet menaxheriale me qëllim njohjen në mënyrë sa më të saktë të profilit të rrezikut operacional të firmës.

3.6.3 Proceset e menaxhimit të rrezikut operacional.

Bankat mund të zgjedhin teknika të ndryshme analitike ose gjykuese për të vlerësuar në një nivel të përgjithshëm rrezikun operacional të firmës (Gallati, 2003). Gjatë përcaktimit të politikës për menaxhimin e rrezikut operacional, niveli menaxherial duhet të konsiderojë si objektiva kryesore:

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

- përcaktimin dhe shpjegimin e ekspozimeve dhe incidenteve që rezultojnë nga stafi, proceset, sistemet dhe ngjarjet e jashtme;
- paralajmërimin e hershëm të incidenteve dhe përshkallëzimin e rrezikut potencial duke parashikuar rreziqet dhe duke identifikuar fushat problematike përmes monitorimit të vazhdueshëm të treguesve kryesorë të rrezikut;
- përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësive të personelit në menaxhimin e rrezikut operacional dhe fuqizimin e njësive të biznesit për të ndërmarrë veprimet e nevojshme;
- forcimin e mbikëqyrjes menaxheriale;
- sigurimin e mjeteve objektive të matjes;
- integrimin e të dhënave cilësore, sasiore dhe informacioneve tjera.

Qëllimet e menaxhimit të rrezikut operacional, paraqiten si më poshtë (Bessis, 1998):

- parandalimi i ngjarjeve të mundshme që shfaqen si rrezik operacional;
- zbutja e efekteve negative të shkaktuara nga rreziqet operationale dhe zvogëlimi i ndikimit të tyre;
- kontrolli adekuat i çdo dëmtimi shkatuar nga ngjarjet operationale.

Ekzistojnë tre mënyra për trajtimin e rrezikut operacional, të tilla si shmangia e rrezikut, reduktimi i rrezikut si dhe ndarja dhe transferimi i rrezikut. Shmangia e rrezikut është një vendim që duhet të realizohet në kontekstin e aspektit kohor, ekspertizës së disponueshme, qëllimeve strategjike dhe rrezikut reputacional. Reduktimi i rrezikut ka për qëllim zvogëlimin e shpeshtësisë së shfaqjes dhe intensitetit të ngjarjeve të rrezikut operacional. Instrumente të tilla zakonisht përdoren nga mekanizma të shumtë organizativë dhe nga sistemi i kontrollit të brendshëm. Ndarja dhe transferimi i rreziqeve

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

është i pranueshëm vetëm nëse rreziku nuk mund të bëhet në mënyrë adekuate, pra të reduktohet nëpërmjet kontrolleve të brendshme (Filipovska, 2011).

Procesi i menaxhimit të rrezikut operacional kalon nëpërmjet gjashtë hapave të rëndësishëm, të paraqitura si më poshtë.

Hapi 1: Identifikimi i rrezikut

Një rrezik përcaktohet si një ngjarje e mundshme që mund të shkaktojë degradim, dëmtim dhe humbje të pajisjeve ose pronës. Përvoja dhe mjetet specifike analitike ndihmojnë në identifikimin e rreziqeve operationale.

Hapi 2: Vlerësimi i rrezikut

Vlerësimi i rrezikut përcaktohet si zbatimi i masave sasiore dhe cilësore për të përcaktuar nivelin e rrezikut operacional. Ky proces përcakton probabilitetin dhe ashpërsinë e një ngjarje apo rreziku që mund të shkaktohet nga stafi.

Hapi 3: Analizimi i masave për kontrollin e rrezikut

Ky hap merret me zbulimin e strategjive dhe mjeteve specifike që zvogëlojnë, pakësojnë ose eliminojnë rrezikun operacional. Të gjitha rreziqet kanë të paktën tre komponentë: probabilitetin e shfaqjes, ashpërsinë e rrezikut dhe ekspozimin e stafit dhe pajisjeve ndaj rrezikut. Masat efektive të kontrollit zvogëlojnë ose eliminojnë të paktën një nga këto komponentë. Analiza duhet të marrë parasysh kostot dhe përfitimet e përgjithshme të veprimeve, duke siguruar zgjedhje alternative nëse është e mundur.

Hapi 4: Marrja e vendimeve në lidhje me kontrollin

Hapi i katërt merret me identifikimin e vendimmarrjes së duhur. Kjo vendimmarrje duhet të zgjedhë kontrollin më të mirë, bazuar në analizën e hapit 3.

Hapi 5: Zbatimi i kontrolleve të rrezikut

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

Sipas këtij hapi, niveli menaxherial duhet të formulojë një plan për zbatimin e kontrolleve që janë përzgjedhur, pastaj të sigurojë kohën, materialet dhe personelin e nevojshëm për zbatimin e këtyre masave.

Hapi 6: Mbikëqyrja dhe rishikimi

Pasi të jenë vendosur kontrollet, procesi duhet të rivlerësohet periodikisht për të siguruar efektivitetin e tyre. Punonjësit dhe menaxherët e çdo niveli duhet të përmbushin rolet e tyre përkatëse për të siguruar se kontrollet zbatohen në kohë. Procesi i menaxhimit të rrezikut vazhdon gjatë gjithë kohës së ciklit jetësor të sistemit apo aktivitetit.

3.7 Rreziku i likuiditetit.

Rreziku i likuiditetit ndodh në momentin kur një bankë nuk mund të përmbushë një kërkesë për para ose të paguaje detyrimet e saj për shkak të pamundësisë së mjeteve monetare ose mbledhjes së fondeve në kohën e duhur me një çmim të arsyeshëm. Menaxhimi efektiv i rrezikut të likuiditetit në banka është thelbësor për të siguruar një funksionim normal të këtyre institucioneve. Në tregjet e sotme financiare, rreziku i likuiditetit paraqet sfida të caktuara për nga pikëpamja konceptuale dhe matëse. Në të vërtetë, menaxhimi i rrezikut të likuiditetit merr një rëndësi edhe më të madhe në momentin kur ai ndërvepron me rrezikun e tregut dhe rrezikun e kredisë gjatë periudhave me probleme në tregjet financiare (Bervas, 2006).

Bankat zakonisht e menaxhojnë rrezikun e likuiditetit sipas standarteve të pranuara ndërkombëtarisht. Si në çdo rrezik tjetër, diversifikimi i burimeve të financimit është një element shumë i rëndësishëm në menaxhimin e rrezikut të likuiditetit. Bankat i diversifikojnë këto burime financimi sipas maturimit, kategorisë së klientëve, tregjeve, monedhës dhe rajoneve. Kjo siguron monitorimin e balancës midis depozitave kryesore

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

(që përbëjnë llogaritë e klientëve dhe depozitat me afat), të cilat janë të qëndrueshme dhe depozitave me shumicë, të cilat zakonisht janë më pak të qëndrueshme dhe kanë një afat maturimi të shkurtër. Teknika relativisht të reja, siç është sigurimi etj., kanë ndihmuar në diversifikimin e fondeve. Bankat gjithashtu vendosin dhe i përmbahen kufijve të elementëve kryesorë të rrezikut të likuiditetit, të tilla si pragjet minimale për aktivet shumë likuide. Këto institucione financiare, gjithashtu mbajnë plane për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit dhe kryejnë rregullisht stres-teste për të fituar besim në aftësinë e tyre për të operuar nën një krizë likuiditeti.

➤ Shkaqet e rrezikut të likuiditetit:

Rreziku i likuiditetit lind në momentin kur një palë e interesuar në tregtimin e një aktivi nuk mund ta realizojë atë, për faktin se askush në treg nuk është i gatshëm ta blejë këtë aktiv. Rreziku i likuiditetit bëhet veçanërisht i rëndësishëm për palët që janë gati për të mbajtur ose aktualisht kanë një pasuri, pasi ajo ndikon në aftësinë e tyre për ti tregtuar. Sipas tregut, një aktiv është i pavlerë në rast se çmimi i tij bie në zero. Në qoftë se, njëra nga palët në treg nuk mund të gjejë palën tjetër të interesuar për tregtimin e aktivit, atëherë kjo tregon një problem të pjesëmarrësve në treg për gjetjen e njëri-tjetrit. Ky lloj problemi përbën edhe arsyen se përse rreziku i likuiditetit zakonisht është më i lartë në tregjet në zhvillim. Me rrezik likuiditeti do të kuptojmë atë rrezik financiar i cili shkaktohet në një institucion nga pasiguria e likuiditetit. Një institucion financiar mund të humbasë likuiditetin nëse vlera e tij e kreditit bie, duke përjetuar dalje të papritura të mjeteve monetare ose ndonjë ngjarje tjetër që shkakton probleme në tregtimin apo huadhënien në institucion. Po ashtu një institucion financiar është i ekspozuar ndaj rrezikut të likuiditetit nëse tregjet ku kjo firmë operon janë subjekt i humbjes së

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

likuiditetit. Rreziku i likuiditetit ndahet në rrezikun e likuiditetit të tregut dhe të financimit. Rreziku i likuiditetit të tregut lidhet me faktin që institucioni financiar e ka të vështirë të shesë një aktiv financiar afër vlerës së tregut, ndërkohë që likuiditeti i financimit lidhet me faktin që kur institucioni ka nevojë për fonde e ka të vështirë ti sigurojë ato. Rreziku i likuiditetit gjithashtu përbëhet edhe nga rreziqe të tjera (Jarrow & Subramanian 1997). Nëse një organizatë tregtare ka një pozicion në një aktiv jolikuid, aftësia e saj e kufizuar për të likuiduar atë pozicion në një kohë të shkurtër përbën edhe rrezikun e saj të tregut. Për shkak se rreziku i likuiditetit ka tendencë të jetë pjesë e rreziqeve të tjera financiare, është e vështirë ose e pamundur të izolohet.

Në të gjitha rrethanat përvec atyre më të thjeshta, nuk ekzistojnë mënyra matëse gjithëpërfshirëse të rrezikut të likuiditetit. Disa teknika të menaxhimit të aktiveve dhe pasiveve aplikohen për të vlerësuar rrezikun e likuiditetit. Po ashtu një test i thjeshtë për matjen e rrezikut të likuiditetit është verifikimi i flukseve neto të ardhshme të parasë në baza ditore që realizohet nëpërmjet stres-testeve. Analiza të tilla si këto nuk mund të masin lehtësisht flukset monetare të kushtëzuara, siç janë flukset e mjeteve monetare nga derivatet ose letrat me vlerë të kolateralizuara. Nëse flukset e mjeteve monetare të një organizate janë kryesisht kontingjente, rreziku i likuiditetit mund të vlerësohet duke përdorur një formë të analizës së skenarit bazuar në hapat e mëposhtëm:

- Ndërtimi i skenarëve të shumëfishtë për lëvizjet e tregut gjatë një periudhe të caktuar kohe;
- Vlerësimi i flukseve të përditshme të mjeteve monetare në secilin skenar.

Për shkak se bilancet ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga një organizatë në tjetrën, ka pak standardizim në lidhje me zbatimin e këtyre analizave.

3.7.1 Matja e rrezikut të likuiditetit.

Matja e rrezikut të likuiditetit mund të realizohet nëpërmjet metodës së raportit kredi-depozitë, raportit të rezervës cash dhe raportit të likuiditetit (Lawrence & Robinson, 1995).

➤ Raporti kredi-depozitë:

Ky raport krahason totalin e kredive me probleme ndaj totalit të depozitave në një periudhë të caktuar kohe. Një bankë e përcakton pozicionin e saj të likuiditetit me këtë metodë duke e ndarë portofolin e saj të kredive me probleme nga shuma e depozitave, dhe duke krahasuar koeficientin ose raportin e marrë me objektivin e përcaktuar nga autoritetet rregullatore. Kur ky raport del më i lartë se mesatarja, banka mund të miratojë një politikë shtrënguese të kredisë për të kontrolluar ndikimin e mundshëm negativ të likuiditetit. Në këtë rast banka duhet të përzgjedhë në mënyrë selektive klientët më potencial të mundshëm për dhënien e kredive të reja.

➤ Raporti i rezervës cash:

Ky raport, i njohur gjithashtu si raporti i parasë së gatshme ndaj depozitave, mat likuiditetin duke e lidhur vëllimin mesatar të mjeteve monetare ose aktiveve likuide, me totalin e depozitave të bankës. Ndonjëherë, llogaritjet e raportit të rezervës së parasë marrin në konsideratë totalin e depozitave ose totalin e aktiveve të bankave të ngjashme. Raporti llogaritet nga autoritetet rregullatore të tilla si Banka Qendrore dhe zbatohet nga bankat tregtare. Formula e mëposhtme aplikohet në llogaritjen e raportit të cash-it:

$$\text{Rezerva e parave} = \text{Totali i arkëttimeve} / \text{Totali i depozitave}$$

Një disavantazh i këtij raporti është paaftësia për të njohur mundësinë dhe tendencën e një banke për të mbledhur para nga burimet alternative në përmbushje të nevojave të

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

likuiditetit .

➤ Raporti i likuiditetit:

Llogaritja dhe zbatimi i raportit të likuiditetit përbën një nga mënyrat e sakta për vlerësimin e likuiditetit të bankave. Raporti llogaritet duke pjesëtur likuiditetet e specifikuara me detyrimet e përgjithshme aktuale të bankës si më poshtë:

Raporti i likuiditetit = Likuiditetet e specifikuara / Detyrimet gjithësej

Çështja kritike në përdorimin e këtij raporti lidhet me përcaktimin e përbërjes së aktiveve likuide të specifikuara.

3.7.2 Modelet e rrezikut të likuiditetit.

Modelimi i rrezikut të likuiditetit mund të realizohet nëpërmjet stres-testeve. Tregu aktual përbën një shembull të skenarit të stres-testeve. Një model i tillë mund të përcaktojë masën e ndikimit të rrezikut të likuiditetit në mjaftueshmërinë e kapitalit. Një pjesë e problemit lidhet me njohjen e nevojave të parasë jashtë bilancit që mund të lindin si pasojë e një përçarje të tregut, siç janë kërkesat për kolateral, opsionet dhe rimbursimet. Kjo gjithashtu thekson dobinë e modeleve dinamike ERM që përfshijnë strategjitë e reagimit ndaj ngjarjeve të ndryshme. Ajo që është e rëndësishme në këto modele lidhet me përgjigjet që japin skenarët duke marrë parasysh mundësinë që të gjithë lojtarët e tjerë po ndjekin të njëjtat strategji.

3.7.3 Proceset e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.

Një menaxhim efektiv i rrezikut të likuiditetit përfshin aplikimin e sistemeve për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar ekspozimet ndaj këtij rreziku. Niveli menaxherial duhet të jetë në gjendje të identifikojë me saktësi dhe të përcaktojë në kohën e duhur burimet kryesore që shkaktojnë rrezikun e likuiditetit në bankë. Për të

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

identifikuar burimet e duhura, niveli menaxherial duhet të jetë në gjëndje të kuptojë si rrezikun ekzistues, ashtu edhe rrezikun që mund ti kanoset bankës në të ardhshëm. Gjithashtu këto drejtues duhet të jenë vigjilentë për burimet e reja të rrezikut të likuiditetit që mund të shfaqen në nivelin e transaksionit dhe të portofolit (BIS, 2008).

Sistemet e menaxhimit të informacionit (MIS) luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e rrezikut të likuiditetit. Këto sisteme shërbejnë për matjen monitorimin dhe kontrollin e rreziqeve ekzistuese dhe të ardhshme të likuiditetit, si dhe raportimin e tyre tek nivelet e larta menaxhuese. Një sistem efektiv i menaxhimit të informacionit (MIS) është thelbësor për marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me zvogëlimin e rrezikut të likuiditetit në bankë. Informacioni duhet të jetë i gatshëm për menaxhimin e përditshëm të likuiditetit dhe kontrollin e rrezikut. Të dhënat duhet të jenë të konsoliduara në mënyrë të përshtatshme, të strukturuar, të fokusuara dhe të disponueshme në kohën e duhur. Teorikisht, raportet e rregullta të likuiditetit që gjeneron një bankë i mundësojnë asaj monitorimin e këtij rreziku gjatë një periudhe krize. Menaxherët duhet të jenë të vëmendshëm në monitorimin e krizës kur zhvillojnë sistemin e menaxhimit të informacionit (MIS) të likuiditetit. Problemet e likuiditetit mund të lindin shumë shpejt dhe për këtë arsye një menaxhim efektiv i këtij rreziku duhet të kërkojë raportim të brendshëm të përditësuar. Meqenëse likuiditeti i bankës preket kryesisht nga flukse të mëdha të mjeteve monetare kryesore dhe agregate, informatat e hollësishme për çdo transaksion nuk ndihmojnë në përmirësimin e analizës. Përmbajtja dhe formati i raporteve varen kryesisht nga praktikat e menaxhimit të likuiditetit të bankës, rreziqet dhe karakteristika të tjera. Këto raporte duhet të përshtaten me nevojat e bankës. Menaxhimi i përditësuar mund të kërkojë informata më të

Kuptimi dhe llojet e rreziqeve financiare që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare

hollësishme, në varësi të kompleksitetit të bankës dhe rreziqeve që ndërmerr. Nivelet menaxhese duhet të shqyrtojnë rregullisht përmbledhjen e çështjeve komplekse ose të detajuara për bordin. Për të patur një menaxhim të suksesshëm të aktiviteteve të përditshme të një banke dhe për të kuptuar profilin e rrezikut të likuiditetit duhet të kemi parasysh:

- cilësinë e aktiveve dhe tendencat e tyre;
- parashikimet e fitimeve;
- reputacionin e përgjithshëm të bankës në treg;
- llojin dhe përbërjen e strukturës së përgjithshme të bilancit;
- llojin e depozitave të reja që merren, burimin, maturimin dhe çmimin e tyre.

Një sistem efektiv i matjes dhe monitorimit është thelbësor për menaxhimin adekuat të rrezikut të likuiditetit. Rrjedhimisht, bankat duhet të krijojnë sisteme që u mundësojnë atyre kapjen e rrezikut të likuiditetit para kohe, në mënyrë që të merren masa të përshtatshme korrigjuese për të shmangur humbjet e mëdha. Bankat ndryshojnë në lidhje me rrezikun e tyre të likuiditetit (varësisht nga madhësia dhe kompleksiteti i biznesit) dhe kërkojnë teknika të matjes së rrezikut të likuiditetit në përputhje me rrethanat. Për shembull, bankat që kanë rrjete të mëdha mund të kenë qasje në depozita të qëndrueshme dhe me kosto të ulët, ndërsa bankat e vogla kanë mbështetje të konsiderueshme në depozitat e institucioneve të madhe. Megjithatë, likuiditeti i bollshëm nuk e shmang nevojën për një mekanizëm i cili mat dhe monitoron profilin e likuiditetit të bankës. Një sistem efektiv i matjes dhe monitorimit të rrezikut të likuiditetit ndihmon në menaxhimin e likuiditetit në kohë krize, si dhe optimizon kthimin përmes shfrytëzimit në mënyrë efikase të fondeve në dispozicion.

3.8 Përmbledhje e kapitullit.

Në këtë kapitull u trajtua në mënyrë të detajuar rëndësia e pesë rreziqeve kryesore financiare (rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit, rreziku i normës së interesit, rreziku i kursit të këmbimit dhe rreziku operacional) që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare. Po ashtu në këtë kapitull u trajtua në mënyrë të detajuar matja, procesi i menaxhimit si dhe modelet përkatëse për secilin rrezik financiar të marrë në studim. Në këtë mënyrë, përmbillet kuadri teorik i këtij punimi, për të vijuar më tej me kapitullin metodologjik dhe studimin empirik.

PJESA E DYTË: STUDIMI EMPIRIK

KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E KËRKIMIT

4.1 Shfrytëzimi i kuadrit teorik në funksion të realizimit të studimit empirik.

Teoritë mbi rreziqet financiare janë të shumta. Një pjesë e mirë e tyre janë përfshirë në kuadrin teorik të këtij punimi. Megjithatë, në funksion të pyetjeve kërkimore dhe hipotezave bazë të studimit, vetëm një pjesë e kuadrit teorik do të shfrytëzohet në mënyrë të detajuar për realizimin e studimit empirik. Konkretisht, rreziqet financiare përbëjnë çështjet kryesore të kuadrit teorik të cilët do të shërbejnë si instrumente bazë për të realizuar analizën e të dhënave empirike.

Siç u përmend edhe në kapitujt teorikë, rreziku është studiuar prej kohësh nga autorë të ndryshëm dhe nuk ka një përkufizim universal. Gallati (2003) e përcakton rrezikun si një gjendje në të cilën ekziston një ekspozim ndaj vështirësive, ose një gjendje në të cilën ekziston mundësia e devijimit nga një rezultat i dëshiruar që pritet ose shpresohet.

Rreziku i kredisë u shfaq si një çështje e rëndësishme e administrimit të rreziqeve financiare gjatë viteve 1990. Duke qënë se gjatë kësaj periudhe, tregjet finaciare u bënë shume konkurruese, bankat filluan të ekspozoheshin gjithnjë e më shumë ndaj rrezikut të kredisë. Ky rrezik është faktori kryesor për nga rëndësia, i cili i shkakton edhe humbjet më të mëdha bankës. Rreziku i kredisë përcaktohet si një pamundësi e huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij ndaj bankës sipas kushteve të përcaktuara në kontratë midis dy palëve (Greuning & Bratanovic, 2009). Duke qënë se rreziku i kredisë është shkaku kryesor i falimentimit të bankës, menaxhimi në mënyrë efikase i këtij rreziku merr një

rëndësi të veçantë në lidhje me mbijetesën dhe mbarëvajtjen e biznesit bankar.

Rreziku i normës së interesit përkufizohet si ekspozimi i gjendjes financiare të një banke ndaj lëvizjeve të pafavorshme të normave të interesit. Pranimi i këtij rreziku është një pjesë normale e sistemit bankar dhe mund të jetë një burim i rëndësishëm përfitimi. Megjithatë, rreziku i tepruar i normës së interesit mund të përbëjë një kërcënim për bankën. Ndryshimet në normat e interesit mund të kenë efekte negative si në të ardhurat neto të një banke ashtu edhe në vlerën e saj ekonomike (Jacque, 1996). Prandaj, një menaxhim efektiv i rrezikut të normës së interesit brenda niveleve të duhura është thelbësor për sigurinë dhe vazhdimësinë e bankave.

Rreziku i kursit të këmbimit, si të gjithë rreziqet e tjera, ndikon në përfitueshmërinë e bankave tregtare dhe lidhet me efektin e ndryshimeve të papritura të kursit të këmbimit në vlerën e firmës (Madura, 1989). Në veçanti, ky rrezik përkufizohet si humbje e mundshme direkte ose indirekte në flukset e mjeteve monetare të firmës, nga lëvizja e kursit të këmbimit. Për të menaxhuar rrezikun e kursit të këmbimit, një firmë duhet të përcaktojë llojin specifik të ekspozimit aktual të rrezikut, strategjinë mbrojtëse dhe instrumentet në dispozicion për t'u marrë me rreziqet e monedhës. Për të matur ndikimin e lëvizjeve të kursit të këmbimit në një firmë që është e angazhuar në transaksione në valutë të huaj duhet të identifikohen llojet e rreziqeve ndaj të cilave firma është ekspozuar dhe sasinë e rrezikut të hasur (Hakala & Wystup, 2002).

Rreziku operacional nuk është një koncept i ri, deri më tani ky rrezik nuk ka marrë aq shumë vëmendje sa rreziku i kredisë, për shkak se ky i fundit ka një impakt shumë më të madh në përfitueshmërinë e bankave tregtare. Menaxhimi i rrezikut operacional përfshin marrjen e masave të përshtatshme për të siguruar transaksione

cilësore dhe pa gabime, në mënyrë që të ofrohen shërbime sa më të mira për klientët. Ndryshimet e ndodhura në tregjet financiare, globalizimi, si dhe ristrukturimi i korporatave patën një ndikim të konsiderueshëm në madhësinë dhe natyrën e rreziqeve operacionale të bankave tregtare (Helbok & Wagner, 2006). Rreziku operacional është një term i cili ndryshon brenda industrisë bankare dhe për këtë arsye për qëllime të brendshme bankat mund të zgjedhin strategji të ndryshme për menaxhimin e këtij rreziku. Menaxhimi i rrezikut operacional nuk është sot një praktikë e re, pasi bankat gjithmonë janë përpjekur të parandalojnë mashtrimet, të ruajnë integritetin e kontrolleve të brendshme, të reduktojnë gabimet në përpunimin e transaksioneve e kështu me radhë, në mënyrë që të ruhet cilësia e shërbimeve për klientët e tyre dhe të minimizohen humbjet që shkaktohen nga ky rrezik (Banerjee & Banipal, 2005) .

Rreziku i likuiditetit është një tjetër faktor financiar i cili paraqitet në momentin kur një bankë nuk mund të përmbushë një kërkesë për para ose të financojë detyrimet e saj për shkak të mungesës së likuiditetit. Menaxhimi efektiv i rrezikut të likuiditetit në banka është thelbësor për të siguruar vazhdimësinë dhe funksionimin e institucioneve financiare. Në tregun e sotëm bankar, rreziku i likuiditetit paraqet sfida të caktuara nga pikëpamja konceptuale dhe matëse, pasi bankat kanë pësuar humbje nga menaxhimi jo i mirë i këtij rreziku (Bervas, 2006).

Siç u theksua edhe më lart, ndër të gjitha rreziqet, rreziku i kredisë është indikator kryesor financiar që ka ndikuar më shumë në perfitueshmerinë e bankave tregtare. Gjithashtu një menaxhim i mirë i rrezikut të likuiditetit, rrezikut të normës së interesit, rrezikut operacional si dhe i rrezikut të kursit të këmbimit ndikon pozitivisht në perfitueshmërisë së bankave tregtare.

4.2 Burimet e informacionit.

Rikujtojmë edhe një herë pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë të punimit.

Pyetjet kerkimore:

1. *Si ndikon rreziku i kredisë në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri ?*
2. *A ndikon negativisht likuiditeti i tepërt në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri?*

Hipotezat bazë:

1. *Ndër rreziqet financiare, rreziku i kredisë ka ndikimin më të madh në përfitueshmërinë (ROE) e bankave tregtare në Shqipëri.*
2. *Likuiditeti i tepërt ndikon negativisht në përfitueshmërinë (ROE) e bankave tregtare në Shqipëri.*

Siç u theksua edhe në fillim të këtij studimi, bazuar tek literatura dhe hulumtimet ekzistuese mbi sistemin bankar, me rreziqe financiare do të kuptojmë:

- rrezikun e kredisë,
- rrezikun e likuiditetit,
- rrezikun e normës së interesit,
- rrezikun e kursit të këmbimit,
- rrezikun operacional.

Këto rreziqe financiare përbëjnë edhe variablat e pavaruara të punimit ose indikatorët kryesorë që ndikojnë në përfitueshmërinë (ROE) e bankave tregtare. Të dhënat dytësore të punimit për testimin hipotezave janë të marra nga:

1. literatura ekzistuese dhe studime të ndryshme mbi rreziqet financiare të realizuara në Shqipëri dhe jashtë saj;

2. pasqyrat kryesore financiare të bankave tregtare në Shqipëri, gjatë periudhës 2006-2015.

4.3 Popullata e synuar.

Popullata e synuar të këtij punimi janë 16 bankat tregtare që kanë operuar në Shqipëri gjatë periudhës 2006-2015. Mugenda & Mugenda (2003) theksojnë se popullata e synuar duhet të ketë disa karakteristika të observueshme, përmes të cilave studiuesi synon të përgjithësojë rezultatet e punimit. Të dhënat janë siguruar në total për të gjithë sistemin bankar nga pasqyrat kryesore financiare të bankave tregtare në Shqipëri, gjatë periudhës 2006-2015.

4.4 Metodologjia, metodat dhe instrumentet bazë të hulumtimit.

Ky punim ka karakter analizues sasior dhe cilësor. Metodatat bazë sipas të cilave do të realizohet një analizë e tillë, kanë të bëjnë me korrelacionin ndërmjet variablave si dhe analizën e regresionit linear të shumëfishtë. Pjesën më të madhe të analizës e zë krahasimi i impaktit të rreziqeve financiare (variabla të pavarura) mbi përfitueshmërinë (variabël i varur) e bankave tregtare në Shqipëri gjatë periudhës 2006-2015. Me të dhënat dytësore dhe me karakter sasior të këtij punimi, të marra nga pasqyrat kryesore financiare të bankave tregtare shqiptare, synohet testimi i hipotezave të studimit. Përpunimi i të dhënave të studimit realizohet nëpërmjet programit statistikor EViews6.

4.5 Mbledhja e të dhënave dhe përpunimi i tyre.


Të dhënat e studimit janë dytësore, seri kohore dhe i përkasin periudhës 2006-2015. Më poshtë paraqitet grafikisht mbledhja dhe përpunimi i të dhënave tremujore të marra nga pasqyrat kryesore financiare të bankave tregtare shqiptare, në lidhje me variablat e marra në studim:

- *Variabel i Varur*: Përfitueshmëria (ROE).

- *Variabla të Pavarura:* Rreziqet Financiare (rreziku i kredisë, rreziku i normës së interesit, rreziku i likuiditetit, rreziku operacional dhe rreziku i kursit të këmbimit).

1. ROE (*Kthimi nga Kapitali Aksioner*) = $\frac{\text{Të Ardhura Neto}}{\text{Kapitali Aksioner}} \cdot 100$.

Grafiku Nr. 5 – ROE (në %)




Burimi : Banka e Shqipërise.

Në Grafikun Nr. 5 paraqitet kthimi nga kapitali aksioner gjatë periudhës 2006-2015 në sistemin bankar shqiptar. Ky tregues llogaritet si raport i të ardhurave neto ndaj kapitalit aksioner. Siç shihet edhe në grafik, treguesi i përfitueshmërisë (ROE) e ka patur minimumin e tij në tremujorin e fundit të vitit 2015 dhe maksimumin në tremujorin e fundit të vitit 2013.

2. RK (Rreziku i Kredisë) = $\frac{\text{Totali i Kredive} + \text{Interesi i Përlllogaritur}}{\text{Totalin e Aseteve}} \cdot 100$.

Grafiku Nr. 6 – Rreziku i Kredisë (në %)




Burimi : Autori (2017).

Në Grafikun Nr. 6 paraqitet situata e rrezikut të kredisë gjatë periudhës 2006-2015 në sistemin bankar shqiptar. Ky tregues llogaritet si raport i totalit të kredive plus interesin e përlllogaritur ndaj totalit të asetëve. Siç shihet edhe në grafik, ky raport e ka patur minimumin e tij në tremujotin e parë të vitit 2006 dhe maksimumin në tremujorin e fundit të vitit 2011.

3. RL (Rreziku i Likuiditetit) = $\frac{\text{Kapital Rregullator}}{\text{Totalin e Aseteve}} \cdot 100$.

Grafiku Nr. 7 – Rreziku i Likuiditetit (në %)



Burimi : Autori (2017).

Në Grafikun Nr. 7 paraqitet situata e rrezikut të likuiditetit gjatë periudhës 2006-2015 në sistemin bankar shqiptar. Ky tregues llogaritet si raport i kapitalit rregullator ndaj totalit të aseteve. Siç shihet edhe në grafik, ky raport e ka patur minimumin e tij në tremujorin parë të vitit 2006 dhe maksimumin në tremujorin e tretë të vitit 2013.

4. $RO \text{ (Rreziku Operacional)} = \text{Kosto Operacionale} / \text{Totalin e Aseteve} * 100$.

Grafiku Nr. 8 – Rreziku Operacional (në %)




Burimi : Autori (2017).

Në Grafikun Nr. 8 paraqitet situata e rrezikut operacional gjatë periudhës 2006-2015 në sistemin bankar shqiptar. Ky tregues llogaritet si raport i kostove operacionale ndaj totalit të aseteve. Siç shihet edhe në grafik, ky raport e ka patur minimumin e tij në tremujorin tretë të vitit 2006 dhe maksimumin në tremujorin e tretë të vitit 2014.

5. RNI (Rreziku i Normës së Interesit) = $GAP(A-P) / \text{Totalin e Aseteve} * 100$.

Grafiku Nr. 9 – Rreziku i Normës së Interesit (në %)




Burimi : Autori (2017).

Në Grafikun Nr. 9 paraqitet situata e rrezikut të normës së interesit gjatë periudhës 2006-2015 në sistemin bankar shqiptar. Ky tregues llogaritet si raport i GAP-ve ndaj totalit të aseteve. Siç shihet edhe në grafik, ky raport e ka patur minimumin e tij në tremujorin parë të vitit 2009 dhe maksimumin në tremujorin e dytë të vitit 2011.

6. RKK (Rreziku i Kursit të Këmbimit) = $\text{Pozicioni Hapur Neto (USD, EURO, GBP)}$.

Grafiku Nr. 10 – Rreziku i Kursit të Këmbimit (në mln lek)



Burimi : Autori (2017).

Në Grafikun Nr.10 paraqitet situata e rrezikut të kursit të këmbimit gjatë periudhës 2006-2015 në sistemin bankar shqiptar. Ky tregues llogaritet me Pozicionet e Hapura Neto në valutë (USD, EURO, GPB) dhe ka patur një minimum në tremujorin e tretë të vitit 2011 dhe një maksimum në tremujorin e dytë të vitit 2015.

Të dhënat dytësore të marra dhe të përpunuara nga pasqyrat kryesore financiare të bankave tregtare shqiptare u testuan nëpërmjet programit statistikor EViews6. Pas testimit është bërë analiza përshkruese statistikore dhe analiza e regresionit linear të shumëfishtë. Këto lloj analizash japin një panoramë të përgjithshme të rezultateve të punimit, duke identifikuar impaktin e rreziqeve financiare (variabla të pavarur) në përfitueshmërinë/ROE (variabel i varur) e bankave tregtare shqiptare.

4.6 Qasja teorike e Modelit Ekonometrik.

Deri tani u përshkrua mënyra e mbledhjes së të dhënave të punimit nga pasqyrat kryesore financiare të bankave tregtare shqiptare gjatë periudhës 2006-2015. Në këtë paragraf, do të diskutohet rreth qasjes teorike dhe modelit ekonometrik të marrë në shqyrtim për testimin e variablave. Bazuar edhe në disa studime të tjera të ngjashme të realizara nga Mureti, (2012) dhe Imane, (2014), *Modeli Linear i Shumëfishtë* është modeli ekonometrik më i përshtatshëm për këtë studim. Qëllimi kryesor i këtij modeli është të tregojë impaktin e secilit rrezik financiar mbi përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri. Nisur nga kjo, variabli i varur (y) është përfitueshmëria (ROE), ndërsa variablat e pavarurara (x -et) janë rreziqet financiare (rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit, rreziku i normës së interesit, rreziku i kursit të këmbimit dhe rreziku operacional). E thënë ndryshe, nga ana e majtë e ekuacionit të regresionit të shumëfishtë do të jetë përfitueshmërinë (ROE), si variabel të pavarur (y) dhe nga ana tjetër do të jenë

rreziqet financiare të marra në studim, si variabla të pavarura (x -et). Për të analizuar të dhënat dhe për të parë efektin e secilit rrezik financiar (variabla të pavarura) mbi përfitueshmërinë e bankave tregtare (variabël i varur) përdoret *Metoda e Katrorëve më të Vegjël (OLS)*, nëpërmjet programit statistikor Eviews6.

Më poshtë interpretohen dy modelet (*Modeli Linear i Thjeshtë* dhe *Modeli Linear i Shumëfishtë*) që mund të përdoren për testimin e hipotezave, duke argumentuar arsyen pse është zgjedhur përdorimi i *Modelit Linear të Shumëfishtë*.

Ekuacioni i Modelit Linear të Thjeshtë paraqitet si më poshtë:

$$Y_i = \beta_0 + \beta_1 X_i + u_i;$$

$Y_i \Rightarrow$ Variabël i varur;

$\beta_0 \Rightarrow$ Konstante;

$X_i \Rightarrow$ Variabël i Pavarur;

$u_i \Rightarrow$ Termi i gabimit.

Duke qënë se studimi ka më shumë se një variabël të pavarur, duhet të përdoret ekuacioni i *Modelit Linear të Shumëfishtë*, i cili paraqitet si më poshtë:

$$Y_i = \beta_0 + \beta_1 X_i + \beta_2 X_i + \beta_3 X_i + \dots + \beta_n X_i + u_i.$$

Bazuar në ekuacionin e mësipërm dhe variablat e marrë në këtë studim, ekuacioni ekonometrik specifikohet si më poshtë:

$$ROE = \beta_0 + \beta_1 RK + \beta_2 RL + \beta_3 RNI + \beta_4 RO + \beta_5 RKK + u_i, \text{ (Ekuacioni).}$$

- $ROE \Rightarrow$ Pëfitueshmëria (Variabel i varur);

ROE (Kthimi nga Kapitali Aksioner) = Të Ardhura Neto / Kapitali Aksioner*100.

- $\beta_0 \Rightarrow$ Konstante;

- $\beta_1, \beta_2, \beta_3, \beta_4, \beta_5 \Rightarrow$ Koefiçentët e variablave të pavarura;

- **RK** => *Rreziku i Kredisë (Variabël i pavarur);*

$$RK = \text{Totali i Kredive} + \text{Interesi i Përlllogaritur} / \text{Totalin e Aseteve} * 100.$$

- **RL** => *Rreziku i Likuiditetit (Variabël i pavarur);*

$$RL = \text{Totali i Kredive} + \text{Interesi i Përlllogaritur} / \text{Totalin e Depozitave} * 100.$$

- **RNI** => *Rreziku i Normës së Interesit (Variabël i pavarur);*

$$RNI = \text{GAP(A-P)} / \text{Totalin e Aseteve} * 100.$$

- **RO** => *Rreziku Operacional (Variabël i pavarur);*

$$RO = \text{Kosto Operacionale} / \text{Totalin e Aseteve} * 100.$$

- **RKK** => *Rreziku i Kursit të Këmbimit (Variabël i pavarur);*

$$RKK = \text{Pozicioni Hapur Neto (USD, EURO, GBP)}.$$

- **ui** => *Termi i gabimit.*

Në kapitullin vijues do të realizohen testet përkatëse për secilin variabël dhe pastaj do të ndërtohet ekuacioni i *Modelit Linear të Shumëfishtë* me *Metodën e Katrorëve më të Vegjël (OLS)*. Nëpërmjet ekuacionit të regresionit të shumëfishtë do të bëhet interpretimi i impaktit të rreziqeve financiare (variabla të pavarura) mbi përfitueshmërinë (variabël i varur) e bankave tregtare në Shqipëri gjatë periudhës 2006-2015.

4.7 Kufizimet e studimit.

Modelet teorike dhe të dhënat empirike për vendet e zhvilluara, në pjesën më të madhe të rasteve janë të aksesueshme, dhe kjo ndikon pozitivisht në realizimin e këtij punimi. Ndërsa, literatura dhe të dhënat për menaxhimin rreziqeve financiare në Shqipëri janë të limituara. Në mënyrë të theksuar, kjo vihet re në pamundësinë për të siguruar statistika të plota nga pasqyrat kryesore financiare të bankave tregtare në

Shqipëri. Megjithatë, nga ana tjetër një mungesë studimesh në këtë fushë, e bën punimin më të rëndësishëm dhe më të domosdoshëm për menaxhimin me sukses të rreziqeve financiare në sistemin bankar shqiptar. Një kufizim tjetër i punimit lidhet me analizën e përfitueshmërisë si variabl i varur. Përfitueshmëria përkufizohet një tregues financiar i cili jep informacion mbi kthimin e bankave tregtare dhe matet nëpërmjet ROA (kthimi nga aktivet) dhe ROE (kthimi nga kapitali aksioner). Gjatë testit të stacionaritetit të këtyre variablave rezultoi se treguesi ROA del jo-stacionar (i paqëndrueshëm), ndërsa treguesi ROE stacionar (i qëndrueshëm). Kjo tregon arsyen se përse treguesi i përfitueshmërisë ROA përjashtohet nga analiza e regresionit, duke përbërë edhe një kufizim të punimit.

4.8 Përmbledhje e kapitullit.

Në këtë kapitull u shpjegua pjesa e kuadrit teorik, metodologjia, metodat si dhe instrumentat bazë për realizimin e studimit. Gjithashtu, në këtë kapitull u shpjeguan burimet e informacionit, mënyra e mbledhjes së të dhënave, qasja teorike e modelit ekonometrik, popullata e synuar si dhe kufizimet e studimit. Ndërkohë, kapitulli vijues konsiston në analizën e të dhënave empirike dhe testimin e hipotezave të studimit.

KAPITULLI V: ANALIZA E TË DHËNAVE EMPIRIKE

Në këtë kapitull do të diskutohet mbi rreziqet financiare në sistemin bankar shqiptar, rregulloret e Bankës së Shqipërisë për secilin rrezik financiar dhe mbi rezultatet empirike të studimit që shtrihen në të gjitha banka tregtare shqiptare, gjatë periudhës 2006-2015. Përmes këtyre rezultateve do të bëhet i mundur vërtetimi ose hedhja poshtë e hipotezave të ngritura që në fillim të studimit. Pjesa e parë e analizës jep një informacion të përgjithshëm lidhur me rreziqet financiare në bankat tregtare shqiptare si dhe rregulloret e Bankës së Shqipërisë, ndërkohë që pjesa e dytë analizon më në detaje lidhjen ndërmjet nivelit të përfitueshmerisë (ROE) si variabël i varur dhe rreziqeve financiare (rreziku i kredisë, rreziku i normës së interesit, rreziku i likuiditetit, rreziku operacional dhe rreziku i kursit të këmbimit) si variabla të pavarura. Analiza e regresionit linear të shumëfishtë do të na ndihmojë të kuptojmë më mirë lidhjen ndërmjet këtyre variablave, duke shpjeguar rëndësinë e secilit indikator mbi përfitueshmërinë e bankave tregtare shqiptare.

5.1 Situate e përgjithshme mbi ecurinë e rreziqeve financiare në sistemin bankar shqiptar.

Reforma në fushën bankare, ishte pjesë e reformave strukturore që ndërmorën autoritetet shqiptare pas vitit 1992 dhe që synonin, krahas stabilizimit makroekonomik, transformimin e ekonomisë shqiptare në një ekonomi tregu, nëpërmjet privatizimit të ekonomisë, krijimit të institucioneve financiare dhe institucioneve të mbrojtjes sociale.

Me kalimin në ekonominë e tregut, Shqipëria përjetoi një proces të vazhdueshëm të konsolidimit të sektorit bankar. Në pjesën më të madhe të viteve '90, ky proces ishte

relativisht i ngadaltë si pasojë e zhvillimeve në tregjet financiare informale, të cilat kishin infektuar zhvillimin ekonomik e financiar të vendit. Përqindjet e larta të interesit të ofruara nga këto tregje mbanin pezull efektivitetin e politikës monetare në drejtim të normës së interesit. Përveç kësaj, pengesë për shtrirjen e reformave në sektorin bankar ishte edhe përqendrimi i lartë i depozitave dhe kredive në tre bankat shtetërore. Kjo solli humbje të mëdha si rezultat i rritjes së portofolit të kredive me probleme, të favorizuara nga një kuadër rregullator i pazhvilluar dhe jokoherent i mbikëqyrjes. Procesi i konsolidimit të sistemit bankar që mori hov pas kësaj periudhe, karakterizohet nga reduktimi i peshës së bankave shtetërore, privatizimi gradual i tyre si dhe rritja e ndjeshme e numrit të bankave private nga 4 që operonin në vitin 1997, në 16 banka në vitin 2006. Në këtë drejtim, banka qendrore u tregua tepër e kujdesshme në përzgjedhjen dhe licencimin e bankave private. Gjatë kësaj periudhe u licencuan edhe tre banka me kapital tërësisht shqiptar.

Pavarësisht nga shtimi i numrit të bankave tregtare në vend, zgjerimi i aktivitetit bankar deri në vitin 2003 ka rezultuar i kujdesshëm duke iu përmbajtur zhvillimit ekonomik të vendit. Gjatë periudhës 1998-2003, mjetet totale të sektorit bankar u rritën mesatarisht me 13% në vit, në harmoni me rritjen e PBB-së nominale gjatë kësaj kohe. Megjithatë, gjatë viteve 2004-2006 vihet re një zgjerim akoma më i vrullshëm i mjeteve bankare me 67%, shifër kjo 2-3 herë më e lartë se rritja kumulative e PBB-së nominale. Si rezultat i rritjes së besimit në sistemin bankar vendas, madhësia e këtyre mjeteve në raport me PBB-në në vitin 2006 u ngrit në nivelin 70%, raport ky tashmë i krahasueshëm me ato të vendeve të Europës Qendrore-Lindore.

Një situatë e kënaqshme paraqitet edhe përsa i përket kredisë bankare ndaj

sektorit privat dhe individëve. Norma e rritjes së saj tejkaloi vazhdimisht ritmin e zgjerimit të mjeteve bankare. Gjatë viteve të fundit, kredia private u përmirësua ndjeshëm duke shënuar një rritje kumulative prej 175% gjatë periudhës 2005-2006, rritja më e lartë në rajon dhe në vendet e Europës Qendrore-Lindore. Një karakteristikë mbështetëse në favor të bankave kredituese të huaja është zgjedhja e lirë e monedhës së kreditimit, ku gati 3/4 e huasë totale është dhënë në monedhë të huaj. Deri më tani mund të gjykohet se oferta e kredisë është në nivele prudente, pasi portofoli i kredive me probleme edhe pse ka pësuar një ngritje modeste në 3.1% të kredisë bruto në vitin 2006, flet për një ekspozim të kufizuar të sektorit bankar ndaj rrezikut të mospagesave në kohë. Por, me gjithë përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë së aktiveve dhe ecurisë financiare të bankave tregëtare, shtrirja e kredidhënies ndaj sektorit privat dhe individëve mbetet akoma e ulët në raport me PBB-në, rreth 21.3% në vitin 2006, krahasuar me 49% në Europën Qendrore-Lindore, fakt që tregon për kapacitete të tjera të pashfrytëzuara të shërbimeve bankare në ekonominë shqiptare (Ibrahimi, 2007).

5.1.1 Rregullore e Bankës së Shqipërië “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, Vendim Nr. 62, datë 14.09.2011.

Rregulloret e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë për menxhimin e rreziqeve financiare janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen e sistemit bankar. Nisur nga kjo, më poshtë paraqiten disa nga nenet kryesore në lidhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”.

Objekt i **nenit 1** sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja” është përcaktimi i

rregullave për administrimin e rrezikut të kredisë në veprimtarinë e bankave dhe degëve të bankave të huaja si dhe përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e rrezikut dhe klasifikimin e kredive dhe aktiveve të tjera, si dhe llogaritjen e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga zhvlerësimi i tyre. Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë, të cilat këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhen me termin e përbashkët “banka”.

Termet e përdorur më poshtë sipas **nenit 4** të rregullores së Bankes së Shqipërisë *“Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”*, kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin për bankat:

1. “Aktive të tjera” - janë aktivet financiare brenda dhe jashtë bilancit (duke përjashtuar kreditë), të cilat sipas standardeve kontabël, mbahen me koston e amortizuar.
2. “Standardet kontabël” - janë standardet kontabël të hartuara nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare, të cilat sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, zbatohen nga bankat për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare.
3. “Kredimarrës i ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit” - është kredimarrësi që përfiton kredi në valutë (monedhë të huaj) dhe/ose të indeksuar në valutë (monedhë të huaj) nga banka, dhe plotëson kriteret e mëposhtme:
 - të ardhurat e tij në origjinë gjenerohen në monedhë vendase ose në një monedhë të ndryshme nga monedha e përfitimit të kredisë;
 - të ardhurat e tij në valutë (monedhë të huaj) mbulojnë më pak se 80% të kështit të kredisë ose të kredisë në total (kryegjë dhe interes, në varësi të periudhës së

llogaritjes) dhe detyrimeve të tjera në monedhë të huaj ose të indeksuara në valutë;

- nuk është i mbrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit nëpërmjet një produkti derivativ (instrumente derivative), që përdoret për këtë qëllim dhe që ofron kushte të përshtatshme mbrojtjeje.

5. “*Stress-testing*” - është teknikë e administrimit të rrezikut të kredisë e përdorur për të vlerësuar ndikimin e ndryshimit të mundshëm të një ose më shumë faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm mbi qëndrueshmërinë financiare të bankës.

6. “Ristrukturimi i kredisë” - është lehtësimi/et që banka bën për kredimarrësin/it për shkak të vështirësive financiare të tyre të shkaktuara nga arsye ekonomike ose ligjore, të cilat nuk bëhen nga banka në asnjë rast tjetër dhe përfshijnë në përgjithësi:

- lehtësimet e bëra në kushtet e kredisë nëpërmjet ndryshimit të një ose disa kushteve të kontratës (duke përfshirë ndryshimin e produktit dhe kapitalizimin e interesit), të cilat lidhen kryesisht me afatin, kryegjënë dhe normën e interesit;
- marrjen (përdorimin) e kolateralit apo pasurive të tjera për shlyerjen e pjesshme të kredisë;
- zëvendësimin e kredimarrësit fillestar ose përfshirjen e një kredimarrësi shtesë.

7. “Vështirësi financiare të kredimarrësit” - janë përkeqësimet e gjendjes financiare të kredimarrësit, të cilat mund të sjellin vonesa në pagesat e kredisë ose klasifikimin e kredisë si kredi me probleme.

8. “Kredi me probleme” - janë kreditë e klasifikuara në tre kategoritë e fundit të klasifikimit të kredive. Shuma bruto (kryegjë + interes) e tyre përbën totalin e kredive me probleme.

9. “Kapitalizimi i interesit” - është procesi përmes të cilit interesi i përlllogaritur i shtohet

kryegjësë.

10. “Kolateral” - është aktivi që përdoret për të siguruar ekzekutimin e detyrimit ndaj bankës, në rastin kur kredimarrësi nuk paguan kredinë sipas kushteve dhe afateve të kontratës.

11. “Garanci” - është angazhimi, i shprehur në mënyrë të shkruar nga një palë e tretë, për të paguar kredinë brenda një afati të caktuar, në rastin kur kredimarrësi nuk paguan sipas kushteve dhe afateve të kontratës.

12. “Maturitet i mbrojtjes së kredisë” - është koha deri në datën më të afërt në të cilën marrëveshja e garancisë ose lënia si kolateral mund të përfundojë.

13. “Vlerësues i pavarur” - është personi, i pajisur me licencën përkatëse ose certifikatën për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, i cili është i pavarur nga procesi i vendimmarrjes në dhënien e kredisë.

14. “Plani i emergjencës” - është një dokument i hartuar nga banka, në të cilin pasqyrohen rregullat dhe procedurat që duhen zbatuar në kushte jo të zakonshme.

Sipas **nenit 5** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja*”, bankat krijojnë dhe zhvillojnë sistemin për administrimin e rrezikut të kredisë, të përshtatshëm me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarive të tyre financiare, gjithashtu sistemi i administrimit të rrezikut të kredisë është tërësia e politikave, procedurave, rregullave dhe strukturave të bankës, që shërbejnë për administrimin e rrezikut të kredisë dhe fundmi sistemi i administrimit të rrezikut të kredisë duhet të sigurojë në vazhdimësi vlerësimin në kohë të cilësisë së kredive dhe aktiveve të tjera, duke përcaktuar njëkohësisht fondet rezervë për mbulimin e humbjeve të lidhura me këtë lloj rreziku.

Sipas **nenit 6** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja*”, banka:

- krijon një strukturë të përshtatshme organizative për administrimin e rrezikut të kredisë, duke përcaktuar qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese;
- siguron që funksioni i shitjes të kredive, të jetë i ndarë qartë nga pikëpamja organizative dhe operacionale, nga funksionet mbështetëse operacionale dhe ato të kontrollit të rrezikut të kredisë, deri në nivelet më të larta drejtuese;
- siguron strukturat e duhura për vlerësimin, matjen dhe kontrollin e rrezikut të kredisë, lidhur me përqëndrimin sipas sektorëve, sipas gjeografisë/vendeve, sipas monedhave, sipas llojit të kredisë etj.

Sipas **nenit 9** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja*”, bankat hartojnë strategjinë, politikat, procedurat dhe rregullat e brendshme për monitorimin dhe kontrollin në vazhdimësi të cilësisë së portofolit të kredisë dhe të aktiveve të tjera, që përfshijnë:

- strategjinë e kreditimit sipas periudhave, duke përfshirë objektiva realiste në lidhje me zgjerimin e portofolit të kredisë, përbërjen e tij sipas sektorëve, sipas gjeografisë/vendeve, sipas monedhave, sipas llojit të kredisë etj.;
- politikat e normave të interesit, të afateve, të shlyerjeve dhe të madhësisë e të llojit të kredive;
- rregullat dhe kriteret e vendosura për njohjen dhe analizën financiare të kredimarrësit dhe/ose të garantuesit të kredisë;
- procedurat për dokumentacionin e nevojshëm që duhet plotësuar për dhënien e

kredive, si edhe për miratimin e kredisë, sipas hierarkisë së strukturave;

- politikat e administrimit të rrezikut për të gjithë portofolin dhe për çdo klient në veçanti, kufijtë e kredisë sipas llojeve të kredimarrësve, sipas sektorëve, monitorimin sipas objektit dhe llojit të kredisë, etj.;
- metodologjinë dhe procedurat e vlerësimit të cilësisë së kredive dhe të krijimit të fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga zhvlerësimi i kredive;
- metodologjinë për vlerësimin, matjen dhe kontrollin e rrezikut të kredisë, lidhur me përqendrimin sipas sektorëve, sipas gjeografisë/vendeve, sipas monedhave, sipas llojit të kredisë etj.;
- kriteret për ristrukturimin e kredive;
- procedurat për vlerësimin e cilësisë së aktiveve të tjera dhe për llogaritjen e fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga zhvlerësimi i këtyre aktiveve;
- procedurën për verifikimin e vlerësimit të kolateralit “pasuri e paluajtshme”, të kryer nga një vlerësues i pavarur;
- procedurat për monitorimin dhe vlerësimin periodik të kolateralit financiar;
- procedurat për monitorimin periodik të garancive.

Bankat, nëpërmjet zhvillimit të *stress test*-eve, sipas **nenit 10** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja*”, vlerësojnë në vazhdimësi dhe në mënyrë të mjaftueshme ekspozimin e tyre ndaj rrezikut të kredisë, duke marrë në konsideratë ndryshimet e mundshme në të ardhmen të faktorëve të rrezikut që ndikojnë në cilësinë e portofolit të kredive dhe gjendjen financiare të bankës, të materializuara në të ardhurat neto dhe në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Periodiciteti me të cilin bankat kryejnë *stress test*-et, si dhe raportimi i rezultateve në strukturat drejtuese, përcaktohet prej tyre në përputhje me madhësinë e veprimtarisë, ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë dhe peshën e tyre në sistemin bankar, me kusht që ky periodicitet të mos jetë më pak se dy herë në vit. Banka e Shqipërisë mund t'i kërkojë në çdo rast bankës kryerjen e *stress test*-eve në periudha më të shpeshta dhe/ose sipas skenarëve me supozime të përcaktuara.

Stress test-et e realizuara nga banka përfshijnë të paktën përdorimin e skenarëve të veçantë dhe/ose të kombinuar, bazuar në faktorë të tillë si: rënia ekonomike, ndryshimi i shpejtë i kushteve të tregut (ndryshe rreziku i tregut i përcaktuar nga luhatjet në kursin e këmbimit, normat e interesit etj.) me ndikim negativ në ndryshimin e aftësive për pagimin e rregullt të detyrimit (borxhit), apo edhe të skenarëve të një përkeqësimi të portofolit të kredive, pavarësisht nga përcaktimi i faktorit të rrezikut që mund të shërbejë si shkak për materializimin e një situate të pafavorshme.

Bankat përcaktojnë metodologjinë për realizimin e *stress test*-eve, supozimet e përdorura, si dhe veprimet në kundërpërgjigje të rezultateve të gjeneruara, ku përfshihen:

- zbatimi, analiza e skenarëve të *stress test*-eve dhe periodiciteti i realizimit të tyre;
- realizimi i *stress test*-eve për skenarë individualë dhe skenarë të kombinuar, në kushtet e ndodhjes së njëkohshme të disa skenarëve;
- dokumentimi dhe rishikimi në mënyrë periodike i supozimeve të përdorura për kryerjen e *stress test*-eve;
- forma dhe periodiciteti i raportimit të rezultateve të *stress test*-eve në strukturat drejtuese;
- veprimet që duhet të ndërmerren nga strukturat drejtuese apo/dhe strukturat e

veçanta të ngarkuara për administrimin e rrezikut të kredisë, mbështetur në rezultatet e *stress test-eve*.

Në **nenin 11** të rregullores “*Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja*”, Banka e Shqipërisë shprehet se bankat tregtare duhet të bëjnë klasifikimin e kredisë çdo muaj, në një nga kategoritë e mëposhtme:

1. “Standarde”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset e pritshme hyrëse të parasë janë plotësisht të mjaftueshme për vazhdimësinë e veprimtarisë së tij dhe shlyerjen e detyrimeve;
- kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 1 deri 30 ditësh nga data e pagesës së këstit.

2. “Në ndjekje”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset hyrëse të parasë janë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet, pavarësisht vështirësive financiare të momentit, dhe se nuk ka shenja përkeqësimi të gjendjes së kredimarrësit për të ardhmen;
- kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 31 deri 90 ditësh nga data e pagesës së këstit.

3. “Nënstandarde”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e rregullt të detyrimeve të prapambetura, ose banka nuk disponon gjithë informacionin e kërkuar ose të përditësuar, të nevojshëm për të vlerësuar plotësisht gjendjen financiare të tij;
- kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 91 deri 180 ditësh nga

data e pagesës së këstit.

4. “Të dyshimta”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e plotë të detyrimeve, kredimarrësi shfaq probleme likuiditeti, dhe deklarimi i kredimarrësit “në paaftësi paguese/i falimentuar”, vlerësohet si një mundësi reale;
- kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 181 deri 365 ditësh nga data e pagesës së këstit.

5. “Të humbura”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet qartë se nuk siguron përmbushjen e plotë të kushteve të shlyerjes së kryegjësë dhe të interesit; ose vlerësohet se mungon i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për përcaktimin e gjendjes financiare; ose kredimarrësi është në paaftësi paguese/ka falimentuar, është përfshirë në proces likuidimi; ose kredimarrësi ka vdekur dhe askush nuk mund të paguajë kredinë; ose banka ka depozituar te përmbartuesi gjyqësor kërkesën për fillimin e procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të kolateralit, në rast se kredia është e siguaruar me kolateral; ose gjykata ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit, në rast se kredia nuk është e siguaruar me kolateral.

Ndryshuar me vendimin nr.22, datë 27.02.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nëse interesi nuk është paguar për një periudhë prej më shumë se 365 ditësh nga data e pagesës së këstit, klasifikimi i kredive kufi bëhet si më poshtë:

1. “Standarde”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset e pritshme hyrëse të parasë janë

plotësisht të mjaftueshme për vazhdimësinë e veprimtarisë së tij dhe shlyerjen e detyrimeve;

- shuma e përdorur e kredisë është më e vogël ose e barabartë me shumën maksimale të miratuar;
- kredia është deri në 30 ditë vonesë nga afati fillestar i shlyerjes.

2. “Në ndjekje”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset hyrëse të parasë janë plotësisht të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet, pavarësisht vështirësive financiare të momentit, dhe se nuk ka të shenja përkeqësimi të gjendjes së kredimarrësit për të ardhmen;
- shuma maksimale e miratuar e kredisë është tejkaluar për një periudhë nga 31 deri në 60 ditë;
- afati përfundimtar i shlyerjes ka kaluar për një periudhë nga 31 deri në 60 ditë.

3. “Nënstandarde”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e rregullt të detyrimeve të prapambetura; ose banka nuk disponon të gjithë informacionin e kërkuar ose të përditësuar, të nevojshëm për të vlerësuar plotësisht gjendjen financiare;
- shuma maksimale e miratuar e kredisë është tejkaluar për një periudhë nga 61 deri në 90 ditë;
- afati përfundimtar i shlyerjes ka kaluar për një periudhë nga 61 deri në 90 ditë.

4. “Të dyshimta”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si

të pamjaftueshme për përmbushjen e plotë të detyrimeve, kredimarrësi shfaq probleme likuiditeti dhe deklarimi i kredimarrësit si “në paaftësi paguese/i falimentuar”, vlerësohet si një mundësi reale;

- shuma maksimale e miratuar e kredisë është tejkaluar për një periudhë nga 91 deri në 180 ditë;
- afati përfundimtar i shlyerjes ka kaluar për një periudhë nga 91 deri në 180 ditë.

5. “Të humbura”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet qartë se nuk siguron përmbushjen e plotë të kushteve të shlyerjes së kryegjësë dhe të interesit; ose vlerësohet se mungon i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për përcaktimin e gjendjes financiare; ose kredimarrësi është në paaftësi paguese/ka falimentuar, është përfshirë në proces likuidimi; ose kredimarrësi ka vdekur dhe askush nuk mund të paguajë kredinë; ose banka ka depozituar te përmbaruesi gjyqësor kërkesën për fillimin e procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të kolateralit, në rast se kredia është e siguaruar me kolateral; ose gjykata ka lëshuar urdhrin ekzekutimit, në rast se kredia nuk është e siguaruar me kolateral.

Sipas **nenit 12** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja*”, bankat vlerësojnë dhe klasifikojnë kredimarrësit në bazë të gjendjes së tyre financiare. Ky vlerësim i gjendjes financiare të një kredimarrësi realizohet sipas kriterëve të brendshme të përcaktuara nga banka, mbështetur në procedura të klasifikimit të kredimarrësve në kategori rreziku.

Bankat vlerësojnë gjendjen financiare të kredimarrësit sipas kriterëve bazuar në faktorët cilësorë dhe sasiorë të mëposhtëm:

- statusi i kredimarrësit, karakteristika personale dhe ekonomike të tij;
- cilësia e menaxhimit, përfshirë dhe atë të menaxhimit të nivelit të lartë të kredimarrësit, në rastet kur kredimarrësi është person juridik;
- cilësia e aksionerëve, cilësia e planeve dhe programeve të mbështetura financiarisht nga banka;
- niveli i kapitalit dhe rezervave të kredimarrësit dhe pjesa e tyre në bilancin e kredimarrësit;
- cilësia e aktiveve të kredimarrësit;
- madhësia e borxhit dhe aftësia për t'i shërbyer, si dhe historiku i ekspozimeve me bankën;
- likuiditeti dhe përfitueshmëria;
- *cash flow*-t (flukset e parave) e periudhave paraardhëse dhe *cash flow*-t (flukset e parave) e pritshëm, të krahasuar me detyrimet e kredimarrësit;
- kushtet e biznesit dhe parashikimet e ardhshme për kredimarrësin, si dhe pozicioni i kredimarrësit në treg dhe në industrinë ku kryen veprimtarinë;
- ekspozimi i kredimarrësit ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

Bankat, në vlerësimin e gjendjes financiare të kredimarrësit, mbështeten kryesisht në dokumentacionin e mëposhtëm:

- bilanci (pasqyra e aktiv-pasivit dhe zërave jashtë bilancit);
- llogaria fitim-humbje;
- vërtetimi i pagës për individët, si dhe deklarata e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre, e dokumentuar për të ardhurat dhe shpenzimet materiale;
- pasqyra e detyrimeve mbi kreditë dhe interesat për t'u paguar;

- pasqyra mbi ndryshimet në kapital;
- pasqyra e *cash flow*-t;
- raportet e ekspertit kontabël mbi gjendjen financiare të kredimarrësit;
- raporte të agjencive të vlerësimit.

Bazuar në **nenin 13** të rregullores së Bankes së Shqipërisë “*Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja*”, ndryshuar me vendim nr.27, datë 27.03.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bankat, në marrëveshje me kredimarrësin, mund të ristrukturojnë kredinë, sipas kriterëve të përcaktuara në manualin e kredisë, të miratuar nga organet e saj drejtuese. Ristrukturimi i kredisë mund të kryhet mbështetur në analizat e tyre, bankat gjykojnë se në të ardhmen gjendja financiare e kredimarrësit do të përmirësohet ndjeshëm, ose të ardhurat nga veprimtaria e tij do të rriten në mënyrë të konsiderueshme dhe se kredimarrësi do ta paguajë (shlyejë) të gjithë kredinë sipas kushteve të reja.

Kredia e ristrukturuar, nuk mund të klasifikohet më lart se një kategori nga kategoria në të cilën është klasifikuar përpara ristrukturimit, deri në plotësimin njëkohësisht të kushteve të mëposhtme:

- kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt këstet (kryegjë dhe interes) për një periudhë prej 6 muajsh nga data e ristrukturimit;
- kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt të paktën 3 këste (kryegjë dhe interes).

Kredia, e cila para ristrukturimit klasifikohet në kategoritë “të humbura”, “të dyshimta” ose “nën standarde”, nuk mund të klasifikohet, në asnjë rast, më lart se kategoria “nën standarde” deri në plotësimin e kushteve. Kredia, e cila para ristrukturimit klasifikohet në kategoritë “standarde” ose “në ndjekje”, nëse ristrukturohet

për herë të parë, ruan të njëjtën klasë dhe për të krijohen fonde rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë, me një normë jo më të vogël se 10% për kryegjënë dhe interesin, deri në plotësimin e kushteve të përmendura në këtë nen.

Në varësi të kategorive të klasifikimit, bankat krijojnë fondet përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë bazuar në **nenin 14** të kësaj rregulloreje. Normat e llogaritjes së fondeve rezervë përcaktohen si më poshtë:

- për kategorinë “standarde”.....1%;
- për kategorinë “në ndjekje”.....5%;
- për kategorinë “nënstandarde”.....jo më pak se 20%;
- për kategorinë “e dyshimtë” jo më pak se 50%;
- për kategorinë “e humbur”..... 100%.

Bazuar në **nenin 15** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja*”, banka, si pjesë të rëndësishme të strategjisë, të politikave, të procedurave dhe të rregullave të brendshme për monitorimin dhe kontrollin në vazhdimësi të cilësisë së portofolit të kredisë, përfshin në veçanti edhe trajtimin e portofolit/eve të ekspozuara ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Banka ponderon me koeficient më të lartë rreziku, për efekt të llogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, vlerën e kredisë në valutë dhe/ose të indeksuar në valutë të ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, siç përcaktohet në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.

Totali i kredive të bankës në valutë dhe/ose të indeksuara në valutë të ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, nuk duhet të kalojë 400% të kapitalit rregullator të saj në baza individuale dhe të konsoliduara. Çdo shumë që tejkalon këtë kufi do të

zbritet nga kapitali rregullator i bankës për efekt të llogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Fshirja e kredive të humbura nga bilanci sipas **nenit 17** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për administrimin rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja*” bëhet me vendim të Këshillit Drejtues të bankës ose organit kompetent të bankës mëmë, në rastin e degës së bankës së huaj, si dhe në çdo rast kur Banka e Shqipërisë ka vlerësuar dhe kërkuar fshirjen e saj. Në çdo rast banka fshin kreditë nga bilanci, jo më vonë se tre vite pas klasifikimit të tyre në klasën “të humbura”. Gjatë kësaj periudhe, banka merr masat e nevojshme për plotësimin e kushteve të përcaktuara në legjislacionin tatimor për fshirjen e kredive 11 nga bilanci.

- Bazuar në këtë nen, përjashtim bëjnë kreditë, për të cilat në vendimmarrjen e vetë bankës dhe vetëm pas miratimit të Bankës së Shqipërisë, argumentohet se: mbështetur në analizën gjendjes financiare të kredimarrësit dhe në cilësinë e kolateralit, vërtetohet mundësia efektive e shlyerjes/ripagimit të saj;
- kreditë në proces ristrukturimi, për të cilat në çdo rast, përjashtimi nga kërkesat e këtij neni, nuk mund të tejkalojë një periudhë 6 mujore që nga dita që kredia ka plotësuar kushtet për t’u fshirë. Dosjet e kredive të fshira nga bilanci, ruhen dhe vlerësohen në vazhdimësi, duke u shqyrtuar jo më pak se një herë në 6 muaj nga Këshilli Drejtues i bankës. Banka, pavarësisht fshirjes së kredive nga bilanci, vazhdon të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e këtyre kredive.

Bazuar në **nenin 18** të kësaj rregulloreje, bankat, të paktën një herë në çdo 3 muaj dhe në rastet kur ekzistojnë të dhëna që tregojnë se cilësia e çdo aktivi tjetër është përkeqësuar në mënyrë thelbësore, bën rishikimin e vlerësimit të tyre sipas përcaktimeve

në standardet e kontabilitetit. Bankat vlerësojnë në mënyrë individuale të gjitha aktivet e tjera, individualisht të rëndësishme, po ashtu bankat vlerësojnë pjesën tjetër të aktiveve të tjera, në mënyrë individuale ose në mënyrë kolektive, duke i grupuar sipas karakteristikave të njëjta dhe së fundmi, bankat, për evidentimin e aktiveve individualisht të rëndësishme, bazohen në madhësinë relative të tyre ndaj totalit të aktivitetit, të kapitalit rregullator, si dhe në informacionin cilësor si pjesë e një grupi të caktuar aktivesh.

Sipas **nenit 19** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja*”, bankat, bazuar në madhësinë e humbjeve të llogaritura sipas standardeve të kontabilitetit, klasifikojnë aktivet e tjera si më poshtë:

1. “Standarde ose të rregullta”, kur madhësia e humbjeve të llogaritura është deri në 5% të ekspozimit.
2. “Të dyshimta ose me probleme”, kur madhësia e humbjeve të llogaritura është më e madhe se 5% e ekspozimit.

5.1.2 Rregullore e Bankës së Shqipërisë “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, Vendim Nr.69, datë 18.12.2014.

Mjaftueshmëria e kapitalit përbën një element shumë të rëndësishëm në menaxhimin me sukses të rreziqeve financiare. Nisur nga kjo, më poshtë janë paraqitur disa nga nenet kryesore në lidhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë “*Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit në bankat tregtare*”.

Objekt i **nenit 1** sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, “*Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit*” është:

- përcaktimi i kriterëve dhe rregullave për llogaritjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit; dhe
- përcaktimi i nivelit minimal të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Në **nenin 5** të kësaj rregullorje, bankat llogarisin mjaftueshmërinë e kapitalit si raport ndërmjet shumës së kapitalit rregullator me shumën e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, e shprehur në përqindje, në baza individuale dhe të konsoliduara, po ashtu bankat sigurojnë që raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, i llogaritur sipas paragrafit 1 të këtij neni, të jetë jo më i vogël se 12%.

Bazuar në **nenin 6** të rregullores së Bankës së Shqipërisë, “*Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit*”, bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezikun, si shumë e elementëve të mëposhtëm:

- zërave të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme, të ponderuar me rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, të llogaritura sipas Metodës Standarde;
- kërkesës për kapital për rrezikun e tregut, të llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara nga kjo rregullore, të shumëzuara me 12.5;
- kërkesës për kapital për rrezikun operacional, të llogaritur sipas Metodës së Treguesit të Thjeshtë ose sipas Metodës Standarde.

Pavarësisht përcaktimeve më sipër, banka i shton totalit të aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun vetëm vlerën pozitive që rezulton nga rritja e klasave në aktiv të bilancit “veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “veprime në valutë me tituj” me jorezidentët të periudhës raportuese krahasuar me të njëjtën periudhë të dy viteve më parë, pasi të jetë zbritur vetëm vlera e shtuar e

detyrimeve ndaj jorezidentëve në valutë të të njëjtave klasa të periudhës raportuese krahasuar me të njëjtën periudhë të dy viteve më parë.

Sipas **nenit 7** të kësaj rregullorje, bankat llogarisin kapitalin rregullator sipas:

- kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, të llogaritur si totali i ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme të ponderuara me rrezikun, të shumëzuara me 12%;
- kërkesës për kapital për rrezikun e tregut, të llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në këtë rregullore, të shumëzuara me 1.5;
- kërkesës për kapital për rrezikun operacional, të llogaritur sipas Metodës së Treguesit të Thjeshtë ose sipas Metodës Standarde, të shumëzuara me 1.5.

Bazuar në **nenin 8** të rregullores së Bankës së Shqipërisë, *“Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”*, bankat llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, sipas Metodës Standarde. Kërkesa për kapital për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, sipas metodës standarde, është e barabartë me 12% të totalit të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme të ponderuara me peshat e rrezikut, në përputhje me përcaktimet e këtij kreu të rregullores.

Sipas pikave të mëposhtme të **nenit 9** të kësaj rregullorje:

1. Vlera e ekspozimit ndaj rrezikut është vlera e tij në bilanc, ndërsa vlera e ekspozimit të mundshëm, do të jetë një përqindje e vlerës së tij, sipas klasifikimit në kategoritë e rrezikut, si më poshtë:

- 100% e vlerës së tij, për kategorinë me rrezik të lartë;
- 50% të vlerës së tij, për kategorinë me rrezik të mesëm;

- 20% të vlerës së tij, për kategorinë me rrezik të ulët;
- 0% të vlerës së tij, për kategorinë pa rrezik.

2. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit përkatës, pas zbritjes së fondeve rezerve për mbulimin e humbjeve.

3. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit, në rastet kur ky ekspozim është subjekt i mbrojtjes së financuar të kredisë, duke konsideruar teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë.

4. Bankat, në rastet kur përdorin metodën gjithëpërfshirëse për njohjen e kolateralit financiar, si teknikë për zbutjen e rrezikut të kredisë, kur ekspozimi është në formën e titujve ose të mallrave (*commodities*) të shitura, të vendosura ose të huazuara në një transaksion riblerje ose në një transaksion të dhënies ose marrjes hua të titujve ose të mallrave (*commodities*) dhe transaksioneve të kreditimit me marzhe, do të rregullojnë vlerën e ekspozimit, me efektet në rritje të kësaj vlere, si rezultat i ndikimit të luhatshmërisë.

5. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit të një instrumenti derivativ, të listuar në aneksin 4 të kësaj rregulloreje.

6. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit të transaksioneve të riblerjes, të transaksioneve të dhënies ose marrjes hua të titujve ose të mallrave (*commodities*), të transaksioneve me afat të gjatë shlyerje (*long settlement*) dhe transaksioneve të kreditimit me marzhe.

7. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit të rrezikut të kredisë ndaj një kundërpartie qendrore, me kusht që, ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë të kundërpartisë qendrore, ndaj të gjithë pjesëmarrësve në marrëveshjet e saj, të jetë plotësisht i kolateralizuar në baza ditore.

Bazuar në **nenin 10** të rregullores së Bankës së Shqipërisë, “*Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit*”, bankat klasifikojnë çdo ekspozim të zërave, brenda dhe jashtë bilancit, në një nga klasat e ekspozimit në vijim:

- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse);
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (*retail*);
- ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;
- ekspozime (kredi) me probleme;
- ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;
- ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;
- ekspozime në pozicione të krijuara nga titullzimi (*securitization*);
- ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SIK; dhe/ose
- zëra të tjerë.

Bazuar në këtë nen të kësaj rregullorje, bankat i klasifikojnë ekspozimin/et në klasën e ekspozimit me pakicë, nëse plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

- ekspozimi është ndaj një ose disa individëve, ose ndërmarrjeve të vogla apo të mesme;
- ekspozimi merr një nga format e kredisë dhe linjave të kredisë së rinovueshme (*revolving*) (p.sh., për karta krediti, kreditë kufi/*overdraft*-et, etj.), kreditë konsumatore dhe qiratë financiare personale (p.sh., kreditë me këste, kreditë dhe qiratë financiare për automjete, kreditë për shkollim, etj.) dhe linjat ose angazhimet e kredisë për ndërmarrjet e vogla apo të mesme;
- ekspozimi është pjesë e një portofoli të diversifikuar mjaftueshëm për nga niveli i rrezikut;
- ekspozimi agregat me pakicë ndaj një individi ose ndërmarrjeje të vogël apo të mesme dhe palëve të lidhura, i cili llogaritet si shumë bruto e të gjitha ekspozimeve (përpara zbritjes së fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve dhe teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë) dhe ekspozimeve të mundshme (duke konsideruar vlerën e tyre, siç përcaktohet në nenin 9 të kësaj rregulloreje), nuk tejkalon shumën 50 milion lekë.

Sipas pikave të mëposhtme të **nenit 191**, të rregullores së Bankës së Shqipërisë, *“Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”*:

1. Banka, bazuar në profilin e saj të rrezikut, përcakton dhe kategoritë e rreziqeve të rëndësishme për t’u konsideruar në procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit.
2. Banka argumenton dhe dokumenton vendimet e saj lidhur me marrjen ose jo në

konsideratë të rreziqeve specifike dhe supozimet e përdorura në procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit.

2. Banka harton dhe/ose përgatit metodologji të përshtatshme të matjes, apo vlerësimit të rreziqeve, me qëllim hartimin e masave apo vlerësimeve të rreziqeve të veçanta.

3. Metodologjitë e matjes apo vlerësimit të rreziqeve do të konsiderohen të përshtatshme, nëse ato përfshijnë:

- përdorimin e metodave për llogaritjen e kërkesave kapitale në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;
- metodologjitë e dokumentuara të brendshme të bankës; dhe/ose
- metodologji të tjera, të përshtatshme për matjen ose vlerësimin e rreziqeve.

4. Banka, nëse konstaton se masa apo vlerësimi i një rreziku të veçantë të përmendur në, nuk pasqyron ekspozimin aktual të bankës në atë rrezik, mund të rregullojë vlerësimin duke bërë një vlerësim më lart ose më poshtë.

5. Banka argumenton dhe dokumenton përdorimin e metodave individuale të përdorura për matjen ose vlerësimin e rreziqeve, vlerësimet jo të matshme të rreziqeve, si dhe rregullimet e vlerësimit të rrezikut.

6. Banka përcakton pozicionin e përgjithshëm të rrezikut të bazuar në matjen apo vlerësimin e rreziqeve individuale.

7. Banka përcakton metodologjinë e duhur të brendshme për përcaktimin e pozicionit/profilin të përgjithshëm të rrezikut.

5.1.3 Rregullore e Bankës së Shqipërië “Për kapitalin rregullator të bankës ”,
Vendim Nr.69, datë 18.12.2014.

Një element tjetër i rëndësishëm i bankave tregtare që duhet menaxhuar me

sukses, në mënyrë që të minimizohen rreziqet financiare është edhe kapitali rregullator i bankes. Nisur nga kjo, më poshtë janë paraqitur disa nga nenet kryesore në lidhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë “*Për kapitalin rregullator të bankës*”.

Sipas **nenit 5** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për kapitalin rregullator të bankës*”, kapitali rregullator është kapitali i bankës, i llogaritur sipas kërkesave të kësaj rregulloreje, për mbulimin e rrezikut të kredisë, të rreziqeve të tregut dhe të rrezikut operacional. Në varësi të karakteristikave të tij dhe kushteve të përcaktuara në këtë rregullore, kapitali rregullator i bankes ndahet në dy kategori:

- kapitali i nivelit të parë;
- kapitali i nivelit të dytë.

Bankat llogarisin kapitalin rregullator të tyre si shumë të kapitalit të nivelit të parë dhe kapitalit të nivelit të dytë, duke marrë në konsideratë, edhe zbritjet sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe/ose të akteve të tjera rregullative. Po ashtu sipas kësaj rregulloreje, bankat përfshijnë kapitalin e nivelit të dytë në kapitalin rregullator të tyre sipas kufijve dhe afateve të mëposhtme:

- deri në 50% të kapitalit të nivelit të parë (deri më 31.12.2016);
- deri në 33.3% të kapitalit të nivelit të parë (duke filluar nga 01.01.2017).

Bazuar në pikat e mëposhtme të **nenit 6** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për kapitalin rregullator të bankës*” :

1. Bankat llogarisin kapitalin e nivelit të parë si shumë të kapitalit bazë të nivelit të parë dhe kapitalit shtesë të nivelit të parë, duke marrë në konsideratë edhe zbritjet sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe/ose të akteve të tjera rregullative.
2. Kapitali bazë i nivelit të parë përbëhet nga elementet e mëposhtme:

- kapitali i paguar (aksione të zakonshme);
- primet e aksioneve (të zakonshme);
- fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme;
- fitimi ushtrimor i fundit të vitit;
- fitimi ushtrimor i periudhës raportuese;
- rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit);
- diferenca rivlerësimi kreditore.

3. Niveli i kapitalit bazë të nivelit të parë duhet të jetë në çdo kohë më i madh se niveli i kapitalit fillestar minimal të kërkuar.

4. Kapitali i paguar përbëhet vetëm nga aksionet e zakonshme, të cilat mbartin të gjitha karakteristikat sipas përcaktimeve në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

5. Rezervat, me përjashtim të rezervave të rivlerësimit, krijohen nga shpërndarja e fitimit të bankës pas zbritjes së tatimit dhe përpara shpërndarjes së dividendëve. Rezervat krijohen me vendim të organeve vendimmarrëse, në zbatim të akteve rregullative të brendshme të bankës, si dhe të kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi.

6. Rezervat e përcaktuara në këtë nen përfshijnë kategoritë e mëposhtme të rezervave:

- rezervat ligjore, të krijuara në zbatim të akteve ligjore dhe rregullative në fuqi;
- rezervat statutore, të krijuara në zbatim të përcaktimeve të statutit të bankës;
- rezervat e tjera, të cilat përfaqësojnë të gjitha rezervat e tjera të krijuara nga shpërndarja e fitimit. Në rezervat e tjera përfshihen edhe rezervat e përgjithshme, të cilat krijohen nga banka në masën 1.25% deri në 2% të totalit të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme të ponderuara me rrezikun. Këto rezerva krijohen duke zbritur një të pestën e fitimit të bankës dhe përdoren lirisht nga banka me qëllim

mbulimin e rreziqeve të paidentifikuar në veprimtarinë e saj dhe nuk pasqyrojnë reduktimin e vlerës së një aktivi të caktuar. Bankat, në rastet kur fondi rezervë i krijuar bie nën nivelin minimal të kërkuar, është e detyruar ta plotësojë atë brenda një afati kohor 2 vjeçar.

7. Fitimet e pashpërndara, të cilat janë të lira nga çdo detyrim i ardhshëm, përfshihen në kapitalin bazë të nivelit të parë të bankës, vetëm me miratimin e asamblesë së përgjithshme për pjesën që parashikohet të jetë element përbërës i tij.

8. Bankat përfshijnë fitimin e periudhës raportuese, si element të kapitalit bazë, vetëm nëse plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

- është miratuar nga eksperti kontabël i autorizuar i bankës;
- është zbritur çdo dividend i ndërmjetëm (pjesshëm) i paguar gjatë vitit, taksat dhe detyrimet e tjera mbi fitimin.

Sipas **nenit 7** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për kapitalin rregullator të bankës*”, bankat nuk përfshijnë në kapitalin e tyre rregullator çdo rritje në vlerën e kapitalit aksioner që rezulton nga aktivet e titullzuara, të tilla si:

- rritjet në të ardhurat e pritshme për bankën nga marzhi i fitimit nga shitja;
- fitimet neto, në rastet kur banka është origjinuese e një titullzimi që burojnë nga kapitalizimi i të ardhurave të ardhshme nga aktivet e titullzuara që sigurojnë përmirësim të cilësisë së kredisë për pozicionet e titullzimit.

Bazuar në pikat e mëposhtme të **nenit 8** të kësaj rregullorje mbi rezervat e mbrojtjes së flukseve të parasë dhe ndryshimet në vlerën e detyrimeve të veta:

1. Bankat nuk përfshijnë në asnjë element të kapitalit të tyre rregullator zërat e mëposhtëm:

- rezervat e vlerës së drejtë që lidhen me fitimet ose humbjet nga mbrojtjet e flukseve të parasë të instrumenteve financiare që nuk vlerësohen me vlerën e tyre të drejtë (fair value), përfshirë flukset e projektuara të parasë;
- fitimet ose humbjet nga detyrimet e bankës që vlerësohen me vlerë të drejtë, që rezultojnë nga ndryshimet në vlerësimin e kredisë (credit rating) të vetë bankës;
- të gjitha fitimet dhe humbjet e vlerës së drejtë që burojnë nga rreziku i kredisë së vetë bankës lidhur me detyrimet derivative.

2. Bankat, nuk kompensojnë fitimet dhe humbjet e vlerës së drejtë, që burojnë nga rreziku i kredisë së vetë bankës, me ato që burojnë nga rreziku i kundërpartisë.

3. Bankat, mund të përfshijnë në kapitalin e tyre rregullator shumën e fitimeve dhe humbjeve nga detyrimet e tyre kur ndryshimet në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të bankës burojnë nga të njëjtat ndryshime në vlerësimin e kredisë së vetë bankës (credit rating).

Sipas **nenit 22** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për kapitalin rregullator të bankës*”, bankat përfshijnë instrumentet e kapitalit në kapitalin shtesë të nivelit të parë, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- të jenë të paguar;
- instrumentet nuk janë blerë nga asnjë prej subjekteve të mëposhtme:
 - banka apo filiale të saj,
 - subjekte, në të cilat banka zotëron në mënyre direkte ose me anë të kontrollit 20% ose më shumë të të drejtave të votës ose të kapitalit të tyre.
- blerja e instrumenteve nuk është financuar direkt ose indirekt nga banka;
- instrumentet renditen poshtë instrumenteve të përfshirë në kapitalin e nivelit të dytë

në rast të situatave të paaftësisë pagueze dhe likuidimit;

- instrumentet nuk janë të siguruara ose të garantuara nga një prej subjekteve të mëposhtme, që përmirëson përparësinë e shlyerjes së pretendimeve ndaj kreditorëve të bankës:
 - banka ose filialet e saj,
 - banka mëmë dhe filialet e tjera të saj,
 - shoqëria holding financiare mëmë ose filialet e saj,
 - shoqëria holding me aktivitet të kombinuar ose filialet e saj,
 - shoqëria holding financiare me aktivitet të kombinuar ose filialet e saj,
 - subjektet palë të lidhura me subjektet e përcaktuara në nënpikat më sipër;
- instrumentet nuk janë subjekt i ndonjë marrëveshjeje apo kontrate që përmirëson përparësinë në këtë instrument, në situata të paaftësisë pagueze ose të likuidimit;
- instrumentet nuk kanë datë specifike maturiteti që burojnë nga ky instrument dhe instrumentet nuk përfshijnë incentiva për bankën për t'i shlyer ato;
- kur instrumentet përfshijnë një ose më shumë opsione call, këto opsione mund të ushtrohen vetëm me diskrecion të emetuesit (bankës);
- instrumentet mund të ripaguhet/shlyhen vetëm kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 38 të kësaj rregulloreje dhe jo më parë se pesë vite nga data e emetimit.
- instrumentet nuk specifikojnë në mënyrë direkte apo të tërthortë që ato mund të ekzekutohen/shlyhen ose riblihen, vetëm në rastet e:
 - likuidimit të saj (bankës),
 - riblerjes së instrumenteve ose mënyrave të tjera të zvogëlimit të shumës së kapitalit shtesë të nivelit të parë, ku banka merr paraprakisht miratim nga Banka e Shqipërisë;

- bankat nuk specifikojnë në mënyrë eksplicite apo implicite se Banka e Shqipërisë do të pranojë një kërkesë për tërheqje, shlyerje apo riblerje të instrumenteve;
- pagesa e interesit (dividentit, etj), siç përcaktohet në kontratën e të tilla instrumenteve, përmbush kushtet e mëposhtme:
 - niveli i pagesës së interesit (dividentit) për këto instrumente nuk ndryshohet në bazë të cilësisë së kredisë së bankës apo të shoqërisë mëmë,
 - dispozitat që rregullojnë këto instrumente i japin të drejtën bankës (full discretion) që, në çdo kohë, të anulojë shpërndarjen e interesave (dividentëve) për një periudhë kohe të pakufizuar dhe mbi baza jekomulative, dhe banka mund t'i përdorë këto pagesa të anuluar pa kufizim për shlyerjen e detyrimeve të saj,
 - anulimi i pagesave të interesit (dividentit etj.) nuk përbën ngjarje dështimi për bankën,
 - anulimi i pagesave të interesit (dividentit) nuk vendos kufizime mbi bankën, vetëm me përjashtim të pagesave për aksionet e zakonshme;
- dispozitat që rregullojnë këto instrumente përcaktojnë se, në rast të një ngjarjeje aktivizuese (trigger event), shuma e kryegjësë së instrumentit mund të ripaguhet/shlyhet (written down) në mënyrë të përkohshme apo të përhershme, ose instrumenti mund të konvertohet në instrumente kapitali që përfshihen në kapitalin bazë të nivelit të parë (aksione të zakonshme);
- dispozitat që rregullojnë këto instrumente nuk përmbajnë klauzola që pengojnë rikapitalizimin e bankës;
- në rastet kur këto instrumente nuk emetohen direkt nga banka duhet të plotësojnë kushtet si më poshtë:

- të jenë të emetuara nga një subjekt që përfshihet në mbikëqyrjen e konsoliduar të bankës,
- të ardhurat të jenë në dispozicion të menjëhershëm të bankës pa kufizime.

Sipas **nenit 23** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për kapitalin rregullator të bankës*”, dispozitat që rregullojnë instrumentet që përfshihen në kapitalin shtesë të nivelit të parë nuk duhet të përmbajnë:

- detyrimin për pagesën e interesave (dividenteve etj.) në rast të kryerjes së pagesave për instrumentet e emetuara nga banka që kanë prioritet më të ulët ose të njëjtë me një instrument të përfshirë në kapitalin shtesë të nivelit të parë (dividend pusher); detyrimin për ndalimin e pagesave të interesit për instrumentet e kapitalit të përfshira në kapitalin bazë ose shtesë të nivelit të parë dhe në kapitalin e nivelit të dytë, në rast se nuk janë kryer pagesat e interesave (dividenteve) për këto instrumente kapitali të përfshira në kapitalin e nivelit të parë shtesë (dividend stopper);
- detyrimin për zëvendësimin e pagesës së interesit (dividentit) me një pagesë të një forme tjetër.

Bazuar në pikat e mëposhtme të **nenit 24** të rregullores së Bankës Shqipërise “*Për kapitalin rregullator të bankës*”:

1. Për instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë zbatohen këto dispozita:

- një ngjarje aktivizuese (trigger event), ndodh kur norma e kapitalit bazë të nivelit të parë të bankës bie nën vlerën 5,125%;
- bankat mund të përcaktojnë vetë ngjarje të tjera aktivizuese të ndryshme;
- kur dispozitat që rregullojnë instrumentin përcaktojnë konvertimin e tyre në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë, në rast të ndodhjes së një ngjarjeje

aktivizuese, këto dispozita duhet të specifikojnë normën e konvertimit dhe një kufi të shumës që lejohet të konvertohet ose një interval brenda të cilit instrumentet do të konvertohen në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë;

- kur dispozitat që rregullojnë instrumentin përcaktojnë zhvlerësimin e tyre në rast të ndodhjes së një ngjarjeje aktivizuese, zhvlerësimi duhet të reduktojë të gjitha elementet e mëposhtëm:

- detyrimin e mbajtësit të instrumentit, në rast paaftësie paguese ose likuidimi të bankës,

- shumën që kërkohet të paguhet në rast ushtrimi të opsionit call ose shlyerjeje të instrumentit,

- pagesat e interesit (dividentit) të bëra mbi këtë instrument.

2. Ripagimi/shlyerja apo konvertimi i një instrumenti të kapitalit shtesë të nivelit të parë gjeneron elemente/zëra që kualifikohen si instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë.

3. Shuma e instrumenteve të kapitalit shtesë të nivelit të parë, të njohura në këtë lloj kapitali, kufizohet në minimumin e shumës të elementeve bazë të kapitalit të nivelit të parë që mund të gjenerohen në rast se shuma e kryegjësë së instrumenteve të kapitalit të nivelit të parë shtesë do të zhvlerësohej plotësisht ose do të konvertohej në instrument të kapitalit të nivelit të parë bazë.

4. Shuma agregate e instrumenteve të kapitalit shtesë të nivelit të parë që është e detyrueshme të ripaguhet/shlyhet ose të konvertohet në rast të ndodhjes së ngjarjes aktivizuese, nuk duhet të jetë më e vogël se më e vogla ndërmjet:

- shumës së nevojshme për të kthyer në nivelin prej 5,125% të normës së kapitalit bazë të nivelit të parë;

- shumës së plotë të kryegjësë të instrumentit.

5. Bankat, në rast të ndodhjes së një ngjarje aktivizuese, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë;
- njofton mbajtësit e instrumenteve të kapitalit shtesë të nivelit të parë;
- zhvlerëson kryegjënë e instrumenteve ose konverton pa vonesë instrumentet në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë, por jo më vonë se një muaj nga data e ndodhjes së ngjarjes.

6. Bankat, të cilat emetojnë instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë që konvertohen në kapital bazë të nivelit të parë, në rast të ndodhjes së një ngjarjeje aktivizuese, duhet të sigurojnë se kapitali aksioner (authorised share capital) të jetë në çdo kohë i mjaftueshëm, për të konvertuar të tilla instrumente në aksione.

7. Bankat sigurojnë në kohë të gjitha miratimet paraprake të nevojshme në datën e emetimit të aksioneve që përfshihen në kapitalin bazë të nivelit të parë, në të cilët do të konvertohen instrumentet që përfshihen në kapitalin shtesë të nivelit të parë, në rast të ndodhjes së një ngjarjeje aktivizuese.

8. Bankat, të cilat emetojnë instrumente që konvertohen në aksione që përfshihen në kapitalin e nivelit të parë bazë, në rast të ndodhjes së një ngjarje aktivizuese, duhet të sigurohen se nuk ka pengesa procedurale në statutin e tyre për konvertimin në fjalë.

Bazuar në **nenin 25** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për kapitalin rregullator të bankës*”, bankat zbresin zërat e mëposhtëm nga kapitali shtesë i nivelit të parë:

- pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të vetë bankës në instrumentet e veta të përfshira në kapitalin e nivelit të parë shtesë, duke përfshirë edhe

instrumentet në kapitalin e nivelit të parë shtesë që banka është e detyruar të blejë si rezultat i një detyrimi kontraktual;

- pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në instrumente të kapitalit të nivelit të parë shtesë të institucioneve financiare me të cilët banka ka pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara), për të cilat Banka e Shqipërisë vlerëson se janë bërë me qëllim për të rritur në mënyrë artificiale kapitalin rregullator të bankës;
- shumën e aplikueshme të përcaktuar në përputhje me nenin 29 për pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta apo sintetike në instrumente të kapitalit të nivelit të parë shtesë të institucioneve financiare, ku banka nuk ka investime të rëndësishme në këto subjekte;
- pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike në instrumente të kapitalit të nivelit të parë shtesë të institucioneve financiare, ku banka ka investime të rëndësishme në këto subjekte, duke përjashtuar pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për pesë ditë ose më pak;
- shumën e zërave të zbritshëm nga kapitali i nivelit të dytë, sipas nenit 33, që tejkalon kapitalin e nivelit të dytë të bankës;
- çdo shpenzim për taksa (tax charge) që lidhen me elementet e kapitalit shtesë të nivelit të parë të parashikueshme në momentin e llogaritjes së tij, përveç rasteve kur banka rregullon në mënyrë të përshtatshme vlerat e zërave të kapitalit shtesë të nivelit të parë, për sa kohë të tilla shpenzime do zvogëlojnë vlerat deri në atë nivel, sa këto zëra mund të përdoren për të mbuluar rrezikun apo humbjet.

Sipas pikave të mëposhtme të **nenit 30** të kësaj rregulloreje:

1. Kapitali i nivelit të dytë përbëhet nga elementët e mëposhtëm:

- instrumentet e kapitalit dhe borxhi i varur që plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në kapitalin e nivelit të dytë (dhe që nuk janë përfshirë në kapitalin e nivelit të parë);
 - primet e emetimit.
2. Elementet e përfshirë në pikën 1, nuk kualifikohen si elemente të kapitalit bazë të nivelit të parë ose si elemente të kapitalit shtesë të nivelit të parë.
3. Bankat mund të përfshijnë elementet e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, në kapitalin e nivelit të dytë, vetëm me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë.
4. Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për përfshirjen e instrumenteve të kapitalit dhe instrumentet e borxhit të varur në kapitalin e nivelit të dytë, vetëm nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 31 të kësaj rregulloreje.
5. Bankat në zbatim të kushteve të përcaktuara në nenin 31 të rregullores, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm si pjesë të kërkesës për marrjen e miratimit paraprak:
- dokumentacioni bazë (kontratë, prospekt etj.) i lidhur me emetimin e këtyre instrumenteve;
 - një ilustrim skematik të plotësimit të tipareve/kushteve të kërkuara për të tilla instrumente, të përcaktuara në nenin 31 të kësaj rregulloreje, duke dhënë referencat përkatëse në dokumentacionin bazë;
 - një përshkrim i trajtimeve kontabël të instrumenteve në fjalë, së bashku me një opinion nga një ekspert kontabël i autorizuar, në lidhje me pranueshmërinë e tyre;
 - llogaritja e kapitalit rregullator dhe kërkesave për kapital në ditën e fundit të muajit, përpara paraqitjes së kërkesës për marrjen e miratimit paraprak;
 - një përlllogaritje e kapitalit rregullator dhe kërkesave për kapital për periudhën e tre viteve të ardhshme.

Bazuar në **nenit 31** të kësaj rregullorje, bankat kualifikojnë si instrumente të kapitalit të nivelit të dytë instrumentet e kapitalit dhe borxhin e varur, pavarësisht nga forma juridike ose trajtimin kontabël i tyre, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- instrumentet ose borxhi i varur të jenë emetuar nga banka dhe të jenë plotësisht të paguar;
- instrumentet të mos jenë blerë ose borxhi i varur të mos jetë financuar nga asnjë prej subjekteve të mëposhtme:
 - banka apo filiale të saj,
 - subjekte, në të cilat banka zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të kontrollit 20 % ose më shumë të të drejtave të votës ose të kapitalit të tyre;
- blerja e instrumenteve ose financimi i borxhit të varur nuk është kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga banka;
- sipas dispozitave të kontratës së instrumenteve ose të borxhit të varur, në çdo rast, pretendimet e të gjithë kreditorëve të tjerë kanë përparësi shlyerje më të lartë krahasuar me pretendimin mbi kryegjënë e instrumenteve ose pretendimin e borxhit të varur;
- instrumentet ose borxhi i varur nuk janë të garantuara dhe nuk janë subjekt i një garancie që përmirëson prioritetin e pretendimeve nga një prej subjekteve të mëposhtme:
 - banka ose filialet e saj,
 - banka mëmë dhe filialet e tjera të saj,
 - shoqëria holding financiare mëmë ose filialet e saj,
 - shoqëria holding me aktivitet të kombinuar ose filialet e saj,

- shoqëria holding financiare me aktivitet të kombinuar ose filialet e saj,
- subjektet palë të lidhura me subjektet e përcaktuara në nënpikat më sipër;
- instrumentet ose borxhi i varur nuk janë subjekt i ndonjë marrëveshjeje që në rastin e kundërt përmirëson përparësinë respektivisht për instrumentet ose borxhin e varur;
- instrumentet ose borxhi i varur kanë një maturitet fillestar të paktën 5 (pesë) -vjeçar;
- kur dispozitat e kontratës së instrumenteve ose borxhit të varur nuk përfshijnë asnjë nxitje (incentivë) për të shlyer apo riblerë shumën e tyre të kryegjësë nga banka, para afatit të maturimit;
- kur instrumentet ose borxhi i varur përfshijnë një ose më shumë opsione call ose opsione të ripagesës së hershme, këto opsione mund të ushtrohen vetëm me diskrecion të emetuesit (bankës);
- instrumentet ose borxhi i varur mund të ripaguhet/shlyhen vetëm kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 37 dhe jo më parë se pesë vite nga data e emetimit ose e financimit, përveç se kur plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 39;
- dispozitat e kontratës së instrumenteve ose borxhit të varur nuk specifikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë që këto instrumente ose borxhi i varur mund të ekzekutohen/shlyhen ose riblihen nga banka vetëm në rastet e paaftësisë paguese apo likuidimit të bankës;
- dispozitat e kontratës së instrumenteve ose borxhit të varur nuk i japin të drejtën zotëruesit të përshpejtojë planin e pagesave të interesave dhe të kryegjësë në të ardhmen, përveç rasteve të paaftësisë paguese apo likuidimit të bankës;
- niveli i pagesës së interesit ose dividendit për këta instrumente ose borxhin e varur, nuk ndryshohet në bazë të cilësisë së bankës apo të bankës mëmë;

- në rastet kur këto instrumente ose borxhi i varur nuk janë emetuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga banka, duhet të plotësojnë njëkohësisht kushtet e mëposhtme:
 - të jenë të emetuara nga një subjekt që përfshihet në mbikëqyrjen e konsoliduar të bankës,
 - të ardhurat (fitimet) janë në dispozicion të menjëhershëm të bankës, pa kufizime.

Sipas **nenit 32** të kësaj rregullorje, bankat llogarisin shumën në të cilën instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë kualifikohen/përfshihen si zëra të kapitali të nivelit të dytë, gjatë pesë viteve të fundit të maturimit të instrumenteve, duke shumëzuar rezultatin e përftuar nga përllogaritja më poshtë:

- shuma nominale e instrumenteve ose e borxhit të varur, në ditën e parë të periudhës së fundit pesëvjeçare të maturitetit kontraktual pjesëtuar me numrin e ditëve kalendarike në atë periudhë;
- numri i ditëve të mbetura kalendarike të maturitetit kontraktual të instrumenteve ose borxhit të varur.

Bazuar në **nenin 33** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për kapitalin rregullator të bankës*”, bankat zbresin nga kapitali i nivelit të dytë zërat e mëposhtëm:

- pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike të vetë bankës, në instrumentet e veta të përfshira në kapitalin e nivelit të dytë, duke përfshirë edhe instrumentet e veta të kapitalit të nivelit të dytë që banka është e detyruar t’i blejë, si rezultat i një detyrimi kontraktual;
- pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë të institucioneve financiare në të cilët banka ka pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara), për të cilat Banka e Shqipërisë vlerëson se janë krijuar me qëllim për

të rritur në mënyrë artificiale kapitalin rregullator të bankës;

- shumën e aplikueshme, të përcaktuar në përputhje me nenin 37 për pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë të institucioneve financiare, ku banka nuk ka investime të rëndësishme në këto subjekte;
- pjesëmarrjet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe sintetike, në instrumente të kapitalit të nivelit të dytë të institucioneve financiare, ku banka ka investime të rëndësishme në këto subjekte, duke përjashtuar pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për më pak se pesë ditë pune.

Sipas **nenit 38** të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për të kryer secilin apo së bashku veprimet e mëposhtme:

- të zvogëlojë, ripaguajë/shlyejë instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë të emetuara nga banka në zbatim të akteve rregullative të brendshme të bankës, si dhe të kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi;
- të ripaguajë/shlyejë instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë ose instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë, para datës së maturimit kontraktual.


5.1.4 Analizë e ndikimit të rrezikut të kredisë në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri.

Për sistemin bankar shqiptar dhënia e kredive përbën një nga burimet më të mëdha të rrezikut të kredisë. Shumica e institucioneve financiare janë përballur me vështirësi të ndryshme gjatë viteve dhe shqetësimet e tyre kryesore lidhen direkt me standardet jo të duhura të kredidhënies për huamarrësit në përgjithësi, me menaxhimin jo adekuat të rrezikut të portofolit të kredisë, me mungesën e vëmendjes së duhur ndaj

ndryshimeve në ekonominë e një vendi apo zhvillimeve dhe situatave që mund të çojnë në përqekësimin e përgjithshëm të cilësisë së kredisë. Në veprimtarinë e tyre të përditshme, bankat përballen me një numër rreziqesh specifike, të cilat mund të rrjedhin nga faktorë të ndryshëm. Megjithatë, rreziku që meriton vëmendje më të lartë dhe analiza më specifike është rreziku i kredisë.

Sipas një studimi kryer nga Bozdo & Kalluci (2006), rreziku i kredisë zë rreth 44% të të gjithë rreziqeve financiare që hasin bankat shqiptare. Kështu që është mjaft e rëndësishme që ky rrezik të mbahet në norma të parashikueshme dhe të menaxhohet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Grafiku Nr. 11 – Peshë e rreziqeve financiare në sistemin bankar Shqiptar



Burimi: “Rreziku i kredisë dhe sistemet e manaxhimit të tij”, Bozdo & Kalluci (2006.)

Një studim i mëvonshëm mbi përcaktuesit makroekonomikë të probabilitetit të mosshlyerjes të një huaje për Shqipërinë u bë nga Shijaku & Ceca (2010). Duke përdorur kuadrin Wilson (1997), ata shpjeguan se norma e huave me probleme, duke përafruar mundësinë e mosshlyerjes, përcaktohet nga norma e rritjes reale, norma e interesit në monedhë të huaj dhe nga kursi i këmbimit kundrejt euros. Arsyeja që norma e huave me probleme ndikohet nga variablat “në monedhë të huaj” lidhet me peshën e

madhe që zënë huatë me probleme në monedhë të huaj në sistemin bankar shqiptar.

Një model tjetër mbi rrezikun e kredisë për Shqipërinë u ndërtua sërisht nga Shijaku & Ceca (2011), duke përdorur një makro stres-test për të vlerësuar ndikimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të kanaleve të rrezikut të kredisë, bazuar në të dhënat e grumbulluara nga bankat. Ajo çfarë modelohet nga ky punim lidhet me cilësinë e portofolit të kredisë së bankave si një funksion i variablave makroekonomike dhe financiarë për të identifikuar faktorët sistematikë të rrezikut të kredisë që banka qendrore duhet marrë parasysh në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar. Analiza e Shijaku & Ceca (2011) u përqendrua në zbulimin e një modeli reagues të cilësisë së portofolit të kredisë ndaj goditjeve makroekonomike, duke përdorur të dhënat e agreguara të bankave. Edhe pse duke pranuar mangësitë që lidhen me mungesën e “fortësisë” së rezultateve, disa konstatime të rëndësishme duhet të ngrihen dhe të hetohen më tej duke përdorur teknika më të sofistikuara dhe seri të dhënash më të gjata në kohë.

Një studim i bërë nga Banka e Shqipërisë në vitin 2012 rezultoi në përfundimet e mëposhtme: Së pari, doli në pah rëndësia e cilësisë së kredisë ndaj goditjeve të Produktit të Përgjithshëm Bruto (PBB)-së. Së dyti, nuk gjendet asnjë tregues për përgjigjen e portofolit në lek, duke sugjeruar se kanali i kredisë ende mund të jetë i dobët për transmetimin e politikës monetare, nëse nuk pranohet asnjë ndikim ndaj kursit të këmbimit. Së treti, kurset e këmbimit dhe normat referencë në huadhënien në monedhë të huaj rezultuan të jenë përcaktues të rëndësishëm të cilësisë së kredisë. Së katërti, asnjë dallim i konsiderueshëm nuk u gjend ndër përgjigjet e bankave; kështu që, supozimi i një përgjigjeje të ngjashme të portofolit të kredisë ndaj goditjeve makroekonomike i pranuar deri tani nga praktikatat e stress-testing mund të merret në konsideratë.

Sipas një studimi të bërë nga Bozdo (2014), modelimi i rrezikut të kredisë mund të rezultojë në të vërtetë në një manaxhim më të mirë të brendshëm të rrezikut në institucionet bankare. Sipas raportit vjetor të Mbikqyrjes të Bankës së Shqipërisë (2014), rreziku i kredisë vijon të mbetet rreziku kryesor ndaj të cilit ekspozohen bankat, ndikuar si nga faktorë të jashtëm (kushtet ekonomike, konkurrenca etj.) ashtu dhe nga faktorë të brendshëm (strukturat e bilanceve, standardet ekredidhënies, sistemet e kontrollit etj.). Ekzaminimet e bëra nga Banka e Shqipërisë kërkojnë riklasifikim të kategorisë së rrezikut për kredimarrës të caktuar, përmirësimin e praktikave të identifikimit, matjes dhe monitorimit të ekspozimeve të bankës ndaj një kredimarrësi apo grup kredimarrësish. Vitet e fundit, bankat tregtare shqiptare njohën ritme të ngadalta të rritjes së kredive krahasuar me periudhat e mëparshme, duke u përqendruar më tepër në rikuperimin e kredive në vonesë dhe shtrëngimin e kriterëve të kreditimit. Në këto kushte, ekzaminimet synuan evidentimin e faktorëve dhe përgjegjësi të brendshme që ndikuan në përkeqësimin e cilësisë së kredive, me qëllim adresimin e dobësive dhe hapjen e rrugëve të reja për procese të shëndetshme kreditimi, të cilat mbështesin ekonominë në përgjithësi dhe aktivitetin e vetë bankave.

Fokusi kryesor i Politikës Operacionale Mbikëqyrëse (POM) të Bankës së Shqipërisë përqëndrohet tek: rreziku i kredisë, rreziku i tregut, rreziku i likuiditetit, rreziku operacional si edhe ai ligjor, të cilët shoqërojnë aspekte të ndryshme të aktivitetit bankar. Profili i rrezikut të një banke vlerësohet kryesisht në bazë të sistemit CAMELS që përditësohet me rezultatet e monitorimit të vazhdueshëm të rreziqeve që shkaktohen nga aktivitetet bankare. Përgjithësisht, cikli mbikëqyrjes i një banke mund të ndryshojë pas një inspektimi të plotë në vend. Banka e Shqipërisë gjykon se industria bankare

duhet të rishikojë strategjitë e rritjes së aktivitetit bankar, duke harmonizuar nevojat për personel të kualifikuar me ato financiare dhe teknologjike.

5.1.5 Udhëzim i Bankës së Shqipërië “Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës”, Vendim Nr. 33, datë 30.04. 2013.

Bankat tregtare duhet të jenë të vëmendshme në lidhje me rrezikun e normës së interesit, pasi një menaxhim jo i mirë i këtij rreziku mund ti shkaktonte humbje të mëdha bankave. Nisur nga kjo, më poshtë janë paraqitur disa nga nenet kryesore që duhen patur parasysh në lidhje me udhëzimin e Bankës së Shqipërisë “Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës”.

Objekt i **nenit 1** sipas udhëzimit të Bankës së Shqipërisë “Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës”, është përcaktimi i kërkesave dhe rregullave bazë për administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, metodës së llogaritjes së ekspozimit ndaj këtij rreziku dhe raportimit në Bankën e Shqipërisë. Në **nenin 2** të këtij udhëzimi, subjekte janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të cilat ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e dhënë nga Banka e Shqipërisë (këtu e më poshtë në këtë udhëzim do të quhen “banka”).

Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar sipas ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

1. “Rreziku i riçimitit” - është mundësia që banka të pësojë humbje financiare si rezultat i mospërputhjeve të maturitetit (për normat e interesit fikse) dhe i riçimitit të normave të interesit (për normat e ndryshueshme të interesit) të pozicioneve të librit të bankës.

2. “Rreziku i kurbës së kthimit (*Yield*)” - është mundësia që banka të pësojë humbje financiare si rezultat i ndryshimit të pjerrësisë së kurbës së kthimit/*yield-it*.
3. “Rreziku bazë (*Basis risk*)” - është mundësia që banka të pësojë humbje financiare si rezultat i ndryshimeve të normave referencë të interesit për instrumentet me karakteristika të ngjashme për nga maturiteti\ ose koha, deri në ndryshimin e ardhshëm të normës së interesit.
4. “Rreziku i opsioneve” - është mundësia që banka të pësojë humbje financiare si rezultat i opsioneve të përfshira në pozicione të ndjeshme ndaj normës së interesit (për shembull kreditë me një opion shlyerjeje të hershme, depozitat me opion tërheqjen e hershme, etj.).
5. “Libri i tregtueshëm” - përbëhet nga pozicionet në instrumentet financiare të mbajtura me qëllim tregtimi ose për të mbrojtur elemente të tjerë të librit të tregtueshëm, me kusht që, këto instrumente të jenë të çliruara nga çdo lloj klauzole/dispozite kufizuese, përsa i përket tregtueshmërisë së tyre, ose aftësisë së tyre për t’u mbrojtur tërësisht.
6. “Libri i bankës” - përbëhet nga zërat e bilancit dhe zërat jashtë bilancit të një banke, përveç atyre që konsiderohen si pozicione të librit të tregtueshëm.
7. “Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit” - është vlera aktuale e të gjitha flukseve monetare neto, të pritshme, të pozicioneve të librit të bankës (për shembull, flukset e pritshme të parasë së një aktivi të bankës, të reduktuara nga flukset e pritshme të parasë së një pasivi të bankës).
8. “Monedha kryesore” - është çdo lloj monedhe që përbën më shumë se 5% të totalit të aktiveve të bilancit.
9. “*Shock-u* standard i normës së interesit” - është zhvendosja paralele, pozitive apo

negative, në kurbën referencë të kthimit (*yield-it*), prej 200 pikësh bazë.

10. “Pikë bazë” - është njësia e barabartë me një të qindtat e 1%.

Sipas **nenit 5** të udhëzimit të Bankës së Shqipërisë, “*Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës*, bankat krijojnë dhe zhvillojnë sistemin për administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, të përshtatshëm me natyrën, vëllimin, kompleksitetin e veprimitarisë dhe profilin e rrezikut të tyre.

Sipas pikave të **nenit 5** të këtij udhëzimi:

1. Bankat, në zbatim të kërkesës së pikës 1 të këtij neni, hartojnë dhe miratojnë strategjinë, politikën dhe aktet e brendshme rregullative për administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, si dhe sigurojnë zbatimin në vazhdimësi të tyre.
2. Bankat krijojnë struktura organizative të përshtatshme, me linja autoriteti dhe përgjegjësie të përcaktuara saktë, të qarta dhe të ndara në mënyrë jo të interpretueshme ndërmjet punonjësve, të cilat sigurojnë pavarësinë e funksionit të administrimit të rrezikut të normës së interesit nga funksioni i krijimit të pozicioneve, që mbartin rrezik të normës së interesit në librin e bankës, si dhe kushte teknike për matjen, monitorimin dhe kontrollin e këtij rreziku (rrezikut të normës së interesit në librin e bankës).
3. Bankat krijojnë një sistem për matjen e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, që siguron mbulimin e të gjitha burimeve të rrezikut të normës së interesit.
4. Bankat krijojnë një sistem për raportimin e ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, i cili është i pavarur nga funksioni i krijimit të pozicioneve që mbartin rrezik të normës së interesit në librat e bankës dhe përfshin edhe raportimin e rregullt tek drejtuesit ekzekutiv, tek punonjësit ose organet e bankës, të ngarkuar me matjen, monitorimin dhe kontrollin e këtij rreziku (rrezikut të normës së interesit në

librin e bankës).

5. Bankat përcaktojnë supozime të vlefshme për sistemin e administrimit të rrezikut të normës së interesit, të cilat janë të përshtatshme, të dokumentuara dhe të qëndrueshme në kohë.
6. Bankat sigurojnë që çdo ndryshim i rëndësishëm në këto supozime të dokumentohet, shpjegohet dhe miratohet nga drejtimi ekzekutiv i bankës.
7. Bankat krijojnë një sistem kontrolli të brendshëm për procesin e administrimit të rrezikut të normës së interesit në librin e bankës.
8. Bankat kryejnë, minimalisht një herë në vit, *stress-test*-e lidhur me rrezikun e normës së interesit në librin e bankës dhe përdorin rezultatet e testeve të tilla, në vendimmarrjet dhe në rishikimin e politikave, akteve të brendshme rregullative dhe limiteve/kufijve, lidhur me këtë rrezik (rrezikun e normës së interesit).
9. Bankat, në kryerjen e *stress-teste*-ve, marrin në konsideratë të gjitha burimet e rëndësishme të rrezikut të normës së interesit.

Sipas **nenit 6** të udhëzimit të Bankës së Shqipërisë “*Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës*”, bankat vlerësojnë burimet/format e ndryshme të rrezikut të normës së interesit, të cilat mund të ndikojnë negativisht në të ardhurat (të ardhurat neto nga interesat) ose ekspozimin në librin e bankës.

Burimet/format e rrezikut të normës së interesit përfshijnë:

- rrezikun e riçmimit;
- rrezikun e kurbës së kthimit;
- rrezikun bazë; dhe
- rrezikun e opsioneve.

Metodat e llogaritjes së ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit në librin e bankës i nënshtrohen kërkesave të mëposhtme, **sipas nenit 7** të udhëzimit të Bankës së Shqipërisë “*Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës*”:

1. Bankat, për qëllime të llogaritjes së ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, përdorin metodën e vlerësimit të ndryshimit në ekspozimin e librit të bankës, duke aplikuar një shock standard të normës së interesit në pozicionet e librit të bankës, në të gjitha monedhat kryesore individualisht, dhe në monedhat të tjera mbi baza të agreguara.
2. Bankat, për qëllime të llogaritjes sipas metodës së vlerësimit të ndryshimit të ekspozimit të librit të bankës, shpërndajnë pozicionet e ndjeshme ndaj normës së interesit, në 14 intervale kohore.
3. Bankat shpërndajnë pozicionet me normë interesi fikse në intervale kohore, sipas maturitetit të mbetur, dhe pozicionet me normë interesi të ndryshueshme në intervale kohore, sipas kohës, deri në ndryshimin e ardhshëm të normës së interesit.
4. Bankat përdorin peshat e ponderuara të përcaktuara, të cilat llogariten si prodhim i shock-ut të normës së interesit prej 200 pikësh bazë (ose 2%) me kohëzgjatjen e modifikuar (estimated modified duration) për çdo interval kohor.
5. Bankat, në rastet që përdorin metodën e vlerësimit të ndryshimit në ekspozimin e librit të bankës, ndjekin hapat e mëposhtëm:
 - mbledhin, për çdo monedhë kryesore mbi baza individuale dhe për të gjitha monedhat e tjera mbi baza të agreguara, pozicionet e aktiveve dhe pasiveve dhe instrumenteve financiare derivative (ose zërat e aktiveve dhe pasiveve jashtë bilancit), për secilin interval kohor, me qëllim llogaritjen e pozicionit neto për çdo

interval;

- shumëzojnë pozicionin total neto të llogaritur, për çdo interval kohor, me peshat e për çdo monedhë kryesore mbi baza individuale dhe për të gjitha monedhat e tjera mbi baza të agreguara;
- mbledhin të gjitha pozicionet e ponderuara, të llogaritura për të gjitha intervalet kohore, me qëllim llogaritjen e pozicionit neto në blerje (long) ose në shitje (short) për çdo monedhë kryesore mbi baza individuale dhe për të gjitha monedhat e tjera mbi baza të agreguara;
- mbledhin pozicionet neto në blerje (long) dhe në shitje (short) për të gjitha monedhat, me qëllim llogaritjen e pozicionit total neto të ponderuar në librin e bankës.

Sipas **nenit 8** të udhëzimit të Bankës së Shqipërisë “*Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës*”, bankat, në rastin kur përdorin një instrument financiar derivativ të librit të bankës, e përfshijnë këtë instrument (financiar derivativ) në llogaritjen e raportit të ndryshimit në ekspozimin në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator. Ndërsa sipas **nenit 9** të këtij udhëzimi, bankat raportojnë mbi ekspozimet ndaj rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, mbi baza individuale dhe të konsoliduara, të cilat konsiderojnë raportimin mbi baza individuale për monedhat kryesore dhe për të gjitha monedhat e tjera mbi baza të agreguara.

Tabela Nr. 4 - Peshat e ponderimit sipas intervaleve kohore

Peshat e ponderimit sipas intervaleve kohore (time band)				
Intervali kohor	Mesi i intervalit kohor	Kohëzgjatja e modifikuar	Ndryshimi i parashikuar në kthim/përfitim (yield)	Peshat e ponderimit
(1)	(2)	(3)	(4)	(5) = (3)*(4)
Menjëherë	0	0	200 bp	0.00%
Deri në 1 muaj	0.5 muaj	0.04 vite	200 bp	0.08%
1 - 3 muaj	2 muaj	0.16 vite	200 bp	0.32%
3 - 6 muaj	4.5 muaj	0.36 vite	200 bp	0.72%
6 - 12 muaj	9 muaj	0.71 vite	200 bp	1.43%
1 - 2 vite	1.5 vite	1.38 vite	200 bp	2.77%
2 - 3 vite	2.5 vite	2.25 vite	200 bp	4.49%
3 - 4 vite	3.5 vite	3.07 vite	200 bp	6.14%
4 - 5 vite	4.5 vite	3.85 vite	200 bp	7.71%
5 - 7 vite	6 vite	5.08 vite	200 bp	10.15%
7 - 10 vite	8.5 vite	6.63 vite	200 bp	13.26%
10 - 15 vite	12.5 vite	8.92 vite	200 bp	17.84%
15 - 20 vite	17.5 vite	11.21 vite	200 bp	22.43%
Mbi 20 vite	22.5 vite	13.01 vite	200 bp	26.03%

Burimi: Banka e Shqipërisë (2013).

5.1.6 Analizë e ndikimit të rrezikut të normës së interesit në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri.

Siç u theksua edhe më lart, normat e interesit zakonisht ndikohen nga tre lloje rreziqesh, (Banka e Shqipërisë 2007):

1. Rreziku i mospagimit brenda afatit:

Ndodh që edhe huamarrësit më korrektë të mos jenë në gjendje të paguajnë borxhin e tyre për një sërë arsyesh. Në qoftë se huamarrësit nuk i kryejnë pagesat e tyre në kohë, interesi që marrin huadhënësit reduktohet dhe kur huamarrësit nuk paguajnë një pjesë të principalit, interesi i tyre bëhet negativ. Të gjitha huatë mund të preken nga rreziku i moskryerjes në kohë të pagesave ose të përballen me probleme, të cilat pengojnë kryerjen e pagesave. Huadhënësit preferojnë ta reduktojnë rrezikun kur ata japin hua. Si rezultat, shumë prej huadhënësve janë të detyruar t'i sigurojnë huatë e tyre. Kjo do të thotë që huamarrësit i japin huadhënësit një lloj garancie kundrejt rrezikut të mospagimit të kësteve të huasë. Shpeshherë, kjo garanci vjen në formën e një kolaterali, një objekt fizik që është në pronësinë e huamarrësit i cili mund të shitet, në momentin kur ky i fundit nuk është në gjendje të paguajë huanë e marrë. Për shembull, në kreditë për automjete, vetë automjeti shërben si kolateral për kredinë. Në përgjithësi, kreditë e siguruara janë më pak të rrezikuara, prandaj ato kanë edhe interesat më të ulta në treg.

2. Rreziku i likuiditetit:

Për krahasim me rrezikun të mospagimit qëndron edhe rreziku i likuiditetit, i cili ndikon normat e interesit. Në qoftë se një letër me vlerë shitet për afërsisht me të njëjtin çmim që është blerë, ajo konsiderohet me likuiditet të lartë. Kjo do të thotë që ajo mund të shndërrohet në para shumë më lehtë se sa një letër me vlerë, e cila nuk shitet për afërsisht me çmimin

e blerjes. Rrjedhimisht, ky instrumnt borxhi është më pak i rrezikshëm se sa një letër me vlerë, e cila ka një diferencë të madhe midis çmimit të blerjes dhe atij të shitjes.


3. Rreziku i maturitetit:

Transaksionet e kredive në përgjithësi përfshijnë dhënien dhe marrjen e fondeve, për një periudhë të caktuar kohe. Në përfundim të kësaj kohe, huaja konsiderohet e maturuar dhe duhet të paguhet. Kohëzgjatja e maturitetit është një tjetër burim i rrezikut të maturitetit.

Bazuar në politikën e miratuar së brendshmi për “Menaxhimin e rrezikut të tregut” sipas Udhëzimit të Bankës së Shqipërisë Nr. 33, datë 30.04.2013, “Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës”, si dhe bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare të Komitetit të Baselit, Qershor 2004, burimet kryesore të lidhura me rrezikun e normës së interesit vlerësohen si:

- rreziku i riçmimit;
- rreziku i kurbës së kthimit (yield);
- rreziku bazë,
- rreziku i opsioneve.

Grafiku Nr. 12 - Pritjet e bankave për aktivitetin kreditues (majtas) dhe për normat e interesit (djathtas)



Burimi: Vrojtimi i aktivitetit kreditues, Banka e Shqiperise (2016).

Sic shihet edhe në Grafikun Nr. 12, në fillim të viteve 2007-2008 pritjet e bankave në lidhje me normat e interesit të kredive, si në lekë ashtu dhe në valutë ishin në rritje, duke pësuar një rënie drastike në tremujorin e dytë të vitit 2009. Pas kësaj periudhe luhatjet ishin relativisht të vogla, duke u zhvendosur ndjeshëm në kahun rënës për tremujorin e parë të vitit 2016.

Sipas studimit të kryer nga Bozdo & Kalluçi (2006), rreziku i normave të interesit zë rreth 10% të të gjithë rreziqeve financiare të sistemit bankar shqiptar. Dy teknikat kryesore të vlerësimit të rrezikut të normës së interesit në librat e bankës janë skedulet e rivlerësimit (analizat e gap-eve dhe të kohëzgjatjes) dhe përdorimet e simulimeve. Shumica e bankave i përdorin modelet e simulimit për të përcaktuar kapitalin e tyre ekonomik, duke u bazuar në humbjet e mundshme sipas skenarit më të keq të supozuar. Madhësia e këtyre humbjeve dhe probabiliteti i ndodhjes së tyre, përcaktojnë madhësinë e kapitalit ekonomik të një institucioni financiar. Përzgjedhja e teknikave varet nga qasja e bankës ndaj vlerës ose fitimeve ekonomike si dhe nga lloji i biznesit. Përdorimi i vlerësimit bazuar tek fitimet krijon vështirësi shpërndarjeje ose agregimi në rast të matjes së rreziqeve të tjera bazuar në kapitalin ekonomik. Nga ana tjetër, përdorimi i një qasjeje të bazuar tek vlera ekonomike mund të krijojë mospërputhje me praktikën e biznesit.

CAMELS është një sistem i cili përdoret për vlerësimin e performancës së institucioneve financiare në mënyrë të plotë dhe uniforme. Ky sistem jep një vlerësim sasior, si në nivel individual të elementëve që shqyrtohen ashtu dhe në nivel të përgjithshëm për një bankë, duke u bazuar në klasifikimin e gjashtë komponentëve thelbësorë të veprimtarisë dhe kushteve të institucionit financiar. Elementët e marrë në

shqyrtim kanë të bëjnë me mjaftueshmërinë e kapitalit, cilësinë e aktiveve, aftësinë e administrimit, cilësinë dhe nivelin e të ardhurave, mjaftueshmërinë e likuiditetit, si dhe me ndjeshmërinë ndaj rrezikut të tregut. Vlerësimi klasifikohet në një shkallë numerike nga 1 në 5. Një vlerësim me 1 tregon performancë të lartë, praktika të shëndosha dhe shkallë minimale të vëmendjes nga mbikëqyrësi, ndërkohë që një vlerësim me 5 tregon performancë të ulët, praktika të dobëta dhe si pasojë, edhe shkallën më të lartë të vëmendjes mbikëqyrëse.

5.1.7 Rregullore e Bankës së Shqipërië “Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore”, Vendim Nr. 48, datë.14.07.2010.

Një nga rreziqet financiare që ka prekur sistetmin bankar në Shqipëri është edhe rreziku i kursit të këmbimit. Në mënyrë që të minimizohen humbjet, bankat tregtare duhet të jenë të vëmendshme në menaxhimin me sukses të këtij rreziku. Nisur nga kjo, më poshtë janë paraqitur disa nga nenet kryesore që duhen patur parasysh në lidhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore”.

Objekt i **nenit 1** sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore”, është përcaktimi i rregullave dhe kriterëve për llogaritjen, raportimin dhe mbikëqyrjen e pozicioneve të hapura valutore të bankave, me qëllim administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit. Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë, për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë.

Termat e përdorur më poshtë në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e

Shqipërisë”.

1. “Rrezik i kursit të këmbimit” - është rreziku i humbjes nga ndryshimi në kursin e këmbimit midis monedhave të ndryshme të huaja dhe/ose ndryshimi në kursin e këmbimit të lekut ndaj monedhave të huaja.
2. “Aktive (të drejta) dhe pasive (detyrime) në monedhë të huaj” - janë të gjitha aktivet dhe pasivet të regjistruara në monedhë të huaj.
3. “Pozicion strukturor në valutë” - është pozicioni i cili krijohet nga:
 - elemente (zëra të bilancit ose të jashtë bilancit) të cilat nuk janë të natyrës së veprimtarisë (biznesit) kryesore bankare e financiare të bankës dhe/ose janë elemente të qëndrueshme/afatgjata të tilla si: “interesat në pjesëmarrje”; investimet në “filialet”, “aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara dhe të trupëzuara”, dhurimi i kapitalit për degët e bankës të hapura jashtë vendit etj.;
 - transaksione të bankës të cilat ruajnë nivelin e mjaftueshmërisë së kapitalit në rastet kur raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ndikohet nga luhatjet e kursit të këmbimit.

Sipas **nenit 5** të kësaj rregullorje, pozicioni neto i hapur valutor për çdo monedhë të huaj dhe/ose në ar llogaritet si shuma e:

- pozicionit neto spot, që përcaktohet si diferencë midis aktiveve dhe pasiveve në monedhë të huaj dhe/ose në ar, duke përfshirë dhe interesat e përlllogaritur, si dhe transaksionet spot të cilat kanë të bëjnë me blerje dhe shitje të valutave, për të cilat është rënë dakord, por që nuk janë regjistruar ende në librat kontabël;
- pozicionit neto forward, që përcaktohet si diferencë midis të gjitha shumave që do të arkëtohen dhe të gjitha shumave që do të paguhën sipas:
 - marrëveshjeve forward për transaksionet e këmbimeve valutore (dhe/ose të arit),

- marrëveshjeve future të monedhave të huaja (dhe/ose të arit), si dhe do të përfshijë kryegjënë sipas marrëveshjeve swap të monedhave të huaja, të përfshirë në pozicionin spot, dhe
- garancitë e parevokueshme, letrat e kredisë të pambuluara dhe instrumentet e tjera të ngjashme, të cilat janë të sigurta që do të ekzekutohen (called) dhe të mundshme për të qenë të parikuperueshme (irrecoverable).
- pozicionit neto të opsioneve të monedhave të huaja (dhe/ose të arit), që përcaktohet si diferencë midis vlerës nominale në total të të gjitha opsioneve Call të blera dhe opsioneve Put të shitura dhe vlerës nominale në total të të gjitha opsioneve Put të blera dhe opsioneve Call të shitura.

Në llogaritjen e pozicionit të hapur valutor nuk përfshihet pozicioni strukturor në valutë. Pozicioni neto i hapur valutor llogaritet për çdo monedhë të huaj (përfshirë edhe arin) të pasqyruar në bilancin e bankës dhe konvertohet në lekë me kursin zyrtar të publikuar nga Banka e Shqipërisë në ditën e llogaritjes. Pozicioni neto i hapur valutor mund të jetë “pozicion neto i hapur valutor në blerje” (long) ose “pozicion neto i hapur valutor në shitje” (short), pozicioni neto i hapur valutor në blerje është kur aktivet në monedhë të huaj janë më të mëdha se pasivet në monedhë të huaj, domethënë kur diferenca midis aktiveve në monedhë të huaj dhe pasiveve në monedhë të huaj është pozitive (me shenjën +). Sipas kësaj rregullorje, pozicioni neto i hapur valutor në shitje është kur aktivet në monedhë të huaj janë më të vogla se pasivet në monedhë të huaj, domethënë kur diferenca midis aktiveve në monedhë të huaj dhe pasiveve në monedhë të huaj është negative (me shenjën -).

Shuma e të gjitha pozicioneve neto të hapura valutore në blerje, e shprehur në lekë,

përfaqëson pozicionin total neto të hapur valutor në blerje, ndërsa shuma e të gjitha pozicioneve neto të hapura valutore në shitje, e shprehur në lekë, përfaqëson pozicionin total neto të hapur valutor në shitje. Vlera më e madhe midis pozicionit total neto të hapur valutor në blerje dhe pozicionit total neto të hapur valutor në shitje përfaqëson pozicionin total neto të hapur valutor të bankës, ose ndryshe ekspozimin e përgjithshëm të bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

Sipas **nenit 7** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore*”, banka krijon sistemin e administrimit të rrezikut të kursit të këmbimit ndaj të cilit ajo ekspozohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, me qëllim identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin e këtij rreziku, po ashtu banka harton politika dhe procedura të nevojshme për administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit që përfshijnë minimalisht:

- objektivat dhe parimet e bankës në ushtrimin e veprimtarive në monedhë të huaj;
- kufizime të qarta dhe të sakta për ekspozimin e bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, në përputhje me kufijtë e lejueshëm të përcaktuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje;
- përcaktime të qarta të përgjegjësive dhe delegimit të tyre në lidhje me aktivitetet në monedhë të huaj si dhe të njësive organizative dhe personave për administrimin e rrezikut nga kursi i këmbimit;
- përjashtimet e mundshme nga kufijtë/kufizimet e brendshme të përcaktuara dhe përgjegjësitë për marrjen e vendimeve për aplikimin e këtyre përjashtimeve. Politika për administrimin e rrezikut nga kursi i këmbimit duhet të jetë në përputhje me natyrën, qëllimin, tipin dhe kompleksitetin e veprimtarive në monedhë të huaj të cilat

banka i kryen dhe/ose planifikon t'i kryejë.

Bazuar në këtë rregullore, komiteti/struktura e administrimit të rreziqeve minimalisht:

- zbaton politikën e administrimit të rrezikut të kursit të këmbimit;
- jep sugjerime për përmirësimin e politikës së administrimit të rrezikut të kursit të këmbimit;
- vlerëson sistemin e bankës për administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit;
- përcakton kufij të brendshëm për raportet midis pozicioneve të hapura valutore për monedha të ndryshme (long dhe short) dhe kapitalit rregullator, dhe i shqyrton në mënyrë periodike këto raporte;
- kryen analiza për ekspozimin e bankës ndaj kursit të këmbimit dhe monitoron veprimtarinë për administrimin e këtij rreziku;
- analizon ndikimin e administrimit të rrezikut të kursit të këmbimit në rezultatet e operacioneve të bankës nëpërmjet skenarëve të ndryshëm apo rezultateve të stress test-eve;
- monitoron kushtet makroekonomike dhe kushte të tjera (të brendshme dhe të jashtme), të cilat kanë ndikim në kursin e këmbimit dhe që e ekspozojnë bankën ndaj rrezikut të veprimtarisë në monedhë të huaj, me qëllim identifikimin në kohë të këtyre rreziqeve dhe marrjen e masave për administrimin e tyre.

Po ashtu sipas **nenit 7** të kësaj rregullorje drejtoria e bankës minimalisht:

- harton dhe aplikon procedura për identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin e rrezikut të kursit të këmbimit të bankës në përputhje me politikën për administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit;

- krijon dhe aplikon sisteme të përshtatshme për matjen e ekspozimit të bankave ndaj rrezikut të kursit të këmbimit;
- krijon dhe aplikon sisteme të përshtatshme për monitorimin dhe matjen e fitimeve dhe humbjeve nga aktivitetet në monedhë të huaj;
- përcakton kushtet dhe termat për monitorimin dhe vlerësimin mbi baza të rregullta të politikës dhe zbatimit të saj;
- harton procedura për vlerësimin e ndikimit të produkteve të reja në ekspozimin ndaj rrezikut të kursit të këmbimit;
- monitoron kushtet ekonomike dhe kushtet e tjera në të cilat banka është duke vepruar, me qëllim përballimin e ndryshimeve eventuale në aktivitetet në monedha të huaja, kursin e këmbimit dhe rrezikun e ekspozimit të monedhës/ave;
- përgatit dhe sugjeron forma, përmbajtje dhe metoda për raportim në këshillin drejtues dhe komitetin e administrimit të rreziqeve për aktivitetet në monedhë të huaj, për administrimin eficient të rrezikut të kursit të këmbimit, ndaj të cilit banka është e ekspozuar.

Po ashtu në këtë nen parashikohet se në rastet kur banka është subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar, politika për administrimin e rrezikut nga kursi i këmbimit përfshin administrimin e rrezikut nga kursi i këmbimit në nivel grupi bankar. Procedurat për zbatimin e politikës për administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit përfshijnë minimalisht:

- raportimin tek drejtoria dhe këshilli drejtues të:
 - pozicioneve të hapura valutore sipas monedhave,
 - pozicionit valutor total,

- fitimit dhe humbjes së realizuar nga veprimtaria në monedhë të huaj;
- sisteme kontrolli në:
 - njësitë e përcaktuara për të kryer dhe administruar veprimtaritë në monedhë të huaj,
 - monitorimin e përputhshmërisë dhe respektimit të kufijve të përcaktuar për ekspozimin ndaj rrezikut të kursit të këmbimit,
 - regjistrimin e transaksioneve që kanë lidhje me veprimtarinë e bankës në monedhë të huaj;
- metodologjinë e kryerjes së stress test-it për ekspozimin e bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, në përputhje me procedurat e brendshme të bankës.


5.1.8 Analizë e ndikimit të rrezikut të kursit të këmbimit në përfitueshërisë e bankave tregtare në Shqipëri.

Sipas studimit të kryer nga Bozdo & Kalluçi (2006), rreziku i kursit të këmbimit zë rreth 10% të të gjithë rreziqeve financiare që hasin bankat tregtare shqiptare. Në një studim të mëvonshëm (Shijaku & Ceca, 2010), konkluzionet e nxjerra nga variablat makroekonomike që përcaktojnë probabilitetin e humbjes së një kredie për Shqipërinë theksojnë se treguesi i kredive me probleme përcaktohet nga norma reale e rritjes ekonomike, nga normat e huaja të interesit, si dhe nga kursi i këmbimit kundrejt euros .

Arsyeja pse treguesi i kredive me probleme është ndikuar nga variablat e “huaja” lidhet me peshën e lartë të portofolit të kredive në valutë në sistemin bankar shqiptar. Deri në vitin 2001, dollari amerikan konsiderohej si monedha më e rëndësishme dhe është përdorur në pjesën më të madhe të aktiviteteve tregtare si mjet për mbrojtjen nga rreziku i zhvlerësimit të monedhës vendase dhe për lehtësimin e transaksioneve me shoqëritë e huaja (Bollano & Ziu, 2007). Gjatë kësaj periudhe bankat përdorën

monedhat e huaja (euro dhe dollar) në aktivitetin e tyre kreditues për të shmangur rrezikun e kursit të këmbimit dhe të normës së interesit. Kjo tregon edhe arsyen se përse monedhat e huaja kanë qenë mbizotëruese në strukturën e stokut të kredisë me një kosto më të ulët krahasimisht me monedhën vendase.

Grafiki Nr. 13 - Pritjet për aktivitetin kreditues në valutë dhe lekë



Burimi: Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues, Banka e Shqipërisë (2016).

Sipas raportit të fundit të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë për tremujorin e parë të vitit 2016, bankat presin rritje të kreditimit si në monedhën vendase, ashtu edhe në valutë (Grafiku Nr. 13). Balancat përkatëse, 32.4% për kredinë në lekë dhe 17.5% për kredinë në valutë, tregojnë për tendenca rritëse relativisht më dinamike të kredisë së akorduar në monedhën vendase. Ndërkohë, pritjet e bankave për normat e interesit të kredive, si në lekë ashtu dhe në valutë, janë të zhvendosura ndjeshëm në kahun rënës për tremujorin e parë të vitit 2016.

Sipas studimit të fundit të Shijaku & Kalluci (2013), në afat të gjatë, kredia bankare lidhet pozitivisht me kursin e këmbimit dhe negativisht me efektin reduktues të shkaktuar nga huamarrja e brendshme e qeverisë. Nga ana tjetër, një gjendje e qëndrueshme makroekonomike dhe politika të orientuara drejt uljes së kostove të

kredisë si dhe një liberalizim më i madh financiar, njëkohësisht do të mbështetnin një kreditim më të lartë dhe do të ulnin rrezikun e kreditimit të sektorit privat. Në të njëjtën kohë, një nivel më i ulët i kredive me probleme shihet se ndikon në një ofertë më të lartë të kredisë nga sistemi bankar. Përmirësimi i eficiencës së kredisë bankare dhe reduktimi i kredive me probleme do të ulnin rrezikun e perceptuar të kredisë, duke inkurajuar ofertën e kredisë. Bazuar te rezultatet, vihet re se mundësimi i politikave më të shëndetshme për rritjen ekonomike dhe përmirësimi i eficiencës së bankave do të ndikonin në tërheqjen e më shumë depozitave dhe në uljen e kostove fikse. Gjithashtu, ruajtja dhe reduktimi i deficitit buxhetor mbështet ndërmjetësimin financiar. Politikat për një sektor financiar të shëndetshëm që stimulojnë financimin e sistemit bankar dhe kufizojnë kreditë me probleme, mbeten thelbësore për një rritje të qëndrueshme të kreditimit.

**5.1.9 Rregullore e Bankës së Shqipërië “Për administrimin e rrezikut operacional”,
Vendim Nr. 03, datë.19.01.2011.**

Zhvillimi i teknologjise ka sjellë sfida të reja në lidhje me menaxhimin e rrezikut operacional në bankat tregtare. Edhe ky rrezik financiar si të gjithë rreziqet e tjera ka ndikuar në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri. Një menaxhim i suksesshëm i këtij rreziku është domosdoshmëri për sistemin bankar. Nisur nga kjo, më poshtë janë paraqitur disa nga nenet kryesore që duhen patur parasysh në lidhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut operacional”.

Objekt i **nenit 1** sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut operacional”, është përcaktimi i kërkesave dhe rregullave për administrimin e rrezikut operacional në veprimtarinë bankare dhe/ose financiare nga subjektet e kësaj rregulloreje. Bazuar në **nenin 2**, subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja,

subjektet financiare jobanka, si dhe shoqëritë e kursim kreditit dhe unionet e tyre, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë.

Termat më poshtë të përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin për bankat, dhe në ligjin nr. 8782 datë 03.05.2001 “Për Shoqëritë e Kursim- Kreditit”, i ndryshuar.

1. “Rrezik operacional” - është mundësia që subjekti të pësojë humbje financiare si rezultat i papërshtatshmërisë ose dështimit të proceseve të brendshme dhe të sistemeve, gabimeve njerëzore, ose i ngjarjeve të jashtme. Rreziku operacional përfshin dhe rrezikun ligjor, por përjashton rrezikun reputacional dhe strategjik. Për qëllime të sistemit të brendshëm të administrimit të rrezikut operacional, subjektet mund të përcaktojnë përkufizime më të specifikuara të këtij rreziku, me kusht që ato të përmbajnë minimalisht elementët e përkufizimit të kësaj rregulloreje.

2. “Rrezik ligjor” - është mundësia që subjekti të pësojë humbje financiare si rezultat i moszbatimit ose zbatimit në mënyrën jo të duhur të detyrimeve ligjore dhe/ose kontraktuale, duke përfshirë dhe procedura të tjera ligjore të cilat mund të ndikojnë negativisht në rezultatin financiar duke mbartur rrezikun e humbjeve financiare në veprimtarinë e subjekteve.

2. “Rrezik strategjik” - është mundësia që subjekti të pësojë humbje financiare si rezultat i vendimmarrjes/ve strategjike të papërshtatshme apo jo të mirëstudiuara në veprimtarinë e subjektit/eve.

3. “Rrezik reputacional” - është mundësia që subjekti të pësojë humbje financiare të shkaktuara nga rënia e reputacionit në veprimtarinë e subjektit/eve si rrjedhojë e opinionit negativ të publikut ndaj subjektit/eve.

Sipas **nenit 5** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për administrimin e rrezikut operacional*”, pavarësisht madhësisë dhe kompleksitetit të organizimit dhe veprimtarisë së tyre, krijojnë dhe zhvillojnë një sistem të brendshëm të përshtatshëm (politika, procedura, rregulla dhe teknika) për administrimin e rrezikut operacional. Ky sistem ka për qëllim të sigurojë identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin në vazhdimësi dhe tërësi të rrezikut operacional. Sistemi i administrimit të rrezikut operacional të subjektit minimalisht duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm:

- përcaktimin, në funksion/varësi të madhësisë dhe veprimtarisë së tij, se çfarë përbën rrezik operacional për subjektin;
- tërësinë e ngjarjeve të pritshme që mund të shkaktojnë rreziqe operationale me rëndësi materiale për subjektin;
- politikat për identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe kontrollin ose zbutjen e këtij rreziku, duke përfshirë dhe specifikuar (kur është e mundur) dhe kufijtë e lejuar të rrezikut operacional;
- veprimet më me përparësi për subjektin në procesin e administrimit të rrezikut operacional, duke përfshirë dhe shkallën dhe mënyrën e transferimit të këtij rreziku jashtë subjektit.

Bazuar në **nenin 6** të rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për administrimin e rrezikut operacional*”, Këshilli Drejtues është organi përgjegjës për krijimin dhe zhvillimin e sistemit të administrimit të rrezikut operacional, të parashikuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje. Këshilli Drejtues, në kuadër të administrimit të rrezikut operacional, është përgjegjës për:

- miratimin e politikave dhe procedurave përkatëse për administrimin e rrezikut

operacional;

- ngritjen e një strukture administrimi të aftë për zbatimin e akteve rregullative të brendshme të subjektit për administrimin e rrezikut operacional;
- përcaktimin e qartë të ndarjes së përgjegjëse dhe linjave të raportimit midis funksioneve të kontrollit të rrezikut operacional, linjave të biznesit dhe funksioneve mbështetëse;
- rishikimin në mënyrë periodike të akteve rregullative të subjektit për administrimin e rrezikut operacional me qëllim administrimin e rreziqeve operationale që rrjedhin nga ndryshimet e tregut dhe faktorët të tjerë të jashtëm, si dhe ato rreziqe operationale që lidhen me produktet, veprimtaritë ose sistemet e reja. Procesi i rishikimit duhet të synojë vlerësimin dhe përzgjedhjen e praktikave më të mira të administrimit të rrezikut operacional, të përshtatshme për veprimtaritë, sistemet dhe proceset e subjektit.

Sipas **nenit 7** të kësaj rregullorje, drejtoria është përgjegjëse për zbatimin e akteve të brendshme rregullative për administrimin e rrezikut operacional të subjektit, të miratuara nga Këshilli Drejtues. Drejtoria, në funksion të administrimit të rrezikut operacional, është përgjegjëse për:

- zbatimin e politikave, proceseve dhe procedurave për administrimin e rrezikut operacional në të gjitha shërbimet/produktet, veprimtaritë, proceset dhe sistemet me rëndësi për subjektin;
- zbatimin në vazhdimësi dhe nga të gjitha strukturat e subjektit të akteve të brendshme për administrimin e rrezikut operacional;
- zbatimin e përgjegjëse dhe zhvillimin e linjave të raportimit për të inkurajuar dhe

për të ruajtur llogaridhënien, për të siguruar burimet financiare dhe njerëzore të duhura për administrimin efektiv të rrezikut operacional;

- komunikimin në mënyrë të qartë të punonjësit e të gjitha niveleve, veçanërisht në njësitë që janë të ekspozuara ndaj rrezikut operacional, të politikës së subjektit për administrimin e rrezikut operacional;
- drejtimin e veprimtarisë bankare dhe/ose financiare të subjektit nga personel i kualifikuar, me përvojë, dhe aftësi teknike të nevojshme;
- të siguruar që personeli përgjegjës për monitorimin e zbatimit të politikës së administrimit të rrezikut operacional, të jetë i pavarur nga njësitë që ata mbikëqyrin;
- sigurimin e dokumentimit të politikave, proceseve dhe procedurave që lidhen me teknologjitë e përparuara, të cilat, në veçanti mbështesin transaksionet me vlera të larta.

Neni 6 i rregullores së Bankës së Shqipërisë “*Për administrimin e rrezikut operacional*” thekson se subjektet identifikojnë dhe vlerësojnë rrezikun operacional në të gjitha shërbimet/produktet, veprimtaritë, proceset dhe sistemet me rëndësi. Subjektet, përpara hedhjes në treg, të shërbimeve/produkteve të reja, kryerjes së veprimtarive apo proceseve të ndryshme, dhe/ose krijimit të sistemeve të reja, sigurojnë zbatimin e procedurave të mjaftueshme dhe të përshtatshme për vlerësimin paraprak të rrezikut operacional që mund të lidhet me to. Po ashtu subjektet identifikojnë në mënyrë efektive rrezikun operacional duke konsideruar faktorët e brendshëm (të tillë si: struktura e subjektit, natyra e veprimtarive, cilësia e burimeve njerëzore, ndryshimet organizative dhe qarkullimi i punonjësve) dhe faktorët e jashtëm (të tillë si: ndryshimet në industri dhe përparimet teknologjike), të cilët mund të ndikojnë në mënyrë të

pafavorshme në arritjen e objektivave të subjektit.

Subjektet vlerësojnë ekspozimin që ato kanë ndaj rreziqeve të identifikuar, duke përcaktuar në këtë mënyrë profilin e tyre të rrezikut me qëllim përdorimin efikas të burimeve njerëzore dhe teknike për administrimin e këtyre rreziqeve. Subjektet përcaktojnë metodat dhe teknikat e tyre për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut operacional.

Në pikat mëposhtme të **nenit 9** të kësaj rregullorje parashikon që subjektet duhet të zhvillojnë një proces monitorimi dhe raportimi periodik të rrezikut operacional dhe të ekspozimeve ndaj këtij rreziku, me qëllim identifikimin e shpejtë dhe plotësimin e mangësive në politikat, proceset dhe procedurat për administrimin e këtij rreziku.

1. Subjektet, në realizimin e procesit të monitorimit efektiv dhe të vazhdueshëm të rrezikut operacional duhet të:

- përcaktojnë tregues të përshtatshëm që sigurojnë paralajmërim të hershëm të rritjes së rrezikut operacional i cili mund të sjellë humbje në të ardhmen;
- vendosin kufij për këta tregues, kur është e mundur, me qëllim krijimin e një procesi efektiv monitorimi, që mund të ndihmojë për të identifikuar rreziqet kryesore dhe me rëndësi për subjektin dhe për t'i mundësuar këtij të fundit monitorimin në kohë të tyre;
- përcaktojnë periodicitetin e procesit të monitorimit, duke marrë në konsideratë shkallën e rrezikut dhe natyrën e ndryshimeve në mjedisin në të cilin operojnë;
- sigurojnë përfshirjen e rezultateve të monitorimit në raportet e rregullta për drejtorinë dhe këshillin drejtues.

2. Subjektet zbatojnë procedura të brendshme që sigurojnë raportimin e rregullt për

drejtorinë dhe këshillin drejtues të administrimit të rrezikut operacional, përkatësisht nga njësitë e biznesit, nga funksioni/njësia organizative e administrimit të rrezikut operacional dhe njësia e kontrollit të brendshëm.

3. Raportet e rrezikut operacional të parashikuara në pikën 3 të këtij neni duhet të përmbajnë si vijon:

- të dhëna për situatën e brendshme financiare, operacionale dhe të respektimit të kufijve të përcaktuar për treguesit e rrezikut, si dhe informacion mbi tregun në lidhje me ngjarjet të cilat janë të rëndësishme për vendimmarrjen;
- një pasqyrë të plotë të çdo problemi të identifikuar dhe udhëzime për veprimet korigjuese në çështje të pazgjidhura.

4. Subjektet sigurojnë shpërndarjen e raporteve në të gjitha nivelet e drejtimit dhe tek përfaqësuesit e linjave të biznesit të cilat ndikohen nga problematikat e ngritura në raport. Subjektet analizojnë këto raporte me qëllim përmirësimin e praktikave dhe procedurave ekzistuese dhe hartimin e politikave/praktikave dhe procedurave të reja në administrimin e rrezikut operacional.

Tabela Nr. 5 - Ngjarjet e rrezikut operacional që mund të shkaktojnë humbje të rëndësishme

Lloji i ngjarjes	Përkufizimi
Mashtrimi	Mashtrimi i brendshëm lidhet me ushtrimin e veprimtarive të paautorizuara, vjedhje dhe/ose mashtrime që përfshijnë të paktën një punonjës të subjektit. Disa ngjarje të cilat klasifikohen si mashtrime të brendshme jepen më poshtë: a) raportime të gabuara dhe me dashje në lidhje me pozicionet e subjektit; b) kryerje e transaksioneve të paautorizuara të subjektit; c) transaksione të brendshme (nën llogarinë e punonjësit të subjektit); d) shkatërrim i qëllimshëm i aktiveve të subjektit; e) vjedhje, grabitje, zhvatje, përvetësime në subjekt; f) falsifikime; g) evazion fiskal i qëllimshëm.
Mashtrimi	Mashtrimi i jashtëm i referohet mashtrimeve dhe/ose vjedhjeve që kryhen nga një palë e tretë jashtë subjektit. Ky përfshin ndër të tjera: a) vjedhjet dhe grabitjet; b) falsifikimet; c) dëmtimet e qëllimshme të sistemeve kompjuterike (<i>Hacking damage</i>); d) vjedhjet e informacionit; e) etj.
Praktikat e punësimit dhe të sigurisë në punë	Kjo kategori i referohet ngjarjeve që lidhen me marrëdhëniet e punonjësve, sigurisë së mjediseve të punës si dhe diversitetit/diskriminimit. Shembuj të cilët mund të sjellin humbje operacionale, përfshijnë: a) kompensimin e pretendimeve të punonjësve (shembull: ngjarjet e diskriminimit etj.); b) përfundimin e gabuar (të padrejtë) të kontratës/ave të punësimit; c) shkeljet e rregullave të shëndetit dhe sigurisë.

Klientët, produktet	Në këtë kategori, humbjet operacionale lindin si pasojë e një dështimi për të përmbushur një detyrim të klientit, ose nga natyra dhe projektimi i produktit. Shembuj të këtyre ngjarjeve, ndër të tjera përfshijnë: a) shkelje të detyrave të besuara (në mirëbesim); b) keqpërdorim i informacionit konfidencial të klientit; c) pastrim parash; d) defekte të produkteve; e) tejkalim i të drejtave të aksesit në programin kompjuterik bankar bazë; f) gabime njerëzore ose të llogaritjeve automatike; g) tejkalim të kufijve të ekspozimit ndaj klientit.
Dëmtime fizike të aktiveve	Kjo kategori përfshin humbjet si pasojë e fatkeqësive dhe/ose veprimeve të tjera, të tilla si: a) katastrofa natyrore, të cilat përfshijnë (tërmete, zjarr, përmytje etj.); b) terrorizëm; c) vandalizma.
Ndërprerja e aktivitetit dhe dështimi i sistemeve	Ngjarjet e rrezikut operacional në këtë kategori përfshijnë, ndër të tjera: a) dështimin e plotë ose të pjesshëm të pajisjeve ose programeve; b) probleme të telekomunikacionit; c) ndërprerje të shërbimeve; d) vjetrim të pajisjeve.
Ekzekutimi, shpërndarja dhe administrimi i proceseve	Kjo kategori përfshin ngjarjet e rrezikut që lidhen me përpunimin e transaksioneve ose me administrimin e proceseve dhe të marrëdhënieve me palë të treta. Shembuj të ngjarjeve të tilla, ndër të tjera përfshijnë: a) mangësi në komunikim; b) gabime në hedhjen e të dhënave (shembull: të dhëna të gabuara); c) mosrespektimi i afateve ose përgjegjësi; d) keqfunksionim i moduleve/sistemeve; e) gabime në kontabilitet; f) gabime në raportim; g) mangësi në dokumentacionin ligjor; h) hyrje e paaprovuar në llogarinë e klientit; i) mosmarrëveshje me palët e treta; j) mosfunksionim i kontratave të shërbimit me palë të treta sipas kushteve dhe termave të rëna dakord.

Burimi: Banka e Shqipërisë (2011).

5.1.10 Analizë e ndikimit të rrezikut operacional në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri.

Sipas studimit të kryer nga Bozdo & Kalluçi (2006), rreziku operacional zë rreth 10% të të gjithë rreziqeve financiare të sistemit bankar shqiptar. Identifikimi dhe menaxhimi i rrezikut operacional mbetet një përparësi. Në terma më praktik, ky proces duhet të synojë në ndërtimin e mekanizmave të brendshëm që përvetësojnë krijimin e tepricave në drejtime të caktuara të veprimtarisë bankare dhe synojnë një diversifikim më të mirë të investimeve, si dhe mbështetjen e formave më të qëndrueshme të burimeve financiare. Të gjitha këto kërkojnë forcimin e sistemit të auditimit të brendshëm, nxitjen e strukturave për të vlerësuar dhe administruar rreziqet operationale në përgjithësi, personel me ekspertizë bankare, si dhe vendosjen e marrëdhënieve të qëndrueshme me depozituesit dhe klientët e tjerë të shërbimeve bankare përmes rritjes së transparencës.

Sipas Agalliu (2014) portofoli i kredisë përbën zërin me peshën më të lartë ndër aktivet e sistemit bankar shqiptar, duke zënë rreth 45% të totalit të aktiveve. Pavarësisht se pesha e këtij portofoli ka ardhur në rënie gjatë viteve të fundit (si pasojë e shtesës së portofolit të letrave me vlerë), kreditimi i ekonomisë përbën veprimtarinë bazë të bankave tregtare në Shqipëri. Si rrjedhim, rreziku i kredisë përbën edhe rrezikun kryesor financiar ndaj të cilit ekspozohet sistemi bankar shqiptar. Gjithashtu, duke qenë se veprimtaria e bankave shqiptare karakterizohet nga produkte dhe shërbime tradicionale jo shumë të ekspozuara ndaj rrezikut të tregut, duke marrë në konsideratë mungesën e tregut financiar të organizuar dhe duke konsideruar se rreziku operacional është në nivele relativisht të ulëta, mund të thuhet se sistemi bankar shqiptar dominohet nga rreziku i kredisë.

**5.1.11 Rregullore e Bankës së Shqipërië “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”,
Vendim Nr. 71, datë.14.10.2009.**

Bankat tregtare në Shqipëri nuk kanë patur probleme me likuiditetin, mundësisht këto institucione financiare kanë patur likuiditet të tepërt. Por nga ana tjetër një likuiditet i tepërt mund ti shkaktojë humbje bankave, prandaj rreziku i likuiditetit duhet të menaxhohet me kujdes nga bankat tregtare. Nisur nga kjo, më poshtë janë paraqitur disa nga nenet kryesore që duhen patur parasysh në lidhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”.

Objekti i **nenit 1** sipas rregullores “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”, është përcaktimi i kërkesave dhe standardeve minimale për administrimin efektiv të rrezikut të likuiditetit, nga subjektet e kësaj rregulloreje. Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të cilat ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë. Këto subjekte, këtu e më poshtë në këtë rregullore, do të quhen “banka”.

Termat e përdorur më poshtë në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

1. “Mungesë Likuiditeti” do të konsiderohet çdo situatë në të cilën banka:

- nuk disponon aktive likuide të mjaftueshme ose ka vështirësi për t’i realizuar ato në treg, me qëllim përmbushjen e detyrimeve kur ato maturohen dhe kërkohen nga depozituesit ose kreditorët e tjerë, ose
- nuk ka mundësi të financojë rritjen e aktiveve të veta.

2. “Rreziku i likuiditetit” është mundësia e humbjes financiare si rezultat i mungesës së

likuiditetit.

3. “Kushte/situata jo të zakonshme” janë ato situata në të cilat ekziston një kërcënim real që mund të çojë bankën në mungesë likuiditeti.

4. “Plani i emergjencës” është një dokument i hartuar nga banka, në të cilin pasqyrohen rregullat dhe procedurat që duhen ndjekur në kushte jo të zakonshme, si dhe procedurat për mundësimin e fondeve të emergjencës.

5. “Fluksi neto i parasë” është diferenca ndërmjet flukseve hyrëse dhe flukseve dalëse të parasë për një periudhë të përcaktuar kohe, duke u reflektuar kështu në rritje apo ulje të sasisë së *cash*-it.

6. “Maturiteti kontraktual i mbetur i të drejtave dhe detyrimeve” është periudha kohore e mbetur deri në përfundimin e afatit të maturimit të të drejtave dhe detyrimeve kontraktore.

7. “Përqendrimi në burimet e financimit” është gjendja kur një vendimmarrje e vetme apo një faktor i jashtëm i vetëm mund të shkaktojë tërheqje të menjëhershme dhe të konsiderueshme të fondeve, duke detyruar kështu bankën të ndryshojë ndjeshëm strategjinë e saj të financimit.

8. “*Stress-testing*” është teknikë e administrimit të rrezikut e përdorur për të vlerësuar ndikimin e mundshëm të një ose me shumë faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm mbi qëndrueshmërinë financiare dhe/ose likuiditetin e bankës. *Stress test*-et mund të përfshijnë analiza të skenarëve apo analiza të ndjeshmërisë.

9. “Depozitues të mëdhenj” konsiderohen njëzet depozituesit me vlerën më të madhe të depozitave në totalin e depozitave të bankës.

10. “*Gap-i*” është diferenca midis aktiveve dhe pasiveve të bankës, sipas intervaleve të

maturitetit.

11. “Haircut” është përqindja me të cilën pakësohet vlera e aktivitetit likuid për qëllime të përlogaritjes së treguesit të likuiditetit, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.”

Sipas **nenit 5** të rregullores “*Për administrimin e rrezikut të likuiditetit*”, bankat krijojnë sistemin e administrimit të rrezikut të likuiditetit, i cili ka për qëllim mirëadministrimin e rrezikut të likuiditetit. Bankat sigurojnë që sistemi i administrimit të rrezikut të likuiditetit, në mënyrë sasiore dhe cilësore, të jetë në përputhje me madhësinë e bankës, tipologjinë e aktivitetit dhe nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit.

Sistemi i administrimit të rrezikut të likuiditetit përfshin minimalisht:

- strategjinë dhe politikat për administrimin e rrezikut të likuiditetit;
- strukturën organizative të krijuar për administrimin e rrezikut të likuiditetit;
- sistemin e kontrollit të brendshëm;
- sistemin e administrimit të informacionit;
- planin e emergjencës.

Bazuar në **nenin 6** të rregullores “*Për administrimin e rrezikut të likuiditetit*”

Bankat hartojnë strategjinë dhe politikat për administrimin e rrezikut të likuiditetit. Strategjia për administrimin e rrezikut të likuiditetit përmban minimalisht elementët e mëposhtëm:

- objektivat e strategjisë;
- parimet për administrimin e rrezikut të likuiditetit;
- metodologjinë e përgjithshme që banka do të zbatojë për administrimin e rrezikut të likuiditetit në periudha afatshkurtra dhe afatgjata;

- metodologjinë e përgjithshme dhe vizionin e bankës për të hyrë në shumë tregje dhe burime financimi.

Sipas **nenit 7** të rregullores “*Për administrimin e rrezikut të likuiditetit*” Banka krijon strukturë organizative të përshtatshme për administrimin e rrezikut të likuiditetit, si dhe përcakton qartë kompetencat dhe ndarjen e përgjegjësisë të njësive/funksioneve organizative të bankës që realizojnë monitorimin dhe administrimin e rrezikut të likuiditetit. Këshilli drejtues i bankës ose organi kompetent i bankës mëmë për degën e bankës së huaj, për qëllime të administrimit të rrezikut të likuiditetit kryen veprimet e mëposhtme:

- shqyrton dhe miraton strategjinë, politikën/at dhe procedurat e administrimit të rrezikut të likuiditetit si dhe monitoron zbatimin e tyre, duke përfshirë miratimin dhe monitorimin e planit të emergjencës;
- shqyrton çdo vit përshtatshmërinë e strategjisë dhe politikave të zbatuara, si dhe në çdo rast që paraqiten zhvillime të rëndësishme që ndikojnë në veprimtarinë e bankës;
- miraton kufijtë e brendshëm të ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit në përputhje me profilin e saj të rrezikut, strategjinë e biznesit dhe rolin e saj në sistemin financiar;
- shqyrton dhe analizon raportin për administrimin e rrezikut të likuiditetit, shmangiet nga politikat e miratuara, si dhe miraton dhe monitoron strategjitë për rregullimin e këtyre shmangieve;
- shqyrton rezultatet e gjeneruara nga *stress test*-et dhe përcakton, në përputhje me këto të fundit, masat për rregullimin e profilit të likuiditetit në përshtatje me tolerancën e rrezikut;

- sigurohet që struktura/t përgjegjëse administron/jnë rrezikun e likuiditetit në mënyrë efektive, duke vlerësuar paralelisht rreziqet e tjera, veçanërisht ato të tregut dhe të kreditit;
- vlerëson dhe monitoron efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në funksion të administrimit të rrezikut të likuiditetit.
- miraton procedurat e nevojshme për matjen dhe monitorimin e flukseve neto të parasë, si dhe për monitorimin e likuiditetit në monedhat kryesore dhe në total.

Këshilli drejtues i bankës ose organi kompetent i bankës mëmë për degën e bankës së huaj, krijon komitete/struktura për administrimin e rrezikut/qeve. Këto komitete/struktura, krahas administrimit të rreziqeve të tjera të subjektit, janë përgjegjëse edhe për administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe realizojnë në funksion të këtij të fundit bazuar në:

- hartimin dhe zbatimin e strategjisë, politikave dhe procedurave për administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe dhënien e propozimeve për rishikimin e treguesve të tij;
- zhvillimin dhe vlerësimin e sistemit të administrimit të rrezikut të likuiditetit me qëllim ruajtjen e efikasitetit të tij;
- shqyrtimin e raporteve lidhur me gjendjen e likuiditetit të bankës dhe përcaktimin e monitorimin e veprimeve të nevojshme për administrimin e rrezikut të likuiditetit;
- rishikimin periodik të kufijve të ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit dhe propozimin e ndryshimit të këtyre kufijve;
- hartimin e metodologjisë së kryerjes së *stress teste*-ve dhe procedurave për raportimin e rezultateve të gjeneruara prej tyre, si dhe raportim in periodik pranë Këshillit Drejtues mbi gjendjen dhe perspektivën e likuiditetit të bankës;

- sugjeron zgjidhjen e çdo problemi potencial të likuiditetit dhe siguron vazhdimësinë e operacioneve të bankës;
- siguron kushtet për funksionimin efektiv të sistemit të kontrollit të brendshëm;
- çdo veprim tjetër që vlerësohet i nevojshëm në funksion të administrimit të rrezikut të likuiditetit.

Bazuar në **nenin 8** të kësaj rregullorje, banka miraton procedura për kontrollin e brendshëm të cilat duhet të sigurojnë përfshirjen e procesit të administrimit të rrezikut të likuiditetit brenda procesit të administrimit të rrezikut në tërësi. Funksioni i kontrollit të brendshëm të administrimit të rrezikut të likuiditetit është pjesë përbërëse e sistemit të përgjithshëm të kontrollit të bankës ku përfshin minimalisht elementët e mëposhtëm:

- monitorimin e përputhshmërisë së treguesve të likuiditetit me kufijtë e përcaktuar dhe raportimin mbi tejkalimet e mundshme të tyre;
- kontrollin periodik të afateve, saktësisë dhe plotësisë së të dhënave dhe supozimeve të përdorura për qëllime të matjes dhe monitorimit të rrezikut të likuiditetit;
- aplikimin e masave për korrektimin e dobësive të konstatuara;
- zhvillimin e vazhdueshëm të metodave dhe metodologjive për matjen dhe kontrollin e rrezikut të likuiditetit;
- sigurimin e përputhshmërisë me të gjitha ligjet, rregulloret dhe aktet e tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë, si dhe me rregullat e brendshme të bankës.

Sipas **nenin 9** të kësaj rregullorje, banka krijon një sistem informacioni i cili siguron në kohë dhe në mënyrë të qëndrueshme për procesin e vendimmarrjes, të dhënat e nevojshme për matjen, monitorimin, kontrollin dhe raportimin e treguesve të rrezikut të likuiditetit me qëllim administrimin e këtij të fundit. Sistemi i informacionit duhet të

sigurojë të dhëna dhe informacion minimalisht për çështjet e mëposhtme:

- matjen, kontrollin dhe monitorimin e likuiditetit të bankës mbi baza ditore dhe në periudha kohore të përcaktuara qartë;
- matjen, kontrollin dhe monitorimin e likuiditetit të bankës për çdo monedhë të huaj, e cila ndikon në mënyrë të konsiderueshme në likuiditetin e përgjithshëm të bankës, mbi baza individuale dhe të agreguara;
- monitorimin e përputhshmërisë së treguesve të likuiditetit me kufijtë e përcaktuar për ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit;
- gjenerimin e të dhënave me qëllim llogaritjen e treguesve të likuiditetit dhe përgatitjen e formave të raportimit për nevoja të strukturave drejtuese të bankës dhe të gjithë personave të tjerë të përfshirë në procesin e administrimit të rrezikut të likuiditetit;
- raportet e përqendrimit të depozitave dhe monitorimin e qëndrueshmërisë së tyre;
- software për kryerjen e *stress test*-eve të likuiditetit.

Sipas **nenit 10** të rregullores “*Për administrimin e rrezikut të likuiditetit*” banka administron likuiditetin jo vetëm në kushte/rrethana normale, por përgatitet për administrimin e tij dhe në kushte/rrethana të jashtëzakonshme. Banka kryen gjithashtu në mënyrë periodike *stress test*-e, me qëllim identifikimin dhe matjen e ekspozimit të saj ndaj rrezikut të likuiditetit, si në kushte/situata normale të aktivitetit të përditshëm, ashtu dhe në situata jo të zakonshme. Për këtë qëllim banka kryen analizën e ndikimit në fluksin e parave, të aftësisë paguese afatshkurtër dhe afatgjatë, të përgatitjes për të vepruar në kushte/situata jo të zakonshme, si dhe vlerëson kapacitetin e saj për të rritur aktivitet nëpërmjet identifikimit të burimeve më të favorshme të financimit.

Periodiciteti me të cilën banka kryen *stress test*-et përcaktohet prej saj në përputhje me madhësinë e veprimtarisë së bankës, ekspozimin e saj ndaj rrezikut të likuiditetit dhe peshën e saj në sistemin bankar, me kusht që ky periodicitet të mos jetë më pak se 4 herë në vit. Banka e Shqipërisë mund t'i kërkojë në çdo rast bankës kryerjen e *stress test*-eve në periudha më të shpeshta. Rezultatet e *stress test*-eve shqyrtohen nga Këshilli Drejtues i bankës të paktën çdo 3 muaj dhe përdoren për:

- përmirësimin e strategjive dhe politikave të administrimit të rrezikut të likuiditetit;
- hartimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullativ të nevojshëm për zgjidhjen e çështjeve kryesore lidhur me pozicionin e likuiditetit të bankës;
- zhvillimin e planeve efektive të emergjencës.

Stress-test-et e realizuara nga banka përfshijnë përdorimin e skenarëve të veçantë bazuar në faktorë të brendshëm, të skenarëve të bazuar në kushtet e tregut ku banka vepron, si dhe në faktorë makroekonomikë (faktorë të jashtëm). Skenarët për kryerjen e *stress test*-eve mund të përfshijnë supozimet e mëposhtme:

- tërheqje masive të depozitave;
- përkeqësim i mundshëm i aftësisë së kredimarrësve për të shlyer detyrimet, që nënkupton përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredisë;
- pamundësi të konvertimit me lehtësi dhe pa humbje të konsiderueshme të aktiveve në cash;
- mundësinë e shlyerjes së parakohshme të detyrimeve në kushtet e ekzistencës së opsioneve kontraktuale që e mundësojnë këtë shlyerje;
- rrezikun operacional dhe shkallën e ndikimit të tij në rritjen e rrezikut të likuiditetit;
- ndryshimet në kushtet ekonomike në sektorët ndaj të cilëve banka është ekspozuar

dhe përkeqësimin e ekonomisë në tërësi;

- përkeqësim të funksionimit të tregjeve në të cilat banka operon dhe/ose një reduktim të ndjeshëm të besimit në këto tregje;
- *shock*-un e normës së interesit dhe atë të kursit të këmbimit;
- efektin e ndryshimeve të ndjeshme në vlerën e aktiveve të bankës dhe/ose aktiveve të pranuar prej saj si garanci (kolateral);
- kufizimin e pjesshëm apo të plotë të financimit nga burimet kryesore të financimit, duke përfshirë mundësinë e vazhdueshmërisë së financimit nga banka mëmë;
- ndikimin e zhvillimeve negative ekonomike në shkallë rajonale dhe globale;
- çdo situatë tjetër të mundshme që vlerësohet si e përshtatshme.

Supozimet e renditura në **pikën 6** të këtij neni kanë vlerë udhëzuese për bankën, ndërkohë që banka përdor ato situata që përshtaten më mirë me kompleksitetin, profilin e rrezikut dhe peshën e saj në sistemin bankar. Banka përcakton metodologjinë për realizimin e *stress test*-eve, supozimet e përdorura, si dhe veprimet në kundërpërgjigje të rezultateve të gjeneruara, e cila përfshin:

- zbatimin, analizën e skenarëve të *stress test*-eve dhe periodicitetin e realizimit të tyre;
- realizimin e *stress test*-eve për skenarë individualë dhe skenarë të kombinuar, në kushtet e ndodhjes së njëkohshme të disa skenarëve;
- dokumentimin dhe rishikimin në mënyrë periodike të supozimeve të përdorura për kryerjen e *stress test*-eve;
- formën dhe periodicitetin e raportimit të rezultateve të *stress test*-eve në strukturat drejtuese;

- veprimet që duhet të ndërmerren nga strukturat drejtuese apo/dhe strukturat e veçanta të ngarkuara për administrimin e rrezikut të likuiditetit, mbështetur në rezultatet e *stress test*-eve.

Në **nenin 11** të kësaj rregullorje parashikohet që banka të zhvillojë një plan emergjence për administrimin e rrezikut të likuiditetit në kushte të jashtëzakonshme, të cilin e teston në mënyrë periodike të paktën çdo 2 vjet. Plani i emergjencës është pjesë e sistemit të administrimit të rrezikut të likuiditetit dhe përmban:

- ndarje të qartë të detyrave, kompetencave, përgjegjësive dhe vendimmarrjes në lidhje me vënien në zbatim të planit;
- treguesit e paralajmërimit të hershëm të përdorur si sinjalizues për zhvillimin e kushteve të jashtëzakonshme si dhe përcaktimin e personave përgjegjës brenda bankës për monitorimin dhe raportimin e këtyre treguesve;
- kushtet në të cilat do të zbatohet plani;
- përcaktimin e veprimtarive që duhet të ndërmerren, identifikimin e burimeve të mundshme të fondeve, nivelin e tyre dhe përparësitë në përdorim, si dhe përcaktimin e intervaleve kohore brenda të cilëve këto veprimtari duhet të ndërmerren;
- komunikimin me depozituesit kryesorë, partnerët e biznesit, klientët e tjerë dhe publikun;
- të dhënat e kontaktit të personave përgjegjës për zbatimin e planit.

Banka e rishikon planin e emergjencës në mënyrë periodike, me qëllim marrjen në konsideratë të ndryshimeve të mundshme të kushteve të brendshme dhe të jashtme të operacioneve të bankës. Në kushte të situatave të vështirësive ekonomiko-financiare, banka bashkëpunon ngushtësisht me Bankën e Shqipërisë dhe shkëmben informacion

të vazhdueshëm me të mbi gjendjen e saj financiare, si dhe mbi veprimet e ndërmarra për rikthimin e saj në parametra të kënaqshëm.

Sipas **nenit 12** të rregullores “*Për administrimin e rrezikut të likuiditetit*”, banka identifikon, vlerëson dhe administron rrezikun e likuiditetit duke u bazuar në elementët e mëposhtëm:

- parimet e vlerësimit të rrezikut të likuiditetit;
- planifikimin dhe monitorimin e fondeve (flukseve) hyrëse dhe dalëse;
- përcaktimin dhe ruajtjen e një strukture të përshtatshme të maturitetit;
- monitorimin e burimeve të financimit dhe përqendrimit të tyre;
- monitorimin e garancive (kolateralit) për qëllime të likuiditetit;
- monitorimin e linjave të financimit;
- normat e likuiditetit.

Bazuar në **nenin 13** të kësaj rregullore, banka identifikon, vlerëson dhe administron rrezikun e likuiditetit duke u bazuar minimalisht në parimet e mëposhtme:

- parimin e mbështetjes në burime të qëndrueshme financimi;
- parimin e minimizimit të diferencave midis maturiteteve në momentin e vlerësimit dhe atyre të parashikuara në kontratë;
- parimin e diversifikimit të burimeve të financimit sipas llojit, monedhës, instrumenteve, maturimit, numrit të klientëve dhe tregjeve, duke konsideruar nivelin e likuiditetit të tyre;
- parimin e zgjerimit të ekuilibruar/të kontrolluar të veprimtarisë dhe të ruajtjes së një vlere të mjaftueshme të aktiveve likuide;
- parimet e disponueshmërisë së burimeve njerëzore për administrimin efektiv të

rrezikut të likuiditetit.

5.1.12 Analizë e ndikimit të rrezikut të likuiditetit në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri.

Sipas Sumanth (1998), produktiviteti dhe likuiditeti janë problemi kryesor i vendeve në zhvillim dhe i atyre të zhvilluara. Kjo e bën më të nevojshëm monitorimin dhe matjen e treguesve të ndryshëm, si dy mjete për identifikimin dhe kurimin e shpejtë të performancës nëse është problematike.

Sistemi bankar në Shqipëri është prekur dy herë nga tërheqjet masive të depozitave. Kështu, kriza e vitit 2002 dhe ajo e vitit 2008, nxorrën jashtë sistemit bankar rreth 8% të totalit të depozitave. Karakteristikë e këtyre krizave në dallim nga vendet e tjera ishte se pavarësisht tërheqjeve, Shqipëria nuk u prek dhe nuk e vuajti nga mungesa e likuiditetit, por nga mungesa e besimit të klientëve në sistemin financiar. Madje në vitin 2008, u vu re një dalje e cashit të filialeve të bankave në Shqipëri, drejt kompanive nënë jashtë vendit. Për të shmangur këtë dalje të cash-it, Banka e Shqipërisë, nxorri një udhëzim i cili u ndalonte bankave nxjerrjen e valutës jashtë vendit, pavarësisht se impakti i këtij udhëzimi mbeti i panjohur. Shumë e rëndësishme në këto periudha ishte besimi që u arrit të përcillej tek publiku që sistemi bankar në Shqipëri ishte shumë i sigurtë. Pavarësisht tërheqjeve të bëra, mund të thuhet që gati të gjitha depozitat e tërhequra në vitin 2002 dhe një pjesë e konsiderueshme e atyre të 2008, u arrit të kthehej në sistemin bankar .

Krahas pranisë së vazhdueshme në media për sqarimin e publikut, Banka e Shqipërisë vendosi një regjim të përforcuar të monitorimit të zhvillimeve, duke nisur nga marrja e një informacioni ditor kryesisht për zhvillimet në situatën e likuiditetit dhe

kredisë të sektorit bankar. Gjithashtu, për të ruajtur gjendjen likuide të sektorit bankar, u ndërmorën operacionet e nevojshme të tregut të hapur duke ofruar likuiditet të bollshëm për bankat tregtare, kryesisht me maturime javore, mujore dhe tremujore.

Banka e Shqipërise dhe në veçanti, Departamenti Mbikëqyrjes është autoriteti i vetëm në Shqipëri, i cili mbikëqyr rrezikun e likuiditetit dhe menaxhimin e tij nga bankat që kryejnë aktivitet në vendin tonë. Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit në Shqipëri realizohet nga struktura të përcaktuara të çdo banke, që ndryshe quhen edhe si komitetet e menaxhimit të aktiv-pasiveve (ALCO). Bankat janë përgjegjëse për ngritjen e një sistemi raportimi që tregon me saktësi gjendjen e likuiditetit ditor dhe mujor të institucionit. Çdo ditë bankat tregtare raportojnë në Bankën e Shqipërise lidhur me hyrje-daljet e cash-it, si dhe bëjnë raportime mujore lidhur me disa tregues të likuiditetit. Raportet e likuiditetit më të përdorshëm në Shqipëri janë: Raporti Depozita/Aktive Totale, Raporti Kredi/Aktive Totale, Raporti Kredi/ Depozita. Banka e Shqipërisë nëse vëren probleme tek një bankë e caktuar mund të kërkojë raportime më të shpeshta dhe të marrë masa për sistemimin e gjendjes së këtij institucioni financiar. Udhëzimi i ri i Bankës së Shqipërisë, e konsideron shumë të rëndësishëm për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, krijimin e një strategjie të qartë për menaxhimin e rrezikut, kryerjen e stres-testeve si dhe krijimin e planeve të kontigjencës për reagime në situata të caktuara. Stres-testet duhet të bëhen minimalisht 4 herë në vit, dhe nëse Banka e Shqipërisë e konsideron të nevojshme mund të kërkojë që këto teste të bëhen dhe më shpesh.

Sipas studimit të kryer nga Bozdo & Kalluçi (2006), rreziku i likuiditetit zë rreth 13% të të gjithë rreziqeve financiare të sistemit bankar shqiptar, duke u bërë kështu i dyti për nga rëndësia pas rrezikut të kredisë. Prandaj është shumë e rëndësishme që ky

rrezik të menaxhohet me sukses në mënyrë që bankat tregtare të minimizojnë humbjet.

Vika (2009) nëpërmjet Metodës së Përgjithësuar të Momenteve (mPm) identifikoi disa faktorë që ndikojnë kredinë totale për sektorin privat dhe kreditë e dhëna në lekë (për periudhën 2004-2006), duke gjetur lidhje pozitive të ndryshores së varur me kursin nominal efektiv të këmbimit, PBB, likuiditetin e sektorit bankar dhe termin e bashkëveprimit midis treguesve të politikës monetare dhe likuiditetit (megjithëse dy faktorët e fundit rezultuan statistikisht të parëndësishëm).

Në sistemin bankar, zakonisht përdoret raporti i kredive ndaj depozitave si tregues i likuiditetit për sistemin, pasi paraqet pjesën e depozitave të investuara në kredi. Një vlerë e lartë e raportit tregon pamundësi të bankave për financime të mëtejshme në kredi ndërkohë që një vlerë shumë e ulët tregon një shkallë të ulët financimi si rrjedhim edhe fitime jo të mjaftueshme për bankat. Sipas raporteve të bankës së Shqipërisë vlera e këtij raporti arriti kulmin me mbi 65% në vitin 2009, ndërsa në vitët e fundit kjo vlerë është ulur me rreth 10%.

5.2 Analiza e regresionit, korrelacioni ndërmjet variablave dhe testimi i hipotezave.

Kjo çështje fokusohet në analizën e hipotezave që rrjedhin nga teoria e trajtuar gjerësisht në pjesën e parë të këtij punimi, duke evidentuar variablat të cilat bëjnë të mundur testimin e hipotezave. Ky punim do të analizojë impaktin e pesë rreziqeve kryesore financiare (rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit, rreziku i normës së intersit, rreziku i kursit të këmbimit dhe rreziku operacional) mbi përfitueshmërinë (ROE) e bankave tregtare në Shqipëri. Të dhënat dytësore që do të testohen, janë të marra nga pasqyrat kryesore financiare të bankave tregtare në Shqipëri, gjatë periudhës 2006-2015. Më pas këto të dhëna janë përpunur për llogaritjen e treguesve financiarë që përbëjnë variablat e modelit. Fillimisht është menduar që për të realizuar një

analizë më gjithëpërfshirëse të merren në konsideratë të pestë rreziqet kryesore financiare të përmendura më lart. Në funksion të vërtetimit të hipotezave, më poshtë paraqiten të gjitha testet e realizuara mbi variablat e marra në studim nepërmjet programi statistikor EViews6.

1- Testet e stacionaritetit për seritë kohore.

Para se të ndërtohet analiza e regresionit linear të shumëfishtë, duhet të bëhet *Testi i Stacionaritetit* për të gjitha variablat e marra në studim (ROE, rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit, rreziku i normës së interesit, rreziku i kursit të këmbimit dhe rreziku operacional). Ky test tregon qëndrueshmërinë e të dhënave për secilin variabël. Për të vërtetuar hipotezat e ngritura, në analizën e regresionit futen vetëm ato variabla të cilat gjatë testimit dalin stacionare. Për të identifikuar stacionaritetin e serive kohore procedojmë me testin *Augmented Dickey-Fuller* të paraqitur më poshtë.

Hipotezat:

H_0 : Seria kohore ka një rrënjë njësi (ose nuk është stacionare).

H_a : Seria kohore është stacionare.

Rregulli i vendimit :

- Nëse **Probabiliteti** ≤ 0.05 , hipoteza bazë bie poshtë dhe pranojmë hipotezën alternative.
- Nëse **Probabiliteti** > 0.05 , hipoteza bazë nuk hidhet poshtë.

Më poshtë paraqiten testet e stacionaritetit për variablat e marra në studim:

• Testi i stacionaritetit për serinë kohore ROE (Kthimi nga Kapitali Aksioner).

H_0 : Seria ROE ka një rrënjë njësi (ose nuk është stacionare).

H_a : Seria ROE është stacionare.

Testi: Augmented Dickey-Fuller.

Kriteri për të marrë vendimin:

Nëse $p \leq 0.05$ atëherë hipoteza bazë bie poshtë dhe pranojmë hipotezën alternative.

Nëse $p > 0.05$ atëherë hipoteza bazë nuk hidhet poshtë.

Në rastin konkret, $p = 0.0137$, pra më i vogël se 0.05, (Tabela Nr. 6). Kjo do të thotë që hidhet poshtë hipoteza bazë dhe pranohet hipoteza alternative.

Rezultati: Seria kohore ROE është stacionare në nivel.

- **Testi istacionaritetit për serinë kohore RK (Rreziku i Kredisë).**

H_0 : Seria RK ka një rrënjë njësi (ose nuk është stacionare).

H_a : Seria RK është stacionare.

Testi: Augmented Dickey-Fuller.

Kriteri për të marrë vendimin:

Nëse $p \leq 0.05$ atëherë hipoteza bazë bie poshtë dhe pranojmë hipotezën alternative.

Nëse $p > 0.05$ atëherë hipoteza bazë nuk hidhet poshtë.

Në rastin konkret, $p = 0.0021$, pra më i vogël se 0.05, (Tabela Nr. 6). Kjo do të thotë që hidhet poshtë hipoteza bazë dhe pranohet hipoteza alternative.

Rezultati: Seria kohore RK është stacionare në nivel.

- **Testi i stacionaritetit për serinë kohore RL (Rreziku i Likuiditetit).**

H_0 : Seria RL ka një rrënjë njësi (ose nuk është stacionare).

H_a : Seria RL është stacionare.

Testi: Augmented Dickey-Fuller.

Kriteri për të marrë vendimin:

Nëse $p \leq 0.05$ atëherë hipoteza bazë bie poshtë dhe pranojmë hipotezën alternative.

Nëse $p > 0.05$ atëherë hipoteza bazë nuk hidhet poshtë.

Në rastin konkret, $p = 0.0402$, pra më i vogël se 0.05 (Tabela Nr. 6). Kjo do të thotë që hidhet poshtë hipoteza bazë dhe pranohet hipoteza alternative.

Rezultati: Seria kohore RL është stacionare në nivel.

- **Testi i stacionaritetit për serinë kohore RNI (Rreziku i Normës së Interesit).**

H_0 : Seria RNI ka një rrënjë njësi (ose nuk është stacionare).

H_a : Seria RNI është stacionare.

Testi: Augmented Dickey-Fuller.

Kriteri për të marrë vendimin:

Nëse $p \leq 0.05$ atëherë hipoteza bazë bie poshtë dhe pranojmë hipotezën alternative.

Nëse $p > 0.05$ atëherë hipoteza bazë nuk hidhet dot poshtë.

Në rastin konkret, $p = 0.0143$, pra më i vogël se 0.05, (Tabela Nr. 6). Kjo do të thotë që hidhet poshtë hipoteza bazë dhe pranohet hipoteza alternative.

Rezultati: Seria kohore RNI është stacionare në nivel.

- **Testi i stacionaritetit për serinë kohore RO (Rreziku Operacional).**

H_0 : Seria RO ka një rrënjë njësi (ose nuk është stacionare).

H_a : Seria RO është stacionare.

Testi: Augmented Dickey-Fuller.

Kriteri për të marrë vendimin:

Nëse $p \leq 0.05$ atëherë hipoteza bazë bie poshtë dhe pranojmë hipotezën alternative

Nëse $p > 0.05$ atëherë hipoteza bazë nuk hidhet dot poshtë

Në rastin konkret, $p = 0.8693$, pra më i madhe se 0.05, (Tabela Nr. 6). Kjo do të thotë që hipoteza bazë nuk hidhet poshtë.

Rezultati: Seria kohore RO nuk është stacionare në nivel.

- **Testi i stacionaritetit për serinë kohore RKK (Rreziku i Kursit të Këmbimit).**

H_0 : Seria RKK ka një rrënjë njësi (ose nuk është stacionare).

H_a : Seria RKK është stacionare

Testi: Augmented Dickey-Fuller

Kriteri për të marrë vendimin:

Nëse $p \leq 0.05$ atëherë hipoteza bazë bie poshtë dhe pranojmë hipotezën alternative.

Nëse $p > 0.05$ atëherë hipoteza bazë nuk hidhet dot poshtë.

Në rastin konkret, $p = 0.7824$, pra më i madhe se 0.05, (Tabela Nr. 6). Kjo do të thotë që hipoteza bazë nuk hidhet poshtë.

Rezultati: Seria kohore RKK nuk është stacionare në nivel.

Pasi u bënë testet e stacionaritetit për të gjithë variablat, u pa që stacionare dolën këto variabla: Përfitueshmëria (ROE), Rreziku i Kredisë (RK), Rreziku i Likuiditetit (RL) dhe Rreziku i Normës së Interesit (RNI). Nisur nga ky rezultati, në analizën e regresionit linear të shumëfishtë që do të shqyrtohet më poshtë, përjashtohen dy variabla të pavarura, Rreziku Operacional (RO) dhe Rreziku i Kursit të Këmbimit (RKK), pasi këto dy variabla nuk dalin stacionare gjatë testimit. Pavarësisht këtij rezultati, analiza ekonometrike dhe vërtetimi i hipotezave nuk kompromentohet, pasi edhe rishikimi i literatures tregon se këto dy rreziqe nuk kanë patur impakt të madh mbi përfitueshmërinë e bankave tregtare.

Tabela Nr. 6 – Përmbledhje e rezultateve të testit të stacionaritetit

Variablat	t-statistic	Probabiliteti	Rezultati
ROE	-3.486271	0.0137	Stacionare
RK	-4.194065	0.0021	Stacionare
RL	-3.038987	0.0402	Stacionare
RNI	-3.468110	0.0143	Stacionare
RO	-0.552450	0.8693	Jo stacionare
RKK	-0.885276	0.7824	Jo stacionare

Burimi: Autori (2017).

2- Analiza e regresionit linear të shumëfishtë.

Pas testit të stacionaritetit në lidhje me variablat e marra në studim është momenti të ndërtohet analiza e regresionit linear të shumëfishtë, në funksion të vërtetimit të hipotezave të ngritura në fillim të studimit. Ekuacioni i cili lidh vlerën mesatare të **y-it** me ndryshoret e pavarura $x_1, \dots, x_k$, quhet ekuacioni i regresionit linear të shumëfishtë dhe ka trajtën:

$$y = \beta_0 + \beta_1 x_1 + \beta_2 x_2 + \dots + \beta_k x_k + u$$

➤ **$ROE = \beta_0 + \beta_1 RK + \beta_2 RL + \beta_3 RNI + \beta_4 RO + \beta_5 RKK + ui$** , (Ekuacioni para testit të stacionaritetit).

➤ **$ROE = \beta_0 + \beta_1 RK + \beta_2 RL + \beta_3 RNI + ui$** (Ekuacioni pas testit të stacionaritetit).

Rikujtojmë edhe njëherë pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë, të cilave do t'u japet përgjigje nëpërmjet analizës së regresionit:

Pyetjet kërkimore:

1. Si ndikon rreziku i kredisë në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri ?
2. A ndikon negativisht likuiditeti i tepërt në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri?

Hipotezat bazë:

1. Ndër rreziqet financiare, rreziku i kredise ka ndikimin më të madh në përfitueshmërinë (ROE) e bankave tregtare në Shqipëri.
2. Likuiditeti i tepërt ndikon negativisht në përfitueshmërinë (ROE) e bankave tregtare në Shqipëri.

Më poshtë paraqitet ekuacioni i vlerësuar me testet përkatëse (testi i rëndësisë tërësore dhe individuale):

Ekuacioni i vlerësuar: $\hat{y} = b_0 + b_1x_1 + \dots + b_kx_k$

ROE = 14.01315 - 1.093620**RK** - 0.300790**RNI** - 0.819490**RL**

• **Testi i rëndësisë tërësore.**

Ky test realizohet për të parë rëndësinë e modelit në tërësi.

$$H_0: \beta_1 = \beta_2 = \beta_3 = 0$$

H_a : Të paktën njëri nga parametrat është i ndryshëm nga zero.

Testi: Least Squares.

Kriteri për të marrë vendimin:

Nëse $p \leq 0.05$ atëherë hipoteza bazë bie poshtë dhe pranojmë hipotezën alternative.

Nëse $p > 0.05$ atëherë hipoteza bazë nuk hidhet dot poshtë.

Në rastin konkret, $p = 0.003458$, pra më i vogël se 0.05, (Tabela Nr. 8). Kjo do të thotë që hipoteza bazë hidhet poshtë dhe pranohet hipoteza alternative.

Rezultati: Modeli është statistikisht i rëndësishëm.

- **Testi i rëndësisë individuale.**

Ky test realizohet për të parë rëndësinë e secilit variabël të pavarur në model.

Rreziku i Kredisë (RK).

$$H_0: \beta_1 = 0$$

$H_a: \beta_1$ i ndryshëm nga zero.

Testi: Least Squares.

Kriteri për të marrë vendimin:

Nëse $p \leq 0.05$ atëherë hipoteza bazë bie poshtë dhe pranojmë hipotezën alternative.

Nëse $p > 0.05$ atëherë hipoteza bazë nuk hidhet dot poshtë.

Në rastin konkret, $p = 0.0158$, pra më i vogël se 0.05, (Tabela Nr. 7). Kjo do të thotë që hipoteza bazë bie poshtë dhe pranohet hipoteza alternative.

Rezultati: Rreziku i kredisë (RK) është variabël statistikisht i rëndësishëm.

Rreziku i Normës së Interesit (RNI).

$$H_0: \beta_2 = 0$$

$H_a: \beta_2$ i ndryshëm nga zero.

Testi: Least Squares.

Kriteri për të marrë vendimin:

Nëse $p \leq 0.05$ atëherë hipoteza bazë bie poshtë dhe pranojmë hipotezën alternative.

Nëse $p > 0.05$ atëherë hipoteza bazë nuk hidhet dot poshtë.

Në rastin konkret, $p = 0.5891$, pra më e madhe se 0.05, (Tabela Nr. 7). Kjo do të thotë që hipoteza bazë nuk hidhet poshtë.

Rezultati: Rreziku i normës së interesit (RNI) është variabël statistikisht i

parëndësishëm.

Rreziku i Likuiditetit (RL).

$$H_0: \beta_3 = 0$$

$H_a: \beta_3$ i ndyshëm nga zero.

Testi: Least Squares.

Kriteri për të marrë vendimin:

Nëse $p \leq 0.05$ atëherë hipoteza bazë bie poshtë dhe pranojmë hipotezën alternative.

Nëse $p > 0.05$ atëherë hipoteza bazë nuk hidhet dot poshtë.

Në rastin konkret, $p = 0.0445$, pra më i vogël se 0.05, (Tabela Nr. 7). Kjo do të thotë që hipoteza bazë hidhet poshtë dhe pranohet hipoteza alternative.

Rezultati: Rreziku i Likuiditetit (RL) është variabël statistikisht i rëndësishëm.

- **Interpretimi i modelit.**

$$ROE = 14.01315 - 1.093620RK - 0.300790RNI - 0.819490RL$$

Bazuar në analizën e mësipërme, arrijmë në përfundimin se modeli ekziston në tërësi dhe është statistikisht i rëndësishëm, pasi F-statistic, e cila është masa e rëndësisë së përbashkët të variablave shpjeguese, është statistikisht e rëndësishme në nivelin 5%, sipas vlerës korresponduese të probabilitetit 0.003458. Gjithashtu rezultatet tregojnë se rreziku i kredisë, rrezikut i likuiditetit dhe konstantja janë statistikisht të rëndësishëm. Rreziku i kredisë (-1.093620RK) është statistikisht i rëndësishëm në nivelin 5% me probabilitet 0.0158, duke nënkuptuar një lidhje të zhdrejtë (negative) me përfitueshmërinë (ROE). Kjo do të thotë që, nëse i mbajmë konstant të gjithë variablat e tjerë, një rritje me një njësi në variablin RK do të çojë në uljen e variablit ROE me 1.093620 njësi.

Po ashtu, rrezikut i likuiditetit (-0.819490 $\mathbf{RL}$) është statistikisht i rëndësishëm në nivelin 5% me probabilitet 0.0445, duke nënkuptuar një lidhje të zhdrejtë (negative) me përfitueshmërinë (ROE). Kjo do të thotë që nëse i mbajmë konstant të gjithë variablat e tjerë, një rritje me një njesi në variablin $\mathbf{RL}$ do të çojë në uljen e variablit $\mathbf{ROE}$ me 0.819490 njësi. Ndërsa rreziku i normës së interesit (-0.300790 $\mathbf{RNI}$) nuk është statistikisht i rëndësishëm në nivelin 5 %, pasi rezulton të ketë një probabilitet prej 0.5891, (Tabela Nr. 7).

$Adjusted R^2 = 0.406045$ (40,60%), kjo nënkupton që 40,60% e ndryshimit të përgjithshëm të përfitueshmërisë (ROE) shpjegohet nga variablat e pavarura të ekuacionit të regresionit, (Tabela Nr. 8).

Tabela Nr. 7 – Përmbledhje e rezultateve të testit të rëndësisë individuale

Model	Koeficienti Beta	Std. Error	t-statistic	Probabiliteti	Rezultati
1					
Konstante	14.01315	3.454602	4.056373	0.0003	---
RK (Rreziku i Kredisë)	-1.093620	0.774848	-1.411405	0.0158	Rreziku i kredisë (RK) është variabël statistikisht i rëndësishëm.
RNI (Rreziku i Normës së Interesit)	-0.300790	0.551881	-0.545027	0.5891	Rreziku i normës së interesit (RNI) është variabël statistikisht i parëndësishëm.
RL (Rreziku i Likuiditetit)	-0.819490	0.478582	-1.712338	0.0445	Rreziku i likuiditetit (RK) është variabël statistikisht i rëndësishëm.

Burimi: Autori (2017).

Tabela Nr. 8 – Përmbledhje e rezultateve të testit të rëndësisë tërësore dhe shpjegueshmërisë së ROE

Model	R-squared	Adjusted R-squared	F-statistic	Prob(F-statistic)
1	0.451734	0.406045	5.435130	0.003458
Rezultati		Adjusted R2 = 0.406045 (40,60%). 40,60% e ndryshimit të përgjithshëm të përfitueshmërisë (ROE) shpjegohet nga variablat e pavarura të ekuacionit të regresionit.		Modeli është statistikisht i rëndësishëm.

Burimi: Autori (2017).

3- Supozimet e modelit.

Pas ndërtimit të analizës së regresionit linear të shmëfishtë, është e rëndësishme të bëhen testet mbi supozimet e modelit, të paraqitura si më poshtë:

a) *Testimi mbi normalitetin e shpërndarjes së mbetjes / testi Jarque Bera.* Ky test siguron formën klasike të shpërndarjes normale, në mënyrë që të mos kemi gabime në vlerësuesit tanë. Testi *Jarque Bera* i paraqitur më poshtë, tregon nëse shpërndarja e mbetjeve në tërësi është normale apo jo.

- **Supozimi për shpërndarjen normale të mbetjeve.**

H_0 : Ndryshorja e rastit ε ka shpërndarje normale.

H_a : Ndryshorja e rastit ε nuk ka shpërndarje normale.

Testi: Jarque-Bera.

Kriteri për të marrë vendimin:

Nëse $p \leq 0.05$ atëherë hipoteza bazë bie poshtë dhe pranojmë hipotezën alternative.

Nëse $p > 0.05$ atëherë hipoteza bazë nuk hidhet poshtë.

Në rastin konkret, $p = 0.05765$, pra më e madhe se 0.05, (Tabela Nr. 9). Kjo do të thotë që hipoteza bazë nuk hidhet poshtë.

Rezultati: Ndryshorja e rastit ε ka shpërndarje normale.

b) *Testi për korrelacionin e rendeve të larta ose ndryshe testi i multikolinearitetit* realizohet për të parë nëse ekzistojnë lidhje të forta apo korrelacione midis variablave shpjeguese apo të pavarura. Në rast se ekzistojnë lidhje të tilla, duhet vepruar për eliminimin e tyre në mënyrë që të përftohet një model sa më i mirë. Prania e multikolinearitetit falsifikon parametrat β , duke bërë që të mos kuptohet nga buron ndikueshmëria $x-y$. Për të identifikuar korrelacionet midis variablave na vjen në ndihmë testi *Breusch-Godfrey* i paraqitur si më poshtë:

- **Supozimi për korrelacionin e rendeve të larta.**

H_0 : Mungon korrelacioni i rendeve të larta për ndryshoren e rastit ε .

H_a : Ka korrelacion të rendeve të larta për ndryshoren e rastit ε .

Testi: Breusch-Godfrey për korrelacionin e rendeve të larta.

Kriteri për të marrë vendimin:

Nëse $p \leq 0.05$ atëherë hipoteza bazë bie poshtë dhe pranojmë hipotezën alternative.

Nëse $p > 0.05$ atëherë hipoteza bazë nuk hidhet poshtë.

Në rastin konkret, $p = 0.6999$, pra më i madhe se 0.05, (Tabela Nr. 9). Kjo do të thotë që hipoteza bazë nuk hidhet poshtë.

Rezultati: Mungon korrelacioni i rendeve të larta për ndryshoren e rastit ε .

c) *Testi i homoskedasticitetit* realizohet për të parë barazinë e variancave të mbetjeve, pra shpërndarjen e njëjtë të mbetjeve (homo = e njëjtë & skedasticitet = shpërndarje). Variancë e njëjtë do të thotë që, mbetjet janë të shpërndara në mënyrë uniforme. Për të identifikuar homoskedasticitetin procedojmë me testin *Breusch-Pagan-Godfrey*, paraqitur si më poshtë:

- **Supozimi për homoskedasticitetin.**

H_0 : Ndryshorja e rastit ε ka variancë të njëjtë për çdo vlerë të ndryshores së pavarur (Homoskedasticiteti).

H_a : Ndryshorja e rastit ε nuk ka variancë të njëjtë për çdo vlerë të ndryshores së pavarur (Heteroskedasticiteti).

Testi: Breusch-Pagan-Godfrey.

Kriteri për të marrë vendimin:

Nëse $p \leq 0.05$ atëherë hipoteza bazë bie poshtë dhe pranojmë hipotezën alternative.

Nëse $p > 0.05$ atëherë hipoteza bazë nuk hidhet poshtë.

Në rastin konkret, $p = 0.3050$, pra më e madhe se 0.05, (Tabela Nr. 9). Kjo do të thotë që hipoteza bazë nuk hidhet poshtë.

Rezultati: Ndryshorja e rastit ε ka variancë të njëjtë për çdo vlerë të ndryshores së pavarur (Homoskedasticiteti).

d) *Testi për përshtatshmërinë e formës funksionale*. Ky test realizohet për të parë nëse forma funksionale lineare e zgjedhur është e përshtatshme për këtë studim. Testi i cili përdoret në këtë rast quhet *Ramsey RESET test* dhe paraqitet si më poshtë:

- **Supozimi për përshtatshmërinë e formës funksionale.**

H_0 : Forma funksionale lineare e zgjedhur është e përshtatshme.

H_a : Forma funksionale lineare e zgjedhur nuk është e përshtatshme.

Testi: Ramsey RESET test.

Kriteri për të marrë vendimin:

Nëse $p \leq 0.05$ atëherë hipoteza bazë bie poshtë dhe pranojmë hipotezën alternative.

Nëse $p > 0.05$ atëherë hipoteza bazë nuk hidhet poshtë.

Në rastin konkret, $p = 0.2957$, pra më e madhe se 0.05, (Tabela Nr. 9). Kjo do të thotë që hipoteza bazë nuk hidhet poshtë.

Rezultati: Forma funksionale lineare e zgjedhur është e përshtatshme.

Tabela Nr. 9 – Përmbledhje e rezultateve të supozimeve të modelit

Supozimet e Modelit	Probabiliteti	Rezultati
Supozimi për shpërndarjen normale të mbetjeve.	0.05763	Ndryshorja e rastit ε ka shpërndarje normale.
Supozimi për korrelacionin e rendeve të larta	0.6999	Mungon korrelacioni i rendeve të larta për ndryshoren e rastit ε .
Supozimi për homoskedasticitetin.	0.3050	Ndryshorja e rastit ε ka variancë të njëjtë për çdo vlerë të ndryshores së pavarur (Homoskedasticiteti).
Supozimi për përshtatshmërinë e formës funksionale.	0.2957	Forma funksionale lineare e zgjedhur është e përshtatshme.

Burimi: Autori (2017).

5.3 Përmbledhje e kapitullit.

Në këtë kapitull u diskutua rreth rezultateve empirike të marrdhënies ndërmjet rreziqeve financiare dhe përfitueshmërisë (ROE) së bankave tregtare në Shqipëri, gjatë periudhës 2006-2015. Me rezultatet e ekuacionit të regresionit linear të shumëfishtë, u bë i mundur vërtetimi hipotezave të ngritura që në fillim të këtij studimi. Pjesa e parë kapitullit dha një informacion të përgjithshëm lidhur me rreziqet financiare në bankat tregtare shqiptare si dhe rregulloret e Bankës së Shqipërisë për secilin rrezik. Ndërsa në pjesën e dytë të këtij kapitulli u analizua më në detaje lidhja ndërmjet përfitueshmërisë (si variabël i varur) dhe rreziqeve kryesore financiare (si variabla të pavarura).

KAPITULLI VI: DISKUTIME, KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

6.1 Konkluzionet e studimit.

1. Konkluzione të përgjithshme të literaturës.

- Sipas literaturës së marrë në studim, rreziku i kredisë është faktori kryesor për nga rëndësia dhe madhësia i humbjeve që i shkakton bankës. Ky rrezik përcaktohet thjesht si mundësia që një huamarrës i një banke do të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të tij ndaj bankës sipas kushteve të përcaktuara në kontratë midis dy palëve (Greuning & Bratanovic, 2009).
- Sipas literaturës, ekspozimi i tepërt i bankave tregtare ndaj rrezikut të normës së interesit mund të përbëjë një kërcënim të madh për fitimet e bankës. Ndryshimet në normat e interesit mund të kenë efekte negative si në të ardhurat e një banke ashtu edhe në vlerën e saj ekonomike. Prandaj, një proces efektiv në menaxhimin e rrezikut të normës së interesit brenda niveleve të duhura është thelbësor për sigurinë dhe vazhdimësinë e bankave. (Jacque, 1996).
- Rreziku i likuiditetit tregon momentin kur një bankë nuk mund të përmbushë një kërkesë për para ose të financojë detyrimet e saj. Sipas literaturës të marrë në studim, në tregjet e sotme, rreziku i likuiditetit paraqet sfida të caktuara nga pikëpamja konceptuale dhe matëse, pasi bankat kanë pësuar humbje nga menaxhimi jo i mirë i këtij rreziku (Bervas, 2006).
- Literatura tregon që rreziku operacional nuk është një koncept i ri. Deri më tani ky rrezik nuk ka marrë aq shumë vëmendje sa rreziku i kredisë, për shkak se ky i fundit

ka një impakt shumë më të madh në përfitueshmërinë e bankave tregtare. Ndryshimet themelore në tregjet e financave, rritja e globalizimit dhe liberalizimi, si dhe ristrukturimi i korporatave, patën një ndikim të konsiderueshëm në madhësinë dhe natyrën e rreziqeve operationale të bankave tregtare (Helbok & Wagner, 2006).

- Një përkufizim i zakonshëm i rrezikut të kursit të këmbimit lidhet me efektin e ndryshimeve të papritura të kursit të këmbimit në bilancin e firmës. Ky rrezik ka luajtur një rol të rëndësishëm në të ardhurat e bankave tregtare gjatë periudhave të ndryshme, prandaj duhet ti kushtohet një vëmendje e veçantë menaxhimit me sukses të këtij rreziku (Madura, 1989).
- Si përfundim mund të thuhet se rreziku i kredisë është indikator kryesor financiar i cili ka ndikuar më shumë në përfitueshmërinë e bankave tregtare kundrejt rreziqeve tjera financiare.
- Sipas Raportit Vjetor të Mbikqyrjes të Bankës së Shqipërisë (2014), rreziku i kredisë përbën 44% të rreziqeve financiare në sistemin bankar shqiptar. Gjatë vitit 2014 bankat tregtare ulën ritmin e dhënies së kredisë, duke shtreguar kushtet e kreditimit në mënyrë që ti shmangeshin rrezikut të kredisë. Banka e Shqipërisë gjatë kësaj periudhe orientoi bankat tregtare, në mënyrë që ata të shisnin kreditë dhe të menaxhonin me sukses portofolet e tyre, politikë e cila ndikoi pozitivisht në uljen e nivelit të kredive me probleme në banka.
- Raportet Vjetore të Mbikqyrjes të Bankës së Shqipërisë tregojnë një gjendje të kënaqshme të likuiditetit në bankat tregtare, duke paraqitur kështu një ekspozim relativisht të ulët ndaj këtij rreziku. Treguesit e likuiditetit qëndruan përtej normave të parashikuara nga aktet rregullative në fuqi të Bankës së Shqipërisë. Por nga ana

tjetër likuiditeti i tepërt ndikoi negativisht, duke ulur përfitueshmërinë në bankat tregtare si pasojë e mosdhënies kredi të këtij likuiditeti.

- Rrezik tjetër i cili duhet të merret në konsideratë nga bankat tregtare është rreziku i tregut. Banka e Shqipërisë, sipas një vlerësimi analizon se ekspozimi i bankave ndaj rrezikut të kursit të këmbimit dhe rrezikut të normës së interesit ka qënë i ulët. Vlera e ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit matet si diferencë midis aktiveve dhe pasiveve të ndjeshme ndaj normës së interesit, e ndarë sipas shportave të riçimitit. Sipas Bankës së Shqipërisë, diferenca e matur qëndron në nivelin 7-8% të totalit të aktiveve, e cila tregon një ekspozim të vogël të bankave ndaj këtij rreziku.
 - Sipas Bankës së Shqipërisë, rreziku operacional është një faktor i cili duhet të merret në konsideratë nga bankat tregtare, pavarësisht se impakti i tij mbi përfitueshmërinë ka qënë i vogël. Cilësia e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit që përdorin bankat, përbën një faktor të rëndësishëm në vlerësimin e këtij rreziku. Sipas Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2014, bankat tregtare përmirësuan programet bazë bankare duke futur versione bashkëkohore, gjë e cila ndikoi në menaxhimin me sukses të rrezikut operacional.
2. Konkluzionet e analizës së regresionit linear të shumëfishtë.
- Ky studim analizoi ndikimin e rreziqeve financiare (rrezikun e kredisë, rrezikun e likuiditetit, rrezikun e normës së interesit, rrezikun operacional dhe rrezikun e kursit të këmbimit) mbi përfitueshmërinë (ROE) e bankave tregtare në Shqipëri gjatë periudhës 2006-2015. Për të analizuar marrëdhëniet midis këtyre variablave, të dhënat dytësore u mblodhën nga pasqyrat kryesore financiare të bankave tregtare shqiptare, publikuar nga Banka e Shqipërisë gjatë periudhës 2006-2015.

- ROE përdoret në analizë si tregues për të matur përfitueshmërinë e bankave tregtare, ndërsa rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit, rreziku i normës së interesit, rreziku operacional dhe rreziku i kursit të këmbimit si tregues të rrezikut financiar. Në kuadër të vërtetimit të hipotezave të punimit, analiza e regresionit linear të shumëfishtë u realizua nëpërmjet programit statistikor Eviews6.
- Gjatë testit të stacionaritetit për variablat e marra në studim, u pa që stacionare dolën vetëm: Përfitueshmëria (ROE), Rreziku i Kredisë (RK), Rreziku i Likuiditetit (RL) dhe Rreziku i Normës së Interesit (RNI). Nisur nga ky rezultat, në analizën e regresionit linear të shumëfishtë përjashtohen dy variablat e tjera të pavarura, Rreziku Operacional (RO) dhe Rreziku i Kursit të Këmbimit (RKK), pasi këto variabla dolën jostacionare gjatë testimit. Pavarësisht këtij rezultati, analiza ekonometrike dhe vërtetimi i hipotezave nuk kompromentohet, pasi edhe rishikimi i literaturës rezulton se këto dy rreziqe nuk është se kanë patur ndonjë impakt të madh mbi përfitueshmërinë e bankave tregtare.
- Bazuar në analizën e regresionit linear të shumëfishtë, arrihet në përfundimin se modeli ekziston në tërësi, pasi F-statistic e cila është edhe masa e rëndësisë së përbashkët të variablave shpjeguese, del statistikisht e rëndësishme në nivelin 5%, sipas vlerës korresponduese të probabilitetit **0.003458**.
- Rezultatet e analizës së regresionit tregojnë se korrelacioni midis rrezikut të kredisë dhe përfitueshmërisë (ROE) është statistikisht faktori më i rëndësishëm në nivelin 5% me një probabilitet prej **0.0158**, pasi koeficienti *Beta* i rrezikut të kredisë rezultoi **-1.093620**, që do të thotë se kemi një lidhje të zhdrejtë (negative) ndërmjet këtyre dy variablave. Kjo nënkupton që, nëse i mbajmë konstant të gjithë variablat e tjerë, një

rritje me një njësi në variablin Reziku i Kredisë (**RK**) do të çojë në uljen e variablilit **ROE** me **1.093620** njësi. Ky rezultat ekonometrik argumentohet me një sërë arsyes, të tilla si: dhënie e kredive që nuk i plotësojnë të gjitha kërkesat për një ecuri të mirë, duke përzgjedhur në këte mënyrë klientë jo të shëndetshëm financiarisht; niveli jo i duhur profesional i oficerëve të kredisë, të cilët duke u mjaftuar me plotësimin formal të kërkesave të vëna nga Banka e Shqipërisë, kryesisht të kolateralit dhe nivelit të të ardhurave, nuk janë në gjendje të njohin e të kuptojnë klientët; një sistem bankar relativisht i ri në dhënien e kredive, pasi teorikisht mendohet se kreditë fillojnë të shfaqin probleme afërsisht mbas 1/3 së kohës së jetëgjatësisë së tyre; situata e ekonomike e vendit tonë por edhe e rajonit që reflektohet në cilësinë e portofolit të kredive; dhënia e kredive pa kriter në vitin 2008.

- Rezultatet e analizës së regresionit tregojnë se korrelacioni midis rrezikut të likuiditetit dhe përfitueshmërisë (ROE) është statistikisht i rëndësishëm në nivelin 5% me një probabilitet prej **0.0445**. Koeficienti *Beta* i rrezikut të likuiditetit rezultoi - **0.819490**, pra kemi një lidhje të zhdrejtë (negative) ndërmjet këtyre dy variablave. Kjo nënkupton që, nëse i mbajmë konstant të gjithë variablat e tjerë, një rritje me një njësi në variablin Rreziku i Likuiditetit (**RK**) do të çojë në uljen e variablilit **ROE** me **0.819490** njësi. Ky rezultat ekonometrik argumentohet me faktin e një niveli të lartë të likuiditetit të mbajtur nga bankat tregtare, duke mos e investuar në asete dhe duke mos përfituar të ardhura nga këto investime.
- Rezultatet e analizës së regresionit tregojnë se korrelacioni midis rrezikut të normës së interesit dhe përfitueshmërisë (ROE) është statistikisht i parëndësishëm në nivelin 5% me një probabilitet prej **0.5891**. Ky rezultat ekonometrik argumentohet me faktin

se, pavarësisht se Banka e Shqipërisë pas vitit 2009 uli vazhdimisht normën bazë të interesit, nuk pati një efekt në dhënien e kredive duke mos sjellë të ardhura shtesë.

- Pavarësisht se rreziku i kursit të këmbimit nuk u analizua nga ana ekonometrike për shkak të paqëndrueshmërisë së këtij variabli (jostacionare), u pa e arsyeshme të realizohej një analizë cilësore, nga e cila rezultoi se ky indikator nuk pati ndonjë efekt në përfitueshmërinë e bankave tregtare si pasojë e qëndrueshmërisë së kursit të këmbimit gjatë viteve të marra në studim.
- Pavarësisht se rreziku operacional nuk u analizua nga ana ekonometrike për shkak të paqëndrueshmërisë së këtij variabli (jostacionare), u pa e arsyeshme të realizohej një analizë cilësore, nga e cila rezultoi se ky indikator ka patur një efekt negativ në përfitueshmërinë e bankave tregtare shqiptare, si pasojë e dështimeve nga sistemet, vjedhjeve dhe mashtimeve .
- $Adjusted R^2 = 0.406045$ (40,60%), kjo nënkupton që 40,60% e ndryshimit të përgjithshëm të përfitueshmërisë (ROE) shpjegohet nga variablat e pavarura të ekuacionit të regresionit.
- Referuar analizës së mësipërme arrihet në përfundimin se rreziku i kredisë ka patur impaktin më të madh në përfitueshmërinë (ROE) e bankave tregtare në Shqipëri gjatë periudhës 2006-2015, pra vërtetohet hipoteza e parë e ngritur në fillim të studimit.
- Gjithashtu referuar analizës së regresionit arrihet në përfundimin se likuiditeti i tepërt ka ndikuar negativisht në përfitueshmërinë (ROE) e bankave tregtare në Shqipëri gjatë periudhës 2006-2015, pra vërtetohet kështu edhe hipoteza e dytë e ngritur në fillim të studimit.

6.2 Rekomandimet përkatëse të studimit.

1. Duke qënë se rreziku i kredisë rezulton faktori kryesor me impaktin më të madh në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri, rekomandohet rritja e cilësisë së portofolit të kredive duke patur parasysh pikat e mëposhtme:
 - Portofoli i kredisë duhet të pasurohet me kredi të reja dhe të shëndosha, duke ndjekur një politikë më të pranishme në treg, por duke mos harruar prudencialitetin, pra çdo kredi e re e kaluar duhet t'i nënshtrohet kritereve të qarta dhe të sakta të dhënies. Pavarësisht situatave, procesi kreditues në banka nuk duhet frenuar.
 - Bankat tregtare duhet të rrisin iniciativën e dhënies së kredive në nivele më të ulta, pra marrja e përgjegjësisë së dhënies së kredive që në nivelin e oficerëve të kredisë dhe jo të gjitha llojet e kredive të kalojnë nga komiteti i kredive, pasi kjo krijon një shkëputje midis atij që analizon, mbledh të dhënat dhe ka kontakte direkte me huamarrësin dhe atij që e aprovon.
 - Banka e Shqipërisë duhet t'u kërkojë bankave tregtare të shpenzojnë më shumë për trajnimin e oficerëve të kredisë, duke rritur kështu numrin e trajnimeve në vit. Në ShBA bankat çdo vit, për 15-30 ditë, kryejnë trajnime për oficerët e kredisë, si për metodikat e kredidhënies, ashtu edhe për njohjen e legjislacionit. Oficerët tanë të kredisë janë aq shumë të ngarkuar me dosjet e tyre, sa shpesh nuk kanë kohë as të trajnohen dhe as të lexojnë e të njohin rregulloret e nxjerra nga Banka e Shqipërisë për kredidhënie. Trajnime të tilla rrisin nivelin profesional të oficerëve të kredisë, ndërsa një kosto e kursyer nga moszhvillimi i tyre kthehet në bumerang për shkak të një pune jo shumë cilësore që pritët të kryhet nga këta analistë.

- Vetë Banka e Shqipërisë duhet të organizojë herë pas herë kurse trajnuese për oficerët e kredisë, pavarësisht se para disa vitesh ka funksionuar një qendër trajnuese e cila jepte leksione për punonjësit e bankave mbi kredidhënien dhe shumë aspekte të tjera bankare.
- Banka e Shqipërisë duhet të shpeshtojë kontrollet tematike on-site për kredinë, në mënyrë që të diagnostikojë me hollësi problemet e çdo banke, duke penalizuar individualisht fajtorët.
- Bankat duhet ta menaxhojnë me shumë kujdes portofolin e tyre të kredisë, duke kryer kontrole sistematike pranë firmave nga oficerët e kredisë, të paktën një herë në vit. Këto kontrole shërbejnë për të njohur situatën e biznesit, në mënyrë që bankat të mund të marrin masa paraprake që kredia të shlyhet. Kjo mund të bëhet nëpërmjet ristrukturimit të kredive, aty ku mund të japë rezultat, për të mos e falimentuar një biznes apo kur nuk ka shpresë kthimi, duke bërë provigjionimin përkatës, dhe duke i paraprirë procedurave të ekzekutimit të kolateralit.
- Duhet përmirësuar e plotësuar manualët e kredidhënies nga bankat, në mënyrë që këto manuale të jenë një dokument i plotë për t'u ndjekur nga oficerët e kredisë, që të marrin parasysh përfshirjen në to edhe të produkteve të reja që bankat po aplikojnë, apo edhe të situatave konkrete që vendi ynë po kalon. Këto procedura të plota, do të parandalojnë dhënien e kredive me probleme.
- Bankat duhet të jenë shumë të kujdesshme në diversifikimin e portofolit të kredive. Ky portofol nuk duhet të përqendrohet vetëm në sektorë të veçantë të ekonomisë, si p.sh. në ndërtim. Prandaj bankat duhet të gjejnë sektorë sa më të larmishëm në dhënien e kredisë.
- Bankat duhet të jenë shumë rigorozë në vlerësimin e qëndrueshmërisë të punës së individëve që marrin kredi për shtëpi. Për punonjësit sezonalë apo me punë të paqëndrueshme, bankat duhet të jenë konservatorë në dhënien e kredisë.

2. Për të minimizuar rrezikun e likuiditetit, që vjen si pasojë e investimit në fusha jo fitimprurëse, si bonot e thesarit, bankat duhet të zhvillojnë procedura dhe politika të brendshme për periudha 2-3 vjeçare të cilat limitojnë investimin në zëra likuide dhe stimulojnë investimet në zëra të tjerë jo kaq likuidë po shumë më fitimprurës.
3. Pavarësisht se rreziku i normës së interesit nuk rezulton shumë i rëndësishëm nga analiza e regresionit të shumëfishtë, realisht ky indikator nuk është i tillë, prandaj Komiteti ALCO duhet të jetë më i fokusuar në vendosjen e normave optimale të interesit dhe mbylljen e GAP-eve të hapura, pasi sistemi bankar në Shqipëri njeh humbje të ndjeshme të shkaktuar nga Gap-et e hapura. (Viti 2001, lireta Italiane).
4. Bankat duhet të jenë shumë të vëmendshme në menaxhimin e rrezikut të kursit të këmbimit dhe për këtë arsye këto institucione duhet të kenë kujdes në mbajtjen e pozicioneve të hapura valutore në limite dhe më të vogla nga ato të Bankës së Shqipërisë në kushtet e këmbimit valutor aktual. Kjo për arsye se kohët e fundit është vënë re një luhatje e rëndësishme e kursit të këmbimit (Euro).
5. Për të menaxhuar me sukses rrezikun operacional dhe për të minimizuar humbjet e mëdha që shkaktohen nga ky fenomen sidomos i kohëve të fundit, bankat duhet të krijojnë struktura organizative, duke ndërtuar një departament të veçantë për menaxhimin e këtij rreziku dhe jo ta realizojnë këtë proces me një person të vetëm.

BIBLIOGRAFIA

Altman, E. I., & Saunders, A. (1997). Credit Risk Measurement: Developments over the Last Twenty Years. *Journal of Banking and Finance*.

Altunbas, Y., Gardener, E.P.M. & Molyneux, P. (2000). Cost economics and efficiency in EU banking systems. Strategic Challenges in Banking. London: MacMillan, pp. 8-31.

Saunders, A., & Cornett, M. M. (2008). Financial Institutions Management, A Risk Management Approach, Sixth Edition.

Apătăchioae, A. (2015). The performance, banking risks and their regulation. 7th International Conference on Globalization and Higher Education in Economics and Business Administration.

Arestis, P., Demetriades, P. O., & Luintel, K. L. (2001). Financial development and economic growth: the role of stock markets. *Journal of Money, Credit and Banking*.

Bervas, A. (2006). Market Liquidity and its incorporation into Risk Management.

Ball, R. (1978). Anomalies in relationships between securities' yields and yield-surrogates. *Journal of Financial Economics*.

Banerjee, S., & Banipal, K. (2005). Managing Operational Risk: Framework for Financial Institutions. Working paper, A.B Freeman School of Business, Tulane University.

Bank for International Settlements (1999). Credit Risk Modeling: Current Practices and Applications. Basel Committee on Banking Supervision, Document No 49.

Baker, M., Ruback, R., & Wurgler, J. (2004). Corporate Finance: A Survey. NBER Working Paper; No W10863.

Bank for International Settlements (2001). Principles for the Management and Supervision of Interest Rate Risk. Basel Committee on Banking Supervision.

Banka e Shqipërisë. Raportet Vjetore të Mbikqyrjes Financiare (2006-2015).

Banz, R. W. (1981). The relationship between return and market value of common stocks. *Journal of Financial Economics*.

Barlow, D. (1993). The Evolution of Risk Management. Risk Management.

Baron, D. P. (1979). The incentive problem and the design of investment banking contracts. *Journal of Banking and Finance* 3, pp. 157-175.

Baron, D. P. (1982). A model of the demand for investment banking advising and distribution services for new issues. *Journal of Finance*.

Barth, J. R., Nolle, D. E., & Rice, T. N. (1997). Commercial Banking Structure, Regulation, and Performance: An International Comparison, Washington: Comptroller of the Currency Economic Working Paper 97-6.

Basak, S., & Shapiro, A. (2001). Model of Credit Risk, Optimal Policies, and Asset Prices. Working Paper, New York University.

Basu, S. (1977). Investment performance of common stocks in relation to their price-earnings ratios: a test of the efficient market hypothesis. *Journal of Finance* .

Beck, T., Demirguc-Kunt, A., Levine, R., & Maksimovic, V. (2000). Financial Structure and Economic Development: Firm, Industry, and Country Evidence, Policy Research Working Paper 2423, Washington: World Bank.

Beck, T., & Levine, R. (2000). New Firm Formation and Industry Growth: Does Having a Market-or Bank-Based System Matter?, Policy Research Working Paper 2383, Washington: World Bank.

Belkin, B., Suchower, S. J., Wagner, D. H., & Forest, L. R. (1988). Measures of Credit Risk and Loan Value in LAS. KPMG Risk Strategy Practice.

Benhabib, J., & Spiegel, M. M. (2000). The role of financial development in growth and investment, *Journal of Economic Growth*.

Benston, G.J., & Smith Jr., C.W. (1976). A transactions cost approach to the theory of financial intermediation, *Journal of Finance*.

Bessis, J. (2002). Risk Management in Banking. Wiley. J., & Sons Ltd. Risk Management Guidelines for Commercial Banks & DFIs.

Bessis, J., (1998). Risk Management in Banking.

Bikker, J., Bos, J. (2008). Bank Performance, A Theoretical and Empirical Framework for the Analysis of Profitability, Competition and Efficiency, Routledge International Studies in Money and Banking, Taylor & Francis e-Library.

BIS (2008). Principles for sound liquidity risk management and supervision.

Black, F. (1972). Capital market equilibrium with restricted borrowing. *The Journal of Business*, 45.

Black, F., & Scholes, M. (1974). The Effects of dividend yield and dividend policy on common stock prices and returns. *Journal of Financial Economics*.

Bolocan, M. (2011). Performanța sistemului bancar din România. Impactul integrării europene.

Boyle, P., & Hardy, M., & Vorst, T. (2005). Life after VaR. *The Journal of Derivatives, Fall*.

Bozdo, J., & Kalluci, I. (2006). Credit risk and its management systems.

Breeden, D. T., Gibbons, M. R., & Litzenberger, R. H. (1989). Empirical test of the consumption-oriented CAPM. *Journal of Finance*.

Brennan, M. J. (1971). Capital market equilibrium with divergent borrowing and lending rates. *Journal of financial and Quantitative Analysis*.

Campbell, J. Y., Lo, A. W., & MacKinlay, A. C. (1997). *The Econometrics of Financial Markets*. Princeton, New Jersey: Princeton University Press.

Chan, L. C., Yasushi, H., & Josef, L. (1991). Fundamentals and stock returns in Japan. *Journal of Finance*.

Charreaux, G. (2005). Pour une gouvernance d'entreprise "comportementale": une réflexion exploratoire. *Revue Française de Gestion*; 31; pp. 215–238.

Lee, C., Lee, A., & Lee, J. (2010). *Handbook of Quantitative Finance and Risk Management*.

Crockford, G. N. (1982). The bibliography and history of risk management: Some preliminary observations. *Geneva Papers on Risk and Insurance*, 7(23), pp. 169–179.

Damodaran, A. (2007). *Strategic Risk Taking. A framework for risk management*.

De Bondt, W., & Thaler, R. (1994). *Financial Decision-Making in Markets and Firms: A Behavioral Perspective*. NBER Working Paper; No. W4777.

De Stefano, M. T. (1999). Basel Committee's New Capital Standards Could Strengthen Banking. *Standard & Poor's Credit Week*.

Dionne, G. (2013). *Risk Management: History, Definition and Critique*. Bibliotheque et Archives Canada.

Dowd, K., Wiley, J., & Sons (2005). *Measuring market risk*.

Duffie, D., & Pan, J. (1997). An Overview of value at Risk. Working Paper, Stanford University.

Dybvig, P. H., & Ross, S. A. (1985). Yes, the APT is testable. *Journal of Finance*.

Ehrlich, I., & Becker, G. S. (1972). Ehrlich and Becker.Pdf. *The Journal of Political Economy*, 80(4), pp. 623–648.

Richard, E., Chijoriga, M., & Peterson, C. (2008). Credit Risk Management System of a Commercial Bank in Tanzania. *International Journal of Emerging Markets*, Vol.3 No.3.

Fabozzi, F. J., Mann, S. V., & Choudhry, M. (2003). Measuring and controlling interest rate and credit risk. 2nd edition, New Jersey: John Wiley & Sons, Inc.

Fama, E. F. (1996). Multifactor portfolio efficiency and multifactor asset pricing. *Journal of Financial and Quantitative Analysis*.

Fama, E. F., & French, K. R. (1992). The Cross-section of expected stock returns. *Journal of Finance*.

Fontaine, Ch., Haarman, A., & Schmid S. (2006). The Stakeholder Theory.

Freixas, X., Parigi, B. M., & Rochet, J. C. (2000). Systemic risk, interbank relations, and liquidity provision by the central bank. *Journal of Money, Credit, and Banking* 32, pp. 611–638.

Froot, K., & Thaler, R. (1990) Anomalies: Foreign Exchange. *Journal of Economic*.

Furash, E. (1994). Organizing the Risk Management Process In Large Banks, Risk Management Planning Seminar, Federal Financial Institutions Examination Council, Washington, D.C.

Greuning Van H., & Bratanovic B. S. (2009). Analyzing banking risk-A Framework for assessing Corporate Governance and Risk Management.Washington: World Bank. pp.187-188.

Hakala, J., & Wystup, U. (2002). Foreign Exchange Risk: Models, Instruments, and Strategies, (London: Risk Publications).

Harrington, S., & Niehaus, G. (2004). Risk Management and Insurance.

Helbok, G., & Wagner, H. (2006). Determinants of operational risk reporting in the banking industry. *Journal of Risk*.

- Holton, G. A. (2003). Value-at-Risk: Theory and Practice, (San Diego, California: Academic Press).
- Hull, J. (2006). Options, Futures and Other Derivatives.
- Hull, J. (2012). Risk management and financial institutions.
- Hull, J. (2007). Risk Management and Financial Institutions.
- Ibrahimi, F. (2007). Gjendja e sistemit bankar dhe sfidat në të ardhmen, European Finance Convention, Tiranë.
- Imane, Y. (2014). Risk Management Practices and Financial Performance in Jordan: *Empirical Evidence from Islamic Banks*.
- J. P. Morgan (1997). CreditMetrics Technical Document, April.
- Jacque, L. (1996). Management and Control of Foreign Exchange Risk. Norwell, Massachusetts: Kluwer Academic Publishers.
- Jarrow, R., & Subramanian, A. (1997). Mopping up Liquidity, Risk.
- Bessis, J. (2001). Risk Management In Banking.
- Jones, D. (2000). Emerging Problems with the Basel Capital Accord: Regulatory Capital Arbitrage and Related Issues. *Journal of Banking and Finance*.
- Jorion, P. & Hill, M. (2007). Value at Risk: The New Benchmark for Managing Financial Risk.
- Jorion, P. (2007). Value at Risk: The New Benchmark for Managing Financial Risk, 3rd ed., New York: McGraw-Hill.
- King, J. L. (2000). Operational Risk, Measurement and Modelling, John Wiley & Sons, Ltd, Chichester.
- Kovner, A., Vickery, J., & Zhou, L. (2013). Do big banks have lower operating costs? New York Federal Reserve Bank. Mimeo.
- Kumar, R. (2014). Strategies of Banks and Other Financial Institutions: Theories and Cases.
- Kupiec, P. (1999). Stress testing in a Value at risk framework. *Journal of Derivatives*, pp.7-24.

Laeven, L., Ratnovski, L., & Tong, H. (2014). Bank size and systemic risk: some international evidence. International Monetary Fund. Mimeo.

Lawrence, C. & Robinson, G. (1995). Liquid Measures, Risk, 8, (7).

Likanen, E. (2012). The High-Level Expert Group on Reforming the Structure of the EU Banking Sector: Final Report.

Longin, F. M. (2001). Beyond the VaR, The Journal of Derivatives.

Lopez, J. A. (1999). Methods for Evaluating Value at Risk Estimates, Federal Reserve Bank of San Francisco Economic Review.

Markowitz, H. (1952). Portfolio selection. *Journal of Finance*.

Marnet, O. (2008). Behavior and Rationality in Corporate Governance. Routledge: Routledge Studies in Corporate Governance.

Marshall, C. L., (2001). Measuring and Managing Operational Risk in Financial Institutions, John Wiley & Sons, Singapore.

Merton, R. C. (1974). On the Pricing of Corporate Debt: The Risk Structure of Interest Rates. *Journal of Finance*.

Moscadelli, M. (2004). The modelling of operational risk: experience with the analysis of the data collected by the Basel Committee, Bank of Italy, Rome.

Mugenda, O. M, & Mugenda, A. G. (2003). Research Methods, Quantitative and Qualitative Approaches. ACT, Nairobi.

Mureti, S. (2012). Relationship between financial risk management and financial performance of commercial banks in Kenya: A research project submitted in partial fulfilment of the requirements for the award of the Degree of Master of Science in Finance, School of Business, University of Nairobi.

Nagy, A., & Solovăstru, A., (2013). Riscurile IOi performanțelor bancare, Studi Financiare.

Olteanu, A. (2003). Management bancar, Ed. Dareco, Bucureti.

Orion, P., Wiley, J. & Sons (2007). Financial Risk Manager Handbook, John Wiley & Sons, 2.

Patterson, J., Stephen M., & Pyle, D. H. (1997). Bank Risk Management: Theory. Research Program in Finance. Retrieved from Perspectives, Vol. 4 (3).

<http://haas.berkeley.edu/finance/P/rpflist.html>.

Sabrani, P. (2002). Risk Management by Banks in India”, IBA Bulletin.

Rregullore e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore”, Vendim Nr. 48, datë.14.07.2010.

https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Buletini_Zyrtar_Vellimi_12_nr_6_5796_1_7115.pdf

Rregullore e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut operacional”, Vendim, Nr. 03, datë 19.01.2011.

https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Rregullore_Per_administrimin_e_rrezikut_operacional_6063_1_6166.pdf

Rregullore e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”, Vendim Nr. 71 datë 14.10.2009.

<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2019/VENDIM%20I%20BSH%20nr.%2014,%20date%207.2.2018.pdf>

Rregullore e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, Vendim Nr. 62, datë 14.09.2011.

https://www.bankofalbania.org/Rreth_Bankes/Legjislacioni/Aktet_nenligjore/Rregullorja_Per_Administrimin_e_rrezikut_te_kredise nga bankat dhe deget e bankave te huaja.html

Rregullore e Bankës së Shqipërisë “Për kapitalin rregullator të bankës”, Vendim Nr.48, datë 31.07.2013.

https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Rregullorja_Per_Kapitalin_Rregullator_7222_1_6210.pdf

Rregullore e Bankës së Shqipërisë “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, Vendim Nr.69, datë 18.12.2014.

http://www.qbz.gov.al/Ligje.pdf/banka/Vendim_BSH%20nr_48_date%2031.07.2013_perditesuar.pdf

Saltzman, S. & Salinger, D. (1998). The ACCION CAMEL, Technical Note.

Snider, W. (1956). Reaching Professional Status: A Program for Risk Mangement in Corporate Risk Mangement: Current Problems and Perspectives. American Management Association.

Standard & Poor’s (2000). Credit Model, Standard & Poor’s, New York.

Stoica, O. (1999). Management bancar, Ed.Economică, Bucureti.

Sharpe, W. F. (1964). Capital asset prices: A theory of market equilibrium under conditions of risk. *Journal of Finance*.

Shimko D. (ed.) (1999). Credit Risk, Models and Management, Risk Books, London.

Terraza, V. (2012). The effect of bank size on risk ratios: Implications of banks' performance.

Udhëzimi i Bankës së Shqipërisë “Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës”, Vendim Nr. 33, datë 30.04. 2013.

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/104-2013.pdf

Van Den Brink, G. (2002). Operational risk. The new challenge for banks, Palgrave.

Varma, J. R., & Hill, M. (2008). Derivatives and Risk Management.

Wernz, J. (2014). Bank Management and Control Strategy, Capital and Risk Management.

ANEKSE

1- Testet e stacionaritetit:

Figura Nr. 5 - Testi i stacionaritetit për serinë ROE (Kthimi nga kapitali aksioner)

Null Hypothesis: ROE has a unit root

Exogenous: Constant

Lag Length: 0 (Automatic based on SIC, MAXLAG=9)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-3.486271	0.0137
Test critical values: 1% level	-3.610453	
5% level	-2.938987	
10% level	-2.607932	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation

Dependent Variable: D(ROE)

Method: Least Squares

Date: 11/08/17 Time: 14:09

Sample (adjusted): 2006Q2 2015Q4

Included observations: 39 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
ROE(-1)	-0.572052	0.164087	-3.486271	0.0013
C	1.482340	0.570996	2.596059	0.0134
R-squared	0.247265	Mean dependent var	-0.204904	
Adjusted R-squared	0.226921	S.D. dependent var	2.152131	
S.E. of regression	1.892260	Akaike info criterion	4.163341	
Sum squared resid	132.4839	Schwarz criterion	4.248652	
Log likelihood	-79.18515	Hannan-Quinn criter.	4.193950	
F-statistic	12.15408	Durbin-Watson stat	2.019361	
Prob(F-statistic)	0.001280			

Burimi : Autori (2017).

Figura Nr. 6 - Testi i stacionaritetit për serinë RK (Rreziku i Kredisë)

Null Hypothesis: RK has a unit root

Exogenous: Constant

Lag Length: 0 (Automatic based on SIC, MAXLAG=9)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-4.194065	0.0021
Test critical values: 1% level	-3.610453	
5% level	-2.938987	
10% level	-2.607932	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
 Dependent Variable: D(RK)
 Method: Least Squares
 Date: 11/08/17 Time: 14:10
 Sample (adjusted): 2006Q2 2015Q4
 Included observations: 39 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
RK(-1)	-0.124066	0.029581	-4.194065	0.0002
C	5.946123	1.330011	4.470731	0.0001
R-squared	0.322222	Mean dependent var		0.426210
Adjusted R-squared	0.303904	S.D. dependent var		1.434816
S.E. of regression	1.197101	Akaike info criterion		3.247602
Sum squared resid	53.02285	Schwarz criterion		3.332913
Log likelihood	-61.32825	Hannan-Quinn criter.		3.278211
F-statistic	17.59018	Durbin-Watson stat		1.750786
Prob(F-statistic)	0.000164			

Burimi : Autori (2017).

Figura Nr. 7 - Testi i stacionaritetit për serinë RL (Rreziku i Likuiditetit)

Null Hypothesis: RL has a unit root
 Exogenous: Constant
 Lag Length: 0 (Automatic based on SIC, MAXLAG=9)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-3.038987	0.0402
Test critical values:		
1% level	-3.610453	
5% level	-2.938987	
10% level	-2.607932	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
 Dependent Variable: D(RL)
 Method: Least Squares
 Date: 11/08/17 Time: 13:56
 Sample (adjusted): 2006Q2 2015Q4
 Included observations: 39 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
RL(-1)	-0.152035	0.051762	-2.937221	0.0057
C	1.327491	0.431224	3.078422	0.0039
R-squared	0.189081	Mean dependent var		0.068083
Adjusted R-squared	0.167165	S.D. dependent var		0.314046
S.E. of regression	0.286598	Akaike info criterion		0.388449

Sum squared resid	3.039125	Schwarz criterion	0.473760
Log likelihood	-5.574762	Hannan-Quinn criter.	0.419058
F-statistic	8.627268	Durbin-Watson stat	1.899625
Prob(F-statistic)	0.005669		

Burimi : Autori (2017).

Figura Nr. 8 - Testi i stacionaritetit për serinë RNI (Rreziku i Normës së Interesit)

Null Hypothesis: RNI has a unit root

Exogenous: Constant

Lag Length: 0 (Automatic based on SIC, MAXLAG=9)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-3.468110	0.0143
Test critical values:		
1% level	-3.610453	
5% level	-2.938987	
10% level	-2.607932	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation

Dependent Variable: D(RNI)

Method: Least Squares

Date: 11/08/17 Time: 14:11

Sample (adjusted): 2006Q2 2015Q4

Included observations: 39 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
RNI(-1)	-0.497554	0.143465	-3.468110	0.0013
C	1.742394	0.509930	3.416925	0.0016
R-squared	0.245326	Mean dependent var		-0.007496
Adjusted R-squared	0.224929	S.D. dependent var		0.523298
S.E. of regression	0.460702	Akaike info criterion		1.337788
Sum squared resid	7.853103	Schwarz criterion		1.423099
Log likelihood	-24.08687	Hannan-Quinn criter.		1.368397
F-statistic	12.02779	Durbin-Watson stat		1.925831
Prob(F-statistic)	0.001346			

Burimi : Autori (2017).

Figura Nr. 9 - Testi i stacionaritetit për serinë RO (Rreziku Operacional)

Null Hypothesis: RO has a unit root

Exogenous: Constant

Lag Length: 1 (Automatic based on SIC, MAXLAG=9)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-0.552450	0.8693

Anekse

Test critical values:	1% level	-3.615588
	5% level	-2.941145
	10% level	-2.609066

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
 Dependent Variable: D(RO)
 Method: Least Squares
 Date: 11/14/17 Time: 17:44
 Sample (adjusted): 2006Q3 2015Q4
 Included observations: 38 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
RO(-1)	-0.070236	0.127135	-0.552450	0.5842
D(RO(-1))	-0.827865	0.136930	-6.045888	0.0000
C	0.177553	0.148203	1.198038	0.2390
R-squared	0.639383	Mean dependent var		0.033533
Adjusted R-squared	0.618776	S.D. dependent var		1.039656
S.E. of regression	0.641918	Akaike info criterion		2.026945
Sum squared resid	14.42206	Schwarz criterion		2.156228
Log likelihood	-35.51195	Hannan-Quinn criter.		2.072943
F-statistic	31.02791	Durbin-Watson stat		1.889384
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi : Autori (2017).

Figura Nr. 10 - Testi i stacionaritetit për serinë RKK (Rreziku i Kursit të Këmbimit)

Null Hypothesis: RKK has a unit root
 Exogenous: Constant
 Lag Length: 0 (Automatic based on SIC, MAXLAG=9)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-0.885276	0.7824
Test critical values:		
1% level	-3.610453	
5% level	-2.938987	
10% level	-2.607932	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
 Dependent Variable: D(RKK)
 Method: Least Squares
 Date: 11/14/17 Time: 17:49
 Sample (adjusted): 2006Q2 2015Q4
 Included observations: 39 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
RKK(-1)	-0.089455	0.101048	-0.885276	0.3817

C	645.2891	519.9675	1.241018	0.2224
R-squared	0.020742	Mean dependent var	308.5328	
Adjusted R-squared	-0.005724	S.D. dependent var	2207.490	
S.E. of regression	2213.799	Akaike info criterion	18.29273	
Sum squared resid	1.81E+08	Schwarz criterion	18.37804	
Log likelihood	-354.7082	Hannan-Quinn criter.	18.32334	
F-statistic	0.783713	Durbin-Watson stat	2.442918	
Prob(F-statistic)	0.381725			

Burimi : Autori (2017).

2- Analiza e regresionit:

Figura Nr. 11 – Analiza e regresionit të shumëfishtë linear


Dependent Variable: ROE
Method: Least Squares
Date: 11/08/17 Time: 14:01
Sample: 2006Q1 2015Q4
Included observations: 40

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	14.01315	3.454602	4.056373	0.0003
RK	-1.093620	0.774848	-1.411405	0.0158
RNI	-0.300790	0.551881	-0.545027	0.5891
RL	-0.819490	0.478582	-1.712338	0.0445
R-squared	0.451734	Mean dependent var	2.809698	
Adjusted R-squared	0.406045	S.D. dependent var	2.047259	
S.E. of regression	1.767795	Akaike info criterion	4.071982	
Sum squared resid	112.5035	Schwarz criterion	4.240870	
Log likelihood	-77.43964	Hannan-Quinn criter.	4.133047	
F-statistic	5.435130	Durbin-Watson stat	1.517779	
Prob(F-statistic)	0.003458			

Burimi : Autori (2017).

3- Supozimet e modelit :

Figura Nr. 12 – Supozimi për shpërndarjen normale të mbetjeve



Burimi : Autori (2017).

Figura Nr. 13 – Supozimi për korrelacionin e rendeve të larta

Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test:

F-statistic	0.308853	Prob. F(2,34)	0.7363
Obs*R-squared	0.713747	Prob. Chi-Square(2)	0.6999

Test Equation:

Dependent Variable: RESID

Method: Least Squares

Date: 11/08/17 Time: 14:06

Sample: 2006Q1 2015Q4

Included observations: 40

Presample missing value lagged residuals set to zero.

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	0.342913	3.570205	0.096049	0.9240
RK	0.003316	0.080255	0.041313	0.9673
RNI	-0.093060	0.582148	-0.159855	0.8739
RL	-0.022795	0.587205	-0.038819	0.9693
RESID(-1)	0.156074	0.201190	0.775756	0.4433
RESID(-2)	0.024161	0.204815	0.117964	0.9068

R-squared	0.017844	Mean dependent var	2.42E-15
Adjusted R-squared	-0.126591	S.D. dependent var	1.698442
S.E. of regression	1.802743	Akaike info criterion	4.153977

Sum squared resid	110.4960	Schwarz criterion	4.407309
Log likelihood	-77.07955	Hannan-Quinn criter.	4.245574
F-statistic	0.123541	Durbin-Watson stat	1.765392
Prob(F-statistic)	0.986164		

Burimi : Autori (2017).

Figura Nr. 14 – Supozimi për homoskedasticitetin

Heteroskedasticity Test: Breusch-Pagan-Godfrey

F-statistic	1.195701	Prob. F(3,36)	0.3252
Obs*R-squared	3.624516	Prob. Chi-Square(3)	0.3050
Scaled explained SS	5.940994	Prob. Chi-Square(3)	0.1145

Test Equation:

Dependent Variable: RESID^2

Method: Least Squares

Date: 11/08/17 Time: 14:07

Sample: 2006Q1 2015Q4

Included observations: 40

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	-0.656128	11.11482	-0.059032	0.9533
RK	-0.326003	0.252828	-1.289424	0.2055
RNI	-1.577972	1.775620	-0.888688	0.3801
RL	2.833786	1.849513	1.532180	0.1342
R-squared	0.090613	Mean dependent var		2.812588
Adjusted R-squared	0.014831	S.D. dependent var		5.730345
S.E. of regression	5.687694	Akaike info criterion		6.409126
Sum squared resid	1164.595	Schwarz criterion		6.578014
Log likelihood	-124.1825	Hannan-Quinn criter.		6.470191
F-statistic	1.195701	Durbin-Watson stat		1.428761
Prob(F-statistic)	0.325197			

Burimi : Autori (2017).

Figura Nr. 15 – Supozimi për përshtatshmërinë e formës funksionale

Ramsey RESET Test:

F-statistic	0.970039	Prob. F(1,35)	0.3314
Log likelihood ratio	1.093531	Prob. Chi-Square(1)	0.2957

Test Equation:

Dependent Variable: ROE

Method: Least Squares

Date: 11/14/17 Time: 17:51

Sample: 2006Q1 2015Q4

Included observations: 40

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	31.60752	18.19526	1.737130	0.0912
RK	-0.154301	0.127438	-1.210795	0.2341
RL	-2.176854	1.393873	-1.561731	0.1273
RNI	-0.573423	0.617617	-0.928444	0.3595
FITTED^2	-0.204786	0.207924	-0.984905	0.3314

R-squared	0.330296	Mean dependent var	2.809698
Adjusted R-squared	0.253758	S.D. dependent var	2.047259
S.E. of regression	1.768531	Akaike info criterion	4.094644
Sum squared resid	109.4695	Schwarz criterion	4.305754
Log likelihood	-76.89288	Hannan-Quinn criter.	4.170974
F-statistic	4.315464	Durbin-Watson stat	1.552236
Prob(F-statistic)	0.006084		

Burimi : Autori (2017).